Për më tepër bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Neni 113.2 dhe Neni 133.4) Avokati i Popullit ka të drejtë për t'iu referuar përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën në Gjykatën Kushtetuese.

Avokati i Popullit, gjatë periudhës dhe prej themelimit të Gjykatës Kushtetuese (Janar 2009) e deri me tani, ka marrë dhjetëra kërkesa për çështje të ndryshme për referim në Gjykatën Kushtetuese.

Pas shqyrtimi të këtyre kërkesave, Avokati i Popullit ka proceduar një total prej 3 aplikacioneve në Gjykatën Kushtetuese.

- A janë të decentralizuara zyrat e Avokatit të Popullit?

Me qëllim që të lehtësoj qasjen e qytetarëve të Kosovës tek Avokati i Popullit, me përjashtim të Zyrës Qendrore (Selia qendrore) e Avokatit të Popullit në Prishtinë, ka edhe zyrat e themeluara në Gjilan, Pejë, Mitrovicë, Prizren dhe Graçanic. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka themeluar një zyrë nën-rajonale në veriun e Mitrovicës, e cila ka funksionuar që nga viti 2000.

Rregullorja e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, Kapitulli III [Procedimi], Neni 23 (Pranimi i Ankesave) parasheh që zyrat rajonale mund të pranojnë ankesa dhe për të proceduar këto ankesa për regjistrim në zyrën qendrore në Prishtinë.

Takimet me qytetar organizohen çdo ditë pune në selinë qendrore të Avokatit të Popullit në Prishtinë dhe në të gjitha zyrat rajonale. Qytetarët gjithashtu mund të caktojnë një takim me Avokatin e Popullit (ose me deputetët e tij) duke kontraktuar zyrën më të afërt të Institucionit të Avokatit të Popullit ose një nga deputetët e tij/saj në zyrën qendrore në Prishtinë dhe një herë në muaj zyrat rajonale në Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Graçanicë.

- Ju lutem jepni të dhëna konkrete në lidhje me ankesat e Avokatit të Popullit dhe si ato përcillen në këto vitet e fundit. Ju lutem jepni të dhëna në lidhje se si Qeveria merr rekomandimet e bordit të organeve përgjegjëse të kontrollit administrativ. Ju lutem jepni një tabelë të detajuar që tregon aktivitetin e Avokatit të Popullit që nga viti 2008 (numri i ankesave të marra, numri rekomandimeve, numri i rekomandimeve të ndjekura).

Lidhura me numrin e parashtrësive të pranuara, ka rritje prej 17% në numrin e ankesave gjatë vitit 2011 në krahasim me vitin 2010; krahasuar me numrin e ankesave nga Janari i vitit 2011 aty ka një rritje prej 15% e numrit të ankesave. Gjatë vitit 2011 ka pasur edhe një rritje në rastet e mbyllura pozitivisht duke arritur në 60%.

Sa i përket viteve të mëparshme përqindja e numrit më të madhe e ankesave është, Gjyqësori (31%), Qeveria (23%), Komunat (17%) etj.

Numri i ankesave të pranuara, numrin e rasteve të papranueshme (raste që pas shqyrtimit të ankesave janë deklaruar të papranueshme), numri i rasteve të hapura (rastet që janë hetuar dhe veprimet që janë marrë) dhe numri i rekomandimeve dhe raporteve nga vitit 2008 gjer në vitin 2011:

Tabela 6: Ankesat e pranuara, rastet e papranueshme, rastet e hapura (hetohen), Raportet dhe rekomandimet (Specifike)

Viti	2011	2010	2009	2008
Ankesat e pranuara	1453	1233	1318	1277
Rastet e papranueshme	907	819	800	780
Rastet e hapura (hetohen)	546	414	518	497
Raportet dhe rekomandimet (Specifike)	11	22	5	16

- Ju lutem specifikoni numrin e veprimeve të ndërmarra zyrtarisht nga ana e Avokatit të popullit.

Avokati i Popullit pushtet për të hapur zyrtarisht hetimet për akuzat për shkeljen e të drejtave të njeriut pa ankesë individuale. Neni 15.3 i Ligjit nr. 03/L-195 mbi Avokatin e Popullit ofron si në vijim: "Avokati i Popullit pushtet të hetojë për t'iu përgjigjur ankesës ose me iniciativën e vet (zyrtare), nëse nga gjetjet, dëshmitë dhe provat e paraqitura nga paraqitja apo nga njohurit e fituara në ndonjë mënyrë tjetër, ekziston një bazë dhe kjo rezulton se Institucionet e Republikës së Kosovës kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut." Në total prej 97 veprime janë ndërmarr me procedurë zyrtare (Ex-officio) në mes periudhës 2008-2012.

-Çfarë sisteme ekzistojnë për të monitoruar zbatimin e politikave dhe ligjeve dhe për të marrë informata kthyese? A ka inspektim të administratës publike dhe si funksionon ajo? (Në sistemet e monitorimit dhe zbatimit të politikave dhe ligjeve, ju lutem referohuni në pyetjen "Çfarë sisteme ekzistojnë për të monitoruar zbatimin e politikave dhe ligjeve dhe për të marrë informata kthyese?")

Sa i përket inspektimit të administratës publike, kapitulli VII i Ligjit mbi Administratën Publike përcakton se mbikëqyrja e administratës publike i takon. Më konkretisht, Neni 63 i Ligjit përcakton se mbikëqyrja e ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë së aktiviteteve administrative të organit përkatës administrativ që ushtrohen nga organi i lartë administrativ brenda Qeverisë. Gjithashtu, artikulli i njëjtë përcakton se për organet qeveritare administrative të MAP-së është i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave të menaxhimit dhe procedurave të brendshme. Gjithashtu, në lidhje me zbatimin e rekrutimit, promovimin dhe shkarkimin e procedurave brenda shërbimit civil, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës mund të ushtrojë inspektime në përputhje me Ligjin 03/L-192, duke themeluar institucionin e tillë.

Me qëllim të mbikëqyrjes së organeve të pavarura, Ligji për Administratë Shtetërore përcakton nevojën për krijimin e organeve të pavarur mbikëqyrës përmes Ligjit të ri, i cili mbetet për t'u zhvilluar.

Sa i përket komunave, mbikëqyrja bëhet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me Ligjin 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

Kjo vlen të përmendet se plani i veprimit i miratuar kohët e fundit për zbatimin e strategjisë së reformës së administratës publike, parasheh zhvillimin e një mekanizmi të qartë ligjor dhe institucional për inspektim brenda administratës publike (Neni 9.1.3), ndërsa përgatitjet janë në procedim e sipër sa i përket zhvillimit të aktit nën-ligjor përkatës në pajtim me ligjin mbi Administratën Shtetërore.

Megjithatë, siç përkrahë në përgjigjen e pyetjes "*Cilat janë procedurat që garantojnë të drejtat e qytetarëve për ankim kundër veprimeve të shërbimeve publike? Përshkruani këto (p.sh. komisionet parlamentare, zyra e avokatit të popullit, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm, inspektoratet, autoritetet për vendosjen e standardeve). Deri në çfarë shkalle janë formuluar rekomandimet nga këto organe (veçanërisht zyra e Avokatit të Popullit) të marra në konsideratë nga Qeveria? Ju lutem siguroni të dhëna konkrete. A ekziston gjykata e veçantë administrative?)", ekziston një numër i mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm, qëllimi i të cilëve është për të siguruar përgjegjshmërinë nga ana e organeve të administratës publike.*

- Çfarë është bërë për të siguruar që shërbimi publik është i hapur dhe transparent? A mundet çdo qytetar i prekur nga një veprim administrativ të gjen bazën për veprim?

Ligji nr. 03/L-215 mbi Qasjen në Dokumente Publike dhe rregullore që janë lëshuar në mënyrë që të zbatohen këtë Ligj, Rregullorja nr. 04/2012 mbi Provat Zyrtare të Kërkesave për qasje në dokumente publike të Qeverisë paraqesin bazën kryesore për të ofruar një shërbim publik të hapur dhe transparent, e drejta e çdo personi fizik ose juridik, pa diskriminim në çfarëdo baze, të kenë qasje, sipas kërkesës, dokumenteve zyrtare të mbajtura, përgatitura ose të marra nga institucioni publik.

Në lidhje me të drejtën e qasjes në dokumente zyrtare të Ligjit nr. 03/L-215 mbi Qasjen në Dokumente Publike Neni 4 (E drejta e qasjes në dokumente) ofron: 'Çdo aplikant i dokumentit të ketë të drejtën në qasje të dokumenteve të institucioneve publike, në përputhje me parimet, kushtet dhe kufizimet e përcaktuara sipas Ligjit'.

Rregullorja nr. 03/2011 mbi Shërbimin e Komunikimit Publik të Qeverisë përcakton detyrat dhe përgjegjësit e zyrave të komunikimit publik në mënyrë që të garantojnë transparencën e administratës publike.

Ligji nr. 03/L-215 Qasjen në Dokumente Publike Neni 10 (Dështimin nga ana e institucioneve publike të përgjigjen) përcakton se refuzimi i kërkesës së aplikantit si dhe dështimi nga ana e autoritetit publik të përgjigjen brenda afatit të caktuar kohor do të konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtën parashtresit që të nisë procedurë para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucionet tjera publike, gjykatës kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi.

Aktet nën-ligjore që janë të miratuar për zbatimin e Ligjit nr. 03/L-215 mbi Qasjen në Dokumente Publike përmban anekse të publikuara në ueb faqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit me qëllim të krijimit të një sistemi më të lehtë për qasje në dokumente publike nga qytetarët.

Institucionet kanë zhvilluar sistem transparent të shërbimeve që ofrojnë mundësi për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike dhe për të marrë një përgjigje brenda 7 ditëve, siç kërkohet me Ligjin mbi Qasjen në Dokumente Publike.

Që nga viti 2008, të gjitha takimet e Qeverisë janë plotësisht të hapura për media. Takimet e kabinetit janë regjistruar dhe transmetuar në sallën e shtypit në ndërtesën e qeverisë, ku gazetaret mund të marrin regjistrimet e takimeve në audio dhe video. Të gjitha vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës janë të publikuara në faqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit. Përveç lajmeve dhe komunikimit në lidhje me aktivitetet e kryeministrit dhe zëvendëskryeministrave, gjithashtu portali publikon edhe të gjitha shpalljet e konkursit, njoftime të ndryshme të prokurimit, udhëzimet administrative, rregulloret projektligjet e miratuara nga Qeveria dhe urdhëresat administrative.

Kjo e drejtë i jepet të gjithë të interesuarve pavarësisht profilit të tyre të punës. Çdo institucion është e nevojshme që të ketë zyrtarin ose njësinë për trajtimin të kërkesave për qasje në dokumente publike.

Që nga vitit i kaluar, institucionet publike kanë përmirësuar paraqitjen e kërkesave zyrtare për qasje në dokumente publike. Për herë të parë këtë vit Qeveria ka dërguar në kuvend një raport të plot për të drejtën e qasjes në dokumente publike, të cilat u botuan më vonë.

Edhe pse ka ende punë për t'u bërë për të përmirësuar këtë sistem, Zyra e Komunikimit Publik në Zyrën e Kryeministrit rregullisht mbikëqyr zbatimin e këtij Ligji, bën rekomandime për të gjitha institucionet, duke i kërkuar nga ato për më shumë transparencë dhe që i mundëson zyrtarëve pjesëmarrjen në takime të ndryshme dhe synojnë ngritjen e kapaciteteve.

Për më tepër, komunat kanë miratuar rregulloret për transparencë, në përputhje me Nenin 68 (Informimi Publik dhe Konsultimet) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe duke themeluar zyrat pritëse për qytetarë, ofrimin e shërbimeve lidhur me kërkesën e institucioneve komunale.

- Cilat janë procedurat që garantojnë të drejtat e qytetarëve për ankim kundër veprimeve të shërbimeve publike? Përshkruani këto (p.sh. komisionet parlamentare, zyra e avokatit të

popullit, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm, inspektoratet, autoritetet për vendosjen e standardeve). Deri në çfarë shkalle janë formuluar rekomandimet nga këto organe (veçanërisht zyra e Avokatit të Popullit) të marra në konsideratë nga Qeveria? Ju lutem siguroni të dhëna konkrete. A ekziston gjykata e veçantë administrative?)

Neni 32 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh që 'Çdo person ka të drejtën mbrojtjen juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative që shkelin të drejtat apo interesat e tij/saj, në mënyrë e përcaktuar me Ligj'.

Neni 127 i Ligjit 02/L-28 mbi Procedurën Administrative përcakton se çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit të paligjshëm për të nxjerr një akt administrativ dhe se organi administrativ i ankesave i drejtohet që do të shqyrtoj ligjshmërinë dhe pajtueshmërinë e aktit të kontestuar'.

Nëse, pas marrjes së përgjigjes nga organi më i lartë administrativ, personi ende nuk është i kënaqur me rezultatin, ai/ajo mund të kthehet në gjykata, në mënyrë që të filloj një kontest administrativ.

Nga ana tjetër, në Republikën e Kosovës ka struktura në fuqi për mbikëqyrjen e veprimtarisë së administratës publike, përgjegjëse për të kontrolluar ligjshmërinë e akteve të nxjerra nga organet administrative.

Komisionet Parlamentare janë themeluar nga Kuvendi, dhe paraqesin një instrument të rëndësishëm me synim për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve të marra nga organet administrative. Një strukturë e tillë është Komiteti i Përhershëm për të Drejtat e Njeriut, Barazia Gjinore, Personat e Pagjetur dhe peticioni brenda kuvendit, i cili merret me të gjitha çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut, dhe ai gjithashtu mund të pranojë ankesa të drejtpërdrejta nga personat juridik dhe fizik të pakënaqur nga veprimet e organeve të administratës publike, kryesisht përmes peticionit. Duke marr parasysh autoritetin e komitetit të inicioj ligjet dhe të mbikëqyr zbatimin e legjislacionit nga ana e ekzekutivit, kjo mund të ndërhyjë në zbatimin e tij, kryesisht nëpërmjet rekomandimeve.

Për më tepër, Ligji 03/L-195 për Institucionin e Avokatit të Popullit 'çdo person, i cili pretendon se liria e tij ose e saj ose u janë shkelur të drejtat nga Ligji, veprimi ose dështimi për të vepruar, keq menaxhimi nga ana e organeve të autoriteti publik, organet tjera ose organizatat që ushtrojnë autoritet publik, mund të kërkoj që institucioni i Avokatit të Popullit inicion procedurën e nevojshme'. Për veç kësaj në bazë të Nenit 16, të gjitha organet e administratës publike janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe të sigurojë qasje në dokumente.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka të drejtë të kryejë hetime zyrtare (ex officio), të dal me raporte dhe do të ofrojë këshilla dhe shërbime ligjore për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Nëse Avokatit i Popullit konstaton se një praktik e caktuar ose situatë që ka një efekt mbi publikun e gjerë dhe që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ai/ajo mund të lëshoj një raport të veçantë për rekomandime drejtuar Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Përveç mekanizmave të përmendur, Ligji 03/L-128 për Auditim të Brendshëm, është bazë për themelimin e Njesisë Qendrore Harmonizuese për Auditimi të Brendshëm, përgjegjës i drejtpërdrejt është Ministria e Financave dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm në të gjitha organet e administratës publike (Neni 7 - 10). Funkcioni i mekanizmave të konsiston në kryerjen e auditimit të brendshëm, ndër të tjera, përputhshmëria me ligjet, rregulloret, rregullat e brendshme dhe kontratat.

Përveç kësaj, Ligji 03/L-075 i Auditorit të Përgjithshëm siguron funksionimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, si një organ i pavarur, përgjegjës për të kryer:

- a. Raporti vjetor i rregullsisë si vërtetim i përgjegjësive financiare që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe shprehjen e opinioneve mbi, ndër të tjerash, korrektësinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të ndërmarra brenda institucionit apo subjektit të audituar;
- b. Auditimi i Performancës në çdo kohë në të organet e administratës publike si një auditim i mënyrës ekonomike, efikasiteti dhe efektiviteti me të cilin institucioni apo subjekti i auditimit përdor dhe i menaxhon resurset e saj në kryerjen e përgjegjësive të saj.

Sa i përket gjykatave administrative, Ligji 03/L-199 për Gjykatat, përcakton krijimin e mekanizmave të tillë, pasi që Ligji të hyn në fuqi në Janar të vitit 2013. Aktualisht, funksioni i gjykatave administrative është kryer nga ana e Kolegjjumit Special për çështje administrative, e cila është pjese e Gjykatës Supreme

1.1.4. Reformat e Sektorit të Sigurisë

- Ju lutem ofroni informata për statusin dhe strukturën e forcave të sigurisë, atyre civile dhe ushtarake, dhe kompetencat e tyre përkatëse lidhur me sigurinë e brendshme. Cilët janë mekanizmat e kontrollit dhe si zbatohen? Ju lutem përfshini informata për burimet njerëzore.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës rregullon forcat kryesore të sigurisë duke siguruar kontrollin civil dhe demokratik të institucioneve të sigurisë (Kapitulli XI i Kushtetutës). Në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin Nr. 03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Ligjin Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Kuvendi, Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Forcës së Sigurisë përbëjnë zinxhirin e mbikëqyrjes civile të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Komandanti i FSK-së i përgjigjet Ministrin të FSK-së, ndërsa Kryeministri ka kompetencë të ushtrojë mbikëqyrje efektive dhe kontroll të Forcës së Sigurisë përmes Ministrin të FSK-së. Presidenti i Republikës së Kosovës është Komandanti Suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Mbikëqyrja demokratike e Forcës së Sigurisë sigurohet përmes Komitetit Parlamentar për Çështje të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës (neni 4 i Ligjit Nr. 03/L-045; neni 4 i Ligjit Nr. 03/L-046).

Bazuar në ligjet përkatëse, FSK-ja është e autorizuar të shërbejë brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe mund të dërgohet jashtë për operacione vetëm kur mandatohet nga Kuvendi dhe në pajtim me vendin pranues, ose sipas ftesës së organizatave ndërkombëtare. Sipas Nenit 10 "Misionet dhe Detyrat", të Ligjit për FSK-në, parasheh se detyrat e Forcës së Sigurisë së Kosovës janë: të marrë pjesë në operacione-përgjigje ndaj krizave, përfshirë operacionet e përkrahjes paqësore, kjo do të përfshijë operacionet jashtë territorit të Republikës së Kosovës kur ftohet të veprojë kështu; t'i ndihmojë autoritetet civile për t'u përgjigjur fatkeqësive apo emergjencave natyrore apo tjera, të përfshirë si pjesë e përpjekjes së reagimit rajonal apo ndërkombëtar; të kryejë shpërthime të kontrolluara artilerike; t'i ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile.

Ligji për FSK-në siguron paanësinë politike the integritetin, neni 11 i Ligjit parasheh se FSK-ja nuk mund të përdoret për qëllime politike ose aktivitete politike. Misioni i FSK-së, si instrument i sigurisë, është të mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Forca e Sigurisë së Kosovës përbëhet nga komponenta aktive me personel maksimum prej 2500 vetash dhe komponenta rezervë me personel maksimum prej 800 vetash. FSK-ja fillimisht përbëhet nga Komanda e Forcës Tokësore e përbërë prej personelit të uniformuar prej 245 vetash, Brigadës së Reagimit të Shpejtë me personel të uniformuar prej 1122 vetash, Brigada Mbështetëse e Operacioneve me personel të unifromuar prej 808 vetash, dhe Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës me personel prej 192 vetash.

Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë rregullon autorizimet, detyrat dhe organizimin si dhe çështje tjera të ndërlidhura me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Kosovës. Policia e Kosovës funksionon nën autoritetin e Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Në pajtim me Kushtetutën, Kryeministri, sipas rekomandimit të Qeverisë, ka autoritetin të emërojë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë. Mbikëqyrja demokratike e Policisë së Kosovës sigurohet përmes Komitetit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Policia e Kosovës ka pushtet dhe detyrë të mbrojtë jetën e njerëzve, pronën dhe sigurinë e tyre, të ruajë rendin dhe sigurinë publike, të hetojë, të zbulojë dhe parandalojë aktet kriminale dhe veprat penale, të mbikëqyrë dhe kontrollojë sigurinë e trafikut, ta menaxhojë dhe kontrollojë kufirin shtetëror, dhe të ofrojë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe emergjencave tjera.

Policia e Kosovës është e organizuar në nivel qendror dhe lokal. Drejtoria e Përgjithshëm e Policisë përbën nivelin qendror, ndërsa drejtorit rajonale, stacionet e policisë, dhe nën-stacionet e policisë, përbëjnë nivelin lokal. Policia e Kosovës përbëhet prej personelit me numër të përgjithshëm prej 8436, nga të cilët 7294 janë të uniformuar dhe 1142 janë personel civil.

Agjencioni Kosovar i Inteligjencës (tutje AKI) është themeluar me Ligjin Nr. 03/L-063 për Agjencionin e Kosovës për Inteligjencë. Neni themelues për themelimin dhe kompetencat kyçe po ashtu reflektohen brenda nenit 129 të Kushtetutës.

AKI është themeluar si Agjencion i sigurisë dhe inteligjencës përgjegjës për zbulim, vlerësim, hetim dhe mbikëqyrje të kërcënimeve ndaj sovranitetit të Kosovës, integritetit territorial, stabilitetit shoqëror-politik, krimit të organizuar, terrorizmit dhe kërcënimeve tjera të brendshme ose të jashtme. Udhëhequr nga Kushtetuta, Ligji i saj i veçantë për institucionin e inteligjencës, AKI-ja është institucion inteligjence profesionale, e paanshme politikisht, dhe shumetnike e mbikëqyrur nga organi parlamentar. Mandati i organit mbikëqyrës përcaktohet nga Ligji për AKI-në. Ndërveprimet mes AKI-së dhe organi mbikëqyrës janë të mbyllura për publikun përderisa nuk përcaktohet ndryshe nga Kryesuesi i organit. Drejtori i AKI-së i raporton organit mbikëqyrës parlamentar, bazuar në kërkesat e këtij të fundit, lidhur me aktivitetet e AKI-së. Gjatë vitit 2011 kanë qenë gjashtë takime raportuese nga Drejtori dhe Inspektori i Përgjithshëm i AKI-së si dhe gjatë vitit 2012 vazhdon me të njëjtën dinamikë. AKI-ja menaxhohet nga Drejtori i Agjencisë e që ndihmohet nga Zëvendës-Drejtori. Procedura e emërimit të Drejtorit, Zëvendës-Drejtorit dhe Inspektorit të Përgjithshëm rregullohet nga Ligji për AKI-në dhe reflekton pajtimin e përbashkët ndërmjet Kryeministrit dhe Presidentit të Republikës. Përgjegjësitë e tyre parashihen në Ligjin për AKI-në, Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Ligje tjera të aplikueshme. Drejtori i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryeministrit të Kosovës.

Inspektori i Përgjithshëm i AKI-së i raporton drejtpërdrejtë Kryeministrit dhe çdo 6 muaj organit mbikëqyrës parlamentar. Përgjegjësitë kryesore të Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm parashihen brenda Ligjit për AKI-në dhe Rregulloren e brendshme për masat disiplinore në AKI. Inspektori i Përgjithshëm është përgjegjës të inspektojë aktivitetet e AKI-së dhe përmes rekomandimeve e komenteve ta ndihmojë Drejtorin e AKI-së lidhur me problemet e mundshme të identifikuara në aktivitetet e AKI-së. Në përgjithësi, Inspektori i Përgjithshëm i AKI-së fillon inspektime, auditime dhe hetime, duke hetuar ankesat lidhur me aktivitetet e AKI-së ose të kryera nga personat në Kosovë.

AKI-ja ka prioritete strategjike që janë paraparë brenda Platformave të Politikave Vjetore të Sigurisë së Inteligjencës e cila përmban udhëzime të përgjithshme për punën e AKI-së. Platforma e Politikave

Vjetore të Sigurisë së Inteligjencës është dokument që ka nevojë të aprovohet nga Qeveria e Kosovës në baza vjetore.

AKI-ja gjatë përmbushjes së mandatit të saj gjithmonë vepron në pajtim me të drejtat njerëzore, të drejtat e komuniteteve tjera dhe gjithmonë respekton të drejtat e qytetarëve pa diskriminim në bazë të seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, përkatësisë kombëtare, të pakicës, pronës ose statusit tjetër.

Ajo i respekton parimet dhe kryen aktivitete në pajtim me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale, dhe parime tjera të rëndësishme që reflektohen në instrumente juridike të njohura ndërkombëtarisht.

AKI-ja nuk ka funksione ekzekutive dhe nuk ka të drejtë të përdorë forcë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Nuk ka pushtet për arrestim dhe, bazuar në kornizën ligjore, struktura e saj operative nuk ka mundësi të nisë procedime penale dhe nuk ka pushtet t'i detyrojë personat ose kompanitë të bashkëpunojnë bazuar në kërkesat e AKI-së. Qytetarët dhe kompanitë mund të bashkëpunojnë me AKI-në vetëm në bazë vullnetare.

AKI-ja nuk mbledhë inteligjencë duke përdorur mekanizma dhe metoda të fshehta lidhur me palët e treta që gëzojnë imunitete dhe privilegje diplomatike të cilat janë paraparë me ligjet përkatëse të Kosovës, përveç me qëllim të parandalimit të kërcënimeve ndaj organizatave ose trupave të tillë.

AKI-ja bashkëpunon me institucione tjera të sigurisë të Qeverisë së Kosovës me qëllim të mbrojtjes së zyrtarëve, objekteve dhe informatave të AKI-së. AKI-ja mund të ofrojë mbështetje të inteligjencës, përfshirë ndihmë ekspertësh, për institucione tjera qeveritare që është e nevojshme për sigurinë e Kosovës.

Individët, institucionet dhe palët e treta kanë të drejtë ankese kundër AKI-së. Ankesat mund të adresohen tek Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë (IOK). AKI-ja është e autorizuar të mbledhë informata, t'i ruajë dhe t'i shpërndajë për qëllime të ligjshme qeveritare, aktivitetet i cili është i rregulluar nga procedura strikte në pajtim me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, dhe nevojës, dhe vetëm për përparimin e sigurisë shtetërore. Të gjitha informatat e mbledhura në këtë mënyrë, klasifikohen në mënyrën që Drejtori i AKI-së e sheh të nevojshme dhe në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm përkatës për mbrojtjen dhe klasifikimin e informatave.

Drejtori i AKI-së ose i caktuari i tij miratojnë shpërndarjen e informatave, siç është e përshtatshme, tek institucionet tjera qeveritare të rezultateve të analizave të AKI-së me kohë dhe në pajtim me mbrojtjen e informatave të klasifikuara.

Mbrojtja e sekretit, mbledhja e informatave dhe mbrojtja e burimeve janë elemente që personifikojnë punën e institucioneve të inteligjencës. AKI-ja do të vazhdojë ta përmbushë mandatin e saj bazuar në këto parime, Kushtetutën dhe ligjin pozitiv.

Informatat lidhur me numrin e të punësuarve dhe strukturën e saj të brendshme duhet të trajtohen si informata konfidenciale, bazuar në rregulloret e brendshme dhe aktet tjera juridike të AKI-së.

1.1.5. Sistemi gjyqësor

- Ju lutem ofroni pasqyrën e sistemi gjyqësor (përfshirë kornizën organizative të sistemit gjyqësor, si dhe institucionet gjyqësore), e që po ashtu mbulon burimet njerëzore dhe financiare

(përfshirë gjyqtarët, prokurorët por edhe stafin civil), kompetencat dhe detyrat, procedurat e përzgjedhjes, reformat e kaluara dhe të planifikuara, trajnimet, infrastrukturën.

Sistemi gjyqësor i Kosovës është i rregulluar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Kapitulli 7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës) dhe nga ligje tjera përkatëse (Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat dhe Ligji Nr. 03/L-233 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës).

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Gjykatat theksojnë se pushteti gjyqësor i takon gjykatave, ndërsa Kushtetuta mandaton Gjykatën Supreme si autoritetin më të lartë gjyqësor që ka juridiksion territorial mbi tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjykata Supreme përfshinë Panelin e Ankesave të Agjencisë së Pronave të Kosovës dhe Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e së cilës janë pjesë e asaj Supreme. Sipas Kushtetutës gjykatat e specializuara mund të themelohen me Ligj kur është e nevojshme, por gjykata të jashtëzakonshme nuk mund të krijohen kurrë. Kryetari i Gjykatës Supreme emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës për mandatat të papërsëritshëm prej 7 vjetësh.

Kushtetuta e përcakton Këshillin Gjyqësor të Kosovës (tutje KGJK) si organin përgjegjës për sigurimin e pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor përderisa reflekton plotësisht natyrën shumetnike të Kosovës dhe ndjekë parimet e barazisë gjinore. Në pajtim me Kushtetutën, sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Presidenti ka të drejtë t'i emërojë, riemërojë dhe shkarkojë gjyqtarët.

KGJK menaxhon në mënyrë të pavarur buxhetin vjetor të Këshillit dhe gjykatave dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e shpenzimeve, ndarjen e fondeve dhe mbajtjen e saktë dhe aktuale të llogarive dhe kryerjen e auditimeve financiare. Këshilli, siç parashihet me ligj, i propozon buxhetin drejtpërdrejtë Qeverisë. Sidoqoftë, nëse Ministri i Financave dërgon propozim-buxhetin për Këshillin dhe gjykatat që ndryshon nga ai i propozuar nga Këshilli, Ministri është i detyruar sipas ligjit që t'ia dërgoj për shqyrtim Kuvendit buxhetin e rekomanduar fillimisht nga Këshilli (neni 15 i Ligjit për KGJK-në). Buxheti vjetor për 2012 për gjyqësinë është 19.464.842 euro dhe sipas buxhetit të ndarë janë 392 pozita të caktuara për gjyqtarë, prej të cilave 252 pozita janë të zëna. KGJK-ja menaxhon 60 gjykata e përdorë 33 objekte nga të cilat 3 janë me qira.

Sistemi aktual gjyqësor i Kosovës përbëhet nga Gjykata Supreme e Kosovës, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje, Gjykata Ekonomike, 5 Gjykata të Qarkut, 26 Gjykata Komunale, dhe 25 Gjykata Komunale për Kundërvajtje. Sidoqoftë, me Ligjin për Gjykatat i cili hyn në fuqi në janar 2013, sistemi gjyqësor i Kosovës do të ristrukturohet dhe reformohet thelbësisht. Kapitulli 3 i Ligjit për Gjykatat thekson se sistemi gjyqësor i Kosovës do të përbëhet nga Gjykatat Themelore, Gjykatat e Apelit, dhe Gjykata Supreme, ndërsa do të themelohen degë brenda juridiksionit të Gjykatës Themelore. Brenda Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore, mund të themelohen Departamente dhe Divizione për veprime më efikase të gjykatës përkatëse. Sipas nenit 9 të Ligjit, Gjykatat Themelore do të jenë Gjykata të Shkallës së Parë. Do të themelohen 7 Gjykata Themelore në qendrat kryesore të Kosovës me degë që e mbulojnë tërë territorin e Kosovës; Gjykatat Themelore do të themelohen në Prishtinë, Gjiilan, Prizren, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, dhe Mitrovicë. Sipas nenit 12 të Ligjit brenda Gjykatave Themelore do të themelohen Departamente me qëllim të caktimit të rasteve sipas lëndëve. Do të jenë 5 Departamente: Departamenti për Çështje Ekonomike që vepron në Gjykatën Themelore të Prishtinës për tërë territorin e Republikës së Kosovës; Departamenti për Raste Administrative që vepron në Gjykatën Themelore të Prishtinës për tërë territorin e Kosovës; Departamenti për Krime të Rënda me qendër kryesore të secilës degë të Gjykatës Themelore; Departamenti i Përgjithshëm që vepron në secilën Gjykatë Themelore dhe në secilën degë të Gjykatës Themelore; dhe Departamenti i të Miturve që vepron brenda Gjykatave Themelore. Gjykata e Apelit do të themelohet si Gjykatë e Shkallës së Dytë me juridiksion territorial në tërë

territorin e Republikës së Kosovës dhe do të organizohet në Departamentin e Përgjithshëm, Departamentin e Krimeve të Rënda, Departamentin e Çështjeve Ekonomike, Departamentin e Çështjeve Administrative, dhe Departamentin e të Miturve.

Funksionet dhe përgjegjësitë e Prokurorisë Shtetërore dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës parashihen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, dhe Ligjin Nr. 03/L-225 për Prokurorinë Shtetërore, cili hyn në fuqi në janar 2013. Kushtetuta thekson se Prokuroria Shtetërore është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen e personave që akuzohen të kenë kryer vepra penale dhe vepra tjera të përcaktuara me ligj. Kryeprokurori Shtetëror emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, sipas propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit Shtetëror është 7 vjet pa të drejtë riemërimi.

KPK-ja ka mandat me ligj që të sigurojë pavarësinë, profesionalizmin, dhe paanësinë e sistemit të prokurorisë, që reflekton natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës si dhe parimet e njohura ndërkombëtarisht të barazisë gjinore. Ndër përgjegjësitë tjera që KPK-ja ka, janë edhe themelimi i komisioneve, paneleve, dhe zyrave kur konsiderohet e nevojshme. KPK-ja është e organizuar si më poshtë: Paneli Vlerësues për Emërimin e Prokurorëve; Paneli i Rishqyrtimit; Komisioni Disiplinor; Zyra Disiplinore e Prokurorisë; Njësia për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve.

Bazuar në legjislacionin aktual, Prokuroria Shtetërore organizohet si më poshtë: Prokuroria Shtetërore, Prokuroria e Veçantë, 5 Prokurori të Qarkut (Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren); dhe 7 Prokurori Komunale (Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren, Gjakovë, dhe Ferizaj). Sidoqoftë, sipas Ligjit për Prokurorinë Shtetërore, që hyn në fuqi në janar 2013, Prokuroria Shtetërore do të ristrukturohet në Prokurorinë Themelore e cila do të shërbejë si Prokurori e Shkallës së Parë, dhe Prokuroria e Apelit si Prokurori e Shkallës së Dytë. Prokuroria Themelore do të organizohet në Departamentin e Krimeve të Rënda, Departamentin e Çështjeve të Përgjithshme, dhe Departamentin e të Miturve. Do të jenë 7 Prokurori Themelore (Prishtinë, Gjilan, Prizren, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, dhe Mitrovicë). Prokuroria e Apelit do të organizohet në Departamentin e Krimeve të Rënda dhe Departamentin e Çështjeve të Përgjithshme.

KPK-ja, siç parashihet me ligj, përgatit buxhetin vjetor për Këshillin dhe Prokuroritë dhe ia dërgon Qeverisë. Nëse Ministri i Financave dërgon buxhetin për Këshillin dhe Prokuroritë të ndryshëm nga ai që është propozuar nga Këshilli, atëherë Ministri i Financave do t'ia dërgojë Kuvendit të Kosovës për shqyrtim buxhetin e rekomanduar fillimisht nga Këshilli. Buxheti i përgjithshëm për vitin 2012 për Prokurorinë Shtetërore është 5.187.409 euro. Në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-079 për Buxhetin, Prokuroria Shtetërore ka të parashikuara 524 pozita, 146 për prokurorë dhe 378 për stafin mbështetës. Nga 146 pozitat e parashikuara për prokurorë 105 janë të zëna, ndërsa 29 kandidatë janë në proces të riemërimit. Pritet të shpallen vendet e lira edhe për 12 pozita. Nga 378 pozitat e parapara për stafin mbështetës, 313 janë të zëna, 21 pozita janë aktualisht në proces të rekrutimit, ndërsa pritet që deri nga fundi i këtij viti do të zihen edhe 44 pozitat e mbetura.

Bazuar në Ligjin Nr. 02/L-25 për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, IGJK-ja organi kryesor i pavarur dhe profesional përgjegjës për ofrimin e trajnimeve për gjyqtarët dhe prokurorët, kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, gjyqtarët laikë, dhe profesionistë tjerë të identifikuar nga IGJK-ja. IGJK-ja vepron në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në për bashkërendimin e nevojave për trajnim profesional për gjyqtarët dhe prokurorët dhe për çështje tjera të ndërlidhura me sistemin gjyqësor. Rol i rëndësishëm që luhet nga IGJK-ja është edhe procesi i hartimit, vlerësimit dhe organizimit të provimit përgatitor për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, trajnimin e kandidatëve për Programin Arsimor Juridik Fillestar dhe në përgatitjen dhe ofrimin e kurseve trajnuese për promovimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

IGJK-ja financohet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës që miratohet nga Kuvendi. Sidoqoftë, të hyrat e IGJK-së mund të plotësohen nga donatorët dhe nga entitete tjera vendore ose ndërkombëtare. Buxheti vjetor për IGJK-në për vitin 2012 është 512,515 euro. IGJK-ja ka staf prej 22 vetash, përfshirë stafin menaxhues. IGJK-ja po ashtu i kryen aktivitetet e saj me ndihmën e gjyqtarëve, prokurorëve, juristëve dhe profesionistëve tjerë të angazhuar në cilësinë e trajnuesve të përkohshëm.

- Në të dhëna, ju lutem tregoni se si Kosova siguron pavarësinë, paanshmërinë, llogaridhënien dhe profesionalizmin e gjyqësisë, sipas ligjit dhe në praktikë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës siguron ndarjen e pushteteve ndërmjet legjislativit, ekzekutivit, dhe gjyqësorit. Kapitulli 7 i Kushtetutës përcakton pushtetin gjyqësor si unik, të pavarur, të drejtë, jopolitik, dhe paanshëm. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është organi përgjegjës, i mandatar me ligj, që të sigurojë pavarësinë dhe paanshërinë e gjykatave. KGJK-ja ka kompetencën dhe përgjegjësinë për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim të gjyqtarëve, përfshirë kandidatët që nuk janë shumicë në Kosovë, ndërsa i përcakton politikat, standardet dhe udhëzimet e ndërlidhura me trajnimin e gjyqtarëve. Presidenti i Republikës së Kosovës, sipas propozimit të KGJK-së, ka të drejtë të emërojë dhe riemërojë gjyqtarët.

Këshilli përbëhet nga 13 anëtarë, ndërsa Ligji ndalon anëtarësinë në Këshill të anëtarëve të Qeverisë, Kryetarëve të Komunave ose ndonjë anëtar të Kuvendit. Anëtarët e Këshillit zgjedhën nga gjyqtarët bashkëpunëtorë; sidoqoftë, shumica e gjyqtarëve zgjedhën nga Kuvendi, 8 zgjedhën nga Kuvendi dhe 5 anëtarë zgjedhën nga gjyqësia. Sipas propozimit dhe rekomandimit të KGJK-së, me amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe amendamentimin e Ligjit për Gjykatën, KGJK-ja do ta ketë pushtetin t'i emërojë dhe riemërojë shumicën e gjyqtarëve.

KGJK-ja, bazuar në Rregulloren për Vlerësimin e Performancës e cila vendos kushtet dhe rregullat e procedurës lidhur me vlerësimin e performancës së gjyqtarëve në të gjitha gjykatat, siguron llogaridhënien dhe profesionalizimin e gjyqtarëve. Rregullorja parimisht vendos kushtet e vlerësimit dhe burimet e informatave që do të përdoren gjatë vlerësimit të gjyqtarëve. Bazuar në nenin të Rregullores, gjyqtarët do të vlerësohen së paku çdo 18 muaj derisa të nxirret vendim për punësimin e tyre të përhershëm. Ndërsa vlerësimi i rregullt i gjyqtarëve me mandat të përhershëm do të kryhet çdo 2 vjet. Rregullorja parasheh themelimin e Komitetit Vlerësues i cili përbëhet nga 7 gjyqtarë, ndërsa Kryetari i Komitetit Vlerësues është gjyqtar i Gjykatës Supreme i emëruar nga KGJK-ja.

- Ju lutem ofroni informata për zbatimin e vendimeve gjyqësore, shkallën e sanksioneve që mund të zbatohen, dhe sistemin e burgjeve?

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore kryhet në bazë të Ligjit Nr. 03/L-008 për Procedurën Ekzekutive. Ligji ka rëndësi parësore pas nxjerrjes së dënimit përfundimtar dhe në fazën e zbatimit të dënimit. Ligji përcakton se gjatë procedurës ekzekutive gjykatat ka për detyrë që të veprojnë me urgjencë dhe ka për detyrë t'i pranojë rastet për procedim sipas rendit të ardhjes së propozimeve për ekzekutim, përveç nëse natyra e besimit ose rrethana tjera të veçanta kërkojnë që gjykatat të veprojnë ndryshe.

Kodi Penal përcakton sanksionet e mëposhtme penale: dënimet kryesore, dënimet alternative, dënimet plotësuese, dhe qortimin gjyqësor. Dënimet kryesore përfshijnë burgimin afatgjatë, dënimin me burgim, dënimin me gjobë. Masat alternative përfshijnë dënimin e pezulluar (me kusht) dhe gjysmë-lirinë. Kur shqiptohet dënimi i pezulluar, gjykatat po ashtu mund të shqiptojë urdhër për trajtim të detyruar rehabilitues, urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, dhe urdhër për punë në bashkësi. Dënimet plotësuese përfshijnë gjobat, privimin nga e drejta për t'u zgjedhur, ndalimin e

ushtrimit të profesionit, veprimtarisë, ose detyrës, ndalimin e ngasjes së automjetit, konfiskimin e objektit, urdhër për publikimin e Aktgjykimit, dhe dëbimin e të huajit nga territori i Kosovës. Qëllimi i qortimit gjyqësor është që t'ia tërheq vërejtjen kryesit kur qortimi është i mjaftueshëm që të arrihet qëllimi i dënimit.

Rregullorja Nr. 02/2012 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ofron bazën për Ministrinë e Drejtësisë në ushtrimin e mbikëqyrjes ekzekutive të Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues. Ministria është përgjegjëse për funksionimin më efektiv të sistemit të burgjeve në Kosovë.

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur Nr. 03/L-193, SHKK dhe SHSK janë organet e mandatuara për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe masave tjera që parashihen me ligj. Ligji parasheh që sanksionet penale dhe masat tjera ekzekutohen në mënyrë të atillë që janë në pajtim me parimet e të drejtave të njeriut dhe standardeve evropiane e ndërkombëtare.

Shërbimi Korrektues i Kosovës është autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e burimit dhe burimit afatgjatë. SHKK-ja ka staf administrativ dhe personelin e uniformuar e të armatosur përgjegjës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të burgimit dhe burgimit afatgjatë. SHKK-ja përbëhet nga 3 Qendra Korrektuese dhe 6 Qendra të Mbajtjes. Burgu i Sigurisë së Lartë, që është duke u ndërtuar, do ta rrisë nivelin e sigurisë në menaxhimin e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë.

Buxheti vjetor për vitin 2012 për SHKK-në është 15.080.911 euro; numri i stafit të SHKK-së është 1608 veta, nga të cilët 1257 janë staf të korrektimit, 236 staf administrativ dhe 115 personel mjekësor.

Shërbimi Sprovues i Kosovës është organi përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për të miturit dhe të rinjtë e dënuar me masa alternative. Vendimet gjyqësore që ekzekutohen nga SHSK-ja bazohen në Kodin Penal (nenet 41, 49, 50, 51, 52) dhe në dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur që i detajon masat alternative (nenet 8, 18, 23, 24, 31, 83, 84, 91, 94). Buxheti vjetor për vitin 2012 për SHSK-në është 384,751 euro; SHSK-ja ka 67 anëtarë të stafit.

- Ju lutem po ashtu të ofroni informata për kohëzgjatjen e procedurave dhe numrin e përgjithshëm të rasteve të pazgjidhura gjyqësore.

Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore varet nga rasti që trajtohet sipas procedurave gjyqësore, nuk ka dispozita të veçanta ligjore për ta përcaktuar kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore.

Numri i përgjithshëm i rasteve në gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës është 295.842, nga të cilat 82.805 raste janë zgjidhur, ndërsa numri i përgjithshëm i rasteve të pazgjidhura gjyqësore është 213.037.

- Ju lutem ofroni informata për bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndër-institucional?

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka marrë nismën kryesore dhe ka themeluar Komisionin për hartimin e strategjisë me qëllim të rritjes së bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet Prokurorisë, Gjykatave dhe agjencive tjera ligj-zbatuese në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Synimi i Planit Strategjik është që të identifikohen fushat e bashkëpunimit të ndërsjellë me qëllim të përmirësimit të mbajtjes së shënimeve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Projekt-Strategjia pritet të miratohet nga mesi i qershorit 2012.

Sa i përket bashkëpunimit ndërmjet KGJK-së dhe institucioneve tjera, KGJK-ja ka nënshkruar disa Memorandume Mirëkuptimi, si me Policinë e Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese-RrBGH, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave,

Administratën Tatimore të Kosovës, Institutin Gjyqësor, Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditim të Brendshëm.

Me qëllim të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë Shtetërore me agjencitë dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare, KPK-ja dhe Kryeprokurori Shtetëror ka nënshkruar MM-të e mëposhtme:

- a. MM ndërmjet Kryeprokurorit Shtetëror dhe EULEX-it për bashkëpunim;
- b. MM ndërmjet Kryeprokurorit Shtetëror, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave, për bashkërendim dhe mbështetje ndaj Njësisë Bashkërenduese të Kosovës për Zbatimin e së Drejtës Ndërkombëtare (NjBKZDN);
- c. MM ndërmjet Kryeprokurorit Shtetëror dhe Agjencionit të Kosovës për Inteligjencë;
- d. MM ndërmjet KPK-së dhe KGJK-së lidhur me Zyrën për Vlerësim dhe Verifikim Gjyqësor dhe Prokurorial;
- e. MM ndërmjet KPK-së dhe KGJK-së lidhur me transferimin e aseteve dhe personelit nga KGJK-ja tek KPK-ja;
- f. MM ndërmjet KPK-së dhe MD-së lidhur me transferimin e kompetencave nga MD-ja tek KPK-ja sa i përket personelit;
- g. MM ndërmjet KPK-së dhe RrBGH-së.

Prokuroria Shtetërore nënshkroi MM të dyanshme për bashkëpunim në shkëmbimin e informatave në luftimin e krimit të organizuar, krimet ndërshtetërore, trafikimin e qenieve njerëzore, me prokuroritë shtetërore të vendeve të mëposhtme si me: Kroacinë, Turqinë, Italinë, Francën, Shqipërinë, dhe Malin i Zi.

1.1.6. Lufta kundër korrupsionit

- Ju lutem ofroni pasqyrën e përpjekjeve të bëra për adresimin e praktikave korruptive. Ju lutem përfshini pasqyrën e institucioneve, autoriteteve, strukturave dhe mekanizmave dhe ofroni përshkrimin e fushëveprimit dhe detyrave të tyre përkatëse, si dhe skemat organizative, dhe pasqyrën e burimeve njerëzore dhe financiare.

Një nga përparësitë e institucioneve të Republikës së Kosovës është lufta kundër korrupsionit dhe praktikave korruptive. Qeveria ka krijuar kornizën e nevojshme të politikave dhe asaj ligjore kundër korrupsionit dhe ka themeluar institucionet e nevojshme me qëllim të zbatimit të legjislacionit dhe politikave kundër korrupsionit. Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit 2012-2016, Strategjia pritet të miratohet po ashtu nga Kuvendi. Korniza ligjore kundër korrupsionit përfshin ligjet e mëposhtme: Ligji Nr. 2004/34 Kundër Korrupsionit, Ligji Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Ligji Nr. 03/L-151 për Deklarimin dhe Origjinën e Pronës dhe Dhuratave për Zyrtarët e Lartë Publikë, Ligji Nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve, Ligji Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligji Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Origjinën, dhe Kontrollin e Pronës së Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Origjinën, dhe Kontrollin e Dhuratave të të gjithë Zyrtarëve Publikë.

Agjencia Kundër Korrupsionit është organ i pavarur dhe i specializuar përgjegjës për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Struktura dhe kompetencat e Agjencisë dalin nga Ligji Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Neni 1 i Ligjit rregullon statusin dhe përgjegjësitë në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, si dhe zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsioni.

Puna e Agjencisë mbikëqyret nga Komiteti për Legjislacion, kompetencat e të cilit përfshijnë shqyrtimin e raporteve të Agjencisë, mbikëqyrjen dhe vlerësimin periodik të performancës së Drejtorit të Agjencisë dhe nisjen e procedurave për përzgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit të Agjencisë. Me propozimin e Agjencisë, Kuvendi i Kosovës miraton buxhetin vjetor të Agjencisë, ndërsa Agjencia është e pavarur në ekzekutimin e buxhetit të saj. Agjencia ka 35 të punësuar, ndërsa 10 pozita janë të parapara me ligj. Buxheti vjetor i Agjencisë është rreth 500.000 euro.

Më 14 shkurt 2012 Presidentja e Republikës së Kosovës ka themeluar Këshillin Kombëtar Kundër Korrupsionit. Vendimi dhe Rregullorja e Punës e Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit (KKKK) përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve që janë pjesë e Këshillit. Objektivi i KKKK-së është t'i ravijëzojë dhe bashkërendojë aktivitetet e institucioneve në zbatimin e strategjisë kundër korrupsionit, dhe t'i përcaktojë përparësitë dhe politikat për zbatimin e legjislacionit kundër korrupsionit. Që nga themelimi, Këshilli është mbledhur dy herë. Përfundimet dhe rekomandimet e Këshillit do ta marrin formën e Planit të Veprimit për t'u zbatuar nga autoritetet shtetërore dhe agjencitë tjera.

Për më tepër, më 26 shkurt 2010 Qeveria ka nxjerrë Vendimin Nr. 02/110 për Themelimin e Task-Forcës kundër Korrupsionit brenda Prokurorisë së Veçantë të Republikës së Kosovës. Kjo task forcë përbëhet nga 8 prokurorë, 5 vendorë e 3 ndërkombëtarë, 30 policë hetues dhe 5 ekspertë kundër korrupsionit. Detyrat dhe përgjegjësitë e Task-Forcës janë t'i hetojë rastet e pastrimit të parave dhe korrupsionit, përfshirë rastet e krimit të organizuar si kompetencë ekskluzive e Task-Forcës. Buxheti i përgjithshëm i PVRK-së është 701.792 euro. Më 4 maj 2011 Qeveria e Kosovës ka nxjerrë Vendimin Nr. 05/14 për ndarjen e buxhetit shtesë për PVRK-në në shumë prej 130.000 euro; ky buxhet shtesë është ndarë vetëm për vitin 2011. Për më tepër, Prokuroria Shtetërore ka caktuar Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit brenda Prokurorisë së Qarkut të Prishtinës, si dhe në çdo prokurori të qarkut është caktuar një prokuror për rastet e korrupsionit. Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Kombëtar janë që t'i ravijëzojë dhe bashkërendojë më mirë aktivitetet e përndjekjes në nivel kombëtar.

- Ju lutem ofroni pasqyrën e bashkëpunimit & bashkërendimit ndër-institucional në luftën kundër korrupsionit?

Presidentja e Republikës së Kosovës ka themeluar Këshillin Kombëtar Kundër Korrupsionit me qëllim të përmirësimit të bashkërendimit dhe bashkëpunimit të institucioneve përgjegjëse në luftimin e korrupsionit. Prokuroria Shtetërore ka caktuar Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit brenda Prokurorisë së Qarkut të Prishtinës, e gjithashtu në çdo Prokurori të Qarkut është emëruar një prokuror për rastet e korrupsionit. Ju lutem referojuni pyetjes së mëparshme për më shumë detaje.

- Ju lutem ofroni informata dhe analiza për zbatimin e strategjive të mëparshme, politikave, planeve të veprimit dhe legjislacionit lidhur me luftën kundër korrupsionit.

Agjencia Kundër Korrupsionit ka kryer vlerësimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit 2009-2011; bazuar në gjetjet e vlerësimit, është hartuar dhe miratuar nga Qeveria Strategjia e re dhe Plani i Veprimit 2012-2016. Përfundimet dhe rekomandimet që dalin nga vlerësimi i Strategjisë sugjeruan planifikim më të mirë të veprimit, përmirësimin e lidhjes së objektivave strategjikë me planin e veprimit, ndërsa përmirësimin e mekanizmave raportues për zbatimin e planit të veprimit.

Marrëdhëniet me bashkësinë ndërkombëtare

- Ju lutem ofroni pasqyrën e bashkëpunimit me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë?

Kuvendi ka miratuar Ligjin Nr. 04/L-031 për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, i cili mandaton Ministrinë e Drejtësisë si autoriteti kompetent në çështjet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar. Ministria e Drejtësisë, në pajtim me nenin 29 të Statutit të Tribunalit Penal për ish Jugosllavinë i cili përcakton bashkëpunimin e shteteve me tribunalin në hetimin dhe përndjekjen e personave të akuzuar për vepra penale kundër njerëzimit, i ka proceduar me kohë dhe në mënyrë efektive të gjitha kërkesat.

Për më tepër, sipas Ligjit Nr. 03/L-052 për Prokurorinë e Veçantë të Republikës së Kosovës, PVRK-ja ka kompetencë ekskluzive t'i përndjekë dhe hetojë krimet e luftës, përfshirë format e ndryshme të përpjekjeve për bashkëpunim ndaj krimeve, që organet e tribunaleve ndërkombëtare, si Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, mund t'u referohen autoriteteve të Kosovës për hetim dhe përndjekje, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin e zbatueshëm. Kapitulli III i Ligjit përcakton se krimet e luftës për shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës (neni 118, KPK), krimet e luftës për shkeljet e rënda të ligjeve dhe zakoneve të zbatueshme në konfliktin e armatosur ndërkombëtar (neni 119, KPK), krimet e luftës për shkeljet e rënda në shkelje të nenit 3 i përbashkët për Konventat e Gjenevës (neni 120, KPK), krimet e luftës në shkeljen e rëndë të ligjeve dhe zakoneve të zbatueshme në konfliktin e armatosur të karakterit jo ndërkombëtar (neni 121, KPK) bien nën kompetencën ekskluzive të PVRK-së.

- Ju lutem përshkruani bazën ligjore për bashkëpunim me KFOR-in dhe EULEX-in. Ju lutem përshkruani bashkëpunimin praktik me këto dyja?

Prania ushtarake ndërkombëtare përcaktohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Deklarata e Pavarësisë e Republikës së Kosovës. Neni 153 i Kushtetutës thekson se prania ushtarake ndërkombëtare ka mandatin dhe pushtetin e përcaktuar në instrumentet ndërkombëtare përkatëse, përfshirë Rezolutën 12 të KSOKB-së dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Sipas Deklaratës së Pavarësisë institucionet e Republikës së Kosovës mirëpritën praninë civile ndërkombëtare për mbikëqyrjen e Planit të Ahtisarit dhe misionin e BE-së për Sundimin e së Drejtës.

Qeveria e Kosovës ka ftuar EULEX-in dhe Zyrën e Bashkimit Evropian që ta themelojnë Bordin e Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e së Drejtës (BPBSD) për bashkëpunim të përgjithshëm strategjik të përpjekjeve të tyre të përbashkëta për reforma në fushën më të gjerë të Sundimit të së Drejtës në Kosovë. Bordi ofron mbikëqyrje të nivelit të lartë të përparimit dhe bashkërendimit të zbatimit të përpjekjeve të përbashkëta për reformën e Sundimit të së Drejtës. Këto reforma bazohen në qasjen programatike të EULEX-it për mentorim, monitorim, dhe këshillim nga personeli i EULEX-it si dhe Procesi i Stabilizim-Asocimit. Në punën e tij, BPBSD-ja udhëhiqet nga objektivat e mëposhtëm strategjikë: kontributi për zhvillimin e institucioneve efektive, të qëndrueshme, dhe demokratike në fushën më të gjerë të Sundimit të së Drejtës; ta forcojë aftësinë e institucioneve të Kosovës që të rreshtohet me standardet evropiane dhe praktikat më të mira si dhe *acquis communautaire* në fushën e Sundimit të së Drejtës; të zhvillojë autoritete gjyqësore, policore, dhe të doganave të pavarura dhe shumetnike dhe të sigurojë se këto institucione janë të lira nga ndërhyrja politike, promovojnë të drejtat e njeriut dhe janë në pajtim me standardet e njohura evropiane dhe praktikat më të mira.

Në qershor 2008, NATO-ja u pajtua që ta fillojë zbatimin e detyrave të saj të reja në Kosovë, që të ndihmojë daljen nga gjendjes e jashtëzakonshme Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe në themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe strukturës civile që e mbikëqyrë FSK-në. Këto detyra zbatohen në bashkëpunim dhe këshillim të ngushtë me autoritetet përkatëse vendore dhe ndërkombëtare. Kjo forcë profesionale, krejt vullnetare po trajtohet sipas standardeve të NATO-s dhe është vendosur nën udhëheqje civile e kontroll demokratik. NATO-ja vazhdon të ndihmojë në themelimin e organizatës nën udhëheqje civile që ushtron kontroll civil mbi FSK-në. Përgjegjësia kryesore për këtë

detyrë qëndron në Shtabin Qendror të NATO-së në Bruksel; KFOR-i ka për detyrë ta mbështesë ekipin këshillimor të NATO-s që është themeluar në Prishtinë.

- Ju lutem tregoni organizatat ndërkombëtare në të cilat Kosova është anëtare ose vëzhguese?

Tabela 7: Lista e anëtarësisë në organizata ndërkombëtare

Organizata Ndërkombëtare	Përfaqësimi	Data e Pranimit
<u>Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (MEQTL)</u>	Kosovë/ <u>UNMIK</u>	26 korrik 2007
<u>Unioni Ndërkombëtar i Rrugëve dhe Transportit (UNIRT)</u>	Shoqatë e Transportit Rrugor	29 korrik 2008
<u>Traktati i Bashkësisë Energjetike i Evropës Jug-Lindore (TBEEJL)</u>	Kosovë/ <u>UNMIK</u>	1 korrik 2006
<u>Zona e Përbashkët Evropiane e Aviacionit (ZPEA)</u>	Kosovë/ <u>UNMIK</u>	30 nëntor 2006
<u>Organizata Transportuese e Evropës Jug-Lindore (OTEJL)</u>	Kosovë/ <u>UNMIK</u>	11 qershor 2004
<u>Shoqata Ndërkombëtare e Avokaturës</u>	Kosovë	28 maj 2009
<u>Fondi Monetar Ndërkombëtar</u>	Kosovë	29 qershor 2009
<u>Banka Botërore</u>	Kosovë	29 qershor 2009
<u>Forumi Ekonomik i Vjenës</u>	Kosovë	25 mars 2009
<u>Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit</u>		

1.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave

- A janë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore si dhe Protokollet e saj të zbatueshme në Kosovë? Nëse po, ju lutem ofroni referencë për zbatimin e KEDNJ ose praktikën e saj/jurisprudencën në ndonjë rast të veçantë?

Parimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe liritë themelore janë të rrënjosura në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Nenin 22 i Kushtetutës siguron zbatim të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe, në rast konflikti, garanton përparësinë mbi dispozitat ligjore dhe aktet tjera të institucioneve publike. Për më tepër, nenin 53 i Kushtetutës obligon autoritetet e Kosovës t'i interpretojnë dispozitat lidhur me të Drejtat e Njeriut dhe Liritë në pajtim me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata Kushtetuese si autoriteti më i lartë për interpretimin e Kushtetutës i referohet rasteve gjyqësore të GjEDNJ-së, shumica e vendimeve dhe gjykimeve të Gjykatës Kushtetuese bazohen në praktikën e GjEDNJ-së. Në rastin Nr. KI 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të interpretimit të karakterit subsidiar të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese iu referua rastit të GjEDNJ-së-Selmouoni k. Francës Nr. 25803/94, (vendimit të datës 28 korrik 1999). Në të njëjtin rast, me qëllim të interpretimit të kërkesës për shterjen e mjeteve juridike, Gjykata Kushtetuese iu referua GjEDNJ-së, rasti Cinar k. Turqisë Nr. 28602/95 - Vendimi i datës 13 nëntor 2003. Në një rast tjetër, në rastin Nr. KI40/09 Imer Ibrahim i dhe 48 ish nëpunës tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese erdhi në përfundim se ka shkelje të Nenit 46 të Kushtetutës i ndërlidhur me Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Marrëveshjet ndërkombëtare dhe instrumentet e mëposhtme garantojnë nga Kushtetuta: Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Femrës; Konventa për të

Drejtat e Fëmijës; Konventa kundër Torturës dhe Dënimeve tjera Mizore, Jonjerëzore ose Trajtitimit Poshtërues.

- A është Konventa Ndërkombëtare e OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike e zbatueshme në Kosovë?

Konventa Ndërkombëtare e OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike është e paraparë në Kushtetutë prandaj zbatohet drejtpërsëdrejti.

- Cilat janë sfidat/veprimet e ndërmarra për ta rritur vetëdijen për dy dokumentet e lartpërmendura dhe për Kartën Evropiane të të Drejtave Themelore në mesin e juristëve të tashëm dhe të ardhshëm si dhe avokatëve nëpër Kosovë?

Zyra e Kryeministrit është institucioni i mandatuar përgjegjës për ruajtjen dhe promovimin e parimeve të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore duke siguruar që këto parime dhe vlera të reflektohen në legjislacionin e Kosovës dhe të zbatohen në pajtim me to. ZQM/ZKM në bashkëpunim me mekanizmat ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë ka ofruar trajnime për Njësitë Komunale të të Drejtave të Njeriut për rëndësinë e zbatimit praktik të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, Konventën Kundër Torturës, dhe Konventën për të Drejtat Civile dhe Politike. Për më tepër, Instituti Gjyqësor i Kosovës ofron trajnim të vazhdueshëm juridik dhe arsimim për gjyqtarët, prokurorët, juristët e ardhshëm dhe avokatët, përfshirë module trajnimi për Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Gjatë vitit 2011 janë mbajtur tri sesione trajnimi për temat e lidhura me: të Drejtën për Liri dhe Siguri (neni 5 i KEDNj); të Drejtën për Gjykim të Drejtë (neni 6 i KEDNj); të Drejtën për Respektim të Jetës Private dhe Familjare (neni 8 i KEDNj). Përfshirja e këtyre temave dhe përfshirja e tyre në modulet e trajnimit theksohen në rritjen e aftësive praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e dispozitave të KEDNj-së dhe rastet gjyqësore nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

- A garantohet me ligj barazia e trajtimit ndërmjet meshkujve dhe femrave?

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7, garanton barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillim demokratik të shoqërisë, duke ofruar mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj të pjesëmarrjes në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe fusha tjera të jetës shoqërore. Për më tepër, vlerat e barazisë gjinore ruhen dhe reflektohen në legjislacion dhe dokumente tjera juridike si Ligji për Barazi Gjinore Nr. 2004/2, Ligji Kundër Diskriminimit Nr. 2004/3, Ligji i Punës Nr. 03/L-212, Ligji për Trashëgimi Nr. 2004/26, Ligji i Familjes Nr. 2004/32, Ligji për Shërbyesit Civilë Nr. 03/L-149, Ligji për Shëndetin Riprodhues Nr. 02/L-76, Ligji për Ndërprerjen e Shtatzënisë Nr. 03/L-110, Ligji për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, dhe Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna Familjare Nr. 03/L-182.

- Cilat janë konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të ratifikuara nga Kosova?

Duke pasur parasysh se Kosova nuk është anëtare e OKB-së dhe mekanizmave tjerë, ajo nuk ka përgjegjësi të ratifikojë konventa ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Sidoqoftë, Republika e Kosovës i ka futur në Kushtetutën e saj (Kapitulli II Të Drejtat dhe Liritë Themelore) marrëveshjet ndërkombëtare dhe instrumentet që garantojnë parimet dhe vlerat e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore.

- Si funksionon raportimi ndaj mekanizmave raportues ndërkombëtar?

Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut dhe Mundësi të Barabarta brenda Zyrës së Kryeministrit, është mekanizmi kryesor i mandatuar në përgatitjen e raporteve për zbatimin e konventave ndërkombëtare. ZQM/ZKM bashkë me njësitë për të drejtat e njeriut në nivelin qendror dhe lokal, ka hartuar raportet e para për zbatimin e konventave ndërkombëtare në bashkëpunim të ngushtë me Agjencitë e OKB-së, KLDNj, UNICEF, OSBE dhe mekanizma tjerë ndërkombëtarë dhe i ka dërguar këto raporte në OKB. Qeveria e Republikës së Kosovës deri tani ka dërguar tri raporte:

Raportin për Zbatimin e Konventës-Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (2005); Raportin për Zbatimin e Konventës për të Drejta Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (2008); Raportin për Zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (2010).

- Cilat janë marrëdhëniet mes Kosovës dhe Këshillit të Evropës?

Qeveria e Republikës së Kosovës po punon vazhdimisht me institucione, agjenci, donatorë, organizata ndërkombëtare dhe OJQ vendore për ta lehtësuar dhe përparuar procesin e zbatimit të të drejtave të njeriut. Këshilli i Evropës ka qenë dhe mbetet një nga partnerët më seriozë për bashkëpunimin e tillë. Duke iu falënderuar këtij partneriteti dhe bashkëpunimi, është arritur përparim domethënës në formësimin, harmonizimin dhe kompletimin e legjislacionit të Kosovës me standardet e Bashkimit Evropian. Zyra për Qeverisje të Mirë/ZKM bashkë me Këshillin e Evropës ka punuar së bashku, veçanërisht në zbatimin e projekteve të përbashkëta si:

- a. Projekti ka adresuar rekomandimet e pranuar nga KE-ja, që dolën pas raportit të dërguar nga Kosova lidhur me zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; është zbatuar nga ZQM në bashkëpunim me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete dhe Këshillin e Evropës gjatë viteve 2008-2009;
- b. Projekti për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë: ky projekt synon përmirësimin e kornizës institucionale si dhe asaj rregullatore në pajtim me standardet evropiane, t'i rrisin kapacitetet për raportimin ndaj kërkesave të Institucionit të Avokatit të Popullit, Zyra për Qeverisje të Mirë, institucione tjera përkatëse që merren me të drejtat e njeriut në nivelin qendror dhe lokal si dhe organizatat e shoqërisë civile. Ky Projekt do të zbatohet gjatë viteve 2012-2013.

Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë: projekt i zbatuar nga Këshilli i Evropës (2010) me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale për ta luftuar korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Si rezultat, do të bëhet vlerësimi i detajuar i situatës aktuale si dhe rekomandimet do të përcillen për përmirësimin dhe njësimin e reformave të nevojshme në luftimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit.

- A ka dispozita për dënimin me vdekje në sistemin juridik të Kosovës?

Në sistemin juridik të Republikës së Kosovës nuk ka dispozita juridike për dënimin me vdekje.

1.2.1. Të drejtat civile dhe politike

- Si po trajtohen abuzimet e të drejtave të njeriut të kohës së luftës (Zhdukjet/personat e humbur, krimet e luftës, refugjatët, përdorimi i tokës dhe prona e paluajtshme)?

Një nga pasojat më të rënda të periudhës së kohës së luftës është çështja e personave të zhdukur. Zhdukja e personave është rezultat i shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, duke shkelur të gjitha konventat ndërkombëtare, ligjet dhe zakonet e luftës. Familjet e personave të zhdukur i kanë paraqitur ankesat e tyre dhe kërkesat tek Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në Kosovë ishin në numër të përgjithshëm prej 6.020 personave të zhdukur. Që nga prilli 2012 sipas listës së përkohshme të KNKK-së, e cila bazohet në punën e Grupit Punues për Persona të Zhdukur (grup i themeluar si forum për dialog ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, kryesuar nga KNKK-ja) numri i personave të zhdukur është 1.780. Që nga lufta më 1999, UNMIK-u ishte i ngarkuar për personat e zhdukur dhe kishte pushtetin ekzekutiv në çështjen e vendndodhjes, nxjerrjes dhe identifikimit, deri në shpalljen e pavarësisë. Deri më 2012 TPNJ-ja ishte përfshirë në fazën identifikuese dhe në mbledhjen e dëshmive për krimet e luftës të kryera në Kosovë. Ndërsa gjatë procesit të zgjidhjes së fatit të personave të zhdukur, ishin përfshirë organe dhe mekanizma tjerë si Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Komisioni Ndërkombëtar i Personave të Zhdukur, KFOR-i, OSBE-ja, dhe, nga viti 2008, EULEX-i. Që nga viti 2003 i tërë identifikimi bëhet përmes analizave të ADN-së (themeluar nga Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet UNMIK-ut dhe KNPZH-së), prandaj numri i saktë i identifikimeve të bëra para asaj date është vështirë të përcaktohet për shkak të modaliteteve të

ndryshme të përdorura në procesin e identifikimit. Bazuar në informatat e mbledhura në dispozicion, përafërsisht 2.000 persona janë identifikuar gjatë periudhës 1999-2002. Për ta mundësuar bashkërendimin e aktiviteteve në fjalë, me ndihmën dhe sugjerimin e partnerëve ndërkombëtarë, Qeveria e Kosovës ka themeluar Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur. Stafi i tij administrativ është transferuar drejtpërdrejtë nga Zyra e mëparshme për persona të zhdukur. Mandati i Komisionit rregullohet me Ligjin për Persona të Zhdukur Nr. 04/L-023.

Të Drejtat Pronësore: Agjencia Kosovare e Pronës është themeluar nga UNMIK-u me Rregulloren 2006/10 për Zgjidhjen e Kërkesave Lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë pronën bujqësore dhe tregtare, e plotësuar me Rregulloren 2006/50 dhe Ligjin Nr. 03/L-079, si Agjenci e pavarur. Mandati kryesor i AKP-së është t'i zgjidhë kërkesat, që kanë të drejtë ankese në Gjykatën Supreme të Kosovës, lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe tregtare, që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Agjencia gjithashtu kishte mandat të merret me numër të kufizuar veprimesh të cilat binin brenda mandatit të Drejtoratit të Strehimit dhe Pronës (DSP) domethënë zbatimin e vendimeve të Komisionit të Ankesave të Strehimit dhe Pronës (KASP), nga të cilat varej zbatimi, menaxhimi i pronave nën administrimin e DSP-së dhe zbatimi i skemës së qerasë.

Në këtë aspekt, Agjencia ka mbledhur mbi 41.958 ankesa nga të cilat afërsisht 90% janë dërguar në zyrat e Agjencisë të vendosura në Serbi, Mal të Zi ose Maqedoni nga personat që jetojnë jashtë Kosovës. Nga numri i përgjithshëm i ankesave, 88.8% lidhen me pronën bujqësore (janë kërkuar 221.225 hektarë tokë), 8.9% të pronës strehuese, dhe 2.3% të pronës tregtare.

Deri më tani janë 29.797 ankesa të shqyrtuara ndërsa ato të mbeturat janë në proces të përgatitjes për shqyrtim. Bashkë me shqyrtimin e ankesave, Agjencia është e angazhuar në zbatimin e vendimeve. Ankuesit e suksesshëm kanë mundësi t'i përzgjedhin mjetet për zbatimin e vendimit përfshirë riposedimin e pronës, vendosjen e pronës në administrim dhe skemën e qerasë, ose mbylljes së rastit. Sapo të nxirren vendimet e Komisionit, Agjencia i zbaton ato dhe pronari i pronës mund ta riposedojë pronën e tij.

Nën administrim janë 5.542 prona e nga të cilat 1.032 janë në skemën e qerasë. Shuma e qerasë është transferuar tek pronarët e pronës, përveç 5% e cila mbahet nga Agjencia për shërbimet e saj.

1.2.1.1. E drejta për gjykim të drejtë/Qasja në drejtësi

- Ju lutem përshkruani situatën lidhur me 'të drejtën për gjykim të drejtë' dhe 'qasje në drejtësi'?
E drejta për gjykim të drejtë parashihet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 31 "E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm" si dhe në Kodin e Procedurës Penale Neni 2 dhe Neni 5 të cilët parashohin se vetëm gjykata e pavarur dhe e paanshme mund të shqiptojë sanksione penale përderisa çdo person i dyshuar ose akuzuar ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme dhe të drejtë dhe që ajo të përfundohet në kohë të arsyeshme. Këto parime kanë ofruar bazë të mjaftueshme që qytetarët të gjykohen drejtë nga organe/gjykata të pavarura.

Qasja në drejtësi u ofrohet dhe garantohet të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës nga legjislacioni në fuqi. Veç kësaj, me qëllim që të sigurohet më mirë kjo qasje, ekziston edhe Ligji për Ndihmën Juridike Nr. 04/L-017 me njësitë e tij përkatëse për mbrojtjen e viktimave dhe integrimin në gjyqësi, duke pasur si qëllim krijimin e kushteve më të mira të mundshme për qasje në drejtësi.

Strukturat përkatëse për mbrojtjen e viktimave dhe integrimin në gjyqësi, më herët brenda Ministrisë së Drejtësisë, janë transferuar tek institucionet përkatëse si Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke pasur për qëllim ofrimin e të gjitha parakushteve për gjykim

të drejtë dhe qasje në drejtësi, duke marrë parasysh fushëveprimin dhe kompetencën e KPK-së dhe KGJK-së.

Vlen të përmendet kontributi i madh që ka dhënë Gjykata Kushtetuese e Kosovës në garantimin e gjykimit të drejtë dhe qasjes në drejtësi me rastet që ajo i ka gjykuar në këtë fushë, gjithmonë duke respektuar dhe zbatuar standardet dhe praktikën më të mira evropiane.

1.2.1.2. Liria e shprehjes

- Ju lutem përshkruani kornizën ligjore që garanton dhe mbron lirinë e mediave he lirinë e shprehjes.

Mbrojtja e lirisë së medieve dhe lirisë së shprehjes garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 40 dhe Neni 42 si dhe me ligje tjera përkatëse. Kushtetuta, më saktë neni 40, e thekson lirinë e shprehjes si e drejtë e garantuar për t'u Shprehur, Shpërndarë dhe Pranuar Informata, Mendime dhe Porosi pa pengesë. Më tej, neni 42 garanton lirinë dhe shumësinë e medieve, ndalon censurën dhe shpërndarja e informatave ose ideve përmes medieve nuk mund të parandalohet, përveç rasteve kur paraqitet nevoja nga parandalimi i nxitjes së dhunës, armiqësisë ose urrejtjes bazuar në baza racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Korniza ligjore në fuqi garanton dhe mbron lirinë e medieve dhe lirinë e shprehjes si më poshtë:

- a. Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve Nr. 04/L-44, synon promovimin dhe zhvillimin e shërbimeve në mediet audio-vizuele që u shërbejnë të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës;
- b. Ligji për Radio Televizionin e Kosovës Nr. 04/L-046, synon vendosjen e bazës ligjore në ofrimin qytetarëve të Republikës së Kosovës informata të sakta dhe të shpejta, pa marrë parasysh origjinën e tyre etnike, gjuhësore ose fetare;
- c. Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes Nr. 02/L-65, synon promovimin e shoqërisë tolerante dhe demokratike në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

- A është shpifja vepër penale në Kosovë? Nëse po, kur synon Kosova ta heqë shpifjen nga Kodi Penal?

Pasiguria juridike për shpifjen është eliminuar me Kodin e ri Penal i cili do të miratohet nga Kuvendi gjatë vitit 2012 si dhe dispozitat brenda Kodit Penal pas eliminimit do të rregullohen vetëm me Ligjin për Shpifjet dhe Fyerjet.

Kodi Penal i Kosovës i vitit 2004, neni 188, thekson se 'shpifja' është vepër penale; sidoqoftë në fazën e mëvonshme çështja është rregulluar nga Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes Nr. 02/L-65 i cili është në fuqi që nga viti 2007. Për më tepër, më 20 shkurt 2012, Gjykata Supreme e Kosovës lëshoi qëndrimin Nr. AG.K.94/2012 duke qartësuar se që nga hyrja në fuqi e Ligjit Civil për Shpifjen dhe Fyerjen, neni 188 dhe neni 187 brenda Kodit Penal që parashohin shpifjen dhe fyerjen si vepra penale nuk do të zbatohen dhe këto akte si të tilla janë dekriminalizuar, prandaj të gjitha rastet lidhur me këto çështje do të gjykohen sipas Ligjit Civil për Shpifje dhe Fyerje.

Janë raportuar raste nga gjyqësia lidhur me akuzat kundër gazetarëve ku në shumicën e rasteve, pa marrë parasysh nëse procedimet ishin ndërprerë ose përfunduar, kurrë nuk është raportuar se gjykatat u janë referuar neneve nga Kodi Penal ose që kanë shqiptuar sanksione penale për këto raste.

1.2.1.3. Liria e mbledhjes dhe organizimit

- Duke pasur parasysh Ligjin për Lirinë e Asocimit në OJQ të miratuar së fundmi, ju lutem paraqitni planet dhe veprimet e autoriteteve për t'i strukturuar marrëdhëniet e saj me sektorin e OJQ-ve?

Duke ditur rëndësinë e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe pjesëmarrjen e saj në jetën politike në përgjithësi dhe procesin e vendim-marrjes në veçanti, Qeveria ofron qasje dhe pjesëmarrje në politikë-bërje dhe strategjitë qeveritare. Vëmendje dhe hapësirë e veçantë i kushtohet sektorit joqeveritar në procesin e këshillimit publik si dhe rolit të tyre në përcaktimin dhe monitorimin e zbatimit të dokumenteve strategjike dhe politikave. Me qëllim të përparimit të mëtejshëm të procesit, ZKM-ja ka botuar Udhëzuesin për Këshillim Publik i cili mundëson përfaqësimin e shoqërisë civile në mekanizma të ndryshëm ndër-qeveritarë si komitetet e përhershme, komitete dhe grupe punuese. Për më tepër, në pajtim me dhe në vazhdimësi të zbatimit të Ligjit për Lirinë e Asocimit Nr. 04/L-57, është përgatitur projekt-strategjia fillestare për vendosjen e komunikimit të rregullt ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile, e cila do të miratohet pas përfundimit të saj.

- Si kontribuon Kosova në forcimin e kapaciteteve të OJQ-ve? A ka themeluar Kosova fond për qëllimet e shoqërisë civile?

Projekt-strategjia për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile parasheh krijimin e skemës kombëtare të grandeve për zhvillimin e shoqërisë civile. Deri tani Qeveria ka mbështetur e bashkë-financuar projekte të ndryshme por nuk ka pasur kornizë gjithëpërfshirëse ligjore që parasheh financimin e Organizatave të Shoqërisë Civile. Mungesa e përcaktimit të qartë dhe rregullave për financim si dhe përzgjedhjen e Organizatave të Shoqërisë Civile në vendim-marrje dhe ofrimin e shërbimeve e ka bërë mese të nevojshme fillimin e hartimit të Strategjisë për Bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe Shoqërisë Civile.

1.2.1.4. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë

- Cilat janë karakteristikat kryesore të Ligjit të ri/Projekt-Ligjit për Lirinë e Fesë?

Karakteristikat kryesore të Projekt/Ligjit të ri për lirinë e fesë kanë të bëjnë me eliminimin e mangësive ligjore, domethënë dispozitave për procedurën dhe kushtet e kërkuara për regjistrimin e bashkësive fetare, statusin e tyre juridik, organin përgjegjës për regjistrim dhe taksa në të hyra (klerin dhe stafin administrativ) të këtyre bashkësive.

- Cilat janë kërkesat ligjore për bashkësitë fetare që të themelohen në Kosovë?

Me Projekt/Ligjin e ri për lirinë e fesë, themelimi i bashkësisë fetare në Republikën e Kosovës duhet t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a. Kërkesën për regjistrim që paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar;
- b. Pas themelimit, duhet të jenë së paku pesëdhjetë (50) anëtarë të bashkësisë, qytetarë të Republikës së Kosovës me liri të plotë juridike;
- c. Statutin/Rregulloren që paraqet qartë hierarkinë organizative;
- d. Qëllimi ose ritualet duhet të jenë në pajtim me ligjet e zbatueshme dhe rendin publik të vendit;
- e. Ofrimi i informatave për pronën/pronat që zotërohen ose menaxhohen nga bashkësia, me qëllim të likuidimit;
- f. Veprimtaria e bashkësisë nuk i shkelë të drejtat e njeriut dhe liritë ose rendin publik;

Emri i bashkësisë nuk duhet të jetë identik me bashkësinë tashmë ekzistuese dhe të njohur që përdor emër të tillë në Republikën e Kosovë

- A i financon Kosova bashkësitë fetare?

Projekt/Ligji i ri për lirinë e fesë thekson se shteti nuk e financon asnjë bashkësi fetare. Sidoqoftë, ka fonde vjetore në dispozicion për ruajtjen e monumenteve kulturore ku bashkësitë fetare mund të kërkojnë fonde të tilla kur këto monumente kulturore administrohen nga vetë bashkësitë. Veç kësaj,

bashkësitë fetare, individualisht ose përmes organizatave të tyre bamirëse, mund po ashtu të kërkojnë fonde shtetërore që ta mbulojnë zbatimin e programeve të veçanta bamirëse.

- A lejon Ligji arsimim fetar në shkolla publike?

Në Republikën e Kosovës, Ligji për Shkollimin Parauniversitar Nr. 04/L-032 nuk lejon arsimimin fetar në shkollat publike. Sipas nenit 3, paragrafi 7, të këtij Ligji, “institucionet arsimore publike përmbahen nga udhëzimet fetare ose çfarëdo aktiviteti tjetër që propagandon fe të caktuar”.

- Cili është institucioni përgjegjës për zbatimin e Ligjit të lartpërmendur?

Sipas Projekt/Ligjit për lirinë e fesë, institucioni përgjegjës për zbatimin e Ligjit do të jetë Ministria e Drejtësisë. Pas miratimit të Ligjit, brenda periudhës 3 mujore MD-ja duhet ta themelojë Zyrën për Regjistrimin e Bashkësive Fetare e që, brenda gjashtë muajsh, pason nga kompletimi i legjislacionit dytësor i cili mbulon procedurat e regjistrimit.

- Si i siguron Kosova të drejtat e pakicave (përfshirë lirinë e fesë) përderisa ajo pohon në Kushtetutën e saj të jetë entitet laik?

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 8, Kosova është shtet laik. Në anën tjetër të Drejtat dhe Liritë Themelore garantohej nga Kushtetuta, Kapitulli II dhe neni 38.1 i cili thekson se “Garantohet liria e besimit, ndërgjegjes dhe fesë”. Për më tepër, Ligji për Lirinë e Fesë Nr. 02/L-31 Neni 3, thekson se ‘Barazia ligjore e të gjithë personave, pa marrë parasysh fenë ose besimin e tyre, bashkimin me ndonjë bashkësi fetare ose pjesëmarrjen në rituale, janë të barabarta para ligjit dhe gëzojnë të drejta të barabarta civile, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore’. Të gjithë personat juridikë dhe fizikë gëzojnë të drejta të barabarta sipas këtij Ligji.

1.2.1.5. Mbrojtja e të dhënave personale

- Ju lutem ofroni pasqyrën e situatës në Kosovë lidhur me strategjitë, politikat, legjislacionin dhe pavarësinë e autoritetit për mbrojtjen e të dhënave, si dhe vendosjen e institucioneve dhe agjencive përkatëse dhe fushëveprimin/detyrat e tyre.

Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është themeluar nga Kuvendi si agjenci e pavarur përgjegjëse për monitorimin e ligjshmërisë së trajtimit të të dhënave personale. Funkzioni, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë rregullohen me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr. 03/L-172. Sipas autoritetit dhe kompetencave që dalin nga ky ligj, mbikëqyrja e procedimit të të dhënave kryhet përmes mekanizmit të Agjencisë, si inspektimet dhe kontrollet e organeve publike dhe private.

Për ta siguruar zbatimin e Ligjit dhe procedimi e duhur të të dhënave personale, janë miratuar akte të brendshme juridike si: Rregullorja e Punës, Kodi i Etikës, Rregullorja e Inspektimit, Udhëzimi Administrativ për Zyrtarin në Detyrë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Udhëzimi Administrativ për Kartelat Identifikuese për Mbikëqyrësit Shtetërorë, Formulari për Transferimin Ndërkombëtar të të Dhënave Personale, dhe Listën e Kontrollit për organet publike dhe private që procedojnë të dhëna. Me qëllim që të sigurohet më mirë mbrojtja e të dhënave personale, Agjencia ka kërkuar nga organet përkatëse që t’i harmonizojnë aktet e tyre të brendshme me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e ku, sipas këtij Ligji, Agjencia po ashtu kishte caktuar afatin (31 dhjetor 2011) për caktimin e zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave brenda secilit institucion publik. Për më tepër, po ashtu është dërguar kërkesa tek institucionet që para se të miratojnë legjislacion të ri dhe ato që përfshijnë të dhëna personale, duhet ta presin mendimin e Agjencisë.

Janë mbajtur takime të rregullta ndërmjet Agjencisë dhe Institucionit të Ombudspersonit, Komisionit të Pavarur të Medieve, Komisionit të Pavarur të Medieve të Shkruara, dhe Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit e nga kjo ky bashkëpunim do të formalizohet duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Si institucion përkatës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale është edhe Institucioni i Ombudspersonit ku, sipas Ligjit që themelon Institucionin e Ombudspersonit Nr. 03/L-195, fushëveprimi dhe përgjegjësia e tij bien në mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të personave juridikë ose fizikë nga aktet ose lëshimet e paligjshme nga autoritetet publike dhe organe/organizata tjera që ushtrojnë pushtet publik.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet përkatëse të Republikës së Maqedonisë, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Sllovenisë, dhe Republikës së Malit të Zi, për shkëmbimin e praktikave më të mira për funksionimin më të mirë të Agjencisë. Hapat e ardhshëm të Agjencisë përfshijnë: mundësinë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të dhënave personale; fushata për ngritjen e vetëdijes për qytetarët rreth të drejtave të tyre dhe mbrojtjes së të dhënave personale, duke synuar shpërndarjen e informatave për Regjistrimin e të Dhënave, mbikëqyrjen e Video-Regjistrimeve dhe fletëpalosjeve informative..

1.2.2. Të drejtat ekonomike dhe sociale

- Ju lutem përshkruani kornizën ligjore dhe implementimin praktik të të drejtave të mëposhtme: të drejtat e grave dhe barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, personave të pambrojtur nga shoqëria dhe personave me aftësi të kufizuara, politikat kundër diskriminimit duke përfshirë LGBT, të drejtat e fuqisë punëtore, sindikatave të punës, tregtisë dhe të drejtat e pronësisë.

Korniza ligjore për të drejtat e grave dhe barazisë gjinore është hartuar tërësisht në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe të gjitha dokumentet ligjore (Projekt-ligji dhe legjislacioni sekondar) para miratimit të tyre nga ana e Qeverisë, ato janë dorëzuar për konsultim në Agjencinë për Barazi Gjinore e cila siguron perspektivat gjinore është reflektuar në projektligj

Ligji mbi Barazinë Gjinore Nr. 2004/2: siguron mbrojtjen; ndërsa trajton dhe përcakton barazinë gjinore si vlerë themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë Kosovare, duke ofruar mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, pjesëmarrjen e tyre në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Ligji Kundër Diskriminimit Nr. 2004/3: siguron parandalimin si dhe luftimin e diskriminimit, promovon barazinë gjinore dhe realizimin e parimit të trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, prandaj ndalon dhe i mbron nga çdo lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në gjini.

Ligji i Punës Nr. 03/L-212: siguron të drejtat e gruas sipas kontratës së punësimit nëpërmjet dispozitave të tij të veçanta si pushimit të lindjes, ruajtjen e punësimit dhe mbrojtjen e shëndetit të grave gjatë shtatzënisë, si dhe të drejtën për kujdes të veçantë të fëmijës.

Ligji mbi Trashëgiminë Nr. 2004/26: mbron të drejtat e grave për trashëgimi dhe dispozitat gjinore të tij janë të paanshme dhe pa diskriminim.

Ligji mbi Familjen Nr. 2004/32: rregullon fejesën, martesën, marrëdhënien Prindër dhe Fëmijë, adoptimin, kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, të drejtat pronësore brenda anëtarëve të familjes dhe procedurave të veçanta gjyqësore për mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet anëtarëve të familjes. Kur bëhet fjalë për të drejtat dhe detyrimet, ajo garanton trajtim të barabartë për të dy gjinitë dhe ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë në bazë të gjinisë.

Ligji mbi Shërbimin Civil Nr. 03/L-149: shërbyesit civil kanë trajtim të barabartë në të gjitha aspektet si në menaxhimin e personelit, zhvillimit të karrierës, shpërblime, kompensim dhe mbrojtje ligjore,

pa marrë parasysh gjininë. Ligji ofron një dispozitë specifike me referencë në teknologjinë e përdorur në të që nuk përmban paragjykime për gjini.

Ligji për Shëndetin Riprodhues Nr. 02/L-76: siguron dhe garanton të drejtat e secilit individ, pa marrë parasysh gjininë, ideologjinë, fenë apo kulturën që i përket, për informim dhe edukim në shëndetin seksual dhe riprodhues. Ligji gjithashtu garanton të drejtat e grave për të vendosur lirshëm në kohën, numrin, dhe intervalet e lindjes si dhe i mbron nga shtatzënia e detyruar dhe garanton amësi të sigurt.

Ligji për Ndërprerjen e Shtatzënisë Nr. 03/L-110: siguron bazën ligjore për dhe rregullon ndërprerjen e shtatzënisë. Për më shumë, qëllimi i këtij ligji është të marrë të gjitha masat e duhura për të mbrojtur dhe eliminuar rrezikun e mortalitetit si rezultat nga abortimet ilegale.

Ligji mbi Zgjedhjet Nr. 03/L-073: përmes nenit 27 është e garantuar e drejta për të votuar dhe zgjedhur pa diskriminim në bazë të racës, etnicitetit, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, fesë apo pikëpamjeve politike, edukimit, statusit social apo ndonjë kriter tjetër të ngjashëm, për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, kuota e garantuar me Ligj për femrat përfaqësuese është 30%.

Ligji për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare Nr. 03/L-182: synon mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës në familje për anëtarët e familjes që janë viktimë e një dhune të tillë, përmes masave të përshtatshme ligjore. Zbatimi praktik të kornizës ligjor dhe të drejtave kushtetuese është siguruar përmes mekanizmave institucional dhe politikave publike, të renditura si më poshtë:

- a. Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit;
- b. Zyrtarët e Barazisë Gjinore në Ministrinë përkatëse;
- c. Zyrtarët e Barazisë Gjinore në Komuna;
- d. Grupi i Grave Deputete në Parlamentin e Republikës së Kosovës;
- e. Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazisë Gjinore, Personave të Humbur dhe Peticioneve;
- f. Institucioni i Ombudspersonit në sektorin e Barazisë Gjinore.

Dokumentet strategjike qeveritare për barazinë gjinore të miratuara deri më tani:

- a. Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ), i miratuar më 24.04.2008;
- b. Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje, i miratuar më 25.08.2011;
- c. Plani i Veprimit për Fuqizimin Ekonomik të Grave 2011-2013;
- d. Dokumentet strategjike sektoriale dhe ndër-sektoriale që sigurojnë zhvillimin socio-ekonomik, garantojnë të drejtat e njeriut si dhe parashikojnë treguesit gjinor të detyrueshëm dhe reflektojnë perspektivën gjinore.

Në legjislaturën e katërt ka një total prej 40 deputetëve femra që përbëjnë 33.3% të numrit të përgjithshëm të deputetëve, ndërsa në Qeveri, përfaqësimi i përgjithshëm brenda shërbimit civil më post të vendim-marrjes është rreth 13%.

Personat e pambrojtur dhe personat me aftësi të kufizuara: Në lidhje me të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, brenda sektorit social, mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe ofron shërbime sociale përmes institucioneve-rezidenciale të kujdesit. Kornizat ligjore në fuqi, që rregullojnë mbrojtjen sociale janë si më poshtë: Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligji mbi ndihmën Financiare të familjeve me fëmijë me Aftësi të Kufizuara nga mosha 01-18 vjeçare, Ligji për personat me aftësi të kufizuara prej moshës 16-64 vjeç, Ligji për Skemën Sociale, Ligji mbi Trajnimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-17 dhe udhëzimi administrativ Nr. 06/2011, jep udhëzime të qarta për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara, kriteret e qarta për kushtet që duhet të plotësojë një fëmijë apo i rritur që kërkon 24h shërbime në Institutin bazë të Shtimes ose në një nga shtatë (7) Shtëpitë e Komunitetit. Për momentin, 24 orë kujdes dhe shërbim i ofrohet 130 personave me aftësi të kufizuara mendore në Institutin e Shtimes dhe në dy Shtëpi të Komunitetit që po ashtu janë në Shtime, një në Ferizaj, një në Vushtrri, një në Graçanicë, një në Kamenice dhe një në Deçan.

Ligji mbi Ndhimën Financiare të Familjeve me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara Nr. 03/L-022 ofron ndihmë konkrete financiare për familjet ku numri i përgjithshëm i përfituesve është 2,941 fëmijë me aftësi të kufizuara permanente dhe shuma mujorë për fëmijë është 100€.

Ligji mbi Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara Nr. 2003/23, personat me aftësi të kufizuara me moshë 18-64, rregullon skemën e pensionit për personat me aftësi të kufizuara me pamundësi për të punuar. Për momentin, përfituesit nga kjo skemë mbërrijnë numrin prej 18,121 personash dhe shuma mujore është 45 € (kategoria e parë).

Familjet të cilat plotësojnë kriteret e tjera përfitojnë nga skema sociale, ku numri i personave me aftësi të kufizuara mund të jetë një apo më shumë dhe numri i përfitimeve arrin në 13,853 persona (kategoria e parë).

Ligji mbi Aftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Nr. 03/L-019, ofron shërbime të trajnimeve, aftësimin profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara. Sipas Nenit 12, paragrafit 1 të këtij Ligji, të gjithë punëdhënësit, për çdo të 50-in punëtor duhet të punësojnë një person me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, sipas Ligjit të njëjtë, janë disa procedura të tjera të detyrueshme dhe kriteret për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, përkatësisht në punësim dhe aftësimin profesional.

Njerëzit që jetojnë në varfëri (grupet e pambrojtura), sipas Ligjit mbi Skemën e Ndhimës Sociale, Nr. 2003/15, duhet të marrin asistencë dhe/ose përfitojnë në kesh në momentin kur ata hyjnë në grupin e familjeve të cilat jetojnë në varfëri dhe plotësojnë kriteret e klasifikimit për kategoritë e skemës së asistencës sociale.

- a. Kategoria I: Familjet ku të gjithë anëtarët janë të varur dhe asnjë të punësuar;
- b. Kategoria II: Familjet me një anëtarë që mund të punoj, me më së paku një fëmijë më të vogël se 5 vjeç apo kujdesen për një jetim deri në moshën 15 vjeçare;

Në të dy kategoritë janë të përfshirë personat e pambrojtur brenda familjes, përkatësisht: fëmijët prej 0-5 vjeç, fëmijët prej 6-18 vjeç që vijnë edukim të rregullt, personat 18-65 me 80% paaftësi për të punuar, i vetmi anëtar i familjes që mund të punoj por i papunësuar, kujdestar permanent brenda familjes, prind i vetëm si mbajtës i vetëm i familjes. Asistenca sociale mujore për familje shumëzohet me numrin e anëtarëve të familjes (min. 40€ dhe max. 80€). Skema e asistencës sociale gjithashtu ofron përfitime të tjera si: kujdesin primar mjekësor, subvencionimi i një sasive të caktuar të energjisë elektrike së konsumuar, dhe përjashtimet nga tarifatat e shkollimit në arsimin e nivelit të lartë dhe universitet.

Të Drejtat e Fëmijëve: Një përparim i përgjithshëm është bërë në vënien në vend të legjislacionit për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, ku gjatë procesit të hartimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve është duke u diskutuar dhe parimet e saj përfshirëse janë: jo-diskriminimi, participimi i fëmijëve, zhvillimi i potencialit të plotë të fëmijës dhe interesi më i mirë i fëmijës; Konventa 182 e cila trajton format më të këqija të Punës së Fëmijëve; instrumente të tjera dhe standardet ndërkombëtare.

Me qëllim të zbatimit të kornizës ligjor në praktikë, dokumente strategjike janë krijuar dhe janë në proces të implementimit, si:

- a. Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve 2009-2013;
- b. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve;

Këto dokumente strategjike identifikon çështjet më të rëndësishme që kanë nevojë për intervenim të menjëhershëm për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve, kujdesin e nevojshëm për zhvillimin dhe mirëqenien e një fëmije.

Mirëqenia Sociale: Sipas Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare si dhe aktet e tjera ligjore, format e mbrojtjes dhe shërbimeve për fëmijë përfshijnë: kujdestarinë, kujdesin birësues, miratimin, strehimin rezidencial, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të abuzuar, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të trafikuar, duke përfshirë viktimat e krimeve seksuale, mbrojtjen e fëmijës nga veprat e rënda dhe mbrojtjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Kundër -Diskriminimi: Promovimi i barazisë dhe ndalimi i diskriminimit kanë arritur deri në nivelin më të lartë të kornizës ligjore të shtetit. Prandaj, parimet kundër diskriminimit janë përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin Kundër Diskriminimit Nr. 2004/3. Principet e trajtimit të barabartë përcaktojnë që aty nuk duhet të ketë asnjë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të gjinisë, moshës, statusit martesor, të meta fizike ose mendore, orientimit seksual, nacionalitetit, pikëpamjeve politike, fesë apo besimit, origjinës etnike apo sociale, pronës, ditëlindjes apo ndonjë statusi tjetër, prandaj të gjithë kanë të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore. Zyra për Qeverisje të Mirë, në përputhje me detyrimin që rrjedhin nga Ligji Kundër Diskriminimit, në Nenin. 12, paragrafi 12.3, ka adoptuar një Plan Veprimi për qëllim të zbatimit të Ligjit.

Të Drejtat e Punëtorëve dhe Sindikatave: E drejta mbi punësim është e rregulluar me Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212, ndërsa e drejta për shoqata në sindikata është e rregulluar me Ligjin për Sindikata, Nr. 04/L-11:

- a. Ligji i Punës rregullon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga punësimi, apo në mes të punësuarve dhe punëdhënësve. Kushtet e këtij Ligji duhet të aplikohen nga të punësuarit dhe punëdhënësit publik dhe ata të sektorit privat. Çështjet kryesore të cilat janë të garantuara nga dispozitat e Ligjit të punës janë: ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit, krijimi i marrëdhënieve të punësimit, kontrata e punësimit, përmbajtja e një kontrate të tillë, vendosja e të punësuarve në vendin e punës, orarin e punës, të pushimeve dhe mungesave në punë, mbrojtja dhe siguria e të punësuarve, pagat dhe përfitimet e të punësuarve, ndërprerja e punësimit, procedurat për realizimin e marrëdhënieve dhe të drejtave të punës, dialogu social, si dhe çështje të tjera të rëndësishme në lidhje me punëdhënësit dhe punëmarrësit. Për të siguruar zbatimin e Ligjit të Punës plotësisht, 11 rregullore janë lëshuar.
- b. Ligji për Sindikata synon rregullimin dhe përcakton të drejtat dhe liritë e të punësuarve për të krijuar dhe organizuar lirshëm dhe vullnetarisht sindikata shoqërore në mënyrë që të mbrojnë interesat ekonomike, sociale dhe profesionale. Çështjet e rregulluara dhe të drejtat e garantuara me këtë Ligj janë: e drejta për anëtarësim në sindikatë dhe organizim, anëtarësim në sindikata të punës, zgjedhjet e sindikatave, shuarjen e sindikatave, kriteret dhe kushtet për regjistrimin e sindikatave të tregtisë, strukturën e sindikatës, resurset e financimit dhe të drejtat për të organizuar federatat dhe konfederatat e sindikatës, si dhe çështje të tjera lidhur me këtë fushë. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka lëshuar një akt legjislativ sekondar më qëllim që ky Ligj të zbatohet.

Të Drejtat Pronësore: Agjencia Kosovare e Pronës është themeluar sipas kornizës ligjore të mëposhtme:

- a. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/10, e datës 04.03.20 mbi Zgjidhjen e Kërkesave Lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/50, të datës 16.10. 2006;
- b. Urdhëresa Administrative Nr. 2007/50;
- c. Ligji i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës Nr. 03/L-079 me ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave Lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale të datës 15 Qershor 2008;
- d. Projektligji i ri për ndryshimin e Ligjit të Agjencisë Kosovare të Pronës (në proces)

Legjislacioni i lartpërmendur është zbatuar plotësisht nga Agjencia Kosovare e Pronës. Nga 41.958 kërkesa të pranuar, deri më tani, 29.797 kërkesa janë shqyrtuar dhe pjesa e mbetur është në pritje të gjykimit. Paralelisht me kërkesat për gjykim, Agjencia është e angazhuar në vendime përmes ririposimit, administratës apo mbylljes së rastit. Numri i përgjithshëm i pronave ndër administrim është 5.542, nga të cilat 1.032 janë sipas marrëveshjeve me qira.

- Cilat janë situatat /sfidat kryesore/ veprimet (duke përfshirë bashkëpunimin me autoritetet rajonale dhe lokale dhe OJQ-të, financimi), sa i përket, diskriminimit seksual (grupet LGBT) në Kosovë, në aspektin e diskriminimit, tolerancës nga shoqëria, njohjen e të drejtave?

Sipas Planit të Veprimit (2013-2015) për shkak të zbatimit të Ligjit Kundër Diskriminimit, objektivat e tij kryesore përfshijnë organizimin e fushatave publike, informacionin që i përket shpërndarjes së Ligjit Kundër Diskriminimit, promovimin e zbatimit të tij si dhe organizimin e debateve dhe tryezave të rrumbullakëta. Më 3 Nëntor 2011, u organizua një takim formal me përfaqësuesit e komunitetit të LGBT (Lesbikëve, Homoseksualëve, Biseksualëve dhe komuniteti trans-seksual), me qëllim të mbrojtjes efektive dhe promovimin e të drejtave të komunitetit LGBT të cilat janë të garantuara me Kushtetutë, Ligj Kundër Diskriminimit dhe politikat dhe strategjitë e ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe anti-diskriminim. Ky ishte takimi i parë i këtij lloji, në mes të institucioneve dhe komunitetit me participim të 9 përfaqësuesve. Qëllimi përfundimtar i këtij takimi ishte forma e eksplorimit dhe modalitetet e bashkëpunimit të mirë si dhe kërkimi i mënyrave për aktivitete të përbashkëta dhe projekte për një shoqëri demokratike, të barabartë dhe pa diskriminim në bazë të orientimit seksual. Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut dhe Mundësive të Barabarta kanë ftuar anëtarët e LGBT të jenë pjesë e grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Ligjit Kundër Diskriminimit si dhe pjesëmarrës në fushatat e ngritjes së informimit të përcaktuara për të drejtat e njeriut dhe mos diskriminimit në bazë të orientimit seksual. Në mënyrë që të bashkëpunojnë dhe me efikasitet të promovojnë të drejtat e komunitetit, Zyra për Qeverisje të Mirë do të zhvillojë takime të rregullta me komunitetin LGBT, duke marrë në bord shqetësimet e tyre dhe për të adresuar rekomandimet specifike të institucioneve përkatëse me mandat në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.2.3. Respekti për të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve

- Cila është situata/ sfidat kryesore/ veprimet e ndërmarra (duke përfshirë bashkëpunimin me autoritetet regjionale dhe lokale, duke përfshirë OJQ-të, financimi) i popullatës Rome (duke përfshirë ashkalitë dhe egjiptianët) në fushën e arsimit, punësimit, strehimit, shëndetit dhe diskriminimit.

Zyra për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit në bashkëpunim me të gjitha komunat e Kosovës është duke e përkrahur projektet e infrastrukturës, të tilla si ndërtimin e rrugëve, shtëpive, furnizimin me ujë dhe ujërave të zeza. Këto projekte janë më së shumti të dedikuara për komunitetin RAE. Për më tepër, ZÇK-ja e financon dhe organizon aktivitetet për ditën e Komunitetit RAE. Gjatë vitit 2012, 6 shtëpi janë ndërtuar, ndërsa 4 rastet sociale që i përkasin komunitetit RAE dhe 8 shtëpi të tjera janë duke u ndërtuar aktualisht për komunitetin e minoriteteve.

Gjithashtu ZÇK-ja çdo vit shpall thirrje për propozime (bursë) duke u fokusuar në të drejtat e komuniteteve, duke përfshirë arsimimin, punësimin, ngritjen e ndërgjegjësimit lidhur me çështjen shëndetësore dhe anti-diskriminimin. Përveç kësaj, rrjeti i furnizimit me ujë është duke u ndërtuar në Gërmaqare fshat në komunën e Prizrenit banuar nga komuniteti Boshnjak dhe në komunën e Parteshit të banuar me komunitet Serb. Gjatë vitit 2012, një shkollë në Bostan, fshat në Novobërdë është rinovuar, për nxënësit e komunitetit Romë dhe Serb. ZÇK-ja me fondet e saj mbështetë studentët e komunitetit të minoriteteve për të studiuar në Universitetin Amerikan në Kosovë. ZÇK mbështet projekte të ndryshme edukative për rininë, sportin, kulturën dhe trashëgiminë kulturore (së fundi ka mbështetur klubin e futbollit në Pasjan dhe OJQ-në "Future without Fear" në Shtërpce).

Për më shumë, faza e parë e një projekti në vazhdim 'Ali Ibra' është kompletuar ku 29 familje të RAE-së janë vendosur në shtëpi të reja. ZÇK-ja ka ndarë fondet e saj dhe ka mbështetur familjet e RAE-së duke iu ndërtuar shtëpi në Obiliq.

Bashkëpunimi me autoritetet lokale dhe OJQ-të: ZK-ja ka organizuar 5 takime regionale me qëllim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit në mes të qeverisjes qendrore dhe lokale për zbatimin e strategjisë së RAE-së.

Edukimi: Qeveria e Kosovës i jep rëndësi të veçantë edukimit të fëmijëve të komunitetit RAE. MASHT-i shpërndan libra falas për nxënësit e komunitetit RAE nga klasa e 1-ë deri në të 9-ën. MASHT ka formuluar programin dhe nga Tetori 2011 ka filluar të organizoj dhe ofroj lëndë zgjedhore për nxënësit e klasës së 2-të në 5 shkolla fillore në komunën e Prizrenit. Më shumë, MASHT-i ka organizuar kurse me qëllim që të zvogëloj nivelin e analfabetizmit në komunitetin RAE, për 120 femra.

MASHT-i në bashkëpunim të ngushtë me Drejtoritë komunale për arsim dhe OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare ka ndërmarrë aktivitete që synojnë zvogëlimin e braktisjes së shkollës dhe përfshirjen e nxënësve të rritur në shkolla nëpër komunat e banuara nga komuniteti RAE. Shembulli konkret është që gjatë vitit 2012 numri i nxënësve që janë përfshirë në edukim është 14% më i lartë, krahasuar me atë të vitit 2009-2010.

Situata aktuale në shkolla është:

- a. Fëmijët e komunitetit Roman të përfshirë në edukimin para-shkollor - 57
 - b. Fëmijët e komunitetit Ashkali të përfshirë në edukimin para-shkollor - 2
 - c. Fëmijët e komunitetit Egjiptian të përfshirë në edukimin para-shkollor - 0
 - d. Gjithsej: 59
-
- a. Fëmijët e komunitetit Roman të përfshirë në edukimin para-fillor - 79
 - b. Fëmijët e komunitetit Ashkali të përfshirë në edukimin para-fillor - 159
 - c. Fëmijët e komunitetit Egjiptian të përfshirë në edukimin para-fillor - 52
 - d. Gjithsej: 290
-
- a. Fëmijët e komunitetit Roman të përfshirë në edukimin fillor - 1566
 - b. Fëmijët e komunitetit Ashkali të përfshirë në edukimin fillor - 3541
 - c. Fëmijët e komunitetit Egjiptian të përfshirë në edukimin fillor - 1378
 - d. Gjithsej: 6485
-
- a. Fëmijët e komunitetit Roman të përfshirë në edukimin sekondar - 70
 - b. Fëmijët e komunitetit Ashkali të përfshirë në edukimin sekondar - 243
 - c. Fëmijët e komunitetit Egjiptian të përfshirë në edukimin sekondar - 213
 - d. Gjithsej: 526

Shëndetësia: Ministria e Shëndetësisë ka identifikuar rëndësinë e participimit aktiv të komunitetit RAE në procesin e kampanjave rreth ngritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me menaxhimin e mbeturinave dhe higjienës personale. Kjo komponentë e komunitetit RAE është parashikuar gjithashtu për vitet në vazhdim.

Gjatë viteve 2010-2011, MSH ka organizuar 6 sesione të trajnimeve në Fushë Kosovë, Lipjan, Hallaq dhe Medveq ku kanë marrë pjesë 90 femra nga mosha 15 deri në 50 vjeçare. Temat të cilat janë diskutuar në këto sesione janë: edukimi seksual, perspektiva gjinore, dhuna ndaj grave, shëndetësia ri-prodhuese dhe planifikimi familjar, metodat dhe mjetet kontraceptive, infeksionet seksuale dhe sjelljet e rrezikshme për ITS (infeksionet që transmetohen seksualisht) dhe HIV/AIDS.

Për më shumë, në bashkëpunim me OJQ-në "Health for All" "Shëndet për të gjithë", kanë organizuar trajnime të ndryshme për të rinjtë me qëllim që ti njoftojnë sa më shumë në edukimin shëndetësor dhe parandalimin e HIV/AIDS, duke përfshirë 12 pjesëmarrës nga mosha 17 deri në 34 vjeçare. Gjithashtu, AFH (Akti Final i Helsinkit) me mbështetjen e OJQ-së ARTPOLIS ka organizuar një ekspozitë dramatike në lidhje me HIV/AIDS.

Strehimi: Qeveria e Kosovës ka përfunduar një projekt me kamp 'Osterode' në komunën e Mitrovicës, ku 4 strehimore janë përfunduar; duke mbuluar 20 apartamente dhe 48 familje të komunitetit RAE janë vendosur dhe familjet të tjera janë vendosur në 40 strehimore. Në përputhje me marrëveshjen e arritur me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, me programet RESTART dhe EU-MRSI, 119 familje RAE janë zhvendosur nga kampi Osterode, kurse 19 familje të tjera janë duke pritur për përfundimin e ndërtimit të strehimores, që më në fund të largohen nga kampi. Kampi Osterode do të mbyllet më 30 Qershor 2012, ndërsa Cesmin Lug u mbyll zyrtarisht më 4 Tetor 2010.

- Cila është situata/ sfidat kryesore/ veprimet e ndërmarra (duke përfshirë bashkëpunimin me autoritetet regjionale dhe lokale, duke përfshirë OJQ-të, financimi) e minoritetit Serb në fushën e lirisë dhe fesë (veçanërisht në kishën Ortodokse-Serbe), dhuna, mbrojtja e gjuhës serbe, mbrojtja e simboleve dhe hapësirave fetare (për shembull, kishat Ortodokse dhe manastiret) mbrojtja e simboleve dhe hapësirave fetare (për shembull, kishat Ortodokse dhe manastiret) dhe diskriminimi në përgjithësi?

Neni 9 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligji 02/L-88 në Trashëgiminë Kulturore siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Ligji Nr. 03/L-035 për Policinë, përkatësisht neni 11.5 përcakton që Policia të ofrojë sigurim dhe mbrojtje për pjesët e trashëgimisë fetare dhe kulturore në Republikën e Kosovës.

Vëmendje e veçantë i kushtohet objekteve dhe pajisjeve të cilat i përkasin bashkësive fetare dhe që janë të dedikuara për ritualet fetare. Pra, këto objekte dhe pajisje konsiderohen si të padëmtuara në lidhje me intervenimin e autoriteteve Qeveritare, vetëm atëherë nëse një urdhër është lëshuar për shkak të aktiviteteve ilegale dhe/ose në rastet e rrezikut të jetës apo shëndetit.

Sa i përket financimit, bashkësitë fetare gëzojnë privilegje doganore dhe tatimore për aktivitetet ekonomike që janë specifike për qëndrueshmërinë financiare. Këto privilegje përfshijnë importin dhe blerjen e produkteve themelore për prodhim, materialet, pajisjet dhe bagëtitë si dhe eksportimin e këtyre produkteve (Kodi Doganor dhe Akcizave i Republikës së Kosovës, nr. 03/L-109 Aneksi D).

Sa i përket përdorimit të gjuhës, Rregulla nr. 07/2012 në Zyrën e Komisionarit për gjuhë u miratua më 4 Prill 2012, që paraqet përparim në aspektin e përdorimit të gjuhëve nga Zyre e Komisionarit të Gjuhëve. ZKGGJ ka mbajtur 4 takime të grupit punues për themelimin e Zyrës së Komunikimit për Gjuhë

- Çfarë mekanizmi ka Kosova për të vënë në vend zbatimin dhe raportimin e implementimit të kornizës së KE-së (Këshilli i Evropës) në Konventën për të Drejtat e Minoriteteve?

Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, OSBE dhe Këshillit të Evropës në 2008-ën ka themeluar një Grup Punues që ka monitoruar zbatimin e rekomandimeve të shfaqura pas raportimit në Kornizën e KE-s] në Konventën për të Drejtat e Minoriteteve. ZQM-ja gjatë vitit 2010 ka zhvilluar dhe publikuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga KE-ja dhe plani është dorëzuar tek Sekretari i KE-së. Ky plan kanë qenë një ndihmë e madhe për zbatimin e kornizës së konventës për mbrojtjen e minoriteteve.

- Cilat janë rekomandimet kryesore të KE-së në implementimin e kësaj Konvente?

Rekomandimet kryesore të KE-së në zbatimin e Konventës janë si më poshtë:

- a. Përmirësimi i kushteve shëndetësore të komunitetit RAE në kampe;
- b. Mbrojtje institucionale për objektet dhe qendrat fetare;
- c. Amendamenti i Ligjit të Gjuhës;
- d. Për të ngritur përpjekjet për t'iu mundësuar personave që u përkasin të gjitha komuniteteve të jenë aktiv në pjesëmarrje të jetës ekonomike dhe sociale në Kosovë;
- e. Sigurimi i mësimdhënies në gjuhët e pakicave.

- Si i ka adresuar Kosova këto rekomandime?

Disa nga rekomandimet që Kosova i ka adresuar janë si më poshtë:

- a. Të gjithë fëmijët RAE janë të vaksinuar dhe të pajisur me karta, nuk ka raste të regjistruara të tetanozit. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë bën matjet periodike të gjakut të kontaminuar me plumb dhe trajton rastet individuale;
- b. Në pajtueshmëri me marrëveshjen e arritur me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, programet RESTART dhe EU-MRSI, 119 familje RAE janë zhvendosur në kampin Osterode, ndërsa 19 të tjera janë duke pritur për përfundimin e ndërtimit të strehimoreve që më fund të lëshojnë kampin. Kampi Osterode do të mbyllet më 30 Qershor 2012, kurse Cesmin Lug është mbyllur zyrtarisht më 4 Tetor 2010;
- c. Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sporteve gjatë vitit 2011 ka themeluar një grup punues për të studiuar dhe regjistruar trashëgiminë kulturore shpirtërore të komunitetit RAE;
- d. Ligji në Përdorimin e Gjuhëve Nr. 02/L-37, u miratua më 27 Korrik 2006. Rregulli Nr. 07/2012 në Zyrën e Komisionarit të Gjuhëve u aprovua më 4 Prill 2012;
- e. Shumica e komunave tashmë kanë adoptuar rregullat lokale për implementimin e Ligjit për Gjuhë;
- f. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka ofruar ndihmë emergjente prej €36.500, pra rreth 7% e këtij totali iu është dedikuar komunitetit RAE;
- g. Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka zhvilluar programet në gjuhën Rome dhe deri më tani ka trajnuar dhe punësuar 3 mësues. MASHT gjithashtu ka siguruar transportin e nxënësve që udhëtojnë më shumë se 2km.

1.2.3.1. Institucionet/Përfaqësimi

- Cilat dispozita ligjore ekzistojnë?

Dispozitat të cilat zënë vend në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi lidhur me pakicat janë konventat ndërkombëtare të cilat zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës në përputhshmëri me Kushtetutën:

- a. Akti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (veçanërisht Neni 27);
- b. Këshilli i Evropës – Konventa për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- c. Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- d. Konventa Ndërkombëtare për Eliminim e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave

Marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të detyrueshme në Republikën e Kosovës, në përputhje me Kushtetutën:

- a. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës;
- b. Përfshirja e dispozitave të përgjithshme; Aneksi I mbi dispozitat kushtetuese; Aneksi II mbi të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre; Aneksi III mbi decentralizimin; dhe Aneksi V mbi trashëgiminë fetare dhe kulturore.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

- a. Duke përfshirë Kapitullin III për të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre;

Legjislacioni që lidhet me të drejtat e komuniteteve:

- a. 03/1-047 Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
- b. 2008/03-L068 Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës;
- c. 2006/02-L37 Ligji për Përdorimin e Gjuhëve;
- d. 2008/03-L040 Ligji për Qeverisjen Lokale;
- e. 2008/03-L041 Ligji për Kufijtë Administrativ të Komunave;
- f. 2006/02-L88 Ligji për Trashëgiminë Kulturore;
- g. 2008/03-L39 Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura;
- h. 2006/02-L31 Ligji për Liritë Fetare në Kosovë;
- i. 2008/03-L064 Ligji për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës;
- j. 2010/03-L237 Ligji për Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave.

Legjislacioni Sekondar:

- a. Rregullorja e Qeverisë Nr. 02/2010 mbi Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim

Rregullorja e MPA-së mbi procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve pakicë në shërbimin civil: Termat e Referencës për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) të miratuara nga Grupi Punues ndër-ministral më 21 Prill 2011 Aneksi 8.1 (c).

Legjislacioni tjetër përkatës mbi komunitete, anti-diskriminim dhe qasje në shërbimet publike

- a. 2004/3 Ligji Kundër Diskriminimit; 2004/2 Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë; 2010/03-L-172 Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- b. Shëndeti: 2004/4 Ligji mbi Shëndetin, 2008/03-L-124 Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Shëndetësi;
- c. Edukimi: 2006/02-L-52 Ligji mbi Edukimin Parashkollor; 2002/2 Ligji mbi Edukimin Fillor dhe të Mesëm; 2002/3 Ligji mbi Edukimin e Lartë në Kosovë; 2005/02-L-24 Ligji për Arsimimin dhe Aftësimin e të Kërkuesve;
- d. Mirëqenia Sociale: 2003/15 Ligji për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë; 2005/02-L-17 Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare; 2004/32 Ligji mbi Familjen; 2003/23 Ligji për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar në Kosovë; 2008/03-L-019 Ligji për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- e. Punësimi: 2010/03-L-212 Ligji i Punës; 2006/02-L42 Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional
- f. Shtetësia, Regjistrimi Civil, Dokumentet Personale, Regjistrimi i Vendqëndrimit: 2000/13 UNMIK Rregullorja mbi Regjistrimin Civil Qendror; 2008/03-L034 Ligji për Shtetësinë e Kosovës; 2007/02-L118 Ligji për Emrin Personal; 2004/46 Ligji mbi Regjistrat Civil; 2007/02-L126 Ligji për Ndryshimin e Ligjit nr. 2004/46 mbi Regjistrat e Gjendjes Civile; 2008/03-L037 Ligji për Dokumentet e Udhëtimit; 2008/3-L099 Ligji për Letërnjoftimin; 2007/02-L121 Ligji për Vendbanim dhe Vendqëndrim, Shërbimet Civile: 2010/03-L-149 Ligji për Shërbimet Civile në Republikën e Kosovës; 2010/03-L-147 Ligji mbi Pagat e Shërbyesve Publik; 2010/03-L-192 Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të

Kosovës; 2010/03-L-215 Ligji për Qasje në Dokumente Publike; "Termet e Referencës për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) të miratuara nga Grupi Punues nder-ministoror më 21 Prill 2011 Aneksi 8.1 (c).

- g. Çështjet e Pronës: 2008/03-L067 Ligji mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit; 2009/03-L-154 Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore; 2008/03-L079 Ligji për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave, lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale; 2009/03-L-139 Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; 2003/25 Ligji për Kadastrën; 2003/14 Ligji për Planifikim Hapësinor;
- h. Ankesat administrative në lidhje me performancën e shërbimeve publike: 2005/02-L28 Ligji për Procedurat Administrative; 2010/03-L-195 Ligji për Avokatin e Popullit;
- i. Ri-pranimi: 2010/03-L-208 Ligji për Ri-pranim; 2010/03-L-172.

1.2.3.2. Qasja në Edukim

- A janë shkollat fillore dhe të mesme publike në dispozicion të nxënësve minoritar? Nëse është relevante, sa nxënës prej komuniteteve minoritare janë edukuar në shkolla publike? A studiojnë nxënësit minoritar në gjuhën e tyre amtare? A janë plan-programet në gjuhën e tyre amtare (Ju lutem tregoni saktë cila kurrikulë në cilën gjuhë)?

Nxënësit që i përkasin komuniteteve pakicë siç janë Serbët, Boshnjakët, dhe Turqit studiojnë në gjuhën e tyre amtare. Sa i përket gjuhës Rome, një program i gjuhës Rome, kulturës dhe historisë është zhvilluar, kështu që përgjatë vitit shkollor 2011-2012 është testuar si pilot-projekt në komunën e Prizrenit me mbështetjen e një mësimdhënësi në gjuhën rome i punësuar për këtë projekt. Librat e Edukimit Fillor dhe Edukimit të Mesëm të Ulët në gjuhën turke, boshnjake, dhe rome janë dhënë pa pagesë për nxënësit e këtyre tre komuniteteve. Nuk ka libra sa i përket sistemit të Edukimit Sekondar të lartë në gjuhën boshnjake dhe turke. Librat e Sistemit Sekondar të Lartë janë dhënë nga një OJQ e Bosnjës në Kosovë me mbështetjen e kantonit të Tuzllës për vitin e ardhshëm akademik 2012-2013, kurse librat e të njëjtës natyrë në gjuhën turke janë dhënë nga Ambasada Turke në Kosovë për 2012, 2013, dhe 2014 (për më shumë informata ju lutem referohuni pyetjes: **"A i gëzojnë nxënësit minoritarë të njëjtat të drejta si nxënësit e tjerë në aspektin e dispozitave të teksteve shkollore dhe të transportit me autobus deri në lokalet e shkollës?"**)

Për më shumë, programi në gjuhën Serbe është zhvilluar që të mbulojë klasat 1 deri në 9, por është duke u refuzuar nga komuniteti serb. Megjithatë, në përputhje me dispozitat ligjore, komuniteti Serb është i kualifikuar në përdorimin e programit dhe librave nga Serbia. Prandaj, MASHT-i ka themeluar një komision në përbërje të 3 Shqiptarëve, 3 Serbëve dhe 1 Ndërkombëtarë që kanë rishikuar gjithë programin dhe librat në gjuhën Serbe dhe po ashtu kanë lëshuar një raport me rekomandime (shiko ueb faqen e MASHT-it për më shumë detale).

Programi për komunitetin boshnjak dhe turk është në dispozicion për Edukimin Parashkollor, Edukimin Fillor, Edukimin e Ulët Sekondar, Edukimin e Lartë Sekondar, Shkollimin Profesional dhe Edukimin Joformal. Gjithashtu, programi në gjuhën Shqipe për komunitetet jo-shqiptare është në dispozicion për klasat 1 deri në 9.

- A i gëzojnë nxënësit minoritar të njëjtat të drejta si të tjerët në aspektin e dispozitave të teksteve shkollore dhe transportit me autobus ne lokalet e shkollave.

Bazuar në statistika, në shkollat publike në territorin e Republikës së Kosovës janë rreth 17.500 nxënës të komunitetit Serb (të dhënat nuk janë të plota) 5289 nxënës të komunitetit boshnjak, 3050 të komunitetit turk, 1772 nxënës të komunitetit Romë, Ashkali 3945, Egjiptian 1643, Kroat 34 dhe Goranë 81. Nxënësit që u përkasin grupeve minoritare studiojnë në gjuhën e tyre amtare. Edukimi për minoritete në shkolla publike ofrohet në të gjitha nivelet duke filluar nga niveli para-shkollor

deri në nivelin universitar që ofrohet në gjuhën Serbe, Boshnjake, dhe Turke. Nxënësit e komunitetit RAE mësojnë po ashtu në gjuhën shqipe.

Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka zhvilluar plan programe në gjuhët e komuniteteve pakicë:

Në gjuhën boshnjake, plan programet në vijim janë zhvilluar:

- a. Plan programi për arsimin para shkollor;
- b. Standardet për arsimin parashkollor;
- c. Plan programi në gjuhën boshnjake nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të;
- d. Plan programi për shkollat e mesme;
- e. Plan programi për arsimin profesional për profile të ndryshme;
- f. Plan programi për arsimin jo formal, nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të.

Në gjuhën turke, plan programet në vijim janë zhvilluar:

- a. Standardet për arsimin parashkollor;
- b. Plan programi në gjuhën turke nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të;
- c. Plan programi për shkollat e mesme;
- d. Plan programi për arsimin profesional për profile të ndryshme;
- e. Plan programi për arsimin jo formal, nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të.

Në gjuhën rome, plan programet në vijim janë zhvilluar:

- a. Plan programi në gjuhën rome përmban elemente të historisë dhe kulturës.

Në gjuhën serbe, plan programet në vijim janë zhvilluar:

- a. Plan programi në gjuhën serbe nga klasa e 1-rë deri në klasën e 12-të.
- b. është përpiluar dhe miratuar Korniza e plan programit të edukimit para-universitar në gjuhën serbe në Republikën e Kosovës

Nxënësit nga komunitete e ndryshme që jetojnë në Kosovë gëzojnë të njëjtat të drejta me nxënësit që i përkasin grupeve shumicë. Nxënësit e të gjitha komuniteteve janë të pajisur me tekste shkollore falas çdo vit duke filluar nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të në gjuhën e tyre përkatëse. Të gjitha tekstet shkollore në gjuhën e komuniteteve janë të financuara nga buxheti i Republikës së Kosovës. Transporti i nxënësve nga shkolla deri në shtëpi dhe anasjelltas, deri në distancën 5 km bëhet me autobus, falas. Transporti ofrohet dhe financohet nga drejtoria komunale për edukim.

1.2.3.3. Gjuhët Zyrtare

- Çfarë në lidhje me amendamentimin e planifikuar të ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare?

Ka pasur disa mangësi në zbatimin e Ligjit aktual mbi Përdorimin e Gjuhëve. Në këtë drejtim Kryeministri i Republikës së Kosovës, më 4 Prill e ka nënshkruar Rregulloren Nr. 07/2012 në Zyrën e Komisionarit për Gjuhët që ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e gjuhëve zyrtare dhe statusin e tyre të barabartë në Republikën e Kosovës dhe në të gjitha komunat, si dhe të sigurojë mbrojtjen e gjuhëve të komuniteteve që nuk janë në mesin e gjuhëve zyrtare.

Një grup punues për reformimin e Zyrës së Komisionarit për gjuhët është themeluar dhe deri më tani ka mbajtur 4 takime që janë kryesuar nga ZÇK-ja. Në këtë drejtim, duke e pasur parasysh që Qeveria ka miratuar Rregulloren Nr. 07/2012 që mbulon fushën e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe ka bërë përparim në adresimin e mangësive, është konstatuar se nuk ka nevojë për amendamentimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

- Cilat janë objektivat e Projekt-Ligjit të amendamentuar?

Duke e pasur parasysh që Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Rregulloren Nr. 07/2012 në themelimin e Zyrës së Komisionarit për Gjuhët dhe ka si qëllim themelimin e Bordit për politikën gjuhësore dhe që përfaqësohet nga institucione të ndryshme të Republikës së Kosovës dhe gjithashtu krijimit të një rrjeti të politikave gjuhësore. Një plan punues i këtij grupi punues është miratuar. ZÇK-ja ka koordinuar një proces të përzgjedhjes së përfaqësuesve të Bordit për politikën gjuhësore.

- Cilat janë gjuhët zyrtare në Kosovë?

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 5 paragrafi 1 thotë se: 'Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe', dhe vazhdon në paragrafin 2 të po të njëjtit nen: 'Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj që është, me Ligjin për Gjuhët Nr. 02/L-37.

Ligji për Gjuhët ka për qëllim të rregullojë:

- a. Përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare në institucionet e Kosovës, ndërmarrjeve publike dhe organizatave të tjera që ofrojnë shërbime ose kanë funksione publike;
- b. Të drejtën e komuniteteve në Kosovë për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor;
- c. Karakterin shumë gjuhësor të shoqërisë kosovare në tërësi në përfaqësimin e identitetit shpirtëror unik, intelektual, historik dhe kulturor.

Gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës kanë një status të barabartë në institucionet e saj. Kurse në nivelin lokal, në qoftë se të paktën 5% e banorëve të komunës kanë si gjuhë amtare një gjuhë tjetër përveç asaj që cilësohet si gjuhë zyrtare atëherë gjuha amtare gëzon të drejtën të jetë gjuhë zyrtare në nivel komunal dhe të ketë status të barabartë të përdorimit si gjuhë zyrtare. Për më tepër, nëse së paku 3% e banorëve të komunës kanë si gjuhë amtare një gjuhë tjetër që nuk cilësohet të jetë zyrtare, atëherë gjuha amtare gëzon statusin e gjuhës zyrtare në nivel komunal, përveç kësaj, i njëjti trajtim i jepet gjuhëve që fliten tradicionalisht në një komunë të caktuar.

- A është zbatimi i Ligjit aktual për përdorimin e gjuhëve zyrtare i kënaqshëm? Pse?

Më 4 Prill 2012 ka hyrë në fuqi Rregullorja e Qeverisë Nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionarit për Gjuhët. Si rezultat:

- a. Komisioni ka pezulluar funksionin e tij;
- b. Do të zëvendësohet me një Zyre të re të Komisionarit për Gjuhët; pra mandati i tij është rregulluar me Rregulloren nr. 07/2012.

Përderisa Zyra e Komisionarit të jetë plotësisht funksionale, nëse një ankesë dorëzohet në lidhje me shkeljet e supozuara të të drejtave gjuhësore në bazë të ligjit për gjuhët, hapat e mëposhtëm do të ndërmerren:

- a. Shërbimi Arkivues në Zyrën e Kryeministrit do të regjistrojë ankesën;
- b. Një kopje e ankesës së aplikuesit mbahet;
- c. Zyra e Kryeministrit / Zyra për Çështje të Komuniteteve do të bëjë regjistrimin dhe ruajtjen e ankesës;

Pasi që Zyra e Komisionarit për gjuhë të hyjë në funksion, ajo do të shqyrtojë dhe përpunojë ankesat në pajtim me Rregulloren e Qeverisë Nr. 07/2012.

1.2.3.4. Mediat e Minoriteteve

- A ka themeluar Kosova një fond për mediat e minoriteteve? Nëse është relevante, sa është buxheti vjetor i këtij fondi?

Fondi për mbështetjen e Minoriteteve, grupeve shumë-etnike dhe Mediave jo të favorizuara është krijuar në bazë të Strategjisë Politike për Mediat e Komuniteteve Pakicë në Kosovë që është miratuar nga Qeveria më 19 Prill 2005. Qeveria me vendimin e saj të marrë më 6 Maj 2005 ka ndarë €50.000 për këtë Fond dhe ka aprovuar vendimin për themelimin e Komisionit për menaxhimin e këtij Fondi. Ligji për RTK-në ka vendosur të ndajë 5% prej fondit të mbledhur nga taksa e transmetimit publik për Fondin në Mbështetje të Minoriteteve, grupeve shumë-etnike dhe Mediave jo të favorizuara. Përveç kësaj, Qeveria ka miratuar Rregulloren për Funkcionimin e Fondit, procedurat e tij, dhe gjithashtu rregullat e procedurave për fondin brenda Zyrës për Komunikim Publik (ZKM). Fondi menaxhohet nga Komisioni që përbehet nga 7 anëtarë nga rregullatorët për media të pavarura dhe shoqërisë civile. Deri më tani, Fondi ka shpallur katër thirrje për propozime dhe ka ndarë 43 grande, me një shumë të përgjithshme prej €310.882.

Mediat transmetuese në gjuhët e minoriteteve, multi-etnike apo mediat në shërbim të komuniteteve me nevoja të veçanta kanë përfituar nga këto grande (32 transmetues) dhe deri me sot, 425,902 € kanë qarkulluar duke përfshirë shumën që Fondi mban aktualisht në llogari (106.246 € për vitin 2012). Komisioni është duke punuar në procesin e përzgjedhjes nga 56 media që kanë aplikuar për grande, duke e pasur parasysh që thirrja e hapur është mbyllur në fillim të Majit. Ligji i ri për RTK-në që ka hyrë në fuqi më 9 Maj 2012 ka hequr dispozitën që më parë ka autorizuar ndarjen e 5% të Fondeve që bëhen përmes para-pagesës për RTK-në. Qeveria ka premtuar që në të ardhmen do të bëjë financimin e qëndrueshëm të fondit.

- Cila është përqindja e programeve televizive të transmetuara në gjuhët e minoriteteve në TV-të publike në vitin 2011, si pjesë e përgjithshme e kohës së transmetimit ?

Sa i përket të dhënave statistikore për programet e transmetimit të minoriteteve, duke u bazuar në raportin vjetor të RTK-së, transmetuesi ka përmbushur 15% të skemës së paraparë programore të RTK-së dedikuar minoriteteve.

-Implementimi i Ligjit të ri për transmetuesin publik, kur Kosova është duke planifikuar të vejë në operim kanal publik në gjuhën serbe?

Sipas Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës Nr. 04/L-46 i miratuar nga Kuvendi më 29 Mars 2012, Neni. 8 (Përbërja, skema e RTK-së) Paragrafi 7 parashikon si më poshtë: 'Menaxhmenti dhe bordi i RTK-së duhet të marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar funksionimin operacional të kanalit RTK 2 në gjuhën serbe si ofrues i përmbajtjes jo më vonë së dymbëdhjetë (12) muaj nga miratimi i këtij lig.

1.2.3.5. Romë, Ashkali dhe Egjiptian

- Cili është statusi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të adresuar çështjet e RAE-së?

Sipas Planit të Veprimit për implementimin e Strategjisë RAE dhe indikatorëve të saj, është vënë re një progres mesatar në përmirësimin e jetës së këtyre komuniteteve si në fushën e arsimit, shëndetit, strehimit, zhvendosjes nga kampet, dhe përfshirjen në jetën e përgjithshme shoqërore dhe kulturore.

Është me rëndësi që të përmendet që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe po ashtu OJQ-të ka ndërmarrë disa aktivitete që të ulë nivelin e braktisjes së shkollave dhe të rritë numrin e fëmijëve të regjistruar në shkollë. Është vërejtur një tendencë pozitive sepse numri i fëmijëve të regjistruar në shkollë është rritur 14%

në krahasim me periudhën kohore 2009-2010. Përveç kësaj, programi në gjuhën rome është zhvilluar.

Për më tepër, Qeveria ka zbatuar një projekt për zhvendosjen nga Kampi 'Osterode' në Komunën e Mitrovicës ku banesat e banimit janë ndërtuar dhe 48 RAE janë vendosur, dhe 40 të tjera janë vendosur nëpër shtëpi.

Sa i përket fushës së kujdesit shëndetësor, fëmijët e komunitetit RAE janë vaksinuar dhe po ashtu janë pajisur me karta të shëndetit, dhe asnjë rast i tetanusit nuk është regjistruar. Mistrria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë siguron ekzaminime periodike të gjakut të kontaminuar me plumb dhe ofron trajtim për raste individuale, atëherë kur kontaminimi i tillë ndodh.

Sa i përket fushës së mirëqenies sociale, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka ndarë një fond për ndihmë emergjente në vlerë prej € 36,500 nga të cilat 7% i dedikohen komunitetit RAE. Raporti i plotë në zbatimin e Strategjisë për RAE-në do të publikohet në Qershor 2012.

- Sa është shuma e ndarë e buxhetit publik për vitin 2012 për këtë qëllim ?

Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka përcaktuar ndonjë fond të veçantë për këtë qëllim, mirëpo ministritë e linjës kanë ndërmarrë aktivitete dhe ndarë buxhetin në bazë të projekteve dhe qëllimeve që janë nxjerrë nga Plani i Veprimit në Implementimin e Strategjisë për Integrimin e Komunitetit RAE, për vitin 2012 ndarja e buxhetit nga ministritë linjë është si vijon:

- a. Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK), € 338,112.11;
- b. Ministria për Kthim dhe Komunitete, € 445,936.68;
- c. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Komuniteteve, € 183,000.00;
- d. Ministria e Shëndetësisë, € 93,000;
- e. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, € 67,000.00;
- f. Ministria për Zhvillim Ekonomik, € 4,000.00;
- g. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, € 2,834,522.00;
- h. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, € 9,500.00.

- Cilat janë sfidat kryesore që Kosova po përballlet për të përmirësuar gjendjen/ integrimin e këtyre tri komuniteteve në nevojë?

Planifikimi adekuat buxhetor dhe menaxhimi i tij efektiv: Ndarja e saktë e buxhetit ka qenë një nga sfidat kryesore deri më sot, gjë që nënkupton se nuk ka linjë të veçantë të ndarë nga buxheti siç është e paraparë me Planin e Veprimit për integrimin e komuniteteve RAE.

Koordinimi ndërinstytucional në nivel lokal: Bashkëpunimi në nivel qendror të Qeverisë është vlerësuar si më efikas, ndërsa në nivel komunal komunikimi është kanalizuar përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. ZQM/ZKM është në proces të shqyrtimit të formave të tjera të bashkëpunimit në nivel lokal, si dhe në përmirësimin e komunikimit dhe koordinimit me komunat tjera përkatëse.

Punësimi dhe Mirëqenia Sociale: cilësohen të jetë një nga sfidat më të mëdha për komunitetet RAE. Mundësitë e punësimit janë të kushtëzuara mbi kualifikimet e nevojshme dhe arsimimin. Shërbimet sociale iu ofrohen në mënyrë të barabartë të gjithë atyre që kanë nevojë pa dallim, mirëpo duke pasur parasysh që këto shërbime mbulojnë vetëm shpenzimet e jetesës dhe janë shumë larg përmirësimit të situatës ekonomike për anëtarët e të tri komuniteteve.

Ri-integrimi dhe riatdhesimi: mbetet një sfide, veçanërisht në edukim, punësim dhe strehim. Fëmijët e komunitetit RAE, pas procesit të riatdhesimit zakonisht nuk posedojnë njohuri të ndonjë gjuhe

zyrtare. Për të ndihmuar këtë proces MASHT-i ka filluar të ofrojë kurse të gjuhëve në mënyrë që të mundësojë kyçjen e fëmijëve të komunitetit RAE në sistemin arsimor. Për më tepër, sa i përket strehimit, MKK-ja bashkë me ZÇK/ZKM dhe në bashkëpunim të ngushtë me komunat janë duke bërë përpjekje të mëdha në akomodimin dhe zgjidhjen e çështjeve të banimit për familjet e këtyre komuniteteve.

1.2.3.6. Refugjatët dhe të Zhvendosurit Brenda Vendit

- A ka zhvilluar Kosova ndonjë politikë për krijimin e kushteve për kthimin dhe ri-integrimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit në Kosovë?

Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Ministrisë për Kthim dhe Komunitete ka zhvilluar dhe miratuar Strategjinë për Komunitete dhe Kthim 2009-2013, ndërsa politikat për të krijuar kushte të qëndrueshme për kthim dhe ri-integrim të refugjatëve dhe të zhvendosurve brenda vendit janë zhvilluar në bazë të kësaj strategjie. Këto politika trajtojnë vizionin e përgjithshëm për kontribut drejt zhvillimit të një shoqërie shumë-etnike, të begatë dhe demokratike me të drejta të barabarta.

Për të arritur këtë vizion, kjo strategji fokusohet në tri objektiva kryesore siç është një komunitet i qëndrueshëm, kthim i qëndrueshëm dhe ri-integrim i personave të zhvendosur brenda vendit, si dhe ri-integrimin ekonomik të komuniteteve. Si rezultat, përmirësimet e mëposhtme janë bërë në fusha të tilla si:

I. Fuqizimi dhe Stabilizimi i Komuniteteve në Kosovë

- a. Fuqizimi i të drejtave të komuniteteve dhe sigurimi i implementimit të Ligjit aktual për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
- b. Sigurimi i pjesëmarrjes shoqërore dhe qasjes së komuniteteve në të gjitha shërbimet publike

II. Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur nga Kosova

- a. Të ofrojë mbështetje për të gjithë të kthyerit në Kosovë;
- b. Të sigurohet që personat e zhvendosur dhe të kthyerit potencial të kenë informacion të mjaftueshëm mbi kushtet e kthimit dhe të drejtat e tyre;
- c. Të ofrohen kushte adekuate në vend për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim të të kthyerve.

III. Mbështetje për zhvillimin ekonomik të komuniteteve në Kosovë, si parakusht kryesor për stabilizimin dhe kthimin e qëndrueshëm të komuniteteve

- a. Sigurimi i mundësive të barabarta për zhvillimin e të gjitha komuniteteve;
- b. Sigurimi i ndarjes së fondeve për projektet që i plotësojnë kushtet për stabilizimin dhe integrimin e komuniteteve.

Qëllimi i tretë fokusohet në përmirësimin e kushteve ekonomike dhe integrimin e përgjithshëm të komuniteteve, duke përfshirë të kthyerit në mënyrë që të promovojnë një shoqëri të qëndrueshme, të begatë dhe shumë-etnike në Kosovë.

Bazuar në Strategjinë, Ministria për Kthim dhe Komunitete ka lëshuar Udhëzime në zbatimin e procesit për të kthyerit, Nr. 711 më 27 Mars 2012. Në përgjithësi Qeveria e Republikës së Kosovës nga aktivitetet e saj nga Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009-2013 ka shënuar arritje në procesin e kthimit dhe krijimit të një jete më të mirë për të gjitha komunitetet që jetojnë në Republikën e Kosovës.

- Cila është shuma mesatare e ndarë nga buxheti publik në pesë vitet e fundit?

Qeveria e Kosovës, me qëllim të krijimit të kushteve për kthim dhe ri-integrim të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit dhe po ashtu integrimin e të gjitha komuniteteve në Kosovë, në 6 vitet e fundit ka ndare një vlerë prej € 41,385,346.00.

Ndarja e të dhënave të buxhetit vjetor të përcaktuar për 6 vitet e fundit:

- a. 2007, € 5,200,000.00;
- b. 2008, € 8,058,433.00;
- c. 2009, € 7,800,000.00;
- d. 2010, € 7,726,913.00;
- e. 2011, € 6,300,000.00;
- f. 2012, € 6,300,000.00.

11.2.3.7. Të drejtat kulturore duke përfshirë trashëgiminë kulturore

- A e ka ratifikuar Kosova Konventën e UNESCO-s 2005 mbi Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjes Kulturore?

Republika e Kosovës nuk e ka ratifikuar Konventën e UNESCO-s 2005 mbi Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore, edhe pse vullneti dhe gatishmëria është shprehur gjithmonë nga pala kosovare për të ratifikuar Konventën. Dispozitat për ratifikim dhe njohje të Konventës parashikojnë që ratifikimi mund të bëhet nga vendet anëtare të UNESCO-s, të vendeve anëtare të OKB-së, por edhe nga shtete dhe territore që janë anëtarë të një agjencie të specializuar të OKB-së, me kusht që ata të marrin një ftesë nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s (Neni 26 dhe 27 i Konventës). Republika e Kosovës është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, por deri më tani nuk ka marrë asnjë ftesë nga UNESCO.

- Cili është korniza ligjor që garanton mbrojtjen e të drejtave kulturore në Kosovë?

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 58 paragrafi 5, parasheh që: 'Republika e Kosovës do të promovoj ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Republika e Kosovës do të ketë detyrë të posaçme për të siguruar mbrojtjen efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve të rëndësishme kulturore dhe fetare për komunitetet.' Më tej, po i njëjti nen paragrafi 6 thotë se: 'Republika e Kosovës ndërmerr veprime efektive kundër të gjithë atyre që pengojnë gëzimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve. Republika e Kosovës do të përmbahet nga politikat ose praktikrat që kanë për qëllim asimilimin, kundër vullnetit të tyre, të personave që u përkasin komuniteteve, dhe do t'i mbrojë ata persona nga çfarëdo veprimi që ka për qëllim një asimilim të tillë.' Për më tepër, neni 59 paragrafi 12, garanton se: 'të gëzojnë kontakte të papenguara ndërmjet tyre përbrenda Republikës së Kosovës, dhe të themelojnë e të mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat në cilindo shtet, sidomos me ata që kanë të përbashkët identitetin etnik, kulturor, gjuhësor a fetar, ose trashëgiminë e përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.'

Korniza ligjore që garanton mbrojtjen e të drejtave kulturore në Kosovë është si në vijim:

- a. Ligji për Institucionet Kulturore Nr. 02/L-57 është miratuar nga Kuvendi më 06 Prill 2006. Ligji parashtron kushtet kryesore, kriteret dhe procedurat për themelimin e institucioneve kulturore, karakterin e tyre, organizimin dhe strukturën menaxheriale, detyrat dhe aktivitetet, obligimet dhe përgjegjësitë dhe gjithashtu çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe funksionimin e institucioneve kulturore;
- b. Ligji për Teatrin Nr. 02/L-12 është miratuar nga Kuvendi më 23 Mars 2005. Ky Ligj rregullon funksionimin e aktiviteteve të teatrit, duke përfshirë themelimin, menaxhimin dhe financimin e teatrove publike dhe private. Për shkak të kërkesave të vazhdueshme të komunitetit të artistëve, Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit ka përpiluar Ligjin e ri për Teatrin dhe tani është në pritje të aprovohet nga Kuvendi;

- c. Ligji për Filarmoninë, Operën, dhe Baletin në Kosovë, Nr. 02/L-59 është miratuar nga Kuvendi më 01 Qershor 2006. Ligji garanton themelimin, punën, organizimin, operimin, dhe funksionimin e institucioneve siç janë: Filarmonia, Opera dhe Baleti në Kosovë. Ky Ligj pritet të amendamentohet përgjatë vitit 2012;
- d. Ligji për Ansamblin Kombëtar Shtetëror të Këngëve dhe të Valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera, Nr. 03/L-56 është miratuar nga Kuvendi më 06 Nëntor 2008. Ky Ligj rregullon funksionimin dhe aktivitetet e Ansamblit Kombëtar Shtetëror të Këngëve dhe Valleve “ Shota” e po ashtu ansamblet tjera kulturore dhe artistike, themelimin, drejtimin, menaxhimin, financat, pozicionimin e artistëve dhe çështje të tjera të rëndësishme në këtë fushë. Ligji pritet të ndryshohet përgjatë vitit 2012.
- e. Ligji për Veprimtarinë Botuese dhe Librin, Nr. 02/L-51 është miratuar nga Kuvendi më 16 Mars 2006. Ky Ligj rregullon principet dhe praktikat themelore për zhvillimin e veprimtarisë botuese, zhvillimin e literaturës, artit, shkencës, krijimit profesional dhe kulturor në Republikën e Kosovës;
- f. Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat tjera të përafërta, Nr. 04/L-065. Ky Ligj rregullon të drejtat mbi pronën dhe aspektin moral të së drejtës së autorit, duke u fokusuar në realizimin dhe mbrojtjen e mbrojtjes së autorit;
- g. Ligji për Libraritë, Nr. 04/L-097 është miratuar nga Kuvendi më 6 Prill 2012. Ky Ligj definon principet bazike për themelimin dhe funksionimin e librarive kombëtare, akademike, komunale, shkollore, me nevoja speciale dhe private.
- h. Rregullorja Nr .05/2011 për gradimin dhe pagat e krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore, rregullon sistemin për gradimin dhe rrogat e krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore, që punojnë në Kulturë dhe Institucione të Trashëgimisë Kulturore.

- Cili është legjislacioni që bën mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme?

Legjislacioni për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme përfshinë:

- a. Ligji për trashëgiminë kulturore Nr. 02/L-88, miratuar nga Kuvendi më 9 Tetor 2006. Qëllimi i këtij ligji është ruajtja, mbrojtja, dhe promovimi i trashëgimisë kulturore. Ligji synon të shqyrtojë masat ligjore për mbrojtjen e të gjitha llojeve të trashëgimisë kulturore siç janë: Trashëgimia Arkeologjike Arkitekturale, Të luajtshme dhe shpirtërore (Ligji mbi Trashëgiminë Kulturore Nr. 02/L-88, Neni 1). Po ashtu rregullon lidhjet në mes të pronave, poseduesve dhe shfrytëzuesve të trashëgimisë kulturore, kështu duke krijuar përgjegjësi institucionale për trashëgiminë kulturore. Përveç kësaj, Ligji për Trashëgiminë Kulturore përcakton termat e përdorur për Trashëgiminë Kulturore të tilla si Inventarin me qëllim të regjistrimit, identifikimit, dhe dokumentimit të Trashëgimisë Kulturore, masat ligjore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe përpunimi i procedurave paraprake për caktimin e listës së monumenteve me mbrojtje të përhershme dhe të përkohshme si dhe themelimin e mekanizmave institucional për vlerësimin e trashëgimisë kulturore. Ky ligj është në proces të amendamentimit me qëllim të përmbushjes së kriterëve ndërkombëtare dhe standardet e eliminimit të përplasjeve ligjore, duke përcaktuar përgjegjësitë institucionale, unifikimin e terminologjisë dhe harmonizimin e tij me legjislacionin në fuqi;
- b. Ligji për mbrojtjen e zonave speciale Nr. 03/L-039 është miratuar nga Kuvendi më 20 Shkurt 2008. Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e zonave të mbrojtura dhe sigurimin e Manastireve dhe Kishave Ortodokse dhe Serbe, vendeve të tjera fetare, dhe vendeve historike dhe kulturore me rëndësi të veçantë për komunitetin Serb dhe komunitetet tjera në Republikën e Kosovës;
- c. Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit Nr. 04/L-066 është miratuar nga Kuvendi më 20 Prill 2012. Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja, ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore të Prizrenit, si dhe zonave nën mbrojtje të veçantë, si dhe përcaktimin e rregullave

dhe mekanizmave për mbrojtje, ruajtje, administrim dhe zhvillim të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit;

- d. Ligji për Hoqën e Madhe Nr. 04/L-62 është miratuar nga Kuvendi më 20 Prill 2012. Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen, ruajtjen, dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në fshatin Hoqa e Madhe, si një zonë me mbrojtje të veçantë, si dhe përcaktimin e rregullave dhe mekanizmave për mbrojtje, ruajtje, administrim dhe zhvillim të qëndrueshëm të fshatit Hoqa e Madhe;
- e. Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 2003/14 është miratuar nga Kuvendi më 03 Korrik 2003. Ky ligj ka për qëllim kryesor rregullimin dhe planifikimin hapësinor në territorin e Republikës së Kosovës. Ky ligj është amendamentuar më 01 Nëntor 2008 në mënyrë që të sigurojë harmonizimin e plotë me Ligjin për Mbrojtjen e Zonave të Veçanta;
- f. Ligji për Mbrojtjen e Ambientit Nr. 03/L-025 është miratuar nga Kuvendi më 26 Shkurt 2009. Ky Ligj ka për qëllim themelimin e një ambienti të shëndetshëm për popullin e Kosovës duke i sjellë ngadalë Standardet e Këshillit Evropian për Ambientin;
- g. Ligji për Arkivat e Shtetit Nr. 2011/04-L-088 është miratuar nga Kuvendi më 15 Shkurt 2012. Ky Ligj përcakton rregullat bazike për organizimin dhe operimin e Arkivave të Shtetit në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

Për më shumë, në 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar dokumentin strategjik që paraprin Strategjinë e Integruar të Ruajtjes. Në procesin e hartimit ekzistojnë shtatë udhëzime në Trashëgiminë Kulturore:

- a. Udhëzimi për Inventarin e Pasurisë për Trashëgiminë Kulturore
- b. Udhëzimi për Hulumtime Arkeologjike;
- c. Udhëzimi për Licencimin e Hulumtimeve Arkeologjike;
- d. Udhëzimi mbi kriteret dhe kushtet e vlerësimit e pasurisë së trashëgimisë kulturore;
- e. Udhëzimi për zhvillimin e projekteve të ruajtjes;
- f. Udhëzimi mbi masat e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së pasurisë së luajtshme të trashëgimisë kulturore.

- Çfarë mekanizma ekzistojnë për të siguruar fuqizimin dhe implementimin e këtyre ligjeve?

Mekanizmat që sigurojnë fuqizimin dhe zbatimin e këtyre Ligjeve janë si në vijim:

- a. Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit;
- b. Muzeu i Kosovës dhe rrjetet e tij;
- c. Instituti Arkeologjik i Kosovës;
- d. Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve;
- e. Qendra Regjionale për Trashëgimi Kulturore në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Ferizaj dhe Gjilan;
- f. Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor;
- g. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
- h. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- i. Agjencia Kadastrale e Kosovës;
- j. Instituti i Historisë;
- k. Instituti i Albanologjisë;
- l. Komunitat - Drejtorja për Kulturë, dhe Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

- Cilat janë vendet dhe objektet e mbrojtura ligjërisht në Kosovë?

Në përputhshmëri me Nenet 3.5, 3.6, 3.7 dhe 3.8 Ligji për Trashëgimi Kulturore, Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit ka miratuar Listën e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të

Përkohshme, në Shtator 2011 dhe që përmban 930 monumente nën mbrojtje të përkohshme dhe është e ndarë në dy kategori:

- a. Kategoria për trashëgimi arkeologjike dhe nën kategoritë: monumentet/emblemat dhe lokacionet arkeologjike;
- b. Kategoria për trashëgimi arkitekturale dhe nën-kategoritë: monumentet/emblemat.

Lista për Mbrojtje të Përkohshme të Trashëgimisë Kulturore është e listuar në Aneksin 2, në të cilin janë prezantuar 930 objekte dhe lokacionet e tyre. Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sporteve është në proces të vlerësimit gjithëpërfshirës të trashëgimisë kulturore dhe të zhvillimit të Listës në Mbrojtje të Përhershme të Trashëgimisë Kulturore.

2. KRITERET POLITIKE

2.1. Të dhënat makro-ekonomike

Ju lutëm shkurtimisht komentoni mbi trendët kryesore makro-ekonomike për 5 vitet e fundit për:

a) Rritja reale e PBB-së dhe ndarjen e saj me shpenzime

Gjatë pesë viteve të fundit, ekonomia ka menaxhuar me sukses efektet e krizës ekonomike globale, duke arritur një rritje mesatare vjetore prej 5%. Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) është duke ndikuar shumë sipas konsumit, edhe pse pjesa e saj në PBB ka rënë prej 112.3% në 2007 në 108.2 në 2011.

Investimet publike kanë kontribuar në masë të madhe për rritje të shpejtë ekonomike me pjesëmarrjeje të shtuar në PBB nga 5% në 2007 në 11% në 2011. Investimi privat vazhdon të kontribuojë me 22% në rritjen e PBB-së.

Rritja e shpejtë në importimin e produkteve ka pasur një efekt kështu që net eksportet kanë mbetur konstant, si një pjesë e PBB-së rreth 40%. Eksportimi i produkteve ka shënuar një rritje, veçanërisht në vitin 2010. Pjesëmarrja e saj në PBB gjatë periudhës u rrit nga 5% në 2007 në 7% në 2011. Ngjashëm, eksporti i shërbimeve ka treguar një rritje pozitive të vazhdueshme nga 10% të PBB në 2007 në 12% në 2011.

Në anën tjetër, importi i produkteve është rritur nga 46% e PBB-së në 52%. Kjo rritje u bë më së shumti nga investimet e mëdha publike. Në të kundërtën, importet e shërbimeve kanë mbetur kryesisht konstante me rreth 9% në aspektin e pjesëmarrjes në PBB, për më shumë detaje shih Aneksin 3a.

b) Inflacionin (duke përfshirë inflacionin bazë)

Inflacioni i periudhës 2007-2011 mesatarisht ishte 4,44%. Në 2008, mesatarja vjetore e shkallës së inflacionit ishte 9.4%. Pas uljes së nivelit të çmimit në 2009 kur Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) regjistroi një rritje vjetore prej -2.4%, lëvizja e çmimeve ndërkombëtare (kryesisht ushqimore dhe të naftës), gjithashtu ka shkaktuar presione tek inflacioni në Kosovë. Pra, në 2010 niveli i çmimit u rrit me një mesatare prej 3.5%, duke arritur kulmin prej 7.3% në 2011. Gjatë tre muajve të parë të vitit 2012, në krahasim me vitin e kaluar, një rritje më e ngadaltë në kursin e çmimit ishte vënë re. Duke marrë parasysh që importet përbëjnë një përqindje të rëndësishme të PBB-së në Kosovë, çfarëdo lëvizjeje në çmimet internacionale do të kenë efekt të drejtpërdrejt në nivelin e çmimit në Kosovë. Ushqimi është përbërësi kryesor i shportës së konsumimit dhe prandaj, lëvizjet e çmimeve në tregun botëror kanë ndikuar në çmimet e ushqimit në Kosovë, kështu ka ndikuar në lëvizjen e përgjithshme të çmimeve.

c) Deficiti dhe borxhi i përgjithshëm i Qeverisë dhe ndarjen e tij në nivel Qeveritar

Tre bilancet e Qeverisë së Përgjithshme janë paraqitur në tabelën e më poshtë. Bilanci aktual, paraqet dallimin në mes të hyrave dhe shpenzimeve gjatë kësaj periudhe, ka mbetur pozitivë, duke reflektuar politikat e ndërjegjshme të Qeverisë në lidhje me këtë kategori të shpenzimeve. Në anën tjetër, rritja e shpenzimeve të kapitalit ka ndikuar në bilancin e përgjithshëm primar, që të jetë negativ edhe pse ishte nën nivelin e rekomanduar nga Traktati i Maastricht-it. Gjatë pesë viteve të fundit Qeveria e Kosovës ka vepruar me një suficit të përgjithshëm buxhetor. Shuma totale e borxhit publik (i brendshëm/i jashtëm) është përafërsisht €282.8 milion. Prej kësaj shume totale, €253.1 milion janë borxh i jashtëm dhe €29.7 milion janë letra me vlerë në formë të bonove të Thesarit të lëshuara nga MF-ja.

Tabela 8: Bilanci i Përgjithshëm Qeveritar, në % të PBB

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011
Bilanci aktual	13.7%	8.7%	10.0%	9.1%	10.0%
Bilanci Primar	9.1%	-0.3%	-0.6%	-2.3%	-1.5%
Bilanci i përgjithshëm (Duke përfshirë pagesat e interesit)	9.3%	-0.5%	-1.1%	-2.5%	-1.7%

Burimi: MF-ja

d) Shpenzimet dhe të hyrat e përgjithshme të Qeverisë dhe ndarja e tyre nëpër kategori;

Bazuar në të dhënat gjatë viteve 2007-2011, të hyrat totale kanë vazhduar të rriten me një mesatare vjetore rreth 10%. Të hyrat nga kufiri gjatë kësaj periudhe janë rritur me një mesatare vjetore rreth 11.7% apo rreth 55% në krahasim me vitin 2007. Vetëm në vitin 2011, këto të hyra u rritën për 18% në krahasim me vitin 2010. Të hyrat e brendshme gjatë periudhës së njëjtë u rritën me një mesatare vjetore prej 8.5%, apo rreth 36.1% në krahasim me vitin 2007.

Të hyrat jo-tatimore janë zvogëluar, ndërsa të ardhurat vetanake, në të dyja nivelet, qendrore dhe lokale, janë dyfishuar gjatë kësaj periudhe. Në mënyrë specifike, të hyrat vetanake të komunave janë rritur me një mesatare prej 18.5% kurse të hyrat vetanake të nivelit qendror janë rritur me një mesatare prej 25.5%.

Në 5 vitet e fundit, Qeveria e Kosovës ka marrë dividendë nga Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP) në vlerë totale prej €375.8 milion. Në vitin 2010 Qeveria e Kosovës ka marrë ndihmë të drejtpërdrejta në buxhet me një shumë prej €30milion nga Komisioni Evropian (KE) dhe në vitin 2011 ka marrë €19.2 milion nga Banka Botërore (BB).

Rritja e vazhdueshme ekonomike, e regjistruar gjatë viteve 2007-2011, ishte lidhur me një ngritje në shpenzimet e përgjithshme buxhetore si pjesë e PBB-së. Shpenzimet totale të buxhetit, si pjesë e PBB-së u rritën nga 19.5% në 2007, në 30.1% në 2011, kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve të kapitalit. Ndërsa kategoritë e tjera të shpenzimeve, duke përjashtuar shpenzimet kapitale, pjesa e mëdijëve dhe pagave është zvogëluar si pjesë e PBB-së, për më shumë detaje shiko Aneksin 3a.

Kategoria e *pagave dhe mëditjeve*, si pjesë e PBB-së ka filluar të rritet gjatë vitit 2009, rreth 0.6% në krahasim me vitin 2007, si rezultat i rritjes së pagave për disa kategori të caktuara të nëpunësve civil, dhe transferimi i kompetencave nga ndërkombëtarët në institucione vendore. Gjithashtu, rritja e kësaj kategorie të shpenzimeve ka vazhduar në vitin 2011, si rezultat i rritjes së pagave të nëpunësve publikë, sektorit të nëpunësve të shëndetësisë dhe edukimit.

Kategoria e **mallrave dhe shërbimeve**, si pjesë e PBB-së ka mbetur gati në të njëjtin nivel gjatë kësaj periudhe, përafërsisht 3.6% e PBB-së. Megjithatë, në terma nominal, produktet dhe shërbimet kanë vazhduar të rriten deri në vitin 2010. Gjatë vitit 2011, kjo kategori ka pësuar ulje.

Kategoria e **subvencioneve dhe transfereve**, pas një ngritjeje në 2009 për shkak të rritjes rreth 11% të të gjitha përfitimeve sociale, gjatë 2010-2011 ka mbetur konstante në 5.6% si pjesë e PBB-së.

Kategoria me ngritje më të madhe gjatë 2007-2011 ishte ajo e shpenzimeve kapitale. Duke filluar në vitin 2008, kur Qeveria e Kosovës rriti nivelin e shpenzimeve kapitale për afërsisht 120% dhe pjesa e

këtyre shpenzimeve në PBB u rrit nga 4.6% në 9%. Nga viti 2009 e tutje, pjesëmarrja e saj qëndroi në mes të 10% - 11.5%, për më shumë detaje shiko Aneksin 3a.

e) Përzgjedhja e treguesve monetar dhe financiar;

Veprimtaria financiare e ndërmjetësimit vazhdoi të rritej në vitin 2011. Kreditë e lëshuara nga sistemi bankar shënuan një ngritje vjetore prej 16.4%, ndërsa depozitat u rritën për 8.5% gjatë 5 viteve të fundit, dhe rritja mesatare vjetore e kredisë ishte 22.3%. Rritja më e lartë e normave u regjistrua gjatë viteve 2007 dhe 2008 kur kreditë patën një rritje vjetore prej 40.1% dhe 32.7%, përkatësisht. Normat e rritjes më të ulëta ishin në vitin 2009 kur kreditë u rritën për 8.9%. Sa i përket depozitave, mesatarja e normave të rritjes gjatë 5 viteve të fundit është 18.1%. Rritja më e lartë e normave të depozitave ka ndodhur në vitin 2008 ku depozitat u rritën për 26.3%, ndërsa normat e rritjes më të ulëta janë regjistruar në vitin 2011 kur depozitat u rritën për 8.5%.

Norma e interesit e shpërndarë në vitin 2011 ishte 10.63 përqind. Mesatarja pesë vjeçare e këtij indikatorit për periudhën 2007-2011 është 10.7 përqind. Në pesë vitet e fundit, norma e interesit më e lartë e shpërndarë ishte në vitin 2007 me normë prej 11.3 përqind, ndërsa niveli më i ulët ishte në vitin 2009 me normë prej 10.01 përqind.

Në vitin 2011, sistemi bankar në Kosovë ishte përfitues me një Kthim Mesatar në Asete (KMA) prej 1.5%. Mesatarisht, KMA në pesë vitet e fundit qëndroi në 1.7%. Shkalla më e lartë e KMA-së gjatë kësaj periudhe ishte në vitin 2007 (2.6%) dhe më e ulëta në vitin 2009 (1.4%).

Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK) në vitin 2011 ishte 17.5%, e cila në mënyrë të konsiderueshme e kalon normën minimale prej 12% të kërkuar nga Banka Qendrore. Shkalla e lartë e kapitalit të ishte një karakteristikë e sistemit bankar në Kosovë gjatë gjithë ekzistencës së saj. Gjatë pesë viteve të fundit, sistemi bankar kishte PMK prej 17.7%. Shkalla më e lartë e TMK-së ishte evidencuar në vitin 2010 (18.7%), dhe shkalla më e ulët ishte në vitin 2008 (16.7%), e cila prapë se prapë është më e madhe së niveli i kërkuar nga Banka Qendrore.

f) Bilanci i pagesave, duke përfshirë tregtinë dhe llogarinë rrjedhëse, kapitalin dhe llogarinë financiare

Llogaria rrjedhëse gjatë pesë viteve të fundit ishte e karakterizuar me një deficit të vazhdueshëm që shtrihet në mes të 11% dhe 16% e PBB. Deficiti ishte 672.9 milion euro në vitin 2011 (përafërsisht 15% e PBB). Kjo e reflekton deficitin e lartë të tregtisë në produkte (2.1 bilion euro) që është pjesërisht e zvogëluar nga suficiti i transferëve aktual (990.4 milion euro), shërbimeve (281.3 milion euro), dhe transfereve të të ardhurave (113.8 milion euro). Ekonomia e Kosovës është e karakterizuar me deficit të lartë në tregun ndërkombëtar të mallrave, ku përqindja mesatare e mbulimit të importeve gjatë pesë viteve të fundit qëndroi në 14%.

Llogaria financiare shënoi një bilanc pozitiv prej 377.5 milion euro, kryesisht si rezultat i të ardhurave neto nga investimet e huaja të drejtpërdrejta (379.9 milion euro) dhe asetet rezervë (61.2 milion euro), ndërsa bilanci i portofolit të investimeve (57 milion euro) dhe investimeve të tjera (5.7 milion euro) ra nën shifrat negative kryesisht për shkak të rritjes së investimeve jashtë shtetit. Bilanci pozitiv i investimeve të jashtme të drejtpërdrejta ishte kryesisht në formën e investimeve të kapitalit dhe fitimeve të ri-investuara (329.5 milion euro). Vitin e kaluar, asetet rezervë pësuan një bilanc pozitiv si rezultat i uljes së investimeve nga BQK-ja në asetet e jashtme (depozitat e letrave me vlerë). Në fund të vitit 2011, asetet rezervë ishin 547.7 milion euro, duke shënuar një ulje prej 60 milion euro nga viti i kaluar. Kjo ndodhi për shkak të uljes së investimeve të jashtme nga BQK-ja. Asetet rezervë mesatarisht ishin afër 620 milion euro gjatë pesë viteve të fundit.

Më 5 Maj 2012, Banka Qendrore për herë të parë ka publikuar të dhënat mbi Pozicionin e Investimeve Ndërkombëtare dhe Borxhin e Jashtëm të Kosovës, duke bërë një hap tjetër të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit statistikor të vendit. Statistikat e tilla janë të publikuara në sekuenca kohore në faqet e internetit të BQK-së, FMN-së, IFS-së dhe të Bankës Botërore. Në fund të vitit 2011, pozicioni neto i investimeve ndërkombëtare ishte 104.5 milion euro. Kjo përfaqëson një rënie prej 340 milion euro në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2010.

Gjatë periudhës 2007-2011, teprica e aseteve ndaj detyrimeve të jashtme ka përjetuar një rënie të vazhdueshme. Në fund të vitit 2011, qytetarët e Kosovës kanë zotëruar asete të jashtme me vlerë prej 3.3 bilion euro, duke shënuar një rritje prej 2.4% në krahasim me vitin e kaluar. Drejtuesit kryesorë të një rritjeje të këtillë ishin institucionet financiare të Kosovës të cilat kanë investuar në vendet e jashtme në formë të investimeve me portofoli (letrat me vlere dhe instrumente të borxhit) dhe depozitat në bankat jo-rezidente. Një tjetër kontribuues ishte rritja e qarkullimit të parasë. Kosova është një ekonomi e “eurodizuar”, ku pjesëmarrja e qarkullimit të parave në totalin e aseteve të jashtme është rreth 27%.

Bilanci i detyrimeve të banorëve të Kosovës në fund të vitit 2011 qëndroi në 3.2 bilion euro, duke shënuar një rritje prej 15%. Rritja ndodhi më së shumti për shkak të rritjes së investimeve të huaja direkte në Kosovë, që deri në fund të vitit 2011 ishte €2.4 bilion apo 20.3% më e madhe se në fund të vitit 2010

g) Çfarë është volumi dhe natyra e investimeve të huaja direkte?

Investimet e Huaja Direkte (IHD) vazhdojnë të ndikohen nga zhvillimet ekonomike në vendet anëtare të euro-zonës, e cila gjithashtu përfaqëson burimin kryesor të të ardhurave. IHD-ja ka regjistruar një rritje të vazhdueshme gjatë kësaj periudhe përveç viteve 2008 dhe 2009, kur niveli i tyre, edhe pse në një shkallë të vogël, ishte ndikuar nga kriza globale ekonomike.

Shuma neto e akumuluar e investimeve të huaja direkte (IHD) në Kosovë në fund të vitit 2001 ishte 2.3 bilion euro apo 20.5% më e madhe se në fund të vitit 2010. Investimet e jashtme të Kosovës ishin 102 milion euro një rritje prej 18%. Shumica e këtyre investimeve janë në formë të pasurive të patundshme. Në vitin 2011, IHD-të e brendshme në Kosovë ishin 394.6 milion euro, duke shënuar një rritje prej 7.9% në krahasim me vitin 2010. Ndërsa investimet e jashtme të qytetarëve të Kosovës ishin 15.7 milion euro apo 55% më pak se në vitin 2010, për më shumë shikojeni Aneksin 3a. Investimet e jashtme në formën e kapitalit dhe fitimeve të pashpërndara janë kategoritë kryesore të IHD-ve në Kosovë, të ndjekura nga kategoria e investimeve të tjera. Investimet kapitale të cilat përbëjnë deri në 70.5% të totalit të IHD-ve, në vitin 2010 arritën një total prej 211.8 milion euro (211.1 milion euro në vitin 2009).

Në vitin 2011, struktura e aktivitetet ekonomike të IHD-ve pësuan disa ndryshime. Sektori i ndërtimit ka gëzuar një rritje (si përqindje) në investimet e huaja direkte në Kosovë, të ndjekura nga investimet e pronës së patundshme. Përfshirja e sektorit të prodhimit në totalin e IHD-ve është zvogëluar në krahasim me vitin e kaluar. Pjesëmarrja e sektorit financiar në investime totale, ka qenë mesatarisht 12% e totalit të IHD-ve në vitin 2011.

Tabela 9: Të hyrat dhe volumi i IHD-ve, të paraqitura si % e PBB-së, për periudhën 2007-2011

Viti	2007	2008	2009	2010	2011
IHD	440,7	366,5	287,4	365,8	394,6
PBB	3,393.7	3,851.4	3,912.4	4,215.6	4,700 (Vlerësimi)

IHD si % e PBB	12,99%	9,52%	7,35%	8,68%	8,40%
-----------------------	--------	-------	-------	-------	-------

Burimi: BQK-ja

Origjina e investimeve të huaja është kryesisht nga vendet Evropiane. Sllovenia, Gjermania, dhe Britania e Madhe janë vendet udhëheqëse të IHD me investime në Kosovë.

2.2. Të dhënat ekonomike-sociale

-- Ju lutem jepni dhe komentoni shkurtimisht mbi të dhënat në vazhdim për 5 vitet e fundit

a) PBB-ja për kokë banori në Standardet e Fuqisë Blerëse (në % të mesatares EU-27)

Enti Statistikor i Kosovës në vitin 2009 për herë të parë ka filluar një hulumtim pilot në Paritetin e Fuqisë Blerëse, pjesë e Programit Krahasues Evropian. Ky projekt është momentalisht në vazhdim. Indeksi i Nivelit të Çmimeve (INÇ) për ushqim, pije, dhe duhan për 2009 është përpiluar. Për këtë kategori të konsumimit, INÇ në Kosovë është më e madhe se në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, por më e vogël se në pjesën tjetër të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sa i përket PBB-së për kokë banori në Standardet e Fuqisë Blerëse, enti ende nuk ka prodhuar të dhëna të tilla.

b) Popullsia sipas gjinisë, grupmoshës, dhe shpërndarjes rajonale

Kosova është zyrtarisht e ndarë vetëm në dy nivele, lokalitete dhe komuna, prandaj ne kemi përpiluar të dhëna në nivelin komunal. Të dhënat e paraqitura në tabelë përfaqësojnë gjendjen deri në fund të vitit 2011 dhe vetëm për vitin 2011. Ky numër i popullsisë është nxjerrë nga të dhënat nga statistikat vitale për 9 muaj të vitit 2011 (nga Prilli deri në Dhjetor 2011) ku rritja natyrore del nga bashkëngjitja e mesatares sipas gjinisë dhe grupmoshave të bazuara në të dhënat mesatare të regjistrimit të popullsisë së vitit 2011. Për më shume informacione rreth popullsisë dhe të dhënave në bazë të grupmoshës apo gjinisë në nivelin komunal shiko Aneksin 3b.

Tabela 10: Tabela e Popullsisë sipas grupmoshës dhe gjinisë 2011, ESK

Grupmosha	Totali	Meshkuj	Femra
0-14	492.452	254.951	237.501
15-29	482.541	249.687	232.855
30-49	462.803	225.318	237.485
50-64	201.093	99.013	102.080
65-84	112.408	53.133	59.275
> 85	5.453	1.958	3.495
Total	1.756.751	884.060	872.691

Burimi: ESK-Regjistrimi i popullsisë 2011-rezultatet paraprake (data baza)

Statistikat Jetësore të Kosovës për vitin 2011 (data baza)

Shënim: Të dhënat në këtë tabelë prezantojnë situatën në fund të vitit 2011

Zyra e regjistrimeve (ZR) dhe ESK-ja nuk posedojnë të dhëna mbi grup moshat, gjininë, dhe shpërndarjen regjionale për 5 vitet e fundit, për shkak që deri në vitin 2011 një metodë tjetër e cila i përfshin edhe jo-rezidentët e Kosovës është përdorur. Prandaj, të dhënat nuk përputhen me standardin dhe të dhënat e regjistrimeve të vitit 2011. Gjithashtu, ESK në anketimet e mëparshme (2007-2011) nuk ka përpiluar statistika të popullsisë sipas grupmoshës apo gjinisë në nivelin komunal.

a) Treguesit e tregut të punës: normat e aktivitetit ekonomik, normat e punësimit dhe normat e papunësisë, normat e papunësisë afat-gjate, trajnimi në bazë të edukimit, gjinisë, moshës, gjithashtu në drejtim të divergjencave rajonale.

Shkalla e Aktivitetit (kontingjenti i fuqisë punëtore aktive, paraqet përqindjen e fuqisë punëtore në grupmoshën punuese të popullatës, e cila në Kosovë sipas Sondazhit të Fuqisë Punëtore të fundit në vitin 2009, arrin në 48.1%)

Tabela 10: Shkalla e Aktivitetit Ekonomik

Viti	2005	2006	2007	2008	2009
Totali	49.2	52.3	46.8	46.2	48.1
Meshkuj	69	70.8	65.7	66.2	67.5
Femra	29.9	33.7	28.4	26.1	28.8

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës

Tabela tregon që shkalla e aktivitetit në Kosovë është shumë e ulët, variacionet në ndryshime janë për shkak të përkufizimeve.

Shkalla e punësimit (paraqet përqindjen popullsisë së punësuar në moshën punuese në Kosovë, që sipas të dhënave të fundit të Hulumtimit mbi Fuqinë Punëtore (AFP), në vitin 2009 arrin 26.4%).

Tabela 11: Shkalla e punësimit

Viti	2005	2006	2007	2008	2009
Totali	28.9	29	26.5	24.3	26.4
Meshkuj	46.4	46.5	40.6	38	40.2
Femra	11.9	11.9	12.7	10.6	12.6

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës

Shkalla e papunësisë (paraqet përqindjen e personave të papunësuar në fuqinë punëtore, dhe kjo përqindje sipas AFP-së, në vitin 2009 arrin 45.4%)

Tabela 12: Shkalla e Papunësisë

Viti	2005	2006	2007	2008	2009
Totali	41.4	44.9	43.6	47.5	45.4
Meshkuj	32.9	34.6	38.5	42.7	40.7
Femra	60.5	61.6	55.2	59.6	56.4

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës

Papunësia afat-gjate (është e definuar me kohëzgjatje prej një viti apo më shumë, që në Kosovë, sipas rezultateve të AFP-së, në vitin 2009, është 81.7%).

Tabela 13: Papunësia Afat-gjate

Viti	2005	2006	2007	2008	2009
Totali	83.7	91.5	85	81.8	81.7
Meshkuj	83.5	91.7	84.8	83.2	82.8
Femra	84	91	85.4	79.3	79.8

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës

Shënim: Pas publikimit të raportit final të regjistrimit të popullsisë në Shtator, do të jep një mundësi për të mbushur të dhënat e fuqisë punëtore për vitin 2011. Sa i përket vitit 2012, AFP-ja aktualisht është në terren duke realizuar; rezultatet do të publikohen në Mars të vitit 2013.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka të dhënat e veta rreth shkallës së aktiviteteve, punësimit dhe papunësisë, për vitin 2010 dhe 2011 të cilat janë në dispozicion por nuk janë të përfshira këtu me qëllim që paraqitja e këtyre statistikave të jetë sa më e qëndrueshme.

Tabela 14: Trajnimi sipas gjinisë dhe moshës i organizuar nga Shërbimi i Punësimit (MPMS), 2007-2011

Viti	Numri total i personave	Gjinia		Moshë			
		Femër	Mashkull	15 - 24	25 - 39	40 - 54	Mbi 55
2007	3,047	1,057	1,990	1,363	1,337	341	6
2008	3,240	1,276	1,964	1,633	1,282	311	14
2009	2,977	1,138	1,839	1,503	1,155	310	9
2010	3,306	1,511	1,795	1,632	1,309	347	18
2011	3,449	1,602	1,847	1,787	1,295	316	51

Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Si shihet qartë nga tabela, ka pasur një rritje të vazhdueshme në përfshirjen e personave në trajnime profesionale, duke e përjashtuar vitin 2009 ku kishte një numër më të vogël të pjesëmarrësve. Një rritje më e madhe është e dukshme në dy vitet e fundit për shkak të ngritjes së kapaciteteve dhe të kushteve të përmirësuara për trajnime nga Qendrat Rajonale për Trajnim Profesional. Pjesëmarrja e grave dhe rinisë kishte një trend pozitiv në trajnimet profesionale; gjë që tregon se ata janë kategoritë primare për ministrinë. Për të krahasuar, pjesëmarrja e grave në vitin 2007 ishte 34.69% që në vitin 2011 u rrit në 46.45%.

Tabela 15: Trajnimi sipas nivelit të edukimit të organizuar nga Shërbimi i Punësimit, 2007-2011

Viti	Numri total i personave	Niveli i Edukimit					
		Jo të kualifikuar	Gjysmë të kualifikuar	Të kualifikuar	Shkolla fillore	Shkolla e mesme	Universiteti
2007	3,047	846	41	132	1,807	73	148
2008	3,240	763	59	131	2,004	46	237
2009	2,977	654	27	89	1,885	50	272
2010	3,306	853	16	77	1,898	52	410
2011	3,449	898	19	60	1,953	29	490

Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Tabela e paraqitur me lartë tregon se kategoritë dominuese të trajnuarve janë jo të kualifikuarit, dhe shkollës të mesme, që përbëjnë numrin më të madh të papunësuarve të regjistruar dhe kanë mungesë të aftësive themelore për punë.

Tabela 16: Trajnimi sipas regjionit e organizuar nga Shërbimi i Punësimit, 2007-2011

Regjioni	2007	2008	2009	2010	2011
Ferizaj	245	215	230	287	221
Gjakova	568	543	456	668	708
Gjilan	325	290	411	270	255
Mitrovica	348	521	327	444	625
Peja	365	283	288	330	436
Prishtina	618	846	788	664	618
Prizren	553	542	477	643	586
Total	3,047	3,240	2,977	3,306	3,449

Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Tabela e paraqitur më lart tregon që pjesëmarrja në trajnime ka ndryshuar duke u bazuar në kërkesat dhe kushtet e tregut për trajnimin e ofruar. Për shembull, ndërtimi i një qendre të re moderne në Prishtinë në vitin 2008, ka rezultuar në një ngritje të numrit. Ngjashëm, ndërtimi i një qendre të re në Pejë në vitin 2011 ka rezultuar në një rritje të numrit të personave të trajnuar.

Paralelisht me trajnimin e organizuar nga Departamenti i Arsimit Profesional, MPMS-ja ka blerë shërbimet e trajnimit për profilet që nuk janë në dispozicion në qendrat e saj. Në vitin 2009/10, gjithsej 279 punë - kërkues janë trajnuar në Prishtinë (50 kandidatë janë trajnuar për kontabilitet, 40 në administrim biznesi, 43 në menaxhim të biznesit, 96 në IT, dhe 50 në ndërmarrësi).

Në vitin 2010, 235 kandidatë nga regjioni i Prishtinës, Gjakovës, dhe Ferizajit kanë përfunduar trajnimin për ECDL dhe kontabilitet. Në vitin 2011, me mbështetje të Lux-Development, një fond për trajnim profesional është krijuar e cila është menaxhuar nga MPMS-ja. Numri total i përfituesve të trajnuar në vitin 2011 është 330 (ECDL, etj avancuara të kontabilitetit).

Gjithashtu, në vitin 2010, 60 punëkërkues të verbër dhe 15 persona shurdh memec u trajnuan. Në vitin 2011, 60 punëkërkues të verbër u trajnuan dhe 10 prej tyre janë punësuar për një periudhë tremujore.

2.1. Treguesit Strukturore

- Ju lutem ofroni dhe komentoni shkurtimisht në treguesit e mëposhtëm gjatë 5 viteve të fundit

a) Strukturën ekonomike sektoriale (si pjesë e PBB-së dhe punësimit)

Tabela 17: Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) sipas aktiviteteve ekonomike, çmimeve aktuale 2005-2009 (të dhënat për vitin 2008 dhe 2009 nuk janë publikuar ende zyrtarisht)

Aktivitetet Ekonomike NACE Rev, 1	2005	2006	2007	2008	2009
Agrikultura, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi	11,3	11,7	12,8	13,3	15,1
Industria e Minierave	0,6	0,6	0,5	0,8	0,7
Industria përpunuese,	9,5	9,7	8,3	10,6	11,7
Furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë	3,6	3,1	3,9	3,8	4,3
Ndërtimtaria	8,4	8,9	9,9	8,3	4,8

Tregtia me shumicë dhe pakicë, mirëmbajtja e makinave dhe motoçikleta dhe produkteve për shfrytëzim personal dhe në shtëpi	10,6	10,8	11,2	14,0	13,1
Hotelet dhe restorantet	0,7	0,8	0,7	0,6	0,6
Transport, depo dhe trafik	4,2	4,6	3,5	3,6	3,7
Ndërmjetësim Financiar	2,5	3,0	4,3	4,2	4,8
Biznese me patundshmëri, qira dhe shërbime të biznesit	12,8	12,8	12,2	9,8	9,6
Administrimi i mbrojtjes publike (duke përfshirë Edukimin dhe Shëndetësinë)	20,0	17,3	15,5	13,9	13,7
Aktivitete të tjera sociale dhe shoqërore të shërbimeve personale	2,1	2,6	2,2	2,7	3,2
Taksat në produkte	13,5	14,1	14,9	14,4	14,7
Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)	100	100	100	100	100

b) Struktura e pronësisë së ndërmarrjeve, duke përfshirë vlerësimin e aksioneve të kapitalit, duke bërë dallimin midis kapitalit publik dhe privat;

Sipas të dhënave të mbledhura nga regjistrimi i bizneseve dhe kapitalit nga ndërmarrjet private, 77,85% e aksioneve janë në pronësi të brendshme dhe 22,15% të aksioneve janë në pronësi të huaj.

Tabela 18: Investimet publike dhe private në vlera minimale dhe si përqindje e PBB-së

Në vlerë nominale					
Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011 Vlera.
<i>Në miliona Euro</i>					
Investime	893	1,094	1,166	1,369	1,540
Investimet Private	737	747	766	914	1,012
Investimet Publike	155	347	400	455	528
PBB	3,394	3,851	3,912	4,190	4,606
Publike	<i>Përqindja e PBB-së</i>				
Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011 Vlera
<i>Në miliona Euro</i>					
Investime	26%	28%	30%	33%	33%
Investimet Private	22%	19%	20%	22%	22%
Investimet Publike	5%	9%	10%	11%	11%

Burimi: Ministria e Financave

c) Produktiviteti i punës; evolucioni nga sektorët e ekonomikë; shumë i detajuar

Të dhënat e produktivitetit të punës nuk janë në dispozicion.

- d) Kostot e punës për njësi, duke përfshirë treguesit e konkurrencës ndërkombëtare (ndryshimet në kostot relative të punës për njësi, niveli dhe ndryshimet në të ardhurat mesatare bruto, etj;

Tabela 19: Mesatarja e Kostos Mujore sipas Aktiviteteve Ekonomike si dhe Kostot Shtesë.

Kodi	Aktiviteti Ekonomik	Mesatarja Mujore e Kostos së Punës	Pagat dhe Rrogat	Pensioni dhe kontributet sociale	Kontributi i sigurimeve shoqërore me të cilat puhënsit	Kostoja e trajnimit profesional të paguar nga punëdhënësi	Kostot Tjera	Taksat e paguara nga Punëdhënësi	Kodi
A	Agrikulture, gjueti, pylltari dhe peshkim	357.6	345.4	7.6	-	-	3.7	0.8	-
C	Minierat dhe Guroret	491.3	445.1	16.7	13.3	-	4.0	12.9	0.8
D	Prodhimi	339.9	306.5	10.4	1.4	1.5	7.2	13.5	0.6
E	Furnizimi me gaz, energji elektrike dhe ujë	349.5	326.4	14.6	5.5	0.1	0.1	5.4	2.7
F	Ndërtimtaria	363.8	316.4	13.8	3.0	0.5	18.9	11.8	0.6
G	Shtija me shumicë dhe pakicë, riparimi i pajisjeve motorike	447.7	293.2	33.1	2.9	1.2	111.1	6.6	0.4
H	Hotelet dhe restorantet	269.5	301.9	9.7	1.6	0.4	59.4	4.9	108.4
I	Transporti, magazina dhe trafiku	587.6	407.9	22.9	2.9	0.4	141.3	12.5	0.2
J	Ndërmjetësimi financiar	470.7	448.6	23.0	-	-	-	-	0.9
K	Aktivitetet e biznesit të patundshmërisë dhe bizneset me qira	327.6	228.5	16.3	0.1	0.5	67.1	15.3	0.3
L	Administrimi i mbrojtjes publike	276.9	232.8	33.5	0.0	1.7	7.5	1.3	-
M	Arsimimi	631.1	437.4	16.7	2.7	2.4	157.3	14.8	0.2
N	Shëndetësia	470.4	399.3	27.3	11.9	0.7	10.7	20.5	-
O A	Pastrimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza	293.3	266.4	17.8	0.3	2.0	0.8	6.0	-
O C	Sport, Rekreacion dhe aktivitetet kulturore	442.3	313.3	18.5	3.8	0.3	78.7	39.1	11.5
O D	Aktivitete të tjera të shërbimeve (larje dhe pastrim kimik, sallon bukurie, aktivitetet e varrimit, aktivitetet e kujdesit të trupit dhe të tjera aktivitete që shërbejnë	265.1	252.4	10.0	0.1	1.8	0.8	-	-
Totali		383.7	313.6	18.6	2.7	0.9	48.3	10.1	10.1

- h) Përqindja e personave të punësuar që marrin trajnim; numri i përgjithshëm i atyre që vetëm janë trajnuar dhe pjesa e tyre në numrin e përgjithshëm të të punësuarve, nëse është e mundur nga dega e veprimtarisë; numri i kompanive që kanë ofruar trajnime për punonjësit e tyre dhe pjesa e tyre në numrin e përgjithshëm të kompanive.**

Oda Ekonomike e Kosovës ka programin e saj për trajnimin e bizneseve. Nga viti 2009, ata kanë ofruar trajnime në menaxhim për 300 menaxherë të kompanive. Në transport, OEK-ja ka ofruar trajnim për 600 kandidat. OEK-ja ka filluar një program trajnimi të përbashkët për zejtarë me Odën e Tregtisë së Zejtarisë të Dortmundit për të ofruar një trajnim në auto mekanikë. Gjithashtu gjatë vitit 2006, 1100 punëtorë nga kompani të ndryshme janë trajnuar për materiale të rrezikshme. OEK gjithashtu ofron trajnime për gastronomi.

2.4. Procesi i diskutimit të pagave dhe sistemi i sigurimeve shoqërore

Procesi i diskutimit të pagave dhe sistemi i sigurimeve shoqërore

Ju lutem jepni informacione kualitative dhe/apo kuantitative për 5 vjetët e fundit për çështjet në vijim:

- a) Zhvillimi i pagës mesatare bruto dhe neto në sektorin publik dhe privat, përkatësisht;**

Tabela 20: Mesatarja e pagës në sektorin privat dhe publik, 2007-2011

	2007	2008	2009	2010	2011
<i>Paga Mesatare (Euro)</i>	242	248	-	292 ⁷	327 ⁸
<i>Publike</i>	208	237	270	268	368 ⁹
<i>Private</i>	241	258	-	303	327

Burimi:

- Hulumtimi mbi nevojat e tregut të Punës 2010, KBA / MPMS
- Hulumtimi mbi nevojat e tregut të Punës 2011, KBA / MPMS
- <http://esk.rks-gov.net/dmdocuments/Kosova> në numra

- b) Rregullimet për pagat dhe punësimin në sektorin publik;**

Ligji i Punës Nr. 2010/03-L-212 është akti kryesor ligjor që përcakton principet bazë për pagesën dhe kriteret mbi punësimin, duke përfshirë të drejtat dhe mbrojtjen e punëtorëve.

Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përcakton rregullat e përgjithshme në menaxhimin e financave publike duke përfshirë rregullat e thesarit të financave, procedurat, afatet dhe ndarjen e propozimeve buxhetore, duke përfshirë agjencitë e pavarura. Për

më tepër, Ligji vjetor i cili përcakton ndarjet buxhetore për të gjitha institucionet publike dhe definon procedurat e mëtutjeshme rreth shpenzimeve buxhetore për kategoritë e veçanta duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjeve në fuqi dhe në dispozitat e kushtetutës kur flitet për institucione të pavarura, si dhe rregullon procedurat për menaxhimin e të hyrave vetanake të institucioneve buxhetore.

Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 rregullon tarifat bazë dhe bën aranzhimin dhe nxitjen e performancës së drejtorive dhe zyrave të Ndërmarrjeve Publike (NP). Neni 20 përcakton: “Komiteti i Auditimit do të zhvillojë dhe publikojë politikën e kompensimit që mbulon drejtoritë dhe zyrat e NP-ve. Dispozita e Neni 21 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike përcakton përzgjedhjen dhe emërimin e zyrtarëve.

Për më tepër, punësimi dhe pagat në sektorin publik janë të rregulluara me Ligje të veçanta dhe/ose akte të legjislationit sekondar për disa sektorë ose institucione publike.

Ju lutem gjeni të bashkangjitur listën kryesore për institucionet e sektorit publik:

- a. Ligji për Gjykatat Nr. 03/L-199;
- b. Ligji për Prokurorin e Shtetit Nr. 03/L-225;
- c. Ligji për Avokatin e Popullit Nr. 03/L-195;
- d. Ligji për Policinë Nr. 04/L-076;
- e. Ligji për Bankën Qendrore të Kosovës Nr. 03/L-074;
- f. Ligji për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës Nr. 03/L-075;
- g. Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit Nr. 03/L-159;
- h. Ligji për Gjykatën Kushtetuese Nr. 03/L-121;
- i. Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave Nr. 04/L

Pagat e personelit të gjykatave janë definuar dhe përcaktuar me Ligjin mbi Gjykatat, Neni 29 , “Pagat dhe Kompensimi Gjyqësor” sipas të cilit:

- a. Kryetari i Gjykatës Supreme do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të Kryeministrit të Republikës së Kosovës.
- b. të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Supreme do të pranojnë një pagë ekuivalente me atë të një ministri në Qeveri.
- c. Kryetari i Gjykatës së Apelit do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës.
- d. të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit do të pranojnë një pagë ekuivalente prej nëntëdhjetë (90) % të Kryetarit të Gjykatës së Apelit.
- e. Kryetari i Gjykatës Themelore do të pranojë një pagë ekuivalente me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit.
- f. Gjyqtari mbikëqyrës i një dege të Gjykatës themelore do të pranojë një pagë ekuivalente me nëntëdhjetepesë (95) % të Kryetarit të Gjykatës Themelore.
- g. Çdo gjyqtar i Gjykatës Themelore do të pranojë një pagë bazë jo më pak se shtatëdhjetë (70)% të pagës së Kryetarit të Gjykatës Themelore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të shpallë një plan për kompensime shtesë të cilat njohin përgjegjësinë unike të gjyqtarëve të cilët shërbejnë në departamentet për krimet e rënda, Çështjet Ekonomike apo Administrative; por shumica e pagës bazë dhe kompensimeve shtesë në asnjë rast nuk do të tejkalojë nëntëdhjetë (90) % të pagës së Kryetarit të Gjykatës Themelore.
- h. Paga e një gjyqtari nuk do të zvogëlohet gjatë mandatit në të cilin gjyqtari është emëruar, përveç sanksionimit disiplinor të vendosur nën autoritetin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- i. Gjyqtarët gëzojnë të drejtën e pushimit vjetor prej (20) ditë pune, me pagesë.

Gjithashtu pagat e personelit të Prokurorëve janë të përcaktuara dhe definuara qartë me Ligjin për Prokurorin e Shtetit, respektivisht Neni 21 “Kompensimi i prokurorëve të shtetit” i cili thotë se:

- a. Kryeprokurori i Shtetit pranon pagë ekuivalente me atë të Kryetarit të Gjykatës Supreme.
- b. Prokurorët me mandat të përhershëm në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit pranojnë pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë për qind (90%) me pagën e Kryeprokurorit të Shtetit.
- c. Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale pranon pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë e pesë (95) % me pagën e Kryeprokurorit të Shtetit.
- d. Prokurorët me mandat të përhershëm në Prokurorinë Speciale marrin pagë ekuivalente me pagën e prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;
- e. Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit merr pagë ekuivalente me pagën e kryetarit të Gjykatës së Apelit;
- f. Prokurorët me mandat të përhershëm në Prokurorinë e Apelit pranojnë pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë për qind (90%) me pagën e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.
- g. Kryeprokurorët e prokurorive themelore marrin pagë ekuivalente me kryetarët e gjykatave themelore. Secili prokuror me mandat të përhershëm në Prokurorinë Themelore pranon pagë jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70%) e pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore. Këshilli do të nxjerr skemën për kompensime shtesë që pasqyron përgjegjësitë e veçanta të prokurorit që paraqitet para Departamentit të Krimeve të rënda pranë Gjykatës Themelore, por në asnjë rast shuma e pagës bazë 11 dhe pagesës shtesë nuk do të kalojë nëntëdhjetë për qind (90%) të pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore;
- h. Përpos pagës së tyre bazë, secili prokuror gëzon të drejtën për kompensim shtesë për shërbime tjera siç ceket me ligj apo rregulla të nxjerra nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.
- i. Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e ligjit, paga e prokurorëve të shtetit nuk do të zvogëlohet gjatë periudhës së shërbimit të tyre përpos nëse kjo caktohet si sanksion nga Këshilli Prokurorial apo Komisioni Disiplinor i Këshillit bazuar në përcaktimin se prokurori i shtetit ka kryer sjellje të pahijshme apo ndonjë vepër penale. Prokurorët e shtetit kanë të drejtë në pushim vjetor në masë të barabartë me shërbyesit civilë, por në asnjë rast më pak se njëzet (20) ditë pushimi vjetor;

c) Marrëveshjet për pagat dhe punësimin e administratës publike;

Përveç Ligjit të Punës i cili siguron principet dhe të drejtat themelore në fushën e punësimit, pagat dhe punësimi në administratën publike janë të rregulluara me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe me Ligjin mbi Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147.

Ligji për Shërbimin Civil në fillim definon shërbimin civil dhe kategoritë të cilat nuk janë pjesë e shërbimit civil. Sa i përket punësimit, ky Ligj rregullon skemën e kategorive të punësimit në shërbimin civil, kërkesat e përgjithshme për pranim në fushën e shërbimit civil, limitimet në përzgjedhjen e mbajtësve të zyrave publike në shërbimin civil, emërtimin në pozita të larta të menaxhimit, transferimin e zyrtarëve menaxhuese brenda shërbimit civil, nëpunësit civil të emërtuar apo zgjedhur në një funksion publik jashtë shërbimit civil, kriteret themelore për pranim në shërbim civil, marrëdhëniet e punës në shërbim civil, periudhën e provës, gradimin dhe avancimin, etj.

Bazuar në Nenin 4 “Kategoritë e punonjësve publikë që nuk janë pjesë e Shërbimit Civil” në Ligjin për Shërbimin Civil, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit mësimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe përformuesit e artit, zyrtarët policor të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganor të Doganave të Kosovës, zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të emëruarit politikë dhe anëtarët e kabineteve të tyre,– që nga kabineti i Presidentit, Presidentit të Kuvendit, Kryeministrit dhe kabineteve të Ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale.

Zyrtarët e zgjedhur nëpër poste të institucioneve të administratës publike dhe zyrtarët e emëruar nëpër pozita të caktuara nuk janë punonjës civilë. Të gjithë punonjësit e punësuar në kabinetet bartëse publike nuk janë punonjës civilë.

Personeli i punësuar në institucionet e administratës publike në nivel lokal dhe qendror të Qeverisë, përgjegjës për të kryer funksionet e mbështetjes dhe mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civil.

Ligji për pagat e nëpunësve civil parashikon bazën ligjore për pagat e nëpunësve civil, duke përfshirë pagën themelore dhe llogaritjen e saj, mënyrën e pagesës, klasifikimin e pozicioneve dhe gradimin e pagave në shërbimin civil, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit pozicion, vendosjen e koeficienteve, pagat shtesë duke përfshirë punën jashtë orarit dhe pagat shtesë në përputhje me kualifikimet. Aspekte të veçanta të këtij ligji rregullohen me akte të veçanta të legjislacionit dytësor civil.

- d) c) Pjesa e taksave në faturën e përgjithshme të pagave , duke përfshirë edhe kontributet shoqërore të paguara nga punëdhënësit dhe të punësuarit, si dhe struktura e grupimeve të tatimeve mbi të hyrat.

Tabela 21: Pjesa e taksave dhe kontributeve shoqërore duke përfshirë grupimet tatimore

Taksa mbi të hyrat personale dhe shkalla tatimore, në %, duke përfshirë kontributet e detyrueshme në skemën e pensioneve							
Grupimet e të hyrave mujore, in €		Shkalla Tatimore %		Kontributet e detyrueshme pensionale në pagën bruto			
Mujor	Vjetor	Deri më 2008	Që nga Janari 2009	Nga punëdhënësi	Nga punëmarrësi	Totali deri më 2008	Totali që nga Janari 2009
Mbi to 80 €	960	0	0	5	5	10	10
80 - 250 €	960€ - 3000€	5	4	5	5	15	14
250 - 450 €	3.000€ - 5.400€	10	8	5	5	20	18
Mbi 450 €	Mbi 5.400€	20	10	5	5	30	20

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

2.5. Zhvillimi dhe reformat strukturale dhe ekonomike

- Ju lutem sqaroni shkurtimisht pikat e mëposhtme:

Si është siguruar konsensusi i brendshëm mbi bazat e politikave ekonomike? Ju lutem jepni informacione të plota mbi adoptimin e politikave ekonomike në Kosovë.

Konsensusi i brendshëm mbi bazat e politikave ekonomike është siguruar përbrenda institucioneve Qeveritare përmes përfshirjes aktive, hyrjes, dhe konsultimeve intensive të ministrive linjë që janë përgjegjëse për sektorin e zhvillimit ekonomik, hartimin e Vizionit të Zhvillimit Ekonomik 2011-2014, hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) si një mekanizëm afatmesëm të planifikimit strategjik, dhe të buxhetit. I gjithë ky mekanizëm funksionon si në vijim:

- a) Politikat dhe prioritet kryesore të ekonomisë janë të përcaktuara në planin e Vizionit të Zhvillimit Ekonomik 2011-2014 që është aprovuar më 23 Prill, 2011 (vendimi nr. 01/10). Ky dokument është rezultat i një procesi me pjesëmarrje të të gjitha ministrive përgjegjëse për zhvillimin e sektorit ekonomik, duke përfshirë Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë, Ministrinë e Agrikuturës, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Integritimit Evropian, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, etj. Si rezultat, Plani i Zbatimit të Vizionit të Zhvillimit Ekonomik 2011-2014 është hartuar. Plani është koordinuar nga një grup koordinues i përbërë nga përfaqësues të çdo ministrie dhe janë udhëhequr nga Zyra e Kryeministrit, ndërsa procesi është mbikëqyrur dhe miratuar nga ministrat për Zhvillimit Ekonomik;
- b) Sektori i Ministrave të departamentit ekonomik në fillim të vitit 2012 kanë vendosur që vizioni i zhvillimit ekonomik të avancohet në Platformën e Zhvillimit Ekonomik dhe kanë hartuar një draft të kësaj Platforme. Në Prill të vitit 2012, qeveria ka vendosur (vendimi nr. 02/67) për themelimin e Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik të përbërë nga të gjithë ministrat e të gjithë sektorëve të departamentit ekonomik, Aleancën Kosovare të Biznesit, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike Amerikane. Këshilli është i udhëhequr nga Zëvendës Kryeministri, përgjegjës për zhvillim ekonomik dhe monitorim në zbatimin e platformës për zhvillimin ekonomik dhe iniciativave për reforma ekonomike;
- c) Bazuar në prioritetet e Vizionit të Zhvillimit Ekonomik, një Plan i Veprimit për Zhvillim Ekonomik (PVZHE) ishte hartuar. Plani i Veprimit paraqet një platformë për zbatimin e reformave politike dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës për një periudhë afatmesme. PVZHE 2011-2014 është dokument bazë për hartimin dhe përcaktimin e prioritetëve të Qeverisë për këtë periudhë;
- d) Në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LAS-LMFPP), Nr. 03/L-221, Qeveria dërgoi Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve në Kuvend para 30 Prill-it (siç kërkohet me ligj). KASH tashmë është një nga dokumentet i avancuara për planifikim strategjik që lidh strategjitë sektoriale në buxhetin vjetor. KASH 2013-2015 reflekton prioritetet sektoriale të paraqitura në PVZHE. KASH-i përmban: a) Prioritetet e Qeverisë për 3 vitet e ardhshme (në përputhje me PVZHE-në); b) kornizën makro-fiskale që definojnë shpenzimet e përgjithshme për secilën kategori të shpenzimeve; c) segmentet sektoriale që përshkruajnë kufijtë tregues për secilën kategori të shpenzimeve; d) pjesën e financave komunale, ku burimi i financimit komunal është i definuar (grandet e Qeverisë dhe të hyrat vetanake) dhe kufijtë tregues të shpenzimeve për secilën kategori të shpenzimeve;
- e) Buxheti vjetor është i hartuar në bazë të limiteve të vëna në KASH, një dokument që përcakton shpenzimet për secilën kategori. Kështu që, konsensusi i brendshëm për çështjet themelore të politikave ekonomike është siguruar në nivel të Qeverisë, ndërsa politikat e tilla janë diskutuar gjithashtu edhe në Kuvend.

- Sipas mendimit tuaj cilat janë sfidat e veçanta/prioritetet për politikat ekonomike të Kosovës, duke përfshirë edhe kontekstin e rimëkëmbjes të post-krizës globale, dhe si mendoni se do t'i trajtoni ato ?

Vizioni i Planit Ekonomik 2011 ka theksuar prioritet kryesore në fushën e zhvillimit ekonomik. Prioritetet e shënuara në këtë plan janë të përfshira në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2013-2014 janë si më poshtë:

- a) Ruajtja e Qëndrueshmërisë Makro-Fiskale;
- b) Rritja e investimeve, përmirësimi mjedisit të investimeve dhe mbështetja e sektorit privat;
- c) Modernizimi dhe zhvillimi i infrastrukturës publike;
- d) Rigjallërimi i sektorit të agrikulturës;
- e) Zhvillimi burimeve njerëzore.

Kriza ekonomike nëpër të cilën ekonomia globale është duke kaluar, veçanërisht disa ekonomi Evropiane nuk kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në ekonomi, për shkak të integritetit të pjesshëm të sektorit financiar të Kosovës, baza e ulët e eksportit dhe nivel shumë i ulët i borxhit publik. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka marrë urdhrin të mbikëqyr sektorin financiar. Me qëllim për të forcuar më tej sektorin financiar dhe për ta ruajtur stabilitetin dhe besueshmërinë e saj, Qeveria e Kosovës, së bashku me BQK-në kanë krijuar Fondin për Mbështetje të Likuiditetit dhe Emergjencave (FMLE) që do të shërbejë si një fond në rast të ndonjë goditjeje financiare.

Në pikëpamje të përgjithshëm, masat politike që do të merren për trajtimin e sfidave/ prioriteteve përfshijnë:

- a. Në mungesë të politikës monetare, politika fiskale do të jetë e vetmja vegël për të siguruar dhe mirëmbajtur stabilitetin makroekonomik. Në këtë kontekst Qeveria është përkushtuar për: të mbajtur bilancin bankar në shkallën e rekomanduar prej 3-4% të PBB-së, të limitoj rritjen e shpenzimeve gati deri në 60% të shpenzimeve totale, zhvillimin e politikave fiskale në periudhën 2013 - 2015, dhe për të rritur të hyrat lokale si % e PBB-së. Gjithashtu, me qëllim të mirëmbajtjes së qëndrueshme së nivelit të deficitit dhe borxhit publik, Ligji mbi Borxhet Publike (LBP) Nr. 03/L-175 tregon se niveli i borxhit publik nuk duhet të kalojë 40% të PBB-së. Për t'u siguruar që politika fiskale mbetet në një rrugë të qëndrueshme, Ministria e Financave ka në plan të miratojë një rregull fiskal ligjorë të detyrueshëm, në lidhje me qëndrueshmërinë e bilancit buxhetor i cili do të shërbejë si udhëzimi për politikë-bërësit dhe publikun.
- b. Masat që priten të krijojnë një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat dhe investimeve përfshijnë: përmirësimin e Kornizës Ligjore duke përfshirë Ligjet, riorganizimin e procesit të lejeve të ndërtimit (duke përfshirë zvogëlimin e numrit të dokumenteve dhe kohës së kërkuar për të marrë një leje ndërtimi), miratimin e 'konceptit të ombrellës' për lejet që synojnë eliminimin deri në 50% të licencave ekzistuese deri në vitin 2014. Në fund të vitit 2011, bilanci tregtar arriti në rreth -40% të PBB-së, një nivel i cili konsiderohet të jetë mjaft i madh. Pavarësisht rritjes së vazhdueshme të eksporteve, struktura e saj mbetet bazuar kryesisht në metalet bazë (rreth 60%), në krahasim me importet të cilat janë të ndryshme. Për të ndërtuar një themel të fortë të eksporteve, synimet e Qeverisë janë krijimi i një mjedisi më të favorshëm për investime, zhvillimi i sektorit privat dhe hartimi i politikave fiskale që do të mbështesin sektorët që konsiderohen se kanë potencial dhe të jenë konkurrues në tregun ndërkombëtar.
- c. Modernizimi dhe zhvillimi i infrastrukturës publike përfshinë objektivat për ndërtimin dhe zhvillimin e infrastrukturës rrugore deri në vitin 2014, transformimin e aseteve publike, rritjen dhe zgjerimin e furnizimit me energji, zhvillimin e projekteve të partneritetit publiko-privat (PPP).
- d. Rigjallërimi i sektorit të agrikulturës është një prioritet tjetër. Masat që synojnë të merren janë: rritja e prodhimit bujqësor dhe blegtoral nëpërmjet masave të mbështetjes direkte, qasja më e mirë për kredi bujqësore, lehtësimi i trajnimit profesional, rritja e konkurrencës së kapitalit njerëzor dhe zhvillimi i infrastrukturës agro-rurale.
- e. Zhvillimi i burimeve njerëzore - shkalla e papunësisë në Kosovë ka qenë gjithmonë e lartë; prandaj, mbetet një prioritet i vazhdueshëm që ka nevojë të trajtohen ashtu siç duhet. Në afat të shkurtër kjo sfidë duhet të vihet në shënjestër duke krijuar kushte të përshtatshme për investimet private vendase (NVM) dhe investimet e jashtme. Masat të cilat janë parashikuar të merren për zhvillimin e burimeve njerëzore të cilat gjithashtu do të kenë një ndikim në uljen e shkallës së papunësisë janë: ristrukturimi dhe zhvillimi i sistemit edukativ dhe profesional në mënyrë që të plotësojnë kërkesat e tregut të punës, krijimin e një sistemi të besueshëm të informacionit të tregut të punës, si dhe rritjen e kapaciteteve për aftësime profesionale për punëkërkuarit/papunët për rreth 20% deri në vitin 2014.

- Si ka qenë koordinimi mes palëve të ndryshme (p.sh. ministritë e linjës, Ministria e Financave dhe/ose Banka Qendrore) për formulimin e politikave ekonomike dhe zbatimin e tyre, dhe si janë realizuar? Cilat janë organet konsultative të përfshira në procesin e vendimmarrjes? Deri në çfarë mase janë të përfshirë partnerët socialë? Nëse është e rëndësishme, cila është koha për partnerët socialë dhe organet tjera konsultative për të dhënë mendimin e tyre?

Koordinimi i hartimit të politikave ekonomike është realizuar në nivel politik përmes Grupit të Ministrave të Departamenteve Qeveritare të lidhura me fushën ekonomike. Në nivelin teknik, koordinimi bëhet përmes një grupi të këshilltarëve dhe nëpunësve civil të cilët koordinojnë formulimin dhe hartimin e politikave ekonomike për Vizionin e Zhvillimit Ekonomik 2011-2014. Puna e koordinimit u zhvillua midis muajit Prill dhe Korrik 2011. Grupet e nivelit teknik dhe politik kanë punuar në rishkrimin e politikave gjatë muajve Janar 2012 dhe Prill 2012. Drafti i Vizionit të Planit Ekonomik, për qasje nga publiku, është publikuar në faqe të internetit të Zyrës së Kryeministrit. Takimet dhe konsultimet me organizatat e bizneseve, shoqërinë civile, dhe komunitetin e donatorëve, u mbajtën në Tetor 2011.

Ndërsa procesi konsultativ për hartimin e KASH-it, bazuar në prioritetet e përcaktuara nga mekanizmat e lartpërmendur, është udhëhequr nga MF-ja në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr 03/L-221 përmes mekanizmave të mëposhtëm:

- a. MF-ja inicion mekanizmat e hartimit të KASH-it duke e informuar Kryeministrin dhe kabinetin e tij me aktivitetet, kohëzgjatjen, dhe përgjegjësitë e institucioneve/ ministrive në këtë proces. Pastaj ajo lëshon udhëzime për përgatitjen e KASH-it. Ky dokument është i bazuar në Deklaratën e prioriteteve dhe përmban udhëzime të qarta për përgjegjësitë e organizatave buxhetore (OB) në këtë proces, orarin e dorëzimit të dokumenteve nga OB-të dhe një shembull konkret ilustrues i materialeve të nevojshme që duhet të dorëzohen në MF-ve.
- b. Kabinete qeveritare, sekretarët gjeneral dhe nëpunësit civilë janë të përfshirë në procesin e hartimit të KASH-it në bazë të udhëzimit të MF-ve. Kontributi i tyre përfshin deklaratën e misionit të tyre, pasqyrën e gjendjes aktuale, objektiva të matshme për t'u arritur, tabelat që përmbajnë prirjet historike dhe ndarjet e propozuara buxhetore brenda limiteve të burimeve dhe kufizimeve buxhetore. Rezultati i këtij procesi është KASH Drafti i cili është dorëzuar për aprovim në Kabinetin Qeveritar të Ministrave.
- c. Paralelisht me këtë proces konsultues në hartimin e KASH-it, që ndodh në nivel të institucioneve Qeveritare, Qeveria e Kosovës në Mars të vitit 2012 me synim të rritjes së kualitetit të politikë-bërësve ekonomik morën vendimin nr. 02/67 për krijimin e Këshillit Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik të Kosovës (KKZHEK). KKZHEK është një organ konsultues, me pjesëmarrës nga organizatat e bizneseve së bashku me institucionet Qeveritare. KKZHEK përfshin Ministrinë e Financave (MF), Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministrinë e Industrisë dhe Tregtisë (MIT), Ministrinë e Integriteteve Evropiane (MIE), Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministrinë e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (MASHT), Odën Ekonomike të Kosovës (OEK), Aleancën Kosovare të Biznesit (AKB), dhe Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK). KKZHEK është kryesuar nga Zëvendës - Kryeministri përgjegjës për sektorin ekonomik, i cili gjithashtu është Ministër i Tregtisë dhe Industrisë. Sipas projekt rregullores xx/2012 për funksionimin e Këshillit, mbledhjet duhen të mbahen më së paku çdo dy muaj, apo më shpesh me kërkim të kryetarit apo të paktën nga 3 anëtarë.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 02/67, ndër të tjera, KKZHEK organizon dhe strukturon aktivitetet e institucioneve shtetërore me qëllim që të përmirësojë mjedisin e bizneseve dhe investimeve, aprovon planet operative, dhe inicion diskutimet dhe bashkëpunimin me investitorët

potencial. Një nga detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Këshilli është gjithashtu të monitoroj zbatimin e PVZHE (2011-2014), që është një prioritet me rëndësi shumë të madhe.

Përfshirja e partnerëve socialë në procesin ekonomik të krijimit të politikave është kryer nëpërmjet Këshillit Ekonomik dhe Social (KES) në pajtim me Ligjin për Këshillin Ekonomiko-Social nr. 04/L-008. Këshilli është formuar me synim që të krijoj dhe zhvilloj dialogë social në Kosovë për punëtorët dhe punëdhënësit në çështje me rëndësi të lartë për përmbushjen e të drejtave ekonomike, sociale dhe profesionale të tyre, të cilat janë të realizuara përmes marrëveshjeve bilaterale dhe trepalëshe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. KES përbëhet nga pesë (5) përfaqësues të emëruar nga organizatat e punëtorëve, pesë (5) përfaqësues të emëruar nga organizatat e punëdhënësve dhe pesë (5) përfaqësues të emëruar nga Qeveria. Sipas Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social nr. 04/L-008, bordi takohet më së paku një herë në dy muaj.

- Financat Publike: Cili është qëllimi i sistemit të financave publike? Si është konceptuar kjo? Si janë zhvilluar shpenzimet dhe të hyrat e Qeverisë si pjesë PBB-së përgjatë 5 viteve të fundit, si një tërësi gjithashtu edhe në lidhje me kategoritë?

Financat Publike ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Rrjedhimisht, në një mënyrë është konceptuar që financat e kategorive funksionale përputhen me prioritet kombëtare dhe tendencat e të të ardhurave, bazuar në legjislacionin përkatës.

Planifikimi dhe hartimi i buxhetit kombëtar është kryer në bazë të prioriteteve të Qeverisë, me qëllim të realizimit të planeve afatmesme dhe përmbushjen e vizionit të qëndrueshëm rreth zhvillimit ekonomik. Një proces i tillë kërkon përfshirjen e të gjitha OB-ve të cilat janë përgjegjëse për hartimin e kërkesave buxhetore në linjë me stabilitetin makro-fiskal të vendit.

Zbatimi i politikave fiskale të hartuara nga Qeveria e Kosovës përgjatë periudhës 2007-2011 është kryer në përputhje me objektivat për zgjerim të vazhdueshëm ekonomik, ruajtjen e qëndrueshmërisë makro-fiskale, bazuar në një sistem tatimor të thjeshtë me një bazë më të gjerë dhe një normë më të ulët të taksave. Një qasje e tillë ka lejuar që Kosova të ketë një nga normat më të ulëta tatimore për bizneset, për më shumë detale shih Aneksin 3a.

Bazuar në të dhënat gjatë viteve 2007-2011, të hyrat totale kanë vazhduar të rriten në një mesatare vjetore prej rreth 14 %. Të hyrat nga doganat përgjatë kësaj periudhe janë rritur me një mesatare vjetore për 13% ose rreth 55% krahasuar me vitin 2017, në terme nominale. Vetëm përgjatë vitit 2011, të hyrat e tilla janë rritur për 18% krahasuar me vitin 2010. Të hyrat e brendshme gjatë të njëjtës periudhë janë rritur me një mesatare vjetore rreth 10.3% ose 40.7% krahasuar me vitin 2007. Vetëm në vitin 2011, të hyrat janë rritur për 18% në krahasim me vitin 2010. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të ardhurat si % e PBB-së. Në total, të ardhurat qeveritare janë rritur në mënyrë të vazhdueshme përgjatë 5 viteve të fundit. Të hyrat e përgjithshme në 2007 kanë qëndruar tek shuma €898 milion, duke arritur shumën prej € 1,303 në vitin 2011, për më shumë detale shih Aneksin 3a.

Tabela 22: Të hyrat si % e PBB-së

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011
Të Hyrat Doganore	15.7%	15.7%	16.2%	16.7%	18.0%
Të Hyrat Lokale	5.7%	5.8%	5.3%	5.3%	5.7%
Të Hyrat Jo-Tatimore	5.4%	3.6%	3.3%	3.5%	3.5%
Te Hyra të tjera	0.5%	1.2%	5.5%	3.7%	2.1%
Totali	28.6%	24.2%	29.3%	26.5%	27.8%

Burimi: MF

Rritja e vazhdueshme ekonomike e shënuar gjatë viteve 2007-2011, është shoqëruar me rritje të vazhdueshme të shpenzimeve të buxhetit të përgjithshëm, si pjesë e PBB-së. Shpenzimet e përgjithshme për periudhën 2007 - 2011 janë rritur me një mesatare prej 9.2%. Si një pjesë e PBB-së, shpenzimet janë rritur prej 19.5% në 2007 në 29.9% në 2011, kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve kapitale. Ndërsa kategoritë e tjera të shpenzimeve, me përjashtim të kategorive të shpenzimeve kapitale, pagave, dhe mëditjeve, kanë ulur pjesëmarrjen e tyre në PBB. Sa i përket vitit 2008, Qeveria e Kosovës është fokusuar në rritjen e investimeve kapitale, që është rritur për 120% vetëm në vitin 2008. Kjo politikë nuk është shoqëruar me rritje të konsiderueshme të deficitit primar gjatë viteve 2007-2011, kryesisht si rezultat i rritjes së vazhdueshme të të hyrave buxhetore. Zbatimi i politikave fiskale ka rezultuar në një buxhet pothuajse të balancuar për gjatë viteve 2008-2009. Gjatë vitit 2010, bilanci primar ka arritur -2.3% të PBB-së kurse në vitin 2011 është ulur edhe më tej për -1.5%.

Tabela 23: Shpenzimet e Përgjithshme në % të PBB-së

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011
Të Hyrat	28.6%	24.2%	29.3%	26.5%	27.8%
Shpenzimet Primare	27.8%	28.8%	29.0%	28.7%	29.2%
<i>Nga të cilat: Shpenzimet Kapitale dhe Net Kredi-të</i>	4.6%	9.0%	10.2%	10.9%	11.5%
Bilanci Aktual	13.7%	8.7%	10.0%	9.1%	10.0%
Bilanci Primar	9.1%	-0.3%	-0.6%	-2.3%	-1.5%
Bilanci Total (duke përfshirë pagesat e interesit)	9.3%	-0.5%	-1.1%	-2.5%	-1.7%

Burimi: MF

Në tërësi, shpenzimet e përgjithshme të Qeverisë në vitin 2007 kanë mbërritur shumë prej €661.2 milion, në vitin 2008 kanë mbërritur shumë prej €950.5, si dhe në vitin 2009 kanë mbërritur shumë prej €1,232. Ky trend pozitiv ka vazhduar edhe përgjatë viteve 2010 dhe 2011 me një total të shpenzimeve prej €1,272 milion, respektivisht €1,388 milion për vitin 2011.

- Sistemi buxhetor: ju lutem përshkruani karakteristikat e procesit, planifikimit dhe ekzekutimit të programit rreth buxhetit të Qeverisë. Ju lutem tregoni qëllimet politike, zhvillimet dhe të arriturat sa i përket politikave buxhetore. A janë konsultuar me partnerët sociale në fazën e planifikimit/programimit të ciklit buxhetor. Sa është efikasiteti dhe efektiviteti që sigurohet rreth shpenzimeve të Qeverisë?

Plani Buxhetor: Procesi i buxhetimit është paraprirë nga dokumenti i KASH-it që është përgatitur për tre vitet e ardhshme. Ky dokument ofron objektiva të matshme specifike të cilat lehtësojnë përmbushjen e vizionit dhe programit Qeveritar. Po ashtu ky dokument ndihmon në procesin e buxhetimit duke pasur parasysh që këto objektiva përkthehen në aktivitete dhe projekte përgjatë përpilimit të buxhetit nëpërmjet programeve buxhetore.

Procesi i përpilimit të buxhetit fillon me lëshimin e qarkoreve buxhetore duke filluar nga 15 Maji për secilin vit kalendarik. Në mes të muajit gusht dhe shtator, dëgjimet buxhetore me të gjitha OB-të në nivel qendror organizohen çdo vit për të shqyrtuar kërkesat e tyre për ndarjet buxhetore. Institucionet e ftuara për gjatë dëgjimeve buxhetore janë: Komiteti për Buxhet dhe Financa, Zyra e

Kryeministrit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, dhe institucionet që shprehin interesimin e tyre, duke përfshirë shoqërinë civile.

Sa i përket buxhetit të komunave, forume me autoritete lokale organizohen përgjatë muajve Qershor – Shtator me qëllim të zhvillimit të ciklit buxhetor komunal, duke u fokusuar në përfshirjen e plotë të principeve themelore të stafit komunal, transparencën, konkurrencën, dhe demokracinë. Dëgjime publike me qytetarët janë mbajtur ku prioritet komunale janë përpunuar në detale, dhe pastaj Kuvendi i Komunës ka aprovuar dhe paraqitur buxhetin në Ministrinë e Financave (MF).

Në parashikimet buxhetore që përdorin sistemet elektronike të BDMS (Zhvillimi i Buxhetit dhe Sistemi i Menaxhimit) dhe Programi për Investime Publike (PIP) janë mjete të përdorura për planifikimin e buxhetit. Ndarjet në bazë të Ligjit të Buxhetit, ndarjet buxhetore ndahen në tri kategori:

- a. Ndarjet buxhetore nga OB-të (Ministritë, Komunitat, programet dhe nën-programet);
- b. Ndarjet sipas funksionit dhe ndarjet sipas kategorive ekonomike.

Zbatimi i Buxhetit: Pas miratimit të ndarjeve buxhetore në Kuvendin e Kosovës, procesi për ekzekutimin e procesit fillon përmes Sistemit Informativ për Menaxhim Financiar (SIMF), kryesisht nën përgjegjësinë e OB-ve dhe Departamentit të Thesarit. Departamentet buxhetore vetëm ndjekin ndryshimet në ndarjet buxhetore që janë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (LMFPP) Nr. 03/L-048, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) Nr. 03 / L-049 dhe ligjet vjetore për buxhet. Sipas Ligjit për Buxhet nr. 04-L-079, të paktën dy herë në vit, gjatë ri-shikimit të raportit gjysmë vjetor për mbylljen e vitit fiskal, Ministri do të raportojë në kabinetin e Qeverisë dhe/ose në Kuvend për ndryshimet dhe rregullimet në buxhet që ndodhën gjatë vitit fiskal.

Transferimet/Rishpërndarja në mes kategorive ekonomike, siç janë subvencionet në kapital, si dhe transferimet/rishpërndarja në mesin e ministrive janë të rregulluara me ligj.

Transferimet/Rishpërndarja në mes kategorive janë të rregulluara në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 04/L-048, Neni 30 dhe 31 në pajtim me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 04/L-079, Neni 13-14.

- a. Deri në një përqindje të caktuar, transferimet dhe rishpërndarja e programeve brenda organizatës buxhetore mund të miratohet nga ministri (deri në 15%), Qeveria (deri në 25%) të ndarjeve të prekura negativisht;
- b. Asnjë transferim ndërmjet organizatës buxhetore nuk mund të bëhet pa miratimin e Kuvendit;
- c. Kurdo që një organizatë buxhetore qendrore ka nën kaluar shpenzimet në përputhje me planin rrjedhës të parasë së dorëzuar në Thesar, Ministri me miratimin e Qeverisë mund të autorizojë një reduktim në ndarjet, por vlera e përgjithshme e të gjitha transferimeve nuk duhet të kalojë shumën prej pesë për qind (5%) të vlerës totale të të gjitha ndarjeve buxhetore;
- d. Kur përvetësimi ndërlidhet me një përgjegjësi të veçantë të një organizate buxhetore, një përgjegjësi e tillë është transferuar në mënyrë të ligjshme ose i delegohet një organizate tjetër buxhetore, Ministri mund të transferojë, siç mund të kërkohet në bazë të rrethanave, të gjitha apo një pjesë e përvetësimeve të tilla nga buxheti i organizatës së fundit;
- e. Të gjitha ndryshimet për shkak të transferimeve dhe rishpërndarjes janë evidente në sistemin e Free - Bilancit (SIMFK) Zhvillimi i Buxhetit dhe Sistemi i Menaxhimit (SZHMB) dhe Sistemi i Programit të Investimeve Publike (PIP).

Partnerët shoqëror konsultohen në nivelin e vendimmarrjes, dhe jo në fazën e konsultimeve rreth ciklit buxhetor sepse në këtë fazë konsultimet kryhen vetëm me OB-të, të cilët do të transmetojnë angazhimin dhe qëndrimet e tyre në Këshillin Ekonomik Social.

Raportet tremujore dhe vjetore të progresit fizik dhe financiar rreth zbatimit të projekteve kapitale janë përgatitur përmes sistemit të PIP-it me qëllim të monitorimit të efikasitetit të shpenzimeve. Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit, përmes qarkoreve buxhetore, OB-të janë të detyruara të paraqesin treguesit e performancës për kërkesat e tyre buxhetor.

- Politika dhe Struktura e Shpenzimeve: Ju lutem jepni një përshkrim të shkurtër për Strukturën e Shpenzimeve të Qeverisë bazuar në elementet dhe funksionet ekonomike gjatë pesë viteve të fundit. Cilat janë prioritetet kryesore të Qeverisë rreth shpenzimeve dhe si janë të lidhura me zhvillimin e politikave të përgjithshme ekonomike?

Bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (LMFPP), Nr. 03/L-048 dhe Ligjin për Buxhetin Vjetor, struktura e shpenzimeve sipas klasifikimit funksional është e ndarë në kategoritë e mëposhtme:

- a. Shërbimet e Përgjithshme;
- b. Mbrojtjes;
- c. Zbatimi i Ligjit dhe Sigurisë Publike;
- d. Çështjet ekonomike;
- e. Mbrojtjes së Mjedisit;
- f. Çështja e komuniteteve dhe banimit;
- g. Shëndetësi;
- h. Rekreacion, kulturë, dhe fe;
- i. Arsimim;
- j. Mbrojtje Sociale.

Gjatë periudhës 2008-2011, Qeveria e Kosovës ka orientuar shpenzimet financiare në drejtim të financimit të çështjeve ekonomike, ku theks i veçantë i është dhënë përmirësimit të infrastrukturës rrugore. Qeveria e Kosovës ka drejtuar shpenzimet financiare kundrejt financimit të çështjeve ekonomike, ku rol i veçantë i është dhënë përmirësimit të infrastrukturës. Shpenzimet në këtë kategori kanë pësuar një trend në rritje prej 18.6 të shpenzimeve totale në vitin 2007 në 31.2% në vitin 2011. Kategoria e mbrojtjes sociale ka pësuar një ulje prej 17.9% të shpenzimeve totale në 2007 në 12.9% në vitin 2011. Kategoritë e tjera kanë kaluar nëpër një prirje pak a shumë lineare gjatë kësaj periudhe, për më shumë hollësi shih Aneksi 3a.

Struktura e shpenzimeve nga natyra ekonomike, përfshirë kategoritë e mëposhtme:

- a. Pagat dhe kontributet;
- b. Produktet dhe shërbimet;
- c. Shpenzimet komunale;
- d. Subvencionet dhe transferet;
- e. Shpenzimet kapitale;
- f. Shpenzimet tjera.

Shpenzimet e Përgjithshme sipas kategorive ekonomike si pjesë e PBB-së, janë ngritur nga 19.5% në vitin 2007 në 29.9% në vitin 2011, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve kapitale. Gjithashtu, kategoria e pagave dhe kontributeve është rritur nga 6.1% (si pjesë e PBB-së) në vitin 2007, në 8.4% në vitin 2011, ndërsa kategoria e shpenzimeve tjera si pjesë e PBB-së ka rënë.

Procesi buxhetor është paraprirë nga ana e Planit të Zhvillimit Ekonomik (PZHE) dhe KASH-i. KASH 2013-2015 përmban Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë së Kosovës për periudhën afat-

mesme. Me qëllim të një zhvillimi të përgjithshëm ekonomik, kjo deklaratë përmban katër shtylla kryesore:

- a. Rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- b. Qeverisje të mirë dhe forcimin e sundimit të Ligjit;
- c. Zhvillimin e burimeve njerëzore;
- d. Ngritjen e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët.

Këto janë shtyllat kryesore për zhvillim ekonomik. Për më shumë, përmes strategjive sektoriale dhe OB-ve këto prioritete janë të ndara në objektiva specifike dhe të transmetuara në shpërndarje të veçanta buxhetore. Objektivat konkrete janë të zhvilluara në projekte dhe aktivitete individuale përmes procesit buxhetor, për më shumë shiko Aneksin 3a.

- Politika tatimore: Cilat janë autoritetet përgjegjëse për mbledhjen e taksave në nivelin Qeverisës qendrore? Cilat taksa i mbledhin? Cilat janë përgjegjësitë fiskale të autoriteteve të ndryshme (lloji i taksave të mbledhura)? Si ka ndryshuar regjimi i taksave gjatë pesë viteve të fundit (ndryshimet e normave tatimore, paraqitja e taksave të reja dhe kontributet etj)? A ka ndonjë rrjedhje të përshtatshme të të ardhurave për komunat në mënyrë që të financojë kompetencat e tyre? A ka ndonjë mekanizëm për rishpërndarjen e burimeve ndërmjet komunave? A pritet që buxheti qendror t'i financoj komunat?

Mbledhja e taksave në nivelin Qeverisës qendrore është e mbajtur nga Dogana e Kosovës (DK) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

Llojet e taksave të mbledhura në nivelin qendror nga Dogana janë:

- a. Taksa doganore;
- b. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH);
- c. Akciza

Ndërsa llojet e taksave të mbledhura në nivel qendror nga Administrata Tatimore janë:

- a. Tatimi mbi vlerën e shtuar (VAT)
- b. Tatimi mbi të ardhurat
- c. Tatimin mbi të ardhurat personale, që në bazë të Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale nr. 03/L-161 përfshin të ardhurat nga pagat, qiraja, interesi, përdorimi i aseteve të paluajtshme të pronës, shtimi kapitalit, fitimi në lotari dhe lojërat e fatit, dhe të ardhurat nga bizneset me qarkullim vjetor bruto prej € 50.000 apo më pak.

Që nga viti 2011 e deri më tani, disa ndryshime kanë ndodhur në politikat taksore të Kosovës. Më 1 Janar 2009, Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale ka hyrë në fuqi, i cili ka ofruar një reduktim të normës së tatimit prej 0%, 5%, 10%, dhe 20% në 0% për të ardhura deri në €960, 4% për grupim të të ardhurave vjetore nga €960 deri në €3,000, 8% për grupim të të ardhurave vjetore në mes të €3,000 dhe €5,400, dhe 10% për të ardhurat vjetore më shumë se €5,400. Gjithashtu, sipas këtij ligji, norma e taksës ishte zvogëluar nga 20% në 10% për të ardhurat nga qiratë, interesi, dividendët, shtimit të kapitalit, lotari dhe kumari, pensionet dhe të ardhurat tjera. Pastaj Ligji mbi të Ardhurat Nr. 03/L-115 ishte shfuqizuar nga Ligji mbi të Ardhurat Nr. 03/L-161 e cila përjashtoi taksat mbi të ardhurat nga dividendët.

Gjithashtu, me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi të Ardhurat Nr. 03/L -113 më 1 Janar 2009, norma e taksës ishte ulur nga 20% në 10%. Pastaj, më 1 Janar 2010, hyrja në fuqi e ligjit të ri mbi të Ardhurat Nr. 03/ L-162 ka pasur ndryshime të tjera në taksa. Ndryshime të tilla përfshijnë zvogëlimin e normës të taksave për kompanitë e sigurimeve nga 7% në 5%, përjashtim nga tatimi mbi të ardhurat e dividendit për personat rezidentë dhe jo-rezident, interesi i instrumenteve financiare të lëshuara nga autoritetet publike në Kosovë dhe aktivitetet ekonomike të institucioneve fetare për qëllime të vetë-qëndrueshmërisë.

Me qëllim të një efekti neutral në reformën fiskale në të ardhurat buxhetore, norma e TVSH-së është rritur nga 15% në 16% sipas Ligjit mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar Nr. 03/L - 114. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të TVSH-së Nr. 03/L-146 më 1 Janar 2010, Ministri i Financave ka dhënë leje për, nëse është e nevojshme, të nxjerrë aktet nën-ligjore për futjen e një norme më të ulët (deri në 5%) dhe më të lartë (deri në 21%) të TVSH-së, për furnizimet të caktuara të mallrave dhe shërbimeve që përmban Aneksi III i këtij ligji.

Më 11 Nëntor 2008, Ligji për Kodin Doganor dhe të Akcizave Nr. 03/L-109 ka hyrë në fuqi duke zëvendësuar Rregulloren e UNMIK-ut 2004/1 dhe 2005/32 dhe Udhëzimin Administrative 2004/24.

Gjithashtu, disa ndryshime janë zbatuar edhe në normat e akcizave, e cila në bazë të Ligjit të Ndryshimit dhe Plotësimit, Ligji për Tatimin e Normës së Akcizës Nr. 03/L - 220, gazet e naftës dhe hidrokarburet e tjera të naftës (kodi tarifor 2711) që përdoren për qëllime të prodhimit janë të përjashtuara nga pagesat e akcizës. Nga mesi i vitit 2011, Qeveria mori një vendim për të ndryshuar normën e akcizës në produktet e duhanit, automjetet motorike dhe miratoi aplikimin e akcizës në kumar. Akciza në produktet e duhanit u rrit nga 25 € në 27€ për 1000 njësi të produkteve të duhanit, ndërsa akciza për veturat ishte rritur nga 500€ dhe u klasifikua në bazë të fuqisë së motorit dhe vitit të prodhimit.

Sipas Ligjit për Tatimin në Pronë të Paluajtshme Nr. 03/L-204, Komunitat janë përgjegjëse për mbledhjen e taksave të pronës. Pas ndryshimit dhe miratimit nga Kuvendi i Kosovës, normat e reja me prag minimal janë rritur nga 0.05% në 0.15% që në pajtim me këtë Ligj do të hyjë në fuqi nga 1 janari 2013.

Tabela 24: Tatimi mbi të Ardhurat Personale dhe Normat tatimore në %

Grupimi i të ardhurave, monedha Euro		Normat tatimore, në %	
Mujore	Vjetore	Deri 2008	Nga Janari 2009
Deri në 80 €	960	0	0
80 - 250 €	960€ - 3000€	5	4
250 - 450 €	3.000€ - 5.400€	10	8
përmbi 450 €	përmbi 5.400€	20	10

Tabela 25: Të ardhurat e korporatave dhe normat Tatimore të TVSH-së, në %

	Deri në fund të vitit 2008	Nga viti 2009
Të ardhurat e korporatave	20	10
TVSH-ja	15	16

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës

Parimet e financimit komunal dhe pjesëmarrja e buxhetit komunal në Buxhetin e Kosovës (Grandet qeveritare për komunitat) janë të strukturuar në përputhje me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) Nr. 03/L-049 dhe legjislacioneve të tjera në fuqi.

Ministritë nga viti në vit kanë pasur një rritje të shkallës së decentralizimit fiskal dhe transparencës në planifikimin, regjistrimin/ekzekutimin dhe raportimin e buxhetit të komunës.

Përcaktimi i shumave totale të grandeve të Qeverisë dhe shpërndarja e tyre nëpër komuna individuale kryhet nga Komisioni i Grandeve (KG) në bazë të nenit 33 të LFPL duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- a. Zbatimi i parimeve, kriterëve dhe formulës së përgjithshme të vendosur nga LFPL
- b. Analiza e standardeve sektoriale e dhënë nga ministritë e linjës MASHT, MSH, MAPL
- c. Caktimi i Formulës për grande të veçanta në arsimin para-universitar dhe kujdesin shëndetësor primar
- d. Kornizën makro-fiskale si bazë e KASH-it

Një marrëveshje e tillë institucionale është zhvilluar nga Sekretariati i Komisionit të Grandeve në MF në pajtim me nenin 32 pika 5 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal në konsultim dhe koordinim me: a) Ministritë e linjës MASHT, MSH, dhe MAPL-ja, duke përfshirë fondet për kujdesin shëndetësor sekondar si një kompetencë e shtuar, b) komunat duke përfshirë harmonizimin ndërmjet komunave amë me komunat e reja të përshkruara në memorandumet e mirëkuptimit, c) Departamentit Makroekonomik dhe Departamentit të Buxhetit Qendror të Ministrisë së Financave, dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar (FMN, BB, KE, AAZHN, OSBE-së, etj.).

Sistemi komunal financiar aktualisht përbëhet nga një decentralizim fiskal i avancuar, ku komunat kanë kompetenca të konsiderueshme të shpenzimeve, autoritet për të ofruar shërbime publike, autoritet për të mbledhur të ardhurat, dhe autoritet mjaft të lartë në menaxhimin e financave publike. Sipas rekomandimeve të Misionit të FMN-së për vitin 2013, komunat do të kenë fleksibilitet në ndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2013, duke përjashtuar kategorinë e pagave dhe kontributeve.

Burimet e Financimit Komunal përfshijnë: të hyrat vetanake komunale, grandet specifike operative dhe grandet për kompetencat shtesë, transferet për kompetencat e deleguara, grandet e jashtëzakonshme dhe ndihma të huaja financiare.

Në bazë të LFPL, nenit 23, komunat marrin grande operative nga buxheti i Kosovës si: grandin e përgjithshëm, siç përcaktohet në LFPL në nenin 24, Grand Specifik për Arsim dhe Grand Specifik për shërbimet shëndetësore, duke përfshirë financimin për shëndetin sekondar në pajtim me nenin 25 të LFPL.

Në bazë të Ligjit për Kufijtë Administrativ Komunal nr 03/L-041, neni 9, pas themelimit të një komune të re si një organizatë buxhetore, Ministria e Financave në bashkëpunim me MAPL-së dhe kryetarët e saj, i transferon një shpërndarje të mjaftueshme buxhetore nga OB-të ekzistuese në komuna të reja, në përputhje me shpërndarjen e grandeve të miratuara nga Komisioni i Grandeve.

- Borxhi Publik: Si është siguruar financimi i buxhetit për 5 vitet e fundit (instrumentet kryesore)? Ju lutem jepni informacione të detajuara për aksionet aktuale të Borxhit publik (kreditorët e huaj /vendas, të monedhës, instrumentet, etj), garancitë dhe vonesat.

Për pesë vitet e fundit, Qeveria e Kosovës ka operuar me një suficit të buxhetit të përgjithshëm. Aksionet e përgjithshme të borxhit publik (i brendshëm dhe jashtëm) arrijnë shumën përafërsisht 282.8 milion€. Nga kjo shumë 253.1 milion €, janë borxh i jashtëm, dhe €29.7 milion € janë letra me vlerë të lëshuara nga Ministria e Financave në formë të Bonove të Thesarit. Borxhi i jashtëm duhet të paguhet kreditorëve si në vazhdim:

- a. Bankës Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Rindërtim (Banka Botërore) - 220.7 milion €
- b. Fondit Monetar Ndërkombëtar - rreth 27.3 milion € (SHKO) 23 milion
- c. Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Banka Botërore) - rreth €5.1 milion (SHKO 4.3 milion)

Borxhi i brendshëm prej 29.7 milion € është huazuar nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë. Deri më tani, Ministria e Financave nuk ka lëshuar garanci të kredisë për asnjë institucion. Megjithatë, përmes marrëveshjeve nën-huamarrje, Ministria e Financave ka një marrëveshje detyruese për nën-huamarrje nga institucionet e ndryshme publike të tilla si; Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu (KOSTT), Kompania Rajonale të Ujësjetës "Prishtina". Nuk ka vonesë të borxhit

Tregu i punës:

- a. Papunësia: Si është zhvilluar papunësia dhe sektorët e saj me kalimin e kohës? Sa i përket papunësisë cilat janë kategoritë kryesore? Sa është përqindja e punësimit afat-gjatë? Të lutem listoni faktorët themelor.**

Tabela 26: Papunësia me kalimin e kohës, 2007-2011

Viti	2007	2008	2009	2010	2011
Të papunësuarit e regjistruar	334,595	335,942	338,895	335,260	325,261

Burimi: Raporti i punës dhe punësimit 2011, MPMS

Kategoritë kryesore të papunësisë janë papunësia afat-gjate, rinia, gratë, dhe minoritetet.

Tabela 27: Papunësia afat-gjate e rinisë, grave, personave me aftësi të kufizuara, dhe minoritetet

Kategoria	2007	2008	2009	2010	2011
Papunësia afat-gjate	93.00%	93.50%	94.20%	94.00%	93.80%
Rinia (15-24)	98,695	101,658	103,896	106,342	107,122
Gratë e papunësuarat	156,679	158,120	161,131	160,856	157,922
Personat me aftësi të kufizuara	1,726	1,814	1,903	1,937	2,030
Minoritetet	30,133	30,509	30,695	29,860	29,711

Burimi: Raporti i punës dhe punësimit 2011, MPM


- a. Punësimi: Çfarë është ndarja e punës në mes të sektorit publik dhe privat? Cilat kanë qenë sektorët kryesorë të krijimit të vendeve të punës? Si i vlerësoni marrëdhëniet në mes të rritjes ekonomike dhe punësimit?**

Tabela 28: Ndarja e punësimit në mes të sektorit publik dhe privat, 2007-2011

Viti	2007	2008	2009	2010	2011
Punësimi	225,037	218,231	233,338	245,502	251,510
Publik	74,366	74,701	74,190	77,164	78,068
Privat	150,671	143,530	159,148	168,338	173,442

Burimi: KAS & Fondi i Kursimeve Pensionale

Grafiku 1: Lidhja në mes të rritjes vjetore të PBB-së dhe rritjes së punësimit



E ndërtuar me të dhënat nga Enti Statistikor i Kosovës

- b. Të lutem përshkruaj karakteristikat kryesore të politikave Qeveritare të tregut të punës. Cilat janë hapat kryesorë që janë ndërmarrë/do të ndërmerren për të përmirësuar kushtet e tregut të punës dhe/ apo mospërputhjen në mes të kërkesës dhe ofertës së tregut?

Plani i Veprimit të Kosovës Vizioni Ekonomik 2011-2014 thekson prioritetet dhe sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik. Ndër të tjera prioritetet e këtij dokumenti përfshijnë:

- a. Përmirësimin e mjedisit të investimeve dhe mbështetjen e sektorit privat: Rritja e investimeve dhe mbështetja për zhvillimin e sektorit privat janë themeli i një rritjeje të qëndrueshme ekonomike. Ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit thelbësor që krijojnë kushte për tërheqjen e investimeve në Kosovë dhe heqjen e barrierave të tepërta administrative lehtëson funksionimin e sektorit privat dhe kontribuon në rritjen ekonomike të vendit. Kjo kërkon që reforma gjithëpërfshirëse të eliminoj 50% të licencave të tepërta dhe të kërkesave për leje. Një aspekt tjetër në drejtim të zhvillimit të këtij sektori është intensifikimi i aktiviteteve për tërheqjen e investimeve të huaja dhe integrimin në institucionet financiare ndërkombëtare.
- b. Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor: Aktivitetet në kuadër të strategjisë prioritare kanë për qëllim rritjen e kualitetit të kapitalit njerëzor, me qëllim që të ofrojnë një fuqi punëtore me kualitet më të lartë në tregun e punës. Sa i përket kësaj çështjeje, një theksim do ti jepet edukimit dhe zhvillimit profesional në drejtim të zhvillimit të kapitalit njerëzor në të gjithë sektorët.

Strategjia e punësimit 2010-2012 është njëra ndër dokumentet kryesore Qeveritare për politikën e punësimit. Në pikëpamjen e pengesave për rritjen e punësimit, strategjia afat-gjatë më e përshtatshme është ndarë në tre shtylla kryesore:

- a. Përmirësimi i mjedisit të investimeve dhe ulja e kostos për të bërë biznes, me qëllim që të rrisim krijimin e vendeve të punës duke e nxitur hyrjen e ndërmarrjeve në treg dhe zgjerimin e aktiviteteve më të vlefshme;
- b. Promovimi i një baze të fortë të aftësive dhe shkallë më të lartë të zhvillimit të kapitalit njerëzor përmes edukimit formal dhe sistemeve të formimit profesional;
- c. Përmirësimin e funksionimit të tregut të punës përmes institucioneve, politikave dhe rregulloreve më të mira të tregut të punës.

Në mënyrë që të arrihet një përmirësim i shpejtë në kushtet e tregut të punës, Qeveria ndërmori masa afat-shkurtra për të adresuar nevojën urgjente për punë duke zgjeruar investimet publike dhe programet për punë publike duke ndjekur objektivat afatmesme dhe afatgjata për një rrugë më të qëndrueshme në krijimin e punëve.

Strategjia Sektoriale 2009-2013 përcakton objektiva të mëtejshme në lidhje me politikat e punësimit dhe përputhjes së kërkesës dhe ofertës së tregut të punës. Shiko qëllimet e mëposhtme:

- a. Objektiva 1: Rritja e shkallës së punësimit dhe forcimi i kualifikimit profesional, sipas kërkesës së tregut të punës;
- b. Objektiva 4: Përmirësimi i bashkëpunimit me shtetet rajonale (anëtarët e BE-së dhe shtetet jo-anëtare të BE-së) për ngritjen e mundësisë së punësimit në tregun Kosovar të punës.

Për të përmbushur qëllimin e parë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është duke planifikuar rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve në tregut e punës, përmirësimin e informimit, ndërmjetësimin dhe kualifikimit profesional, infrastrukturën fizike dhe teknologjinë informative, rishikimin dhe ndryshimin e plan-programit aktual të formimit profesional dhe zhvillimeve të reja dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të trajnimit, QAP profesional dhe trajnimin e menaxhimit të personelit, ulja e papunësisë së rinisë, gratë dhe papunësia afatgjate, rishikimin dhe zgjerimin e masave të politikave aktive të tregut të punës për mbrojtjen e punësimit të kategorive të tilla, bilancit të dialogut social, etj.

Sipas Qëllimit të 4, MPMS-ja është duke planifikuar forcimin e zbatimit të standardeve të BE-së dhe të bashkëpunojë në përmirësimin e kapaciteteve teknike, financiare, dhe njerëzore, nëpërmjet marrëveshjeve teknike të binjakëzimit që do të ndihmonin procesin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e politikave, legjislacionit si dhe përmirësimin e partneriteteve për tërheqjen e investimeve dhe financimin e projekteve për krijim e vendeve të punës, duke siguruar mbështetje për sektorin privat nëpërmjet krijimit të shoqërive të përbashkëta.

Gjithashtu, Sektori i Planit Zhvillimor 2012 - 2014 parashikon vazhdimin e procesit të reformimit drejt kapaciteteve për zhvillimin e politikave në nivel të Departamentit të Punës dhe Punësimit, duke krijuar Ndarjet për zhvillimin dhe zbatimin e politikave, krijimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, forcimin e kapaciteteve të shërbimeve publike për punësim, zhvillimin e sistemit të informimit të tregut të punës, etj

- Regjimi i çmimeve: Në cilat sektore janë çmimet e administruara (p.sh. të vëna në mënyre të qartë nga Qeveria) apo të rregulluara (p.sh. të aprovuara nga një rregullator i pavarur)? Ju lutem tregoni kategoritë e gjera të çmimeve të cilat janë të administruara /rregulluara dhe pjesën e çmimeve të administruara /rregulluara në total, duke përfshirë treguesit sasiore.

Sektorët me çmim të rregulluar janë sektorët që ofrojnë shërbime publike. Rregullimi i çmimeve bëhet nga agjencitë e pavarura që funksionojnë si një rregullator ekonomik dhe raportojnë direkt në Kuvendin e Kosovës. Sektorët e mëposhtëm kanë çmime të rregulluara:

- a. Energjia (duke përfshirë edhe ngrohjen qendrore)
- b. Furnizimi me ujë dhe mbeturina
- c. Post-telekomunikacioni
- d. Hekurudhat
- e. Shëndetësia
- f. Arsimimi

Energjia: Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRE) funksionon sipas Ligjit nr. 03/L-185 për Rregullim të Energjisë.

ZRE-ja ka mandat ligjor për rregullimin ekonomik në lidhje me sektorin e energjisë, që do të thotë se ka rol të vendosjes së çmimit për shfrytëzimin e infrastrukturës së energjisë në Kosovë si dhe për shfrytëzimin e energjisë elektrike dhe termale. ZRE-ja është e obliguar të vendosë tarifën për konsumatorët vendas. Në rastet kur, sipas kriterëve të vendosura nga ZRE-ja, është vendosur që

konkurrenca në tregun e energjisë elektrike nuk është efektive, ZRE-ja ka autoritetin e duhur për të vendosur tarifa të energjisë edhe për konsumatorët e tjerë.

Në vendimin e fundit nga ZRE-ja në lidhje me tarifat për energji elektrike është vendosur që konkurrenca brenda sektorit të energjisë elektrike nuk është efektive. Si pasojë, u vendos që të gjithë konsumatorët në Kosovë do të kenë mundësinë të blejnë energjinë elektrike me tarifa të rregulluara. Tarifat e rregulluara me energji elektrike janë: Tarifat për Shtitje të Energjisë Elektrike tek Furnizuesit Publik; Tarifat për Shitje të Energjisë Elektrike nga Furnizuesi Publik; Tarifat e Transmisionit (Transmetim), dhe Tarifat e Shpërndarjes (Shpërndarja).

Tarifat për ngrohje qendrore janë vendosur në bazë të Ligjit Nr. 03/L-116, në bazë të cilës ZRE-ja vendos çmimet dhe tarifat sipas propozimit vjetor të distributorit.

Shëndetësia: Shërbimet e shëndetësisë në sektorin privat janë krejtësisht të pavarura, ndërsa çmimet në sektorin publik janë të njëjta në tërë Kosovën. Në mungesë të ndonjë Ligji apo udhëzimi administrativ, Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka hartuar "Listën e çmimeve të përkohshme për shërbime shëndetësore" në konsultim me ofruesit e shërbimeve shëndetësore në sektorin publik.

Aktualisht MSH-ja është duke hartuar Listën e shërbimeve shëndetësore bazike; metodologjinë e vendosjes së çmimeve, si dhe Listën e Çmimeve për shërbime shëndetësore në sektorin publik. Këto dokumente pritet të përfundohen deri më 1 Korrik, 2012.

Administrimi i çmimeve zë vend vetëm në sektorin publik, për dy kategori në banorëve: i) banorët që nuk janë qytetarë të Kosovës, dhe ii) qytetarët e Kosovës që kanë sigurim shëndetësor. Qytetarëve të Kosovës të cilët nuk kanë sigurim shëndetësor, iu është aplikuar një pako bazë me shërbime shëndetësore pa pagesë (në një tarifë minimale pjesëmarrje).

Edukimi: Tarifat në institucionet private për edukim më të lartë janë të vendosura nga institucionet private të cilat ofrojnë shërbime arsimore.

Sipas nenit 30 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Edukim të Lartë (linku: <http://www.masht.gov.net/advCms/>), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), vendos në baza vjetore maksimumin e tarifave të shkollimit që studentët duhet të paguajnë në institucionet publike për arsimin të lartë. Niveli i pagesës vendoset në bazë të qëndrimit të studentit (në Kosovë apo jashtë Kosovës), natyra dhe kostoja e programit të studimit.

Institucionet publike për edukim të lartë vendosin tarifa dhe pagesa si: pagesa për pranim/dorëzim, pagesa për ri-provim, dhe pagesa për kartën studentore. Këto tarifa janë të aprovuara nga trupi qeverisës i institucionit përkatës dhe janë të konfirmuara nga MASHT.

Furnizimi me ujë dhe mbeturina: Çmimi i ujit dhe mbeturinave është i rregulluar nga Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) sipas Ligjit 03/L-086 (link: <http://gazetazyrtare.rks-gov.net/GZ2008.aspx>), dhe Rregullat R-02/U&K/2008 në vendosjen e tarifave për shërbimet e furnizimit me ujë, kanalizim, furnizim me ujë të pijshëm, dhe R-02/M/2008 në vendosjen e tarifave për shërbimin e mbledhjes dhe hedhjes së mbeturinave në Kosovë (link: http://www.wwo-ks.org/Tariffs_rregullat_tarifore.html)

ZRRUM rregullon të gjitha çmimet të lidhura me:

- a. ndërmarrjet qendrore për jo-trajtimin për furnizim me ujë të pijshëm
- b. ndërmarrjet qendrore për menaxhimin e deponive të përhershme në Kosovë;
- c. 7 ndërmarrjet rajonale në fushën e furnizimit me ujë dhe ujëra të zeza;

d. 7 ndërmarrjet rajonale për grumbullimin e mbeturinave.

Ekzistojnë tri lloje të çmimeve për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza: i) çmimet fikse mujore - EUR/muaj, ii) çmimet vëllimore për furnizimin me ujë - EUR/m³, iii) çmimet vëllimore për shërbimet e ujërave të zeza - EUR/m³, dhe iv) çmimet për furnizimin me ujë të pijshëm dhe të jo të pijshëm. Ky sistem i çmimeve i adreson tri kategori të konsumatorëve: i) familjet, ii) tregtare - industriale, dhe iii) institucionale. Për asgjësimin e përhershëm të deponive të mbeturinave ekziston vetëm një çmim. Pjesëmarrja /përqindja e çmimeve të rregulluara nga ZRRUM:

- a. ZRRUM menaxhon 100% të çmimeve nga kompanitë rajonale dhe korporatat që bëjnë furnizimin me ujë dhe ujëra të zeza si dhe ato të cilat merren me mbledhjen dhe menaxhimin e fushave të përhershme të tokës sanitare;
- b. 71% e popullsisë është e furnizuar me ujë të pijshëm, ndërsa 48% e popullsisë në nivel shtetëror janë të furnizuar me shërbime të ujërave të zeza
- c. Sa i përket grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale, 47% e popullsisë së përgjithshme marrin shërbime të tilla (të dhëna të tilla janë të bazuara në numrin e përgjithshëm të popullsisë që kanë marrë këto shërbime dhe numrin e përgjithshëm të popullsisë së vendit).

Posta dhe Telekomunikacioni: Çmimet e shërbimeve të telekomunikimit janë të vendosura nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) nën autorizimin e garantuar me Ligjin e Telekomunikacionit Nr. 2002/7, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-85 (link: <http://www.art-ks.org/?cid=1,8>).

Sipas analizave të tregut së telefonisë fikse, ART-ja ka krijuar detyrime të kontrollit të çmimeve për Operatorët me Fuqi të Rëndësishme të Tregut (OFRT). ART-ja ka vendosur çmime të detyrueshme drejt dy (2) operatorëve (PTK Sh.A. dhe IPKO Sh.P.K.) për ndarjen e llogarive dhe modelin e llogaritjes së kostos për shpërndarjen e plotë të shpenzimeve (Shpërndarja e Plotë Kostos- SHPK) në bazë të asaj se OFRT duhet të vlerësojnë çmimet e tyre të shërbimit.

Në tregun e telefonisë mobile, ART-ja ka bërë ndërprerjen çmimit thirrjes (MTR), pas dështimit të operatorëve për të arritur marrëveshje të përbashkët, pra për të përcaktuar MTR-në.

Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit është në proces të analizimit të tregut në lidhje me përfundimin e thirrjeve zanore në rrjetin individual publik mobil dhe në varësi të rezultateve të imponojnë çmime obliguese kontrolluese. Për më tepër, deri në fund të vitit ART do të përfundojë procesin e analizës së tregut për linjat me qira dhe shërbimet e internetit kështu që në përpjesëtim me rezultatet do të bëjë rregullimet e çmimeve për OFNT.

Hekurudhat: Sipas Ligjit Nr. 04/L-63 në lidhje me hekurudhat e Kosovës, kompania publike TRAINKOS Sh.A. ka mundësinë e përcaktimit të tarifave të tyre.

Privatizimi:

Ju lutem jepni një pasqyrë të procesit të privatizimit gjatë 5 viteve të fundit për ndërmarrjet shoqërore dhe shtetërore respektivisht. Cilat kanë qenë metodat kryesore të privatizimit? Sa ndërmarrje janë privatizuar/ likuiduar/ dhe dërguar në procedurat e falimentimit? Ju lutem jepni informata rreth madhësisë, punësimit, dhe aktiviteteve të këtyre ndërmarrjeve. Cili është statusi i tanishëm dhe portofoli i agjencisë në krye të privatizimit. Cilat janë perspektivat për mos investime të mëtutjeshme dhe përfundimit të aktiviteteve të së njëjtës agjenci?

Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore

Vështrimi dhe metodat e privatizimit: Procesi i Privatizimit në Kosovë ka filluar me themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) në vitin 2002. Metodatat e përdorura për privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) dhe asetëve të tyre ishin: i) Spin Off i zakonshëm, ii) Spin Off i kushtëzuar, dhe iii) Spin Off special. Spin Off - i zakonshëm nuk përfshin kushte të tjera përveç çmimit të lartë në një raund të tenderimit. Fituesi nën Spin Off-in e kushtëzuar dhe Spin Off-in special, përveç çmimit më të lartë (50% të pikëve), ofertuesi fitues përcaktohet gjithashtu në angazhimin rreth punësimit (25% të pikëve) dhe angazhimin e investimeve (25% të pikëve) të ofruara nga ofertuesi. Për më tepër, kjo metodë përbëhet nga dy raunde të ofertave, ku në raundin e dytë vetëm tre ofertuesit me çmimin më të lartë nga raundi i parë mund të marrin pjesë.

Administrata e UNMIK-ut e cila është themeluar më 1999, ka aranzhuar dhënien me qira të disa NSH-ve me strategji të rëndësishme deri në 10 vite (komercializimi). Deri më sot, prej 18 marrëveshjeve për qira dhënie vetëm 1 është ende me qira kurse 8 prej tyre janë privatizuar. Për shkak të shkeljes së marrëveshjes për 9 NSH-të e tjera kontrata e qirasë është ndërprerë. Nga nëntë (9) NSH-ë, pesë (5) janë privatizuar, një (1) është nën likuidim dhe tri (3) duhet të privatizohen në të ardhmen.

Në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), metoda e Spin Off-it special, e trashëguar nga AKM-ja, nuk praktikohet nga AKP pasi që është dëshmuar të jetë jashtëzakonisht komplekse për Menaxhimentin dhe Bordin e AKP-së, sepse disa nga ndërmarrjet e privatizuara përmes kësaj metode e kanë stërzgatur përbushjen e standardeve rreth punësimit dhe investimeve. Komplikimet janë rritur për shkak të lidhjes së kontratave bazuar në legjislacionin anglez i cili nuk përputhet me ligjet e aplikueshme në Kosovë. NP-të nuk janë nën mandatin e AKP-së. NP-të dikur kanë qenë nën mandatin e AKP-së, e cila gjithashtu është kryesuar nga Bordi dhe ka kryer korporatizimin e këtyre ndërmarrjeve duke i transformuar në Shoqëri Aksionare, aksionar të të cilave është Qeveria e Kosovës. Privatizimi tani bëhet përmes dy metodave kryesore: Metodës së Spin-Off-it dhe Shitjes së Pasurive të ndërmarrjeve të vendosura në procesin e likuidimit..

Ndërmarrjet e Privatizuara, madhësia e tyre, punësimi dhe aktivitetet: Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve shoqërore (NSH-ve), prej të cilave Kompanitë e Reja janë krijuar dhe tenderuar që nga fillimi i privatizimit dhe deri më tani është 313, kurse numri i Kompanive të Reja të tenderuara nga këto NSH është 696. Numri i nënshkruar i kontratave të shitjes është 675, ndërsa numri i ndërmarrjeve të likuiduara është 3. Numri i ndërmarrjeve të reja të tenderuara nuk do të thotë që është numri i Ndërmarrjeve të Reja të Shitura, një Kompani e Re mund të tenderohet por jo edhe të shitet për shkak të arsyeve të ndryshme siç janë: mos dorëzimi i asnjë oferte, dokumentacioni i ofertuesve i plotësuar në mënyrë të pasaktë dhe tenderi është anuluar, tërheqja e ofertuesve etj.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-034 nuk e ka mandatin të monitorojë punësimin dhe aktivitetet e ndërmarrjeve të privatizuara pjesërisht ose tërësisht përmes Spin Off-it të zakonshëm (pa asnjë kusht). Aktivitetet dhe punësimi nga ndërmarrjet e privatizuara përmes Spin Off -it special dhe me kushte, monitorohet nga mekanizmat e AKP-së për periudhë të caktuar kohore. Periudha e monitorimit varet dhe ndryshon nga kontrata dhe angazhimet. Spin Off- et special kanë dy (2) vite të përbushin angazhimet kurse sa i përket periudhës së monitorimit të ndërmarrjeve që privatizohen përmes Spin Off-it me kusht është prej tre (3) vite deri në pesë (5) vite. Prej 25 ndërmarrjeve të privatizuara përmes Spin Off-it special, ku punësimi ishte një nga kushtet, numri i angazhuar i punëtorëve ishte 8,340 kurse numri i raportuar për punësim është 7,108 punonjës. Prej shtatë (7) ndërmarrjeve që janë duke u monitoruar, gjashtë (6) prej tyre sipas kriterëve të KKRF-së (Këshilli Kombëtar për Raportim Financiar) janë të klasifikuara si ndërmarrje të mëdha kurse një (1) është e klasifikuar si ndërmarrje e mesme. Veprimtaria e këtyre ndërmarrjeve është: tre (3) janë Industri Përpunuese (ushqim, duhan dhe industri e lehtë), dy (2) janë hotele dhe

akomodime, një (1) e minierave dhe përpunimit mineral, dhe një (1) i përket industrisë Agrare. Numri i përgjithshëm i të punësuarve aktual është 1295.

Statusi/Portofoli: Neni 5 i Ligjit 04/L-034 përcakton se AKP-ja është një organ i pavarur publik që kryen funksionet dhe përgjegjësitë me autonomi të plotë. Agjencia ka individualitet të plotë ligjor dhe në veçanti ka kapacitet për të hyrë në kontrata, të marrë, mbajë, ose shes pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-034; edhe të padisë dhe të paditet në emër të saj. Agjencia është pasardhës i AKM-së që është themeluar dhe rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit” si dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë nën veprimtarinë dhe detyrimet e Agjencisë.

Numri aktual i NSH-ve në portofolin e Agjencisë është 595. Përgjatë vitit 2011 tre ndërmarrje janë larguar nga administrata direkte e AKP-së pas përcaktimit të statusit të tyre. Deri tani, nga i gjithë portofoli i Agjencisë, 306 NSH janë tërësisht ose pjesërisht të privatizuara me shitjen prej 689 Kompanive të Reja.

Perspektiva dhe Mungesa e Investimeve: Investimet e pritura të kapitalit të AKP-së për tre vitet e ardhshme janë si në tabelën Nr. 1, ndërsa shuma e fondeve të miratuara nga MF janë paraqitur në tabelën Nr. 2.

Tabela 30: Limitet e shpenzimeve të dorëzuara nga AKP-ja për KASH-in 2013-2015.

AKP	2012	2013	2014	2015
Shpenzimet Kapitale	170,000.00	173,000.00	170,000.00	30,000.00

Tabela 31: Kufijtë e aprovuar të shpenzimeve, KASH 2013-2015

	2013	2014	2015	Total
Shpenzimet Kapitale	170,000	125,000	80,000	375,000

Bazuar në nenin 6 (të ardhurat e dedikuara të agjencive të pavarura) të Ligjit Nr. 04/L079 për buxhetin e vitit 2012, AKP-ja është e lejuar të nënshkruajë një memorandum mirëkuptimi (MM) me Ministrinë e Financave (MF) për ndarjen e të ardhurave dedikuara Agjencisë. Kjo nënkupton se pas nënshkrimit të MM-së, barra e buxhetit të Kosovës deri në fund të vitit 2012 do të jetë 0, pasi që Agjencia do të përfshijë investimet kapitale të grumbulluara nga kompania. Ligji për AKP-në Nr. 04/L-034 Neni 21, paragrafi 2 thotë: “Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara për Agjencinë sipas nenit 64 të LMFP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shiteje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo dispozitave të tjera me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia menjëherë duhet të transferoj dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në pajtim me rregullat në fuqi të LMFP-së; Thesarin dhe Ministria e Financave të cilat sigurojnë që fondet të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuara të të ardhurave të Agjencisë”

Në përputhshmëri me Ligjin Nr. 04/L-034, dhe Aneksin 1, Agjencia do të angazhojë një kontraktues i cili do të themelojë një Autoritet Likuidimi për secilën NSH të vendosur në likuidim. Autoriteti Likuidues do të jetë përgjegjës për mbledhjen, vlerësimin, gjykimin e kërkesave, trajtimin e çdo

veprimi ligjor që ndërmerret gjatë procesit, propozimin e planit kreditor për pagesë të jashtme dhe të administrojë atë nëse aprovohet; trajtimin e të gjitha aspekteve administrative gjatë procesit të likuidimit deri sa NSH-ja të shpërbëhet zyrtarisht; mbajtjen e arkivave dhe regjistrave të duhur etj. Kontraktuesit nuk do t'i kërkohet të shesë pasurinë, përveç në rrethana të jashtëzakonshme dhe me pëlqimin paraprak të AKP-së. Ky Autoritet i Likuidimit pritet të angazhohet gjatë vitit 2012. Me kalimin e kohës, Agjencia do të zvogëlohet me një mandat të qartë për të përfunduar detyrën e saj. Procesi i Privatizimit (Tenderimi i Ndërmarrjeve të Reja) pritet që të përfundojë në dy vitet e ardhshme. Por, procesi do të vazhdojë të vendosë të gjitha NSH-të në likuidim, dhe më pas AKP-ja do të vazhdojë vetëm me shitjen e asetëve, kurse kontraktuesi për Autoritetin Likuidues, sa i përket termave të referencës, do të jetë i angazhuar për katër (4) vite, dhe autoriteti pritet të fillojë me likuidimin e portofolit dhe përgjegjësitë e tjera gjatë vitit të dytë.

b) Ju lutem përcaktoni sasinë e privatizimit duke u bazuar në të ardhurat rreth shitjes dhe taksave gjatë 5 viteve të fundit. Si përdorën autoritetet faturat e privatizimit? Si do të përdoren në të ardhmen fondet që rezultojnë nga privatizimi?

Të hyrat e përgjithshme nga procesi i privatizimit të pranuar dhe depozituara: 566,927,733 €, ndërsa të ardhurat nga shitjet e privatizimit për pesë (5) vitet e fundit janë 299,142,966€ dhe të ardhurat nga procesi i likuidimit janë 53,164,712€. Në përputhshmëri me nenin 6 dhe 19 të Ligjit Nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të ardhurat nga Privatizimi dhe likuidimi mbahen në fondin e mirëbesimit në Bankën Qendrore të Kosovës, dhe 75% e këtyre të ardhurave mbahen në mirëbesim për kreditorët dhe pronarët e ligjshëm, pretendimet dhe kërkesat e të cilëve janë vlerësuar dhe zgjidhur gjatë procesit të likuidimit. Fondet e mbetura barten në buxhetin e Kosovës. Pasi që procesi i likuidimit ka stagnuar për shkak të kornizës së ndërlikuar legjislative dhe afateve të zgjeruara, pagesa e kreditorëve të mundshëm dhe pronarët nuk kanë marrë statusin e tyre ende, siç është paraparë në dinamikën e zgjeruar. Deri më tani vetëm 45,139.89€ iu janë shpërndarë kreditorëve të pranueshëm/pronarëve të tre ndërmarrjeve, procesi i likuidimit i cili ka përfunduar në AKP. Tani një total prej 179 Ndërmarrjeve Shoqërore janë në proces të likuidimit.

Në përputhshmëri me ligjin mbi AKP-në, punëtorët e përshtatshëm të ndërmarrjeve përkatëse kanë të drejtë të marrin deri në 20% të të ardhurave të gjitha shitjeve. Në këtë drejtim, shumica prej €49,159,274 i është shpërndarë punëtorëve të pranueshëm që është 20% nga të ardhurat e procesit.

a) A ka pasur përmirësim në qeverisjen e korporatave si pasojë e privatizimit?

Agjencia kosovare e Privatizimit ka trashëguar 23 ndërmarrje që janë shitur përmes metodës së Spin Off-it special dhe të cilat ishin nën monitorimin e AKP-së në mënyrë që të sigurohet përmbushja e angazhimeve të bëra nga blerësit e këtyre ndërmarrjeve.

Në këtë drejtim, si rezultat i përpjekjeve të AKP-së - Angazhimet janë plotësuar nga ana e 15-të blerësve të ndërmarrjeve që janë shitur përmes Spin Off-it special. Shumë prej këtyre ndërmarrjeve mund të konsiderohen si histori suksesi duke pasur parasysh që po e zbatojnë veprimtarinë e tyre me sukses dhe eksportojnë produktet e tyre në tregun e jashtëm duke përfshirë kompanitë e mëposhtme: Ferronikel, M&Sillos, Kosovatex, Ballkani, Verëtaria Rahoveci, etj.

Rast i veçantë është Privatizimi i SharrCem-it, i cili është ende nën monitorim dhe operon me sukses në tregun e brendshëm duke pasur parasysh që mbulon rreth 70% të tregut Kosovar dhe mban numrin e të punësuarve në përputhje me detyrimet e kontratës.

- Sektori Publik: Cila është pjesëmarrja e sektorit publik në ekonomi? Cilët sektorë janë ende nën kontrollin dhe/ose pronësinë e Qeverisë dhe në deri në çfarë mase?

Qeveria e Kosovës është nën procesin e privatizimit të ndërmarrjeve publike, me qëllim të kalimit gradual drejt një ekonomie të tregut të lirë për të gjithë sektorët e ekonomisë. Bazuar në këto parime,

Qeveria e Kosovës si pronar ligjor ka vendosur të privatizojë shumicën e aksioneve (75%) të kompanisë që ofron shërbime publike mobile dhe fikse – PTK-së. Në bazë të autoritetit të dhënë nga ligjet e Kosovës dhe po ashtu në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 02/4, projekti i privatizimit prej 75% të aksioneve të telefonisë mobile dhe fikse të PTK-së, është e menaxhuar nga Komiteti Ndërmnistror për privatizimin e PTK-së.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është po ashtu ndërmarrje publike, si një sektor për prodhimin e energjisë elektrike, si dhe shpërndarjes dhe furnizimit. Në vitin 2008, Qeveria e Kosovës përmes vendimit Nr. 08/09 ka miratuar çmontimin e rrjetit të shpërndarjes lokale dhe furnizimin me energji elektrike në mënyrë që të formojë një kompani të re për privatizim përmes një tenderi të hapur dhe me konkurrence ndërkombëtare. KEK-u ka përparuar në procesin e shkrirjes së biznesit të tij në lidhje me kërkesat e BE-së, duke filluar me ndarjen e KOSTT-it si operator i sistemit të transmetimit, dhe duke vazhduar me themelimin e një kompanie e cila merr përsipër shpërndarjen dhe furnizimin të cilat po i nënshtrohen procesit të privatizimit, proces ky në të cilin Korporata Financiare Ndërkombëtare (KFN) është duke vepruar si këshilltar i transaksionit për Qeverinë e Kosovës konkretisht për Komitetin Qeveritar të Privatizimit.

Në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike (LNP) (Ligji nr. 03/L-087), përveç KEK-ut, PTK-së dhe KOSTT-it në pronësi të Qeverisë Qendrore janë gjithashtu këto kompani: Hekurudhat e Kosovës, Kompania për Menaxhimin e Deponive, Ibër Lepenci PHE, dhe Radio Televizioni i Kosovës (RTK). Ndërsa nën menaxhimin e pushtetit lokal janë shërbimet publike për mbeturina dhe ujë.

Tabela 32: Pjesa e Sektorit Publik në Ekonomi

Përshkimi	2007	2008	2009	2010	2011
<i>Si % e PBB-së</i>					
Të hyrat e përgjithshme	29.0%	24.2%	29.3%	27.8%	28.4%
Të Hyrat Tatimore	21.2%	20.6%	20.8%	21.3%	23.0%
Shpenzimet Totale	19.5%	24.5%	29.0%	30.1%	29.9%
Shpenzimet Aktuale	14.9%	15.4%	18.4%	17.8%	17.8%
Shpenzimet Kapitale	4.6%	9.0%	10.2%	10.9%	11.5%
Konsumimi Publik	9.6%	9.7%	10.5%	11.5%	12.2%

Burimi: Ministria e Financave

- Sektorët e mbrojtur (shërbimet, transportit, strehimi...): Cilët sektorë janë subjekt i mbrojtjes së caktuar (hyrjes në treg, vendosjes së çmimeve...). Ju lutem përshkruani zhvillimet e fundit në këtë drejtim, siç janë masat e veçanta të liberalizimit apo tregut jo të rregullt. Cilët janë sektorët që mbeten nën mbrojtje të veçantë?

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-086, Ndryshimi e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 mbi aktivitetet e Ujërave, Ofruesve të Shërbimeve të Ujërave të zeza dhe Mbeturinave, daton nga 15 Qershori 2008, sektori i ujit dhe i shërbimeve solide jo të rrezikshme komunale ka situatën si në vazhdim;

Shërbimet e Ujit:

- a) Sektori i shërbimeve të ujit është tërësisht i rregulluar në nivelin e 7 kompanive rajonale;

- b) ZRRUM ka licencuar të gjitha kompanitë publike që ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë dhe aktualisht asnjë operator privat nuk ka qasje të shërbimeve në këtë sektor, edhe pse Ligji për Partneritetin Publiko-Privat është miratuar nga Kuvendi.

Shërbimet e Mbeturinave;

- a) Sektori regional i kompanisë publike i cili menaxhon mbeturinat e ngurta komunale është rregulluar nga ZRRUM, dhe rregullatori aktualisht nuk ka licencuar asnjë operator privat;
- b) Në sektorin e grumbullimit të mbeturinave, operatorët publikë kanë mundësinë ligjore të nënkontraktjnë operatorë privat, dhe disa raste të tilla ekzistojnë;
- c) Në shërbimet e grumbullimit të mbeturinave, ka shumë operatorë privatë të licencuar nga institucione të tjera, të cilët kryejnë shërbime të grumbullimit të mbeturinave në disa territore urbane dhe rurale të cilat nuk janë të rregulluara ekonomikisht nga ZRRUM.

Deponitë sanitare të mbeturinave janë tërësisht në pronësi publike; megjithatë, Qeveria është duke e shqyrtuar mundësinë për të futur kapitalin privat në këtë sektor.

Mundësitë e investimit për themelimin dhe modernizimin e deponive të Kosovës (4 deponi dhe 1 pikë transferimi) me një kapacitet të deponive mbi 180,000 ton mbeturina janë shqyrtuar.

Ligji për Shërbime Postare Nr. 03/L - 173, Neni 3.1.3 parasheh:

Shërbimet e Rezervuara që kryhen ekskluzivisht nga Operatori Publik Postar - Posta e Kosovës janë: pranimi, transporti dhe shpërndarja e dërgesave të thjeshta me peshë deri në një (1) kg; pranimi, transportimi dhe shpërndarja e dërgesave përmes gjykatës, procedurat administrative dhe të kundërvajtjes; prodhimin, emetimin, vënien në qarkullim dhe heqjen nga qarkullimi të pullave postare; vendosjen e kutive postare, zbrazjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Shërbimet e pranimit, shpërndarja e dërgesave të zakonshme nuk duhet të konsiderohen si shërbime të rezervuara nëse ato kryhen me një tarifë tri herë më të lartë se çmimi bazë. Në pajtim me Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës Nr. 03/L-076 dhe të Vendimit të Qeverisë 05/110, Hekurudhat e Kosovës SH.A. rregullimi i transportit hekurudhor ka filluar me ndarjen e kompanisë në dy kompani, një për operacione (Trainkos SH.A.) dhe një për infrastrukturë (Infrakos SH.A.). Autoriteti Rregullativ Hekurudhor dhe Ministria e Infrastrukturës janë përgjegjëse për lëshimin e rregulloreve për kriteret e licencimit, certifikatat e sigurisë dhe lejet.

- Ristrukturimi i ndërmarrjeve: Sa ndërmarrje me pronësi shtetërore (apo më parë në pronësi të shtetit) dhe ndërmarrje shoqërore janë ristrukturuar deri më tani? Sa ndërmarrje janë duke u ristrukturuar ose parashikohet të ristrukturohen? Ju lutem identifikoni sektorët e mbetur të ndërmarrjeve shoqërore që kanë nevojë të ristrukturohen? Ju lutem jepni informata në lidhje me fitimin/humbjet totale vjetore të ndërmarrjeve gjatë 5 viteve të fundit. Deri në masën përkatëse, ju lutem shkurtimisht përshkruani strategjinë e privatizimit për ndërmarrjet shoqërore kryesore dhe ndërmarrjet e mbetura në pronësi shoqërore.

Ristrukturimet më të mëdha të ndërmarrjeve publike që kanë zënë vend gjatë 5 viteve të fundit përfshirë: Hekurudhat e Kosovës, Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, KEK dhe PTK.

Bazuar në Ligjin mbi Hekurudhat e Kosovës nr 03/L-076 dhe Vendimit të Qeverisë 05/110, Hekurudhat e Kosovës SH.A. është ndarë në dy kompani, një për operime (Trainkos SH.A.) dhe një për infrastrukturë (Infrakos SH.A.).

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" është ndarë në dy kompani. Një kompani merret me funksionimin e fluturimeve ajrore dhe shërbimeve të pasagjerëve që mbështet PPP-në në Ligjin nr. 04/L-045 në koncesion me Lion Limak për 20 vjet. Kompania tjetër merret me kontrollimin e ajrit dhe mbetet pronë shtetërore.

Shpërndarja dhe furnizimi me energji elektrike ka qenë e ndarë si një kompani e pavarur nga KEK-u dhe është në proces të privatizimit, kurse pjesa tjetër mbetet në sektorin publik.

PTK-ja është në fazën e fundit të ndarjes në dy kompani: Posta e Kosovës, e cila do të mbetet në pronësi publike, dhe Telekomunikacionit që përfshin shërbimin e telefonisë fikse, mobile, dhe internetit, dhe është në proces të privatizimit. Kjo ndarje pritet të finalizohet deri në qershor/korrik të vitit 2012, dhe në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e Postës ajo do të mbajë 1/3 e punëtorëve të tanishëm dhe të gjitha asetet e paluajtshme.

Dy ndërmarrje të rëndësishme shtetërore kanë hyrë në procesin e privatizimit në vitet e fundit, PTK-ja dhe KEK-u.

Baza ligjore për privatizimin e ndërmarrjeve publike është e garantuar me nenin 160 të Kushtetutës së Kosovës dhe është e përcaktuar me nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A ("PTK"): bazuar në parimin e ristrukturimit të pronës publike dhe politikat për sektorin e komunikacionit, Qeveria e Kosovës ka vendosur të privatizojë shumicën e aksioneve të kompanive publike që ofrojnë shërbime të telefonisë fikse dhe mobile-PTK. Ky projekt është hartuar dhe bazuar në standardet më të larta ndërkombëtare për transaksione të tilla. Sipas OBZHE-së (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) për të gjitha aspektet e transaksioneve, një këshilltar profesional ka qenë i angazhuar. Përveç kësaj në lidhje me këshillat strategjike për këtë projekt, një këshilltar strategjik ndërkombëtar ka qenë gjithashtu i angazhuar.

Vështrim i përgjithshëm mbi procesin e privatizimit të PTK-së: Bazuar në strategjinë e gjerë të Qeverisë së Kosovës, në lidhje me pjesëmarrjen e sektorit privat në ndërmarrjet me pronësi publike, më 23 Dhjetor 2008, Qeveria e Republikës së Kosovës (QeK) mori vendimin (02/41) që të themelojë Komitetin Ndërmnistror (KN) i cili do të analizojë të gjitha mundësitë e mundshme për pjesëmarrjen e sektorit privat në PTK SH.A, duke përfshirë privatizimin eventuale të të gjitha ose disa subjekteve të biznesit pas përfundimit të të gjitha analizave dhe studimeve, Komiteti Ndërmnistror i ka propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, vendimin për privatizimin e PTK-së. Pasi vetë qeveria miratoi këtë vendim, ata e dërguan të njëjtin dokument, së bashku me disa të tjerë mbështetës për miratim në Kuvendin e Kosovës. Më 15 Korrik 2010, Komiteti Ndërmnistror i themeluar për të rishikuar të gjitha mundësitë e pjesëmarrjes së sektorit privat në PTK, i ka rekomanduar Qeverisë mundësinë e privatizimit të PTK-së.

Në fazën e hershme të operimit, Komisioni ka miratuar strukturat e menaxhimit dhe implementimit të projektit. Komisioni në përputhje me strukturat e miratuara për këtë projekt, ka emëruar si Këshilltar për Transaksione (KT) konsorciumin e kompanive: Telco Ag dhe Wolf Theiss. Aktivitet kryesorë të kryera në fazën fillestare të projektit nga Nëntori 2009 dhe përgjatë gjashtë (6) muajve të vitit 2012 kanë përfshirë Ekzaminimin/Shqyrtimin e të gjitha aspekteve të PTK-së duke përfshirë edhe tregun potencial.

Pas përfundimit të të gjitha analizave dhe studimeve, Komiteti Ndërmnistror i ka propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës vendimin për privatizimin e PTK-së. Pasi vetë Qeveria miratoi këtë vendim, ata kanë dërguar të njëjtin dokument, së bashku me të tjerë mbështetës për miratim në Kuvendin e Kosovës.

Në Korrik, 2010, Komiteti Ndërmnistror i themeluar për të rishikuar të gjitha mundësitë e pjesëmarrjes së sektorit privat në PTK, i ka rekomanduar Qeverisë mundësinë e privatizimit të PTK-së.

Bazuar në këtë rekomandim, në qershor 2010, Qeveria e Kosovës mori vendimin për të shitur 75% të aksioneve për themelimin e Komisionit Qeveritar për Privatizim (KQP) të PTK-së.

Në Korrik 2010 – diskutimi për privatizimin e PTK-së ka kaluar në Kuvendin e Kosovës dhe pas dy diskutimeve të Komitetit funksional të Kuvendit; në sesionin plenar vendimi për privatizimin e PTK-së është miratuar në parim.

Duke pasur parasysh rëndësinë e projektit, në mënyrë që të arrihet një performancë e suksesshme dhe proces i privatizimit të PTK-së sa më efektiv, në Gusht të vitit 2010 kompania “Hunton and Willaims LLP” është kontraktuar si Këshilltar Strategjik i cili do të japë mendime të pavarura për çdo hap të privatizimit të PTK-së.

Pas miratimit në parim në lidhje me privatizimin e PTK-së, në Korrik 2010, nga Kuvendi i Kosovës, Komisioni Qeveritar për Privatizim ka vendosur të bëjë përdorimin më racional të kohës, duke marrë parasysh projektet konkurruese në rajon, për të bërë shpalljen e thirrjeve për para-kualifikim të investitorëve (blerësit potencial të aksioneve) në PTK. Me këtë njoftim është sqaruar se vazhdimi i këtij projekti do të varet tërësisht nga vendimi përfundimtar i Kuvendit të Kosovës nëse do të privatizohet apo jo.

Në Shtator të vitit 2010, afati i fundit për mbledhje të dokumenteve ka përfunduar në lidhje me fazën e para-kualifikimit dhe kompanitë të cilat kanë paraqitur dokumentet për këtë fazë janë:

- a. AlbTelecom SH.A, Albania (Shumica e aksioneve janë në pronësi të Calik Group dhe Turk Telecom);
- b. Hrvatski Telekom d.d. (HT), Croatia (Shumica e aksioneve të HT janë në pronësi të Deutsche Telecom);
- c. Orascom Telecom Holding S.A.E., Egypt;
- d. Telekom Austria AG, Austria;
- e. Sabafon, Yeme;

Rinisja e procesit në vitin 2011: Në Mars të vitit 2011, Parlamenti i Kosovës ka miratuar vendimin për të shitur 75% të aksioneve të PTK-së. Pas miratimit të Kuvendit, Komisioni Qeveritar për Privatizim ka vazhduar me procesin e para-kualifikimit që ka filluar në vitin 2010 nën zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës.

Në Qershor 2011, dy kompani janë para-kualifikuar të marrin pjesë në procesin e tenderimit të PTK-së: Hrvatski Telecom (HT) dhe Telekom Austria.

Pas përzgjedhjes së dy (2) blerësve potencial, gjatë muajit Korrik 2011, Komisioni Qeveritar për Privatizim ka shqyrtuar raportet analitike për PTK-në (Ekzaminimin Financiar, Ekzaminimin Ligjor, Ekzaminimin Teknik dhe Biznesor, si dhe raportin për çështje rregullative në Kosovë), përgatitur nga Këshilltari për Transaksione (KT), dhe ka miratuar planin për ndarjen e postit nga perspektiva e blerësit, me qëllim që të kthejë atë në ndërmarrje publike.

Pas kësaj, përgjatë muajve të verës 2011, e gjithë struktura e transaksioneve ka qenë e planifikuar si dhe dokumentet për transaksione janë përgatitur, duke përfshirë: Memorandum Informacioni për Kompanitë, Udhëzime për tenderim, Kontrata e Shitjes dhe e Blerjes, the statusi i ri i kompanisë me pronësi të përzier (25% publike, 75% private), Marrëveshjen së Aksionarëve, llogarinë bankare për transferimin e fondeve (Marrëveshja ESCROW)

Ndërkohë, pak ditë para hapjes së ofertave, Kompania Hrvatski Telecom ka shprehur rezervat e saj rreth vazhdimin të procesit, duke kërkuar që të shtyhet. Komisioni Qeveritar për Privatizim, është përpjekur të mbajë këtë kompani në proces; mirëpo, në fund nuk pati sukses. Në Shtator, 2011 të gjitha kompanive që kanë marrë pjesë në fazën fillestare iu është dhënë një periudhë prej dy (2) javësh që edhe herë të shprehin interesimin e tyre rreth pjesëmarrjes në bazë të kriterëve të paracaktuara, por kjo kohë shtesë e dhënë nuk ka rezultuar në ndonjë kompani tjetër të para-kualifikuar.

Në Tetor 2011, Komisioni Qeveritar për Privatizim duke parë që Hrvatski Telecom nuk do të marrë pjesë në procesin e blerjes së aksioneve të PTK-së dhe se vetëm një kompani do të mbetet për të vazhduar procesin (Austrian Telecom) dhe me këtë kushtet për privatizim nuk do të plotësohen, ka vendosur të rifillojë procesin e privatizimit të aksioneve të PTK-së.

Në rrethanat e reja të krijuara, Komisioni Qeveritar për Privatizim ka analizuar rrjedhën e projektit dhe ka vendosur që të rifillojë procesin, të ndërmarrë disa reforma Brenda PTK-së të cilat synojnë rritjen e mëtejshme të vlerës së aksioneve të tilla si: ndarjen e postës, uljen e kostove operative, ndërlidhjen e shpenzimeve për personelin si dhe kostot rreth performancës së kompanisë, dhe kështu me radhë.

Më 14 Nëntor 2011, Komisioni Qeveritar për Privatizim bazuar në autoritetin që ka nga kuvendi si dhe Qeveria e Kosovës, ka vendosur të vazhdojë me ndarjen e postës nga njësitë e tjera të PTK-së. Më lejon të ju rikujtoj, që ky vendim është veçanërisht i rëndësishëm, pasi që ky vendim bazohet në parimet e postës, e cila do të mbetet në pronësi publike, si dhe do të mbetet me të gjitha asetet e paluajtshme aktuale të PTK-së dhe do të krijojë kushte për funksionimin e duhur të shërbimeve postare nga zyra e re postare e kompanisë që do të krijohet në Kosovë. Kurse për shtije do të ofrohen 75% të aksioneve që kanë të bëjnë me sektorin e biznesit të telekomit (që përfshihen subjektet aktuale të telekomit dhe Vala Brenda PTK-së).

Procesi i ri-tenderimit të PTK-së ka filluar në mars të vitit 2012, me angazhimin e ri të Këshilltarit për Transaksione, nga konsorciumi i kompanive: Lazard Freres SAS, dhe Raiffeisen Investment AG. Përcaktimi i dy kompanive të njohura në mbarë botën për postin e këshilltarit të transaksioneve pritet të ndikojë pozitivisht në përfundimin e suksesshëm të procesit të transaksionit.

Planet për Zbatimin e Projektit: Aktualisht, Komisioni i Pavarur Qeveritar ka miratuar afatet për implementimin e procesit të privatizimit, në bazë të cilit, faza e para-kualifikimit pritet të hapet në fillim të qershorit, tenderi në fillim të korrikut, kurse përfundimi i transaksionit pritet të përfundojë në fund të tetorit 2012.

Po ashtu, me qëllim të testimit të tregut dhe promovimit të kompanisë, Komisioni Qeveritar për Privatizim ka autorizuar Këshilltarin e Transaksioneve (KT) që të organizojë dy (2) konferenca me investitorët potencialë në dy (2) qendra të mëdha evropiane (Londër, më 22 Maj, dhe Stamboll më 28 Maj 2012.

Privatizimi i KEDS-it:

- a. Në Mars të vitit 2011, Qeveria ka marrë vendimin nr. 02/04 për ri-themelimin e Komisionit Qeveritar për shpërndarjen dhe furnizimin me Energji, për shkak të ndryshimeve strukturore të Qeverisë, ku e ka ndryshuar vendimin nr. 08/09 datë. 08 Tetor 2008;
- b. Në Janar 2011 - është shpallur "Ftesa për Para-kualifikime";
- c. Në Prill 2011, pas rekomandimeve të marra nga Komisioni i Vlerësimit për para-kualifikime dhe Këshilltar të Transaksioneve IFC, Komisioni Qeveritar për Privatizimin e KEDS-së unanimisht ka vendosur, që kompanitë:

- i. Limak, Yatirim Enerji üretim İşletme Hizmetleri ve İnşaat A.Ş”;
 - ii. Çalik Enerji Sanayi Ticaret A. .Ş.- Çalik Elektrik Dağıtım A.Ş”;
 - iii. TAIB Bank BSC & Yildizlar SSS Holding;
 - iv. Elsewedy Electric S.A.E”, shpall si të para-kualifikuar në procesin e privatizimit të KEDS-së dhe jep qasje në Dhomën e të Dhënave të Kompanisë.
- d. Në Maj të vitit 2011, Dhoma e të dhënave të Kompanisë ka qenë e hapur për investitorët e para-kualifikuar në mënyrë që të u mundësojë atyre të zhvillojnë studimet dhe vlerësimet për të ashtuquajturën kompani;
 - e. Në Qershor 2011 – Emërimi i Grupit Qeveritar për sa i përket projekteve të Energjisë (GQPE) me përfaqësues nga secila ministri, anëtar të Komisionit Qeveritar të Privatizimit dhe institucioneve kryesuese në sektorin e qeverisë: ERO, KEK, KOSTT, ICMM, dhe PATEL. Ky grup shërben si grup punues për shqyrtimin, analizimin dhe komentimin e të gjitha dokumenteve rreth projekteve të energjisë në mënyrë që të mbrojë interesat strategjike, financiare, si dhe sigurinë e dokumentacionit të detajuar në lidhje me transaksionet e KEDS-së;
 - f. NjIP, në bashkëpunim me MZHE-në, ka themeluar Dhomën për Informim Publik, ku aktorët e interesuar nga shoqëria civile, sindikata të pavarura, kompani apo ndërmarrje mund të informohen rreth procesit, duke përfshirë zhvillimet e fundit në privatizimin e KEDS-së;
 - g. GQPE ka shqyrtuar, komentuar dhe përfunduar disa nga dokumentet kryesore për privatizimin e KEDS-së, të cilat do të miratohen nga Komisioni Qeveritar për Privatizim, siç janë:
 - i. Memorandum Informativ (“MI”);
 - ii. Kërkesë për Propozim (“KP”);
 - iii. Marrëveshja për blerjen e energjisë elektrike me shumicë (“BSA”);
 - iv. Marrëveshja për Shitje dhe Blerje (“SPA”);
 - v. Marrëveshja mbi Importet;
 - vi. Marrëveshja e Zbatimit;
 - vii. Marrëveshja për Transferim nga KEK-u në KEDS-së;
 - h. Më 30 Nëntor shpallja për “Ftesë për Oferta” për investitorët e para-kualifikuar
 - i. Miratimi i bankave që do të lëshojnë një Letër Garancie (Oferta për Bono) për KEDS-në
 - j. Më 26 Maj, 2012, Komisioni Qeveritar për Privatizim bazuar në kërkesën e kompanive të para-kualifikuara Çalik & Limak ka miratuar Marrëveshjen për Konsorcium;
 - k. Më 17 Prill, Komisioni Qeveritar për Privatizim bazuar në kërkesën e dy kompanive të para-kualifikuara: T.A.I.B.Bank and Elsewedy ka miratuar Marrëveshjen për Konsorcium si dhe miratimin e “Ofertave të Protokollit” si dhe “Listën Kontrolluese për Dorëzimin e Ofertave Përfundimtare” në procesin e ofertave për privatizimin e KEDS-së.

Plani i Zbatimit:

- a. 21 Maj 2012, afati i fundit për dorëzimin e ofertës për kompanitë e para-kualifikuara;
- b. Qershor 2012, zgjedhja e ofruesit të preferuar;
- c. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Shitjes dhe Blerjes (“MSHB”) - 90 ditë pune pas përzgjedhjes së fituesit, për më shumë detaje shih Aneksin 3a.

- Ju lutem përshkruani karakteristikat themelore të hyrjes në treg në sektorin e korporatave (regjistrimin e bizneseve, procedurat e licencimit, numrin e procedurave të ndara administrative, shumën mesatare të kohës për bashkëpunim) dhe daljes nga tregu (procedurat e falimentimit)? Sa kompani kanë deklaruar falimentimin e tyre gjatë pesë viteve të fundit? Sa kompani janë aktualisht nën procedurat e falimentimit?

Procedurat e regjistrimit janë thjeshtësuar. Ligji mbi Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123 tregon që regjistrimi i bizneseve të reja është pa pagese; kapitali fillestar për SH.P.K është eliminuar, për SH.A është zvogëluar nga 25.0000€ në 10.000€. Ligji për Tregtinë e Brendshme Nr. 04/L-005 e miratuar në

Qershor 2011 ka eliminuar lejet e punës dhe lejet e inspektimit sanitar. 6 licenca janë eliminuar për kompanitë e ndërtimit, të cilat janë: licenca për ndërtim, dizajn, rishikim, licenca e mbikëqyrjes, licenca e pranimit teknik, dhe leja të laboratorit. Koha për të regjistruar një biznes është zvogëluar nga 10 në 3 ditë. Numri i përgjithshëm i ditëve për të filluar një biznes është zvogëluar nga 59 ditë në 5 duke përfshirë edhe procedurën e regjistrimit të biznesit, marrjen e licencës, lejen e punës, certifikatën e inspektimit sanitar etj.

25 qendra të reja të bizneseve janë hapur në komuna. Sistemi i regjistrimit të biznesit është integruar me Administratën Tatimore dhe Doganore, përmes së cilës tash bizneset mundën, paralelisht me regjistrimin, të marrin edhe numrin fiskal, certifikatën e TVSH-së apo certifikatën e importit-eksportit në rast se janë importues të sasisë së ulët. Me fjalë të tjera, bizneset tani mund të regjistrohen me një procedurë në një vend, apo "Zyra pritëse". "Qendra e Shërbimeve të Biznesit" në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë është hapur, dhe përveç regjistrimit të biznesit ajo ofron edhe shërbime të tjera si: Lëshimin e licencave për derivate të naftës, markën tregtare, licencat për turizëm dhe licencat për duhan.

Procedurat e licencimit për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e karburantit janë të përcaktuara nga UA Nr. 07/2010 në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-138 për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmes Zyrës së Licencave duhet të lëshoj Licencën pas paraqitjes së aplikimit dhe dorëzimit të dokumenteve të kërkuar dhe pagesën e taksës. Licenca do të lëshohet për secilin aktivitet dhe ruajtjes, përkatësisht për secilën pikë të shitjes veç e veç, dhe ajo ka një vlefshmëri prej 2 vjetësh.

Procedurat e licencimit për subjektet që ushtrojnë veprimtari tregtare të duhanit janë të përcaktuara nga UA Nr. 04/2012, në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/ L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit. Për të marrë një licencë, aplikuesi duhet të dorëzojë të gjithë dokumentet përkatëse për ushtrimin e aktiviteteve të biznesit (regjistrimin e biznesit, certifikatën e TVSH-së etj) duke përfshirë një vërtetim se subjekti ka hapësirë dhe mjete të mjaftueshme për të ruajtur duhan në minimum prej 10 ton. Për të marrë licencën për eksport/import dhe për shitjen me shumicë të duhanit, një tarifë duhet të paguhet. Një komision i formuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë vendos për lëshimin, vazhdimin, refuzimin dhe heqjen e licencave. Vlefshmëria e licencës është 5 vjet me mundësi të vazhdimit.

Licencat për aktivitet e agjencive turistike është e rregulluar me UA Nr. 12/2010, në përputhje me Ligjin për Turizëm dhe Shërbimeve Turistike, Nr. 03/L -168. Komisioni i licencave i formuar nga Sekretari i Përgjithshëm vendos për lëshimin, vazhdimin, refuzimin, dhe shfuqizimin e licencave. Komisioni ka mandat tre vjeçar. Licenca për ushtrimin e aktiviteteve nga agjencitë është e vlefshme për një periudhë 3 vjeçare.

Një kompani mund të jetë themeluar dhe regjistruar në Kosovë, për çfarëdo qëllimi të ligjshëm dhe mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm specifikuar në kodet e nomenklaturës së veprimtarive. Procedurat dhe lista për dokumentet mbështetëse për regjistrimin e kompanisë me përgjegjësi të kufizuara (SHPK) janë:

- a. Kompletimi i formës A0 (A zero);
- b. Marrëveshja e kompanisë në bazë të nenit 86 të Ligjit nr. 02/ L -123;
- c. Statusi, në pajtim me nenin 33 të Ligjit nr. 0/ L-123;
- d. Dokumenti i identifikimit (letërnjoftimi, pasaporta) e pronarit, personave të autorizuar të kompanisë ;
- e. Pëlqimi i agjentit të regjistruar (lokal) në pajtim me nenin 33.2 të Ligjit nr. 02/L-123.

Koha e nevojshme për kompletimin dhe regjistrimin e një kompanie me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqërive aksionare në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) është 3 ditë. ARBK-ja nuk ka procedurë të falimentimit. Ajo siguron ndalimin e operacioneve të shërbimeve. Procedurat dhe dokumentet e nevojshme për ndërprerjen e punës së korporatave janë:

- a. Kompletimi i formës D;
- b. Shpallja e likuidimit në ½ e faqes së gazetës ditore në tri gjuhë;
- c. Vërtetimi nga Administrata tatimore për ndërprerje të biznesit
- d. Vërtetimi nga Gjykata Ekonomike;
- e. Kopja e letërnjoftimit të pronarit, pasaporta nëse pronari është i huaj;
- f. Vendimi i Likuiditetit të Korporatës;
- g. Vendimi për emërimin likuidues;
- h. Raportimi i pasurive kapitale. Tre të fundit janë në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, seksioni 229.

Pagesa për pro formën do të merret në ARBK dhe të paguhet në bankë me një shumë prej €10.

Gjatë periudhës 2007 - 2011 numri total i kompanive të cilat janë ndalur së funksionuari është 5,882. Për periudhën nga 01.01.2012 deri më 22.05.2012 një total prej 337 kompanive kanë ndërprerë funksionimin.

- Ju lutem tregoni atë që ju e konsideroni se janë prioritetet kryesore të agjendës së reformave strukturore /mikroekonomike.

Prioritetet kryesore (për periudhën 2010-2013) është përmirësimi i reformave të tregut të lirë për heqjen e pengesave për të bërë biznes (duke përfshirë krijimin dhe funksionimin e bizneseve) në mënyrë që të zvogëlohen pengesat Qeveritare për ndërmarrësit potencial dhe ekzistues.

Brenda kornizës së reformës së Vizionit për Zhvillim Ekonomik 2011-2014 dhe Strategjinë për Zhvillimin e NVM-ve 2012-2016, prioritetet kryesore makroekonomike në agjendën e reformës janë:

Reforma e Kornizës Ligjore për të bërë biznes: Përmirësimi i rregullave dhe rregulloreve përmes: thjeshtësimit dhe përmirësimit të kornizës ligjore në aktivitetet e biznesit në mënyrë që të krijohet një mjedis i qartë dhe i qëndrueshëm ligjor për të bërë biznes, me ndërhyrje minimale në biznese, zbatimin e praktikave më të mira në Qeverinë e prokurimit, me qëllim që të ngritë qasjen në informatat e biznesit dhe ngritjen e efikasitetit në procedurat e tenderimit. Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë me vizion për vitin 2020, qëllimi i parë strategjik 1) përcakton veprimet që duhen ndërmarrë për forcimin e kornizës ligjor dhe rregullator për krijimin dhe zhvillimin e NVM. Veçanërisht, qëllimi 1.1) shqetësohet për thjeshtësimin e kornizës ligjore dhe rregulloret ekzistuese.

Reduktimi i barrierave për bizneset: Reduktimi i barrierave në tregti përmes: përmirësimit të politikave, qasjes në informata dhe kapacitetit të ndërtimit. Programi i Qeverisë së Kosovës 2011-2014 është i bazuar në parimet e ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së lirë. Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë me vizion për vitin 2020, qëllimi i katërt strategjik 4) Forcimi i konkurrencës vendase dhe ndërkombëtare të NVM, përcakton veprimet që duhet ndërmarrë për të lehtësuar qasjen e NVM-ve në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare, veçanërisht qëllimi 4.6.3. kanë të bëjnë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe eliminimin e barrierave të tregtisë.

Përmirësimi i qasjes së bizneseve për tu financuar: Zvogëlimi i rrezikut të kreditimit është prioritet kryesor për sektorin financiar, përkatësisht përmes masave të tilla si: ngritjen e sasinë dhe cilësinë së informacioneve në dispozicion për regjistrin e kredive, me qëllim të forcimit të analizave të kredit dhënies, zvogëlimin e rrezikut dhe koston e huamarrjes. Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve në Kosovë me vizion për vitin 2020, qëllimi i dytë strategjik, 2) përcakton veprimet që duhet ndërmarrë

për të përmirësuar qasjen e financimit të NVM-ve. Veçanërisht, qëllimi 2.1) merret me zhvillimin dhe zgjerimin e llojeve të instrumenteve financiare për NVM-të.

-Ju lutem jepni informacione në numrin e kompanive të grupuara në bazë të madhësisë gjatë 5 viteve të fundit. Ju lutem përshkruani pengesat kryesore për rritjen dhe krijimin e vendeve të punës për kompanitë vendore.

Tabela 33: Ndërmarrjet në bazë të madhësisë, 2007 - 2011

Numri i ndërmarrjeve të grupuara në bazë të madhësisë për 5 vitet e fundit (2007, 2008, 2009, 2010, 2011)										
Ndërmarrjet në bazë të madhësisë	Numri i ndërmarrjeve për vit									
	2007		2008		2009		2010		2011	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Mikro- ndërmarrjet (1 - 9) punëtorë	6 744	96.79	8 242	97.50	9 798	97.48	9 420	98.00	9 919	98.40
Ndërmarrjet e vogla (10- 49) punëtorë	178	2.55	160	1.89	215	2.14	165	1.72	139	1.38
Ndërmarrjet e mesme (50 - 249) punëtorë	40	0.57	43	0.51	31	0.31	21	0.22	19	0.19
Ndërmarrjet e mëdha përmbi 250 punëtorë	6	0.09	8	0.09	7	0.07	6	0.06	3	0.03
Totali	6 968	100.00	8 453	100.00	10 051	100.00	9 612	100.00	10 080	100.00

Burimi: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, e përgatitur nga Agjencia për mbështetje të NVM-ve

Disa hulumtime të zhvilluara me ndërmarrje të mikro, të vogla dhe të mesme, përfshirë hulumtimin e 800 NVM-ve i realizuar në fund të vitit 2010 dhe në fillim të vitit 2011), tregon se pengesat kryesore për rritjen e NVM-ve lidhur me krijimin e vendeve të punës janë:

- Qasja në financa (kredi, interesi, kredi afatgjate)
- Situata e përgjithshme ekonomike
- Furnizimi me energji elektrike
- Konkurrenca informale (në mes të ndërmarrjeve lokale)
- Kushtet e tregtisë së jashtme etj.

- Ju lutem shpjegoni se si niveli (në % të PBB-së), struktura (lloji, për çdo sektor ekonomik), dhe burimi (publik/privat) i formimit të bruto kapitalit fiks janë zhvilluar në pesë vitet e fundit. Të lutem trego pjesën e lidhur me investimet në infrastrukturë duke përfshirë ndryshimet në rrugë, hekurudhë dhe linja telefonike. Ju lutemi siguroni një vlerësim sintetik të cilësisë së infrastrukturave të mëdha (transport, telekomunikacion, energji), që tregon fushat ku nevojat për investime janë të rëndësishme.

Tabela 35: Investimet Publike dhe Private në terma nominal dhe si % e PPB-së, 2007-2011

Në vlerë nominale					
Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011 Vlera.
<i>Në milion Euro</i>					
Investime	893	1,094	1,166	1,369	1,540
Investimet Private	737	747	766	914	1,012
Investimet Publike	155	347	400	455	528
PBB	3,394	3,851	3,912	4,190	4,606
Publike	Përqindje e PBB-së				
Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011 Vlera
<i>Në milion Euro</i>					
Investime	26%	28%	30%	33%	33%
Investimet Private	22%	19%	20%	22%	22%
Investimet Publike	5%	9%	10%	11%	11%

Burimi: Ministria e Financave

Tabela 36. Investimet në infrastrukturën rrugore, 2007-2011

Viti	2007	2008	2009	2010	2011
Investimet kapitale*	12.9	114.3	123.5	189.1	264.1
si % totali i investimeve publike	8.30%	32.90%	30.90%	41.60%	26.10%

*duke përfshirë riparimet e rrugëve, ndërtimi i rrugëve të reja dhe urave, sinjalizimin e infrastrukturës

Shënim: Shifrat e investimeve të kapitalit rrugor janë planifikuar nga buxheti i Ministrisë së Financave dhe KASH-i. Mesatarisht, shkalla e ekzekutimit lidhur me projektet rrugore gjatë periudhës 2007-2011 ka qenë përmbi 90%.

Tabela 37. Infrastruktura, vlerësimi i kualitetit të rrugës

Lloji	Gjendja e tanishme e rrugës					TOTALI
	A1	A2	A3	A4	B1	
Rrugës kombëtare (km)	105.2	286.4	245.4		4	641
Rrugët rajonale (km)	291	334.3	265.6	282.1	107	1280
	TOTALI					1921

Legjenda: A1-Kualitet shumë i lartë; A2-Kualitet i mire; A3-Kualitet minimal; A4-Kualitet i ulët; B1-Rruga e pa-asfaltuar.

Infrastruktura ujore: Është relativisht e mirë, por kërkon investime shtesë në mënyrë që të siguroj dhe menaxhoj ujin dhe rrjetin e furnizimit me ujë në mënyrë që të siguroj furnizimin me ujë për 24 orë, sepse shumica e rajonit nuk kanë furnizim të qëndrueshëm; nuk ka trajtim të ujërave të zeza, por një projekt pilot me financimin e Komisionit Evropian u zbatua në Skenderaj dhe u bë funksional në tremujorin e fundit të vitit të kaluar.

Infrastruktura e administrimit të mbeturinave në sektorin publik: Shërbimi komunal i mbeturinave të ngurta të parrezikshme është i mirë në zonat ku shërbimi i ofruar dhe kryerja e punës bëhet në bazë të licencës së lëshuar nga Zyra Rregullative e Ujit dhe Mbeturinave. Infrastruktura operative është relativisht e mirë, ata nuk kanë fonde financiare për përditësimin e parkut makinerisë, ajo gjithashtu kërkon ristrukturim të brendshëm dhe të ardhurat e mbledhura përfshijnë vetëm shpenzimet e thjeshta operuese.

Deponitë e përhershme të infrastrukturës sanitare: Nga fondet e BE-së, katër deponi të përhershme sanitare janë ndërtuar në katër qendra rajonale. Infrastruktura e tyre tani është shkatërruar në masë të madhe; operatorët publik të mbledhjes së mbeturinave paguajnë vetëm një pjesë të borxhit nga faturat e marra. Investime të tjera janë të nevojshme për ruajtjen dhe riprodhimin e deponive me funksion të njëjtë, në të kundërtën perspektiva e tyre nuk është e ndritshme.

Infrastruktura hekurudhore: Infrastruktura hekurudhore është e shpërndarë në tërë territorin e Kosovës me gjatësi prej 333,451 km të linjës hekurudhore të hapur, 105,784 km në stacione të trenit dhe 103,4 km linjë industriale. Hekurudha e Kosovës përmes Leshakut dhe Podujevës, në veri lindje përkatësisht është e lidhur me Serbinë, ndërsa përmes Hanit të Elezit me jugun e Maqedonisë.

Momentalisht, një pjesë e linjës (Nga Prishtina në Podujevë dhe në kufi me Serbinë, si dhe vija jug-perëndimore nga Xërxa në Prizren) nuk është funksionale për shkak të dëmtimeve të mëdha dhe kostos së lartë të riparimit. Vijat e tjera janë funksionale por niveli i tyre nuk është i kënaqshëm për shkak të nevojës së madhe për investime. Aktualisht, sinjalet e sigurimit janë të instaluar vetëm në linjën e stacionit hekurudhor 10 (Leshak - Mitrovicë - Hani i Elezit), ndërsa të gjitha linjat tjera nuk posedojnë pajisje të tilla. Kushtet për ndërtimin e stacioneve hekurudhore nuk janë ende në nivelin e dëshiruar pavarësisht punës së riparimit të kryer në baza vjetore. Pajisje të lëvizshme dhe makineritë për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore janë shumë të vjetra dhe me efikasitetit të ulët dhe këto kërkojnë riparime të përditshme të cilat kanë një kosto të lartë.

Prioritet kyç i INFRAKOS-it është linja hekurudhore 10 që lidh Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë, si dhe nëpërmjet të cilës bëhet shumica e transportit hekurudhor. Studimi i fizibilitetit në vitin 2010 theksoi nevojën për investime të mëdha për modernizimin e kësaj linje hekurudhore.

Fushat kryesore të infrastrukturës hekurudhore të cilat kërkojnë investime janë si më poshtë:

- a. Riparimi i linjës hekurudhore 10 me një shpejtësi prej 100 km/h në 120 km/h, një projekt që llogaritet të kushtoj rreth €174 milion;
- b. Blerja e pajisjeve të nevojshme për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore; një projekt që llogaritet të kushtoj rreth €3 milion;
- c. Riparimin e linjave të tjera hekurudhore, duke përfshirë pajisjet e sinjaleve të sigurimit, telekomunikimit dhe energjisë; një projekt që llogaritet të kushtoj rreth €200 milion

Infrastruktura e Telekomunikacionit

Telefonia fikse: Zgjerimi i telefonisë fikse është rreth 5%. Ka tre operatorë të licencuar që ofrojnë shërbime të telefonisë fikse:

- a. PTK është ndërmarrja e vetme që ofron qasje në telefoni fikse dhe thirrje përmes kabllorit telefonik (PSTN). Në dekadën e fundit, ky është një rrjet operator i ndërtuar që fokusohet

kryesisht në rrjetin NGN, dhe bën lidhjen e të gjitha qendrave urbane me në rrjet të kapacitetit të lartë (fibra optike) e po ashtu bën digjitalizimin e rrjetit qendror. Ndërsa qasja në rrjet është e bazuar kryesisht në kabllo bakri;

- b. IPKO Telecommunications SH.P.K ofron shërbime të telefonisë fikse nëpërmes rrjetit kabllor dhe mbulon pothuajse shumicën e qendrave urbane të Kosovës. Kjo infrastrukturë është e bazuar në qasje hibride, d.m.th lidhja me vendndodhjen e klientit është e kombinuar duke filluar me kabllo optike, bosht të përbashkët dhe më në fund pas instalimit me CPE, klienti është i pajisur me kabllo bakri ose në raste të veçanta me telefona IP;
- c. KONET është operatori i tretë i cili nuk ofron shërbime telefonike fikse, por vetëm atë të linjave me qira.

Niveli i mbulimit të territorit dhe popullatës me shërbimin e telefonisë fikse është shumë i vogël për shkak të delikatesës së punës, dhe nevojës së madhe për investime në rrjetin e qasjes.

Telefonia Mobile: Aktualisht, në Kosovë ka dy operatorë të licencuar mobil (Standard GSM 900/1800). Mbulimi ka arritur të përfshijë 99% të popullatës dhe 88% të territorit. Numri i stacioneve transmetuese ka arritur në 721. Teknologjia e përdorur është EDGE, e cila mundëson ofrimin e shërbimeve në internet përveç zërit, MMS, dhe SMS.

Shërbimet e Internetit: Qasja në internet ofrohet përmes 37 ndërmarrjeve të licencuara, 5 nga të cilat kanë qasje të drejtpërdrejtë në porta ndërkombëtare dhe sigurojnë qasje në rrjete më të vogla të ISP-ve që operojnë në regjione të ndryshme të Kosovës.

Lidhja e internetit për përdoruesit e modemit kabllor cilësohet si një teknologji e përhapur, me rreth 98,000 përdorues. Qasja në internet me teknologjinë ADSL deri në fund të vitit 2011, kishte 36,500 përdorues, nga të cilët 94% janë përdorues individual dhe pjesa e mbetur prej 6% janë biznese. Të dhënat tregojnë një rritje në mesin e përdoruesve të internetit përmes ADSL, ku në krahasim me vitin 2010 është 7.34%.

Teknologjia pa tela (wireless) kryesisht dominon në zonat rurale dhe shtrirjen e frekuencave të palicencuara prej 2.5 GHz dhe 5 GHz janë përdorur. Këto shërbime ofrohen nga ofruesit e vegjël të interneteve dhe kanë një shpejtësi mesatare prej 256 kbps.

Një numër i konsiderueshëm i lidhjeve kabllore ofrohet përmes boshtit të përbashkët kabllor – linjë të bakrit. Teknologjia kryesore vazhdon të jetë me modem kabllor me rreth 67.6% ndërsa, 27.7% e përdoruesve përdorin teknologjinë ADSL. Ofruesit kryesorë të rrjetit të internetit me bosht të përbashkët janë IPKO dhe Kujtesa kurse PTK – TiK është operatori i vetëm i cili ofron qasje në internet për përdoruesit përfundimtar përmes teknologjisë ADLS. Diagramet vijuese përmbajnë përqindje të teknologjisë së përdorur për ofrimin e shërbimeve të internetit.

Investimet nga ana e operatorit të shërbimeve të telekomunikacionit për vitin 2011 arrijnë shumën prej 38,266,377.33€ dhe kjo është një rritje e konsiderueshme krahasuar me vitin 2010 kur investimet kanë arritur shumën prej 30,777,237.11€.

Shifrat e mëposhtme paraqesin investimet e bëra për kategori të ndryshme të shërbimeve. Në 2011, një pjesë e madhe investimeve janë bërë në fushën e telefonisë mobile me 67.40%. Sektori i telekomunikacionit, nevoja për investime në rrjetin e telefonisë fikse është e dukshme. Përveç kësaj, duke ndjekur trendët më të reja në teknologji, është identifikuar nevoja për zëvendësimin e kabllove me fibra optike si dhe zgjerimi i rrjetit në lidhje me gjeneratën e ardhshme të qasjes (NGA).

Infrastruktura e rrjetit shpërndarës të energjisë: Rrjeti i shpërndarjes përfshin 110/x kV dhe nënstacionet e mëposhtme, si dhe linjën prej 35kV dhe më poshtë. Tabelat e mëposhtme paraqesin të dhënat bazë të linjës në përputhje me gjatësinë dhe nënstacionet e tyre që bazohen në nivelin e tensionit dhe sistemin e shpërndarjes.

Tabela 38. Linjat dhe Stacionet e Transformimit

kV	Numri i TS-ve	Numri i Transformatorëve	Ngarkesa(MVA)
220/35/10(20)	1	1	40
220/10(20)		1	40
110/35/10(20)	6	10	312
110/35	6	13	438
110/10(20)	2	4	143
110/10	10	15	512.5
35/10	48	100	640.8
35/0.4	1	1	0.63
10(20)0.4	1675	1718	603.35
10/0.4	5225	5353	1520.24
6/0.4	37	37	7.130

Rehabilitimi dhe fuqizimi i përgjithshëm i rrjetit është i përbërë nga zëvendësimi i linjave dhe poleve 0.4 kV dhe 10 kV dhe transformatorëve 10/0.4 kV. Nevojat specifike për investime janë të bazuara në gjendjen e aseteve të rrjeteve dhe në nivelin e performancës në lidhje me tensionin dhe ngarkesën, duke përfshirë zëvendësimin dhe izolimin e seksionit diriguës, dhe izolimin për të mbështetur operacionet në nivel prej 20 kV, zgjerim të rrjetit prej 10 kV dhe rritje të kapacitetit të transformatorëve në TS 10/0.4 kV. Këto ndryshime do të përmirësojnë qëndrueshmërinë e furnizimit, performancën e tensionit dhe zvogëlimin e uljeve teknike.

Investimet e nevojshme janë përshkruar më poshtë:

- Zgjerimi i mundshëm i rrjetit 110kV duke zëvendësuar rrjetin 35 kV në mënyrë që të adresohen rrjedhjet e mbingarkesës, të rritet niveli i furnizimit dhe zvogëlimi i humbjeve; të rritet numri i transformatorëve dhe i rezultateve në mënyrë që të lehtësojë kufizimet në menaxhimin e rrjedhjes së mbingarkesës;
- Ndërrimi i përcuesve, shtyllat dhe transformatorët e dëmtuar prej 10/0,4 kV në mënyrë që të përputhen me standardet dhe të garantojnë sigurinë publike;
- Kryerja e studimeve në mënyrë që lejojnë shqyrtimin e mundësive për rehabilitimin e përgjithshëm të sistemit (duke përfshirë qëndrueshmërinë e objekteve, gjendjen e riparimeve dhe uljen e performancës) në mënyrë që të vendosen standardet për të ardhmen dhe të rriten kapacitetet (për shembull, ndryshimi i nivelit të tensionit të rrjetit prej 0 kV deri në 20 kV), dhe zvogëlimi i humbjeve teknike në sistem;
- Operimi i Sistemit të Shpërndarjes SCADA, qendra e qarkut dhe operacionet e lidhura dhe proceset komerciale për monitorimin dhe kontrollimin e rrjetit të shpërndarjes;
- Analizimi i modelit të rrjetit të - Fabrika e Fuqisë

Infrastruktura e rrjetit të transmetimit

Të dhënat mbi cilësinë e infrastrukturës bazë të sistemit të transmetimit janë:

Infrastruktura e transmetuesve fizikë:

- Kapaciteti i transmetimit - $K_i=1550$ MW;
- Mbingarkesa e paraparë gjatë orëve të pikut (kulminante) 2012 - $N_p=1190$ MW;
- Diferenca e sigurisë (kapaciteti i rrjetit mbështet kriterin N)- $K_r=360$ MW;

- d. Përmbushja e kritereve N-1 - ~ 90% të rasteve;
- e. Kapaciteti ndërlidhës NTC - ~1700 MW;
- f. Kapaciteti i transformatorëve pa transformuesit shpërndarës - $K_{trans}=3150\text{MW}$;
- g. Kapaciteti i transformatorëve me transformuesit shpërndarës 110/x - $K_{trans}=4970\text{MW}$

Infrastruktura për operim të sigurtë të sistemit të transmetimit:

- a. Sistemi SCADA/EMS (Kontrolli Mbikëqyrës dhe and Blerja e të dhënave/Menaxhimi i Sistemit të Energjisë);
- b. Sistemi i Telekomunikacionit (OPGW);
- c. Sistemi i Matjes nga Larg;

Fushat të cilat kanë nevojë për investime:

- a. Rritja e kapaciteteve të transmetimit:
 - i. për ndërlidhje të linjave Linja 400 kV Kosovë - Shqipëri;
 - ii. Linja 400 kV Kosovë - Maqedoni.

Rritja e kapaciteteve të transmetimit dhe transformuesve:

- a. Në nivelin e konsumit lokal - rritja e kapaciteteve në nivelin shpërndarës, në mënyrë që të mbështetet rritja e konsumit;
- b. Infrastruktura e Kontrolluese e Frekuencës së Ngarkesës - me Shqipërinë.

Sektori i Gazit Natyror: Kosova ka një gaz nëntokësor natyror që është ndërtuar në vitin 1970 dhe veproi deri në vitin 1988 dhe që ka furnizuar një fabrikë në Shkup, Ferronikel-in, Trepçën, Llamkosin dhe ish kazemat ushtarake në Prishtinë, Ngrohjen Qendrore në Qarkun e Prishtinës "TERMOKOS" dhe disa objekte industriale. Furnizimi me gaz është bazuar në procesin e gazifikimit të linjimit në kuadër të ish kompanisë Elektro-Ekonomia e Kosovës përkatësisht organizata e punës "Energji dhe Kimi". Presioni i projektuar operativ i tubacioneve të këtij gazi ishte 25 bare me një kapacitet vjetor prej 480 milion NM³. Tubacioni i gazit është i dëmtuar rëndë në disa pjesë dhe është jashtë funksionit.

Sipas studimit të ESTAP-it, linja ekzistuese nuk ka një kosto të arsyeshme të riparimit prandaj është rekomanduar një linjë e re e tubacioneve me parametra të tjerë operacional. Megjithatë ky është një fakt pozitiv duke pasur parasysh që Qeveria zotëron të drejtat pronësore të aksit rrugor Hanit i Elezit - Mitrovicë dhe kjo do të merret parasysh përgjatë shqyrtimit për përdorimin e asete aktuale.

Përveç kësaj, një studim mbi gazifikimin në Evropën Juglindore është kryer nga Banka Botërore dhe KfW (Tetor 2007), e cila shtjellon mundësitë ekonomike rreth transportimit të gazit në Kosovë. Raporti arriti në përfundim që furnizimi me ngarkesa tregtare dhe industriale dhe ndërtimin e rrjeteve të shpërndarjes së gazit në Prishtinë dhe Mitrovicë.

Megjithatë deri më sot nuk është kryer asnjë studim i cili tregon mundësitë, kostot e instalimit dhe zgjerimit të një sistemi të gazit në të gjithë Republikën e Kosovës. Prandaj, kostot reale të investimeve për instalimin dhe zgjerimin e gazit natyror, si dhe rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes në Kosovë, do të vlerësohen me një studim që do të përfundojë në vitin 2013.

Nuk është bërë asnjë studim për Kosovën sa i përket zhvillimit të rrjetit për transmetim rajonal, rrjetit të brendshëm si dhe rrjetit të shpërndarjes. Megjithatë studimet e bëra për rajonin, veçanërisht Studimi i Gazifikimit për Rajonin e Evropës Juglindore i vitit 2007, përmban detale të shumta për zhvillimin e gazit natyror në Kosovë si pjesë e Unazës së Gazit në Evropën Juglindore; një koncept i propozuar dhe i pranuar nga SEE TKE. Në do t'i referohemi këtij studimi për specifikimin e nevojave kryesore rreth investimeve në gazin natyror të Kosovës.

Në këtë mënyrë, faza e parë dhe kryesore për zhvillimin e sektorit të gazit natyror do të jenë investimet në segmentin e tubacioneve të gazit në Kosovë- linja transmetuese si pjesë e Unazës së Gazit për EJL:

- a. Linja Transmetuese: Zona kufitare e Maqedonisë/Kosovë-Prishtinë; gjatësia e linjës: 63 km, diametri i tubacionit të gazit: 24 inç;
- b. Linja Transmetuese: Prishtinë –zona kufitare Kosovë/Serbi; gjatësia e linjës: 33 km, diametri i tubacionit të gazit: 24 inç.

Sistemi i Shpërndarjes së Ngrohjes Qendrore: Sektori i ngrohjes qendrore është i përbërë nga katër pjesë që furnizojnë me ngrohje zonat urbane të komunave në vijim: Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan. Ky sektor mbulon rreth 5% të kërkesës së përgjithshme për ngrohje në Kosovë.

Rrjeti kryesor i shpërndarjes është Ndërmarrja Qendrore Termokos, Prishtinë me gjatësi prej 63 km, me një kapacitet të instaluar në rrethe prej 2x7 MW, 2x7MW është kapaciteti i instaluar në Spitalin e Prishtinës (rezervë) dhe 1x4MW kapacitet ky i instaluar në ngrohjen qendrore për vetë nevojat e saj dhe 2x0.8 MW kapacitet i instaluar në Fushë Kosovë (jashtë përdorimit). Kapaciteti i përgjithshëm është: 135.6 MW. Një pjesë integrale e sistemit të shpërndarjes është stacioni i pompës dhe shkëmbimit të ngrohjes, me 323 nënstacione (312 aktiv), të cilat po ashtu luajnë rolin e pikave ndarëse ndërmjet rrjeteve primare dhe dytësore. Burimi kryesor për prodhimin e energjisë termike është karburanti i vajit industrial.

Rrjeti kryesor i shpërndarjes në Gjakovë është zgjeruar në gjatësi prej 23.5 km me një kapacitet të ngrohjes prej 38 MW. 275 nënstacione aktive janë pjesë integruese e këtij rrjeti. Burimi kryesor për prodhimin e energjisë termike është karburanti i vajit industrial.

Sistemi i ngrohjes në Mitrovicë përbëhet nga dy rrjete të ndara: rrjeti i shpërndarjes nga Ndërmarrja Qendrore Termomit, Mitrovica, dhe rrjeti i shpërndarjes në Zveçan. Duke u bazuar në Strategjinë për Ngrohje nga Republika e Kosovës 2011-2018, rrethi i ngrohjes Termomit furnizon 160 konsumator të sektorit familjar me një sipërfaqe të ngrohur prej 8500m². Gjatësia totale e shpërndarjes së rrjetit është 6 km me një kapacitet të instaluar prej 1x83 MW.

Sistemi i ngrohjes qendrore në Zveçan ka një rrjet më të vogël të shpërndarjes, me gjatësi prej 0.8 km.

2.6. Tregjet Financiare

2.6.1. Pasqyra e Përgjithshme

- Ju lutem tregoni se si janë të vendosura normat e interesit

Normat e interesit në sektorin bankar të Kosovës janë të përcaktuara nga bankat përkatëse. Për shkak të euroizimit, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) nuk mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në normat e interesit. Përcaktimi rreth normave të interesit në Kosovë është dalluar kryesisht nga ndryshimi i kërkesës dhe ofertës për kredi dhe depozita, rrezikimi i zhvillimit të bankës, si dhe nga kostoja e përgjithshme e financimit të bankës.

- A ekzistojnë kufijtë kuantitativë në zgjerimin e kredisë? Cilat instrumente janë në dispozicion për të parandaluar rritjen e tepërt të kreditit dhe prishjen e cilësisë së dosjeve të huadhënësve?

Limitet e ekspozimit të produkteve kreditore bankare të rrezikshme janë të vendosura nga rregulloret e BQK-së, si në vijim:

- a. Asnjë bankë nuk duhet të lejoj ekspozimin e riskut të kreditit tek një person apo grup i personave që kalojnë 10% të kapitalit të Klasës së I-rë, deri sa ekspozimet e para të jenë miratuar në mbledhjet e rregullta të Bordit të Drejtorëve, në të cilën kuorumi ishte i

pranishëm dhe ka votuar, dhe miratimi i tillë është shënuar në procesverbalin e asaj mbledhjeje;

- b. Asnjë bankë nuk duhet të lejoj ekspozimin e riskut të kreditit tek një person apo grup i personave që kalojnë 10% e kapitalit të Klasës së I-rë, dhe totali i ekspozimeve aktive të mbledhura që kalojnë 300% të totalit të Klasës së I-rë të bankës;
- c. Asnjë bankë nuk duhet të lejoj ekspozimin e riskut të kreditit tek një person apo grup i personave që kalojnë 20% e kapitalit të Klasës së I-rë, siç është përcaktuar në Rregulloren për Kapital;
- d. Niveli i rekomanduar i raportit kredi/depozita prej 80%.

Nga perspektiva rregullative, rritja e portofolit kreditor matet kryesisht në bazë të kapitalit kapitali, përkatësisht aftësia për të absorbuar humbjet e kapitalit të tepërt bankar, dhe BQK-ja mund të kërkoj zvogëlimin apo ndaljen e ngritjes së normës kreditore të bankës, e cila tregon një tendencë për përkeqësimin e gjendjes financiare.

Nga aspekti mbikëqyrës, Departamenti Mbikëqyrës Bankar brenda BQK-së, vlerëson dhe monitoron përshatshmërinë e portofolit të rritjes së kredisë së banës kundrejt profilit të rrezikut të bankës, kapacitetin e menaxhimit të mjaftueshmërisë së rrezikut kreditor, sistemin e paralajmërimit të hershëm dhe testin e stresit.

- Jep një vlerësim të qasjes në tregjet financiare ndërkombëtare nga Kosova dhe nga sektori privat.

Kosova është anëtare e BB-së dhe FMN-së, dhe ka qasje në kreditë që janë të garantuara në marrëveshjet financiare bilaterale. Momentalisht, Kosova përfiton nga kreditë e vogla prej bankës KfW, Bankës Botërore, FMN-së dhe pritet që në të ardhmen të përfitoj një kredi tjetër nga Qeveria Austriake.

Lidhur me investimet financiare, BQK-ja ka qasje në tregjet financiare në veçanti në Euro-zonën dhe shtetet anëtare të BE. Një qasje e tillë është e konsideruar si mjaft e matur dhe në përputhje me kriteret e politikave të investimeve të BQK-së. Sektori financiar i Kosovës nuk ka pengesa ligjore për qasjen në tregjet ndërkombëtare financiare. Qasja e sektorit bankar në tregjet ndërkombëtare financiare bëhet përmes letrave me vlerë dhe rregullimit të tregut të parave. Fusha e sigurimeve shëndetësore përmes kontratave të ri-sigurimit e realizon një qasje të tillë.

-Cilat janë karakteristikat kryesore të pastrimit ndër-bankar dhe sistemit të shlyerjes? Ju lutem vlerësoni funksionimin e këtyre sistemeve. A ka ndryshime të parashikuara në sistemin e pagesave?

Pastrimi dhe rregullimi i sistemit ndër-bankar të pagesave në BQK, është një sistem i zgjidhjes në kohë reale bruto për pagesat kryesore/urgjente dhe shlyerjes neto të pagesave të tjera. Të gjitha pagesat e vogla dhe të mëdha ndër-bankare janë te procesuara nga ky sistem (Pagesat KOS-xhiro, tërheqje automatike, pagesat e shumta/UNIREF; pagesat e rregullta, pagesat prioritare/urgjente, dhe pagesat e letrave me vlerë). Sistemi bazohet në rrjetin lokal të komunikimit, si linja me qira/PRK dhe fibër optik/ IPKO. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në sistem aktualisht janë tetë banka komerciale që janë anëtare të IECS, se bashku me Thesarin për të hyrat e pagesave, dhe BQK-në për pagesat dhe urdhërpagesat në emër të Thesarit.

Funksionimi i këtij sistemi konsiderohet të jetë shumë efektiv (99.9%) pa asnjë ditë të vetme të ndërprerjes që nga krijimi i saj (Maj, 2001). Është e karakterizuar më një ngritje cilësore dhe sasiore (në kohë, shpejtësi, dhe siguri) më një mesatare prej 16 mijë transaksione nominale në ditë, me një vlerë prej 20 milion€. Sistemi është përmirësuar dhe avancuar vazhdimisht për pagesat ndër-

bankare në përgjithësi, në skemën KOS-xhiro, tërheqjet automatike, pagat dhe pagesat, moduli UNIREF, moduli i letrave me vlerë, etj.

Sipas Strategjisë së Zhvillimit të Pagesave Kombëtare, janë paraparë ndryshime dhe zhvillime¹ të reja, të kategorizuara në nëntë shtylla, disa prej të cilave janë finalizuar. Shtyllat e tjera siç është shtylla e dytë janë shumë të rëndësishme, janë të dizajnuara për krijimin dhe zhvillimin e sistemit të pagesave me shumë të lartë dhe pagesave urgjente, SHGBKR (Shlyerja bruto në kohë reale), është në fazën fillestare duke pritur aprovimin nga Banka Botërore për emërimin e një eksperti për asistim gjatë fazës së zbatimit të projektit. Lista e kandidatëve është përzgjedhur nga një komision i BQK-së (në Mars, 2012). Pastaj shtylla e III-të për Qendrën e Procesimit të Kartave Kombëtare, ku BQK-ja parashihet të udhëheqë rrugën si një katalizator në kryerjen e procesimit të qendrës së kartave ndër-bankare në vend.

Projekti "Regjistri i mbajtësve të llogarive bankare" është zbatuar dhe ende funksionon në BQK që nga 2 Maji 2012, dhe në këtë kontekst, të gjitha bankat kanë filluar të raportojnë për të gjitha llogaritë e klientëve në regjistrin e llogarive të Bankës Qendrore.

2.6.2. *Sektori Bankar*

- Sa banka ekzistojnë në Kosovë? Sa institucione të tjera të kreditit janë në Kosovë? Ju lutem listoni ato.

Në Kosovë janë 8 (tetë) banka komerciale dhe 20 institucione kreditore në përgjithësi (duke përfshirë institucionet mikro-financiare dhe institucionet jo-bankare) që operojnë në Kosovë.

Bankat komerciale janë:

- a. ProCredit Bank;
- b. Raiffeisen Bank Kosova SH.A;
- c. NLB Prishtina SH.A;
- d. Banka për Biznes;
- e. Banka Ekonomike;
- f. TEB SH.A;
- g. Banka Kombëtare Tregtare - dega në Kosovë;
- h. Komercijalna Banka - dega në Mitrovicë.

Institucionet mikro-financiare dhe jo-bankare janë:

- a. Finca;
- b. KEP;
- c. KGMAMF-Grameen;
- d. AFK;
- e. Besëlidhja;
- f. KRK;
- g. Mështekna;
- h. Qelim Kosovo;
- i. KosInvest;
- j. Start;
- k. Perspektiva 4;
- l. KAD;
- m. ACP;
- n. Agro Invest;
- o. Timi Invest;
- p. Crimson Finance Fund;
- q. Lesna;

- r. Raiffeisen Leasing;
- s. Factor Leasing;
- t. Fundway Mortgage.

- Asetet e sistemit bankar dhe institucionet tjera kredituese?

Që nga fillimi i operimit të sistemit financiar në Kosovë, sistemi bankar dhe institucionet e tjera kredituese janë rritur vazhdimisht. Në fund të vitit 2011, asetet totale bankare kanë arritur vlerën prej €2.66 bilion (56.6% e PBB-së). Rritja vjetore e aseteve bankare gjatë vitit 2011 ishte 8.3%, ndërsa norma mesatare e rritjes gjatë pesë viteve të fundit ishte 18.2%. Asetet e sistemit bankar në Kosovë dominohen nga kreditë, që në vitin 2011 kanë arritur një vlerë prej €1.7 bilion (36.2% e PBB-së). Në vitin 2011, sistemi kreditues bankar ka regjistruar një rritje vjetore prej 16.4%, ndërsa norma mesatare e rritjes gjatë pesë viteve të fundit ishte 22.3%.

Kredidhënia në ekonominë e Kosovës është e mbështetur edhe nga institucionet mikro-financiare. Asetet e këtij sektori në vitin 2011 kanë arritur një vlerë prej €127.5 milion (2.7% e PBB-së). Në krahasim me vitin 2010, asetet e institucioneve mikro-financiare kishin një rënie prej 8.8%, ndërsa norma mesatare e rritjes për pesë vitet e fundit ishte 15.9%. Struktura e aseteve të institucioneve mikro-financiare është e dominuar nga kreditë, të cilat në vitin 2011 arritën një shumë prej €104.7 milion (2.2% e PBB-së). Në krahasim me vitin e kaluar, kjo prezanton një rënie vjetore prej 9.8%. Gjatë pesë viteve të fundit, kreditë e lëshuara nga institucionet mikro-financiare kanë shënuar një rritje prej 13.6%.

- Depozitat e përgjithshme (nëse është e mundur, sipas llojit të institucionit të kreditit - bankat, kursimet bankare, institucionet e kreditit hipotekar, të tjera).

Sistemi bankar në Kosovë është i përbërë vetëm prej bankave, si institucion financiar i vetëm që mund të pranojë depozita (duke e përjashtuar BQK-në). Në vitin 2011, vlera e të gjitha depozitave në sistem bankar në Kosovë qëndroi në €2.1 bilion. Kjo tregon një rritje vjetore prej 8.5%. Burimet kryesore të depozitave në sistemin bankar janë depozitat familjare të cilat përbëjnë përafërsisht 70% të të gjitha depozitave.

- Përqendrimi i tregut (përkatësisht si pjesë e aseteve totale, të kredive dhe depozitave totale të mbajtura nga institucionet e mëdha)

Që nga fillimi, sistemi bankar i Kosovës është karakterizuar me një shkallë relativisht të lartë të përqendrimit të tregut. Në fund të vitit 2011, tri bankat më të mëdha të shtetit menaxhonin gati 73% të aseteve totale të sistemit. Shkalla e lartë e përqendrimit në treg tregohet edhe me Indeksin Herfindahl Hirschman i cila në vitin 2011 arriti 20990 pika. Indeksi i lartë Herfindahl Hirschman ishte i ngjashëm edhe me tregjet për kredi dhe depozita, që do të thotë se shkalla e përqendrimit të tregjeve është e ngjashme me asetet, kreditë, dhe depozitat e sistemit bankar. Megjithatë, shkalla e përqendrimit në tregun bankar në Kosovë është zvogëluar vazhdimisht gjatë viteve të fundit. Për shembull, në vitin 2008 Indeksi Herfindahl Hirschman i aseteve të sistemit bankar ka arritur një nivel prej 2842 pikë, ndërsa për depozita dhe kredi, indeksi përkatësisht ka arritur 2934 dhe 3009 pika. Për më shumë, në vitin 2008, tri bankat më të mëdha kishin nën menaxhimin e tyre rreth 80% të aseteve të sistemit bankar.

- Ju lutem shpjegoni situatën aktuale në lidhje me qasjen e kompanive private në kredi bankare

Shumica e kredive të lëshuara nga sistemi bankar i Kosovës gjatë pesë viteve të fundit është marrë nga ndërmarrjet private (rreth 70% të kredive totale në vitin 2011), e cila tregon një përparësi të madhe për ndërmarrjet ndaj ekonomive familjare në lidhje me qasjen e kredive në bankë. Në terma nominal, në fund të vitit 2011, bizneset në Kosovë kanë marrë një total prej 1,089,146€ kredi nga bankat, krahasuar me 470.283€ kredi që iu janë lëshuar ekonomive familjare.

Varësisht nga madhësia e biznesit dhe aktivitetet e tyre, produktet bankare dhe financiare janë të strukturuar. Llojet e kredive aktualisht të arritshme nga kompanitë në Kosovë janë: Kreditë komerciale, Bio Kreditë, Kreditë e ri-financimit, Kreditë për agrikulturë, kreditë e pasiguruara, kreditë hipotekare, kreditë e lizingut dhe lloje të tjera të kredive të cilat i përshtaten aktiviteteve të biznesit. Përveç kredive të përmendura më sipër, kompanitë private kanë qasje në tregtinë për prodhimet financiare të vëna në dispozicion nga sektori bankar. Produktet financiare tregtare të lëshuara në Kosova janë: letër garancion, mbledhje dokumentare, letër kredi, etj.

Varësisht nga lloji i kreditit për të cilin është aplikuar dhe kapaciteti i kompanisë, bankat lëshojnë kredi duke rregulluar shumën e kredisë në bazë të kapacitetit të pagesës. Kriteret për aplikim të kredisë ndryshojnë, por më të rëndësishme janë: certifikata e biznesit, certifikata e TVSH-së (nëse është e aplikueshme), pasqyra financiare e kompanisë, lista e aksioneve të kompanisë, lista e pajisjeve, biznesi plani, një kopje e planit, lista poseduese për hipotekë dhe disa dokumente tjera varësisht nga specifikat e aplikacionit të kredisë për kompaninë.

Bankat në Kosovë kanë qenë përgjithësisht konservatore në procesin e dhënies së kredive, duke marrë parasysh krizën ekonomike aktuale në Bashkimin Evropian. Sipas Shoqatës së Bankave të Kosovës kjo ka bërë që bankat të jenë më të kujdesshme, duke rezultuar në një sektor më të fortë dhe të qëndrueshëm financiar, pavarësisht goditjeve të jashtme që mund të ketë ndikuar në ekonominë e Kosovës.

-Ju lutem vlerësoni shkallën e konkurrencës në sektorin bankar (konkurrenca në çmim, produkte të reja, ndryshimet në pjesëmarrje të tregut, dhe indikatorët tjerë). A ka ndonjë shqetësim të veçantë lidhur me pjesën e tregut të bankave më të mëdha?

Pavarësisht shkallës së lartë, rënia e vazhdueshme e përqendrimit të tregut mund të tregojnë një rritje e konkurrencës në sistemin bankar. Shkalla e rënies së përqendrimit në sistemin bankar u bë më e dukshme nga viti 2008, një periudhë e lidhur me hyrjen e tri grupeve të jashtme bankare NLB, TEB, BKT në tregun e sistemit bankar të Kosovës. Në vitin 2008, Indeksi Herfindahl Hirschman për asetet e bankës ka arritur një nivel prej 2,742 pikave, ndërsa në vitin 2011, indeksi ka pësuar rënie në 2,090 pika. Gjatë kësaj periudhe, një reduktim i konsiderueshëm i përhapjes së normës së interesit është vërejtur. Kjo mund të ketë ndodhur për shkak të konkurrencës më të madhe në sistemin bankar. Në vitin 2011, norma e përhapjes së interesit ishte 10.65 përqind, në krahasim me 11.32 përqind në vitin 2007. Sidoqoftë, konkurrenca më e madhe është manifestuar më së shumti me zgjerim të shpejtë, POS terminale, dhe produkte të reja në sistem në vend se me norma të interesit më të ulëta. Duke marrë parasysh sjelljet e mëparshme të bankave dhe zvogëlimin e vazhdueshëm të trendit të shkallës së përqendrimit, mund të konkludohet se konkurrenca në sistemin bankar është rritur. Si pasojë e kësaj, aksionet e larta të tre bankave kryesore nuk tregojnë ndonjë problem serioz në konkurrencën e sistemit bankar.

- Cila është mesatarja e normave të interesit (normat e kredive/depozitave) në sistemin bankar gjatë pesë viteve të fundit? Ju lutemi jepni të dhëna mbi përfitimin e bankave gjatë viteve të fundit dhe jepni komente mbi zhvillimet.

Norma e interesit e shpërndarë në vitin 2011 ishte 10.65 pikë përqindjeje, në krahasim me 11.32 përqind në vitin 2007. Gjatë pesë viteve të fundit, ky indikator ka arritur nivelin më të ulët në vitin 2009 duke qëndruar në 10.01 përqind, por zhvillimi i krizave gjatë kësaj periudhe e solli atë përsëri në nivelet më të larta.

Sistemi bankar i Kosovës është vazhdimisht i karakterizuar me një nivel të lartë të përfitimit gjë që ka përfaqësuar një shtyllë të rëndësishme të stabilitetit të saj. Kthimi në Asetet Mesatare (KAM) në vitin 2011 ishte 1.5%. Megjithatë, në krahasim me vitin 2007, KAM ishte 2.6%, një rënie e përfitimit në sistemin bankar është vënë re. Rënia e përfitimit ishte rezultat i rritjes së shpejtë të aseteve në

krahasim me rritjen në fitimin neto. Norma më të ulëta të rritjes së fitimit neto gjatë kësaj periudhe, më së pari ishin rezultat nga ngadalësimi në rritjen e të ardhurave të bankave komerciale, duke pasur ndikim në ngadalësim të kredive nga fillimi i krizës globale. Pavarësisht nga rënia e përfitimit, sistemi bankar vazhdon të ketë mjaft fitim.

- Cila është pjekuria mesatare e kredive bankare për sektorin privat gjatë pesë viteve të fundit? Cila është pesha e kredive me afat të pjekurisë deri në një vit?

Mesatarja e pjekurisë së kredisë bankare për sektorin privat (biznese dhe ekonomi familjare) në vitin 2011 ishte më një pjekuri kreditore deri në dy vjet (52% e të gjitha kredive apo 74% e shumës së kredive). Kreditë deri në një vit përfaqësojnë 28% të kredive dhe 69% të shumës nominale. Një situatë e ngjashme e përqendrimit kreditor duket në vitin 2010, kur kreditë me pjekuri deri në një vit përfaqësojnë 26% të numrit të kredive dhe 62% të shumës nominale të kredive. Kreditë me pjekuri më të madhe se një vit dhe ato më të madhe se dy vite përfaqësojnë 29% të numrit të kredive dhe 8% të shumës së përgjithshme të kredive.

Kreditë me pjekuri deri në një vit në Dhjetor të vitit 2011 përbëjnë 21.4% të kredive të bankave komerciale të lëshuara për bizneset dhe ekonomitë familjare (apo €351.9 milion). Kjo përqindje e kredive nuk ka vuajtur nga luhajtjet e mëdha gjatë pesë viteve të fundit. Për më shumë, që nga viti 2007 ajo paraqet një figurë me përqindje më të vogël kreditore me pjekuri deri në një vit (rreth 18% të kredive për bizneset dhe ekonomitë familjare). Në këtë kontekst, kategoria kryesore e kredive me pjekuri nga dy deri në pesë vjet, përbën 42.6% të kredive.

- Si e vlerësoni stabilitetin e sektorit bankar? Cila është situata aktuale dhe trendi sa i përket kapitalit, strukturës së kapitalit, kapitali rregullator, asetet me rrezikshmëri? Si është ndikuar sektori bankar nga kriza financiare globale?

Sistemi bankar i Kosovës vazhdon të gëzojë një nivel të lartë të qëndrueshmërisë, të karakterizuar me një nivel të lartë të shkallës së kapitalit, kualitet të mirë të portofolit të kreditit dhe një nivel të kënaqshëm të likuiditetit. Në vitin 2011, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit qëndroi në 17.5% e cila jashtëzakonisht e kalon minimumin prej 12% të kërkuar nga rregullatori. Kërkesa e BQK-së për të mbajtur këtë indikator në 12% vazhdon të plotësohet nga të gjitha bankat që operojnë në Kosovë. Struktura kapitale e sistemit bankar në Kosovë është e karakterizuar me një kualitet të mirë, duke pasur parasysh që shumica e kapitalit (59% e kapitalit total) përbëhet nga kapitali aksionar. Në krahasim me vitin 2010, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit për sektorin bankar të Kosovës u zvogëluar për 1.2 pika përqindjeje. Rënia e treguesit të kapitalit është shkaktuar kryesisht nga normat e larta të aktiviteve të rrezikshme në krahasim me normën e rritjes së kapitalit. Rritja më e shpejtë e aseteve me potencial rrezikshmërie në vitin 2011 ishte për shkak të normës më të lartë të rritjes së kredive. Struktura e aseteve me rrezikshmëri është e dominuar nga asetet me rrezikshmëri prej 100%, të cilat përbëjnë 76.9% të aseteve totale. Sistemi bankar i Kosovës është vazhdimisht i karakterizuar me një pozicion të kënaqshëm të likuiditetit. Raporti kredi-depozita mbetet përafërsisht në 80% e cila është në përputhshmëri me rekomandimet e BQK-së.

Kriza financiare globale ka pasur ndikim të kufizuar mbi sistemin bankar në Kosovë. Kryesisht, ky është rezultat i strukturës së aktiviteve bankare që kanë një nivel mjaft të ulët të ekspozimit në sektorin e jashtëm. Aktivitetet e bankave që operojnë në Kosovë kryesisht mbështeten në kreditimin e ekonomisë lokale, kurse burim kryesor financiar konsiderohen të jenë depozitat e mbledhura brenda vendit. Mirëmbajtja e vazhdueshme e kapitalit dhe kualitetit të mirë të portofolit të kredive në nivel të lartë ka shërbyer në ndërtimin e imunitetit të sistemit bankar kundër efekteve negative që mund të paraqiten nga kriza globale.

Efektet e krizës globale në sistemin bankar kanë kontribuar kryesisht në ngadalësimin e rritjes së kredive në vitin 2009, kështu duke ngadalësuar të ardhurat nga normat e interesit dhe përfitimin e

sistemit bankar. Megjithatë, në vitin 2010 dhe 2011 sistemi kreditor ka përshpejtuar trendin e rritjes duke shkaktuar rritje të fitimit në sistemin bankar. Kriza globale gjithashtu ka shkaktuar një ngadalësim të rritjes ekonomike në vend gjë që ka reflektuar në një rritje të vogël të kredive të këqija. Megjithatë, pavarësisht këtyre efekteve, sistemi bankar i Kosovës ka mbajtur nivel të lartë të qëndrueshmërisë, e cila tregohet edhe nga rezultatet e analizës së stres-testit për sistemin bankar të Kosovës i zhvilluar në baza të rregullta nga BQK-ja. Shkalla e lartë e sistemit bankar është ilustruar po ashtu edhe nga vetë fakti se gjatë kësaj periudhe Kosova ka qenë ndër vendet me rritjen më të lartë të kredive dhe depozitave.

- Ju lutem ofroni një analizë dhe vlerësim (si një sasi absolute, si % e asetëve totale) të kredive joperformuese (NPLs) në banka.

Në vitin 2011, kreditë joperformuese kanë arritur vlerën prej 96.2 milion € (rreth 83€ milion në 2010) që përfaqëson rreth 5.7% të portofolit total të kredive në sistemin bankar. Kreditë me probleme në sistemin bankar në Kosovë përbëhen nga kredi të kualifikuara si "kredi të dyshimta" dhe "kredi të humbura". Struktura e kredive me probleme është e dominuar nga kreditë e klasifikuara si "kredi të humbura" të cilat përfaqësojnë 64.5% të totalit të kredive me probleme. Kreditë joperformuese vazhdimisht janë mbuluar nga dispozitat për humbje nga huat. Në vitin 2011, mbulimi i kredive me probleme është rritur edhe më tej për të arritur 116.7% nga 114.4% në 2010.

- Në çfarë shkalle ka arritur zhvillim i kredive joperformuese në pesë vitet e fundit?

Gjatë periudhës 2007-2009, përqindja e kredive me probleme në totalin e kredive ka arritur rreth 4%, ndërsa në tremujorin e katërt të vitit 2011 ka arritur vlerën prej 5.9%. Pjesa e kredive joperformuese vazhdon të rritet përgjatë tremujorit të parë të vitit 2012 duke arritur 6.2%. Megjithatë, në fund të vitit 2011, kreditë joperformuese janë zvogëluar në 5.7% si pjesë e totalit të kredive, duke shënuar një rënie vjetore prej 0.2% të pikëve.

- A ka pasur ndryshime në legjislacionin e falimentimit? A janë parashikuar rregullime (të mëtutjeshme)? Ju lutem komentoni mbi praktikën dhe kornizën ligjore. Sa lehtë mund të mobilizojnë bankat kërkesat e tyre përmes procedurave të tilla?

Në bazë të Ligjit të ri për Bankat, Institucionet Mikro-Financiare dhe Institucionet Jo-Bankare Nr. 04/L-093, dispozitat për procedurat për "Rezolutën e bankave problematike dhe strategjive dalëse" janë korrigjuar dhe plotësuar krejtësisht me:

- a. Lejen për regjim nga Administrata e Përkohshme për bankat e dobëta;
- b. Përshkrime të detajuara rreth procedurave të likuidimit që janë të aplikueshme për bankat të cilave iu revokohet licenca
- c. Përcaktimin e qartë të procedurave me të cilat bankat mund të paraqesin likuidimin vullnetar.

Me ligjin e ri, pretendimet e bankave mund të realizohen shume më lehtë për shkak të dispozitave të shtuara për administrimin e përkohshëm të bankave të dobëta. Kjo nuk është e dhënë në legjislacionin e mëparshëm.

Nuk ka pasur ndonjë praktikë të administratës apo falimentimit, përveç rastit të rastit të likuidimit të një banke në vitin 2006 i cili është kryer me sukses. Procesi i likuidimit është në vazhdim e sipër në përputhshmëri me kornizën ligjore në fuqi

2.6.3. Sektori Jo-bankar

- Sa institucione të sigurimeve veprojnë në Kosovë?

Numri i kompanive të sigurimit që veprojnë në Kosovë është trembëdhjetë (13) ku dhjetë prej tyre ofrojnë sigurime jo-jetësore, dhe tre (3) kompani të sigurimeve operojnë në tregun e produkteve të sigurimit jetësor.

Nga numri i përgjithshme i kompanive të sigurimeve që operojnë në Kosovë shtatë (7) prej tyre janë në pronësi të huajve, dy (2) kompani me pronësi të përzier, tre (3) prej tyre me pronësi të plotë vendore dhe një (1) është kompani vartëse.

- Përqendrimi i tregjeve përkatëse të jetës dhe jo-jetës (lidhur me premitë bruto të mbajtura nga ndërmarrjet më të mëdha).

Industria e sigurimeve është kryesisht e përqendruar në sigurimet jo-jetësore, ku pjesa më e madhe është sigurimi i detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palës së tretë. Pa marr parasysh faktin se deri në mesin e vitit 2011 ka qenë vetëm një kompani që ka operuar në tregun e sigurimeve jetësore, premitë e sigurimeve jetësore janë ngritur dhe nga 31 dhjetori 2011 aksioni i premive të sigurimeve jetësore ishte 0.15% të totalit të portofolit të premive. Nga fundi i vitit 2011, dy kompani të tjera janë shtuar në tregun e sigurimeve jetësore. Pa marrë parasysh këtë, industria e sigurimeve vazhdon të jetë e dominuar nga sigurimet jo-jetësore, veçanërisht nga sigurimi i detyrueshëm i auto-përgjegjësive ndaj palës së tretë. Dy kompanitë e reja në tregun e sigurimit të jetës duhet të stimulojnë konkurrencë më të madhe mes kompanive dhe të ndryshojnë strukturën e premive të sigurimeve të jetës dhe jo-jetës.

- Ju lutemi të vlerësoni shkallën e konkurrencës në sektor.

Shkalla e konkurrencës zhvillohet kryesisht në produktet jo-jetësore, posaçërisht në sigurimin e auto-përgjegjësive së detyrueshme ndaj palës së tretë, sigurimi Kasko i pronës në mënyrë të vullnetshme, sigurimet nga zjarret dhe aksidentet personale. Tani që numri i kompanive të sigurimeve është rritur, pritet një shkallë më e lartë e konkurrencës.

- Cila është gjendja lidhur me tregjet financiare dhe instrumentet, për shembull kompanitë me kapital të madh investues, prodhimin, lizingun, etj? A ekziston korniza ligjore për operacione të tilla? Ju lutem ofroni çdo informacion mbi zhvillimet e tregut.

Ekzistojnë dy institucione jo bankare të cilat kryejnë aktivitete financiare dhe lizing: Raiffesein Leasing dhe Leasing Factor. Ekziston korniza ligjore, të tillë si Ligji për Bankat, Institucionet mikrofinanciare, dhe institucionet jo bankare financiare Nr. 04/L- 093 i cili rregullon ushtrimin e aktiviteteve financiare jo bankare.

- Ju lutem ofroni informacione për sistemin e kapitalizuar pensional. Cilat janë sfidat kryesore për zhvillimin e tij. Cilët janë hapat e planifikuar?

Sistemi pensional i Kosovës është i organizuar në tre shtylla:

- a. Shtylla e parë – pensioni bazë;
- b. Shtylla e dytë – pensionet individuale që janë të siguruar nga Fondi i kursimeve pensionale të Kosovës;
- c. Shtylla e tretë – fondet vullnetare plotësuese.

Nuk nevojitet kapital fillestar për licencimin e fondit pensional. Pjesa më e madhe e Fondit për kursime pensionale të Kosovës është i investuar jashtë vendit; një pjesë e vogël gjendet në sistemet vendore bankare. Me hapjen e tregjeve të letrave me vlerë dhe hyrjes në fuqi të ligjit për fondet pensionale të Kosovës Nr. 04/L-101, ka krijuar mundësin e investimit të 30% të këtyre fondeve në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës. Sfidat kryesore janë; përfshirja e të gjithë punëtorëve në skemën pensionale dhe orientimin strategjik për liberalizimin e shtyllës së dytë. Hapat e planifikuar përfshirë edhe standardizimin e legjislaturës (përafrimi i legjislaturës me direktivat e EU-së dhe standardet ndërkombëtare), rrisin konkurrencën në shtyllën III, dhe liberalizimin e shtyllës II.

3. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA MSA-JA

3.1. Dialogu politik

Ju lutem përshkruani shtrirjen e marrëdhënieve dhe politikave të jashtme të Kosovës me politiken e BE-së.

Kosova është partner besnik i BE-së në një sërë çështjesh ndërkombëtare dhe rajonale të cilat fillojnë nga kontributi në dialog rajonal dhe në procese të zgjerimit deri te kontributi i dhënë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në botë duke ofruar ndihmë në kuadër të mjeteve buxhetore të Republikës së Kosovës.

Kosova kontribuon në paqen dhe stabilitetin rajonal duke u angazhuar seriozisht dhe në mënyrë të plotë në bashkëpunimin rajonal. Qeveria e Kosovës ka qenë e angazhuar aktivisht në dialogun teknik me Serbinë që ishte nisur në bazë të një rezolute të sponsorizuar nga BE-ja në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së në shtator të vitit 2010. Republika e Kosovës ka emëruar një negociator të nivel të lartë (Zëvendës Kryeministër) për të udhëhequr dialogun dhe ka marrë vendime në koordinim të plotë me Shërbimin e Veprimit të Jashtëm të BE-së. Qeveria e Kosovës gjithashtu ka mbështetur marrëveshjet me vendime të duhura në nivelin lokal për të zbatuar marrëveshjet. Duke ndjekur marrëveshjen e arritur në Bruksel në mes Kosovës dhe Serbisë në përfaqësimin rajonal të Kosovës, Qeveria e Kosovës ka aplikuar në 27 organizata rajonale dhe iniciativa, dhe është pjesëmarrëse aktive në 9 prej tyre në formate të ndryshme, duke kontribuar kështu në përparimin e bashkëpunimit rajonal.

BE-ja është partner kyç i Kosovës në çështje ndërkombëtare duke filluar nga ngrohja globale deri tek ngjarjet që kanë pasuar në "Pranverën Arabe". Bazë për politikë të jashtme dhe të sigurisë në Kosovë mbetet përdorimi i diplomacisë dhe dialogut për të zgjedhur çështje rajonale që rrjedhin nga luftërat jugosllave, por edhe në kontekst më të gjerë global.

3.2. Bashkëpunimi rajonal

- Ju lutem përshkruani pjesëmarrjen e Kosovës në bashkëpunimin rajonal. Ju lutem cekni organizatat në të cilat Kosova është anëtare apo vëzhguese.

Kosova kontribuon në paqen dhe stabilitetin rajonal duke u angazhuar seriozisht dhe në bashkëpunimin të plotë rajonal, Kosova merr pjesë në nismat për bashkëpunim rajonal si dhe është anëtare e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal që nga viti 2008. Kosova kryen detyrën e saj ndaj Këshillit duke kontribuar me 4% në shumën totale të buxhetit të vendeve të Evropës Juglindore. Kosova merr pjesë rregullisht në takimet vjetore; Takimet e Bordit Koordinues Kombëtar dhe në takime tjera sektoriale të Këshillit. Për më tepër, Kosova merr pjesë në iniciativat e KBR-së: Iniciativa elektronike Juglindore dhe Iniciativa Kabllore e Evropës juglindore. Kosova gjithashtu merr pjesë në projektin e Komisionit Evropian për Qendrën për Zhvillimi të Qeverisjes dhe projektin për Monitorimin e Sektorit të Komunikimit dhe Shërbimeve të Shoqërisë Informative. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe rregullisht merr pjesë në mbledhjet e organizuara nga sekretariati i Komunitetit, siç janë: Këshilli ndërministror, Forumi Permanent i Nivelit të Lartë, Task Forca e EE-së, Task Forca për Mjedisin, Task Forca për Strategjinë Rajonale për Energji dhe forume tjera të organizuara nga sekretariati.

Megjithatë KOSTT-i vazhdimisht përballet me pengesa të imponuara nga Serbia në lidhje me anëtarësimin në organizata ndërkombëtare dhe pagesa për përdorimin e ndërlydhjeve për transmetim të energjisë. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i ka dorëzuar një letër të hapur Serbisë në lidhje me shkeljet e dispozitave të Traktatit, megjithatë deri tani situata mbetet e pandryshuar. Serbia është duke shkaktuar pengesa në anëtarësimin e Kosovës në Grupin Rajonal EJL-ë për çështje tregtare dhe në RRESOT-E, KOSTT-i megjithatë ka arritur të jetë anëtare e Rajonit 8, anëtare e CAO-IG (Zyra për Alokim të Resurseve) dhe anëtare në IBEJ (Iniciativa Bashkëpunuese e Evropës Juglindore) derisa ajo rezervon një rol të vëzhguesit në Grupin Rajonal të EJL-së për çështje tregtare.

Zyra e Rregullatorit për Energji është anëtare e Shoqatës Rajonale e Rregullatorit të Energjisë (SHRRE) që nga viti 2005, dhe ka përfaqësuesit e saj në Komisionin për licencim dhe konkurrencë, Komisionin për tarifa dhe në Grupin Punues Ligjor në SHRRE

Tabela 40. Lista e Organizatave Rajonale ku Kosova është anëtare/vëzhguese

Organizata Rajonale	Përfaqësues	Data e pranimit
Kompakti i Investimeve	Kosova	24.04.2012
Qendra Evropiane Juglindore për Mësime Sipërmarrëse	Kosova	23.03.2012
Gjendja e Zhvillimit Rajonal Rural Grupi Punues në EJL	Kosova	26.03.2012
Marrëveshja e Përbashkët Evropiane e Aviacionit	Kosova	23.03.2012
Rrjeti Regjional Ambiental për Anëtarësim	Kosova	19.03.2010
Iniciativa Elektronike e Evropës Juglindore + Iniciativa e kabllorit e Evropës Juglindore - Pozitiv	Kosova	20.04.2012
Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të EJL-së	Kosova	11.05.2012
Sekretariatit i Programi ISIS	Kosova	23.03.2012
Këshilli për Bashkëpunim Rajonal	UNMIK/Kosova	Shkurt 2008
CEFTA dhe Marrëveshjet Bilaterale të Tregtisë së Lirë	UNMIK/Kosova	Korrik 2007
Transporti Vëzhgues Juglindor Evropian (TVJLE)	UNMIK/Kosova	11.06.2004

Tabela 41. Lista e Organizatave Rajonale, ku anëtarësimi është në proces të rregullt

Organizata Rajonale	Përfaqësues	Data e pranimit
Iniciativa Rajonale Antikorrupsion	Kosova	Në proces
Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Jugore	Kosova	Në proces
Këshillimi i Prokurorëve i Evropës Juglindore	Kosova	Në proces
Migracioni Azil, Iniciativa Rajonale e Refugjatëve	Kosova	Në proces
Konventa e Bashkëpunimit Policor (PCCSESECR)	Kosova	Në proces
Task forca për Nxitjen dhe Ngritjen e kapitalit njerëzor	Kosova	Në proces
Iniciativa për gatishmërinë dhe Parandalimi e fatkeqësisë	Kosova	Në proces
Qendra e Punëtorëve të Regjionit të Adriatikut	Kosova	Në proces
Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë (RACVIAC)	Kosova	Në proces
Rrjeti i Shëndetësisë	Kosova	Në proces
Qendra për zhvillim e e-qeverisjeje	Kosova	Në proces

Shkolla Rajonale për Administratë Publike (SHRAP)	Kosova	Në proces
Grupi Visegrad	Kosova	Në proces
Forumi i Odave Ekonomike të Adriatikut dhe Jonit	Kosova	Në proces
Human Dynamics - Positive	Kosova	Në proces

- Ju lutem përshkruani marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me fqinjët e Kosovës, si ne aspektin e marrëveshjeve që ekzistojnë ashtu edhe në bashkëpunim praktik.

Një nga prioritetet e politikës së jashtme të Kosovës është bashkëpunimi rajonal dhe krijimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore duke krijuar marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe. Objektivi strategjik i Kosovës është duke promovuar Kosovën si një faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon. Kosova synon të integrohet plotësisht në iniciativat rajonale, si anëtare me të drejta të plota dhe përgjegjësi të kontribuojnë në nxitjen e marrëdhënieve të mira, të paqes dhe stabilitetit. Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore në bazë të respektimit të barazisë dhe reciprocitetit janë me interes vital për Kosovën në stabilizimin e Evropës Juglindore dhe në zgjidhjen e çështjeve të hapura të mbetura pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Sa i përket bashkëpunimit me Serbinë ju lutem referojuni pyetjes 3.1 për Dialogun politik.

Marrëveshjet e mëposhtme me vendet fqinje janë nënshkruar:

Marrëveshjet me Shqipërinë:

- a. Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e përfaqësisë konsullore, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 13 janar 2012;
- b. Protokoll bashkëpunimi në mes Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 25 nëntor 2009;
- c. Marrëveshja për bashkëpunimin policor-kufitar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 6 tetor 2009;
- d. Marrëveshja për bashkëpunim në arsim dhe shkencë, arritur midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 6 tetor 2010;
- e. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellët në çështjet doganore, nënshkruar më 6 tetor 2010;
- f. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për ri-pranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim, të nënshkruar më 6 tetor 2009;
- g. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin ndërkufitar, të nënshkruar më 6 tetor 2009;
- h. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për lëvizjen e ndërsjellët të shtetasve, të nënshkruar më 6 tetor 2009;
- i. Marrëveshja për kryerjen e procedurave të përbashkëta për të kontrolluar hyrjen/daljen në mes të kalimit kufitar Qafë Prush (Gjakova) - Qafë Prush (Has, Shqipëri);
- j. Marrëveshja për kryerjen e procedurave të përbashkëta për të kontrolluar hyrjen/daljen në mes të kalimit kufitar Qafë Morinë- (Gjakovë) - Qafë Morinë (Tropojë, Shqipëri);
- k. Marrëveshja për kryerjen e procedurave të përbashkëta për të kontrolluar hyrjen/daljen në mes të vendkalimit kufitar Vërmicë (Prizren) - Morinë (Kukës, Shqipëri);

l. Marrëveshja për bashkëpunim në fushat e transportit rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Marrëveshjet me Malin e Zi:

- a. Marrëveshja për bashkëpunim dhe Ndihmën e Ndërsjellët në Çështjet doganore ka arritur në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi, të nënshkruar në Mal të Zi më 17 mars 2010;
- b. Marrëveshja mbi ri-pranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim, dhe Protokollin përkatës ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi, të nënshkruar në Mal të Zi më 30 qershor 2011;
- c. Marrëveshja për regjistrim të vonuar të personave të zhvendosur që jetojnë në Mal të Zi në Regjistrat Themeltar dhe në Regjistrat e shtetasve të Republikës së Kosovës, nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi, më 30 qershor 2011.

Marrëveshjet me Maqedoninë:

- a. Marrëveshja për demarkacion fizik të kufirit në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, marrëveshja u miratua më 17 tetor 2009;
- b. Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim policor, të nënshkruar më 3 tetor 2009 dhe miratuar më 21 janar 2010;
- c. Marrëveshja për Bashkëpunim Ekonomik në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Maqedonisë në Shkup më 16 dhjetor 2009;
- d. Marrëveshja për Shëndetësi dhe Mjekësi në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Maqedonisë, nënshkruar më 16 dhjetor 2009;
- e. Protokollin për Bashkëpunim midis Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë;
- f. Marrëveshja për të shmangur tatimin e dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, të nënshkruar më 6 Prill 2011;
- g. Marrëveshja për ndihmë të ndërsjellët juridike për çështje penale, mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, e nënshkruar më 8 prill 2011 në Prishtinë;
- h. Marrëveshja për transferim të personave të dënuar, mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e nënshkruar më 8 prill 2011 në Prishtinë;
- i. Marrëveshja për ekstradim, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e nënshkruar më 8 prill 2011 në Prishtinë;
- j. Marrëveshja për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellët në dogana dhe çështje, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë;
kurse eksportet në produkte minerale janë rritur për 38.6% më 2011, krahasuar me vitin 2006. Megjithatë, viti 2008 ka shënuar një ndryshim të rëndësishëm në lidhje me destinacionin e këtyre eksporteve. Gjithashtu është shënuar një rritje në kategorinë e pajisjeve, makineri dhe pajisje elektrike, të cilat përmbajnë kategorinë e tretë të mallrave më të rëndësishëm në Kosovë, ndërsa ekziston ende një numër i mallrave tjera që përmbajnë një shumë të rëndësishme të importeve, edhe pse jo aq me rëndësi sa eksporti me metale bazë që përbëjnë përqindjen më të madhe të eksporteve. Një situatë e ngjashme sikur me produkte minerale është edhe me kategorinë e makinerisë dhe pajisjeve, e cila është rritur për 18.7% gjatë vitit 2011, krahasuar me vitin 2006.

Tabela 49. Bilanci tregtar i mallrave industriale gjatë viteve 2010 - 2011 (në milion Euro)

Afati kohor	2010	2011
Importet	269.4	286.6
Eksportet	1668.5	1919.2
Bilanci tregtar	-1399.1	1632.6

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Një rigjenerim i ekonomisë botërore në vitin 2010 ka nxjerr një kërkesë në rritje për tregti të jashtme në metale bazë. Si rezultat, rritja e çmimeve të tregut për metale bazë gjatë të njëjtit vit ka pasur një ndikim pozitiv në nivelin e prodhimit, e shoqëruar nga rritja e nivelit të shitjes. Duke pasur parasysh se 90% e metaleve të eksportit nga Kosova përmbahen prej nikelit, janë rritur eksportet për 77.8% duke arritur një vlerë prej €294.0 milion gjatë vitit 2010. Rritja e kërkesave të jashtme në çmime e industrisë së metalit në tregje ndërkombëtare kanë pasur një ndikim pozitiv në krijimin e një rritjeje të rëndësishme të eksporteve të metaleve bazë, e cila arriti vlerën prej €185.2 milion më 2010 (€88.4 milion në dhjetor 2009), duke kontribuar me 58.6% në rritjen e përgjithshme të eksporteve të Kosovës. Rritja e përgjithshme e eksportit gjatë vitit 2010 u shkaktua nga një rritje prej 55.3% e eksporteve të produkteve minerale, e cila përbën 13.2.% të eksportit të përgjithshëm.

Eksportet e makinerive dhe pajisjeve (kryesisht me përmbajtje të eksporteve të elektricitetit) përbëjnë 3.6% të eksporteve totale.

Tregtia në produkte bujqësore dhe të peshkimit: Para viteve 90-ta, agrikultura në Kosovë ka qenë e dominuar nga ndërmarrjet të pronësive shoqërore, të cilat kanë importuar një pjesë të konsiderueshme të materialeve të papërpunuara. Këto ndërmarrje shoqërore nuk janë më aktive dhe në vend tyre kanë filluar të operojnë ndërmarrje të reja private. Sidoqoftë, numri i fermerëve është ende relativisht i vogël, ndërsa janë të aftë për të siguruar vetëm një pjesë të vogël të kërkesës për ushqime të përpunuara. Si pasojë, kërkesa për produkte të përpunuara dhe të papërpunuara të agrikulturës mbulohet vetëm nga importet.

Tabela 50. Eksporti i produkteve të agrikulturës gjatë viteve 2010-2011 (në milion Euro)

Afati kohor	2010	2011
Kafshë të gjalla dhe produkte shtazore	0.9	0.4
Produkte perimore	12.1	12.6
Kafshë ose perime, dhe vaje ushqimore	0.1	0.1
Ushqime të përpunuara, pije dhe duhan	11.4	12.8

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Kjo sasi e e importeve të produkteve të agrikulturës në Kosovë e tejkalon atë të eksporteve, e cila rezulton në deficit të tregut. Një rritje të importit të produkteve të agrikulturës ka qenë gjatë viteve 2010-2011. Eksporti i produkteve të agrikulturës gjatë viteve 2009-2010 është zvogëluar, ndërsa një

rritje e lehtë në eksport të këtyre mallrave mund të vërehet gjatë vitit 2011. Produktet perimore përbëjnë sasinë më të madhe të eksporteve në produkte të agrikulturës (një vlerë prej €13.9 milion), ndjekur nga ushqime të përpunuara, pije dhe duhan (€14.3 milion). Këto produkte janë eksportuar kryesisht në Shqipëri, Maqedoni, Serbi dhe Gjermani.

Tabela 51. Importe në produkte të agrikulturës gjatë viteve 2010 – 2011 (në milion Euro)

Afati kohor	2010	2011
Kafshë të gjalla dhe produkte shtazore	87	97.4
Produkte perimore	108.5	136.8
Kafshë ose perime, dhe vaje ushqimore	19.3	22
Ushqime të përpunuara, pije dhe duhan	261.7	303.9

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Sa i përket importeve të produkteve të agrikulturës, Kosova kryesisht importon ushqime të përpunuara, pije dhe duhan, të ndjekur nga kafshë të gjalla dhe produkte shtazore.

- Cilat janë marrëveshjet e tregtisë së tanishme të Kosovës (regjimet autonome si dhe marrëveshje tregtare: dypalëshe / rajonale)?

Kosova aktualisht udhëheq tregun e vet brenda një kornize prej 3 kategorive të marrëveshjeve tregtare:

- a. Masa të tregtisë autonome të BE-së (MTA),
- b. Zona e Tregtisë së Lirë e zgjeruar Qendrore Evropiane (CEFTA) si një kornizë shumëpalëshe,
- c. Marrëveshje dypalëshe.

Kosova përfiton nga Masa e preferuar e tregtisë autonome të BE-së (MTA) që nga viti 2000, e cila skadon me 31 dhjetor 2010. Pas një vonese prej gati një vit, këto masa janë votuar nga parlamenti evropian në tetor 2011 dhe nga këshilli evropian më 24 nëntor 2011, të cilat përmirësojnë marrëdhëniet tregtare të Kosovës dhe BE-së. Si pasojë, Kosova përfiton në mënyrë retro-aktive nga kjo marrëveshje preferuese me BE-në si i 1 janarit 2012. Rregullorja e re e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për ndryshimin e Rregullores së Këshillit, e miratuar nga Këshilli i BE-së me 25 nëntor 2011, kanë rikthyer të drejtën për qasje të pakufizuar në tregun e BE-së për të gjitha produktet me origjinë nga Kosova deri në fund të vitit 2015. Gjithashtu ka ndikim retro-aktiv, që do të thotë se eksportuesit e Kosovës, të cilët kanë paguar obligimet doganore në vendet e BE-së në mes 1 janarit 2011, ndërsa nga data kur kjo rregullore do të hyrë në fuqi do të rimbursohen. Pasi që BE-ja është partneri tregtar më i madh i Kosovës, rivendosja e masave tregtare autonome do të nxis tregun dhe do të rrit eksportin e Kosovës në BE-në.

Për më tepër, Konkluzioni Përfundimtar i BE-së me 6 dhjetor 2011, përveç që ia ka dhënë dritën e gjelbër udhërrëfyesin për dhënien e liberalizimit të vizave, në mënyrë të qartë BE-ja shpreh njohjen e progresit, i cili ka arritur përmes përmirësimit të politikave tregtare dhe marrëdhënieve me Kosovën, duke theksuar faktin se Kosova ka arrit progres të rëndësishëm në nisjen e negociatave të lira tregtare.

Kosova është anëtare e CEFTA-së që nga themelimi i tij më 2007. Më parë ajo ka nënshkruar katër (4) marrëveshje e lira tregtare me vendet fqinje, të cilat tani pjesë e CEFTA-së. Pas nënshkrimit të marrëveshjes CEFTA, këto marrëveshje dypalëshe janë bërë pjesë e marrëveshjes CEFTA. Kështu që, aktualisht nuk ekziston ndonjë marrëveshje dypalëshe. Gjatë vitit 2011 Kosova ka kryesuar CEFTA-në dhe ka marrë të gjitha obligimet të dala nga programi punues vjetor.

Së fundmi, Kosova gjithashtu ka përfituar nga Sistemi i përgjithësuar i preferencave (SPP) me BE-në, Norvegjinë dhe Zvicrën, i cili ofron eksport të lirë në këto vende të një numër të konsiderueshëm të produkteve të Kosovës. Kjo lloj marrëveshje me Japoninë gjithashtu është në përfundim dhe pritet që të miratohet së shpejti.

Marrëveshja e ardhshme e tregtisë së lirë e Kosovës me BE-në: Përveç marrëveshje të tanishme të tregtisë të përmbledhura më lartë, papasur progres të rëndësishëm drejt një marrëveshje të tregtisë së lirë mes Kosovës dhe BE-së qysh në fillim të këtij procesi të vitin 2010. Si hap i parë, KE-ja i ka dërguar Qeverisë së Kosovës një pyetësor, me qëllim që të shqyrtohet situata aktuale e disa institucioneve që janë të lidhura me çështjet tregtare (duke përfshirë MTI-në dhe organet e saj, doganat e Kosovës, agjencitë e prokurorisë, Agjencia Statistikore e Kosovës etj.). Si vazhdim i pyetësorit, KE-ja ka dërguar një mision fakt-gjetës në korrik të viti 2010. Ky mision vlerësoi gatishmërinë e Kosovës për të negociuar dhe për të zbatuar marrëveshjen tregtare dhe masat identifikuese që Kosova duhet të marrë përsipër me qëllim të përparësisë së vazhdueshme drejt kësaj marrëveshje. Kosova ka bërë progres të rëndësishëm në drejtim të fillimit të këtyre negociatave për këtë marrëveshje. Në Raportin e Progresit të viti 2011 për Kosovën, BE-ja në mënyrë të qartë pranoi përmirësimin e pozitës së Kosovës në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, duke përfshirë cilësisë e infrastrukturës, të drejtat e pronësisë industriale dhe politikën tregtare. Një dokument për monitorimin e kriterëve të MTL-së është hartuar në fund të vitit 2011, siç kërkohej nga komisionari De Gucht, që synonte shqyrtimin e gjendjes aktuale të disa institucioneve të përfshira në çështjet tregtare.

3.4. Lëvizja e njerëzve, shërbimet dhe e drejta e themelimit

3.4.1. Lëvizja e Njerëzve

A ka nënshkruar Kosova ndonjë marrëveshje bilaterale për rregullimin e të drejtave për lëvizjen e lirë të personave?

Kosova nuk ka nënshkruar ende ndonjë marrëveshje sa i përket lëvizjes së lirë të njerëzve.

- Sa leje pune për të huajt ka lëshuar Kosova gjatë 5 viteve të fundit?

Pajisja me leje pune e të huajve të cilët gjenden në marrëdhënie pune në territorin e Kosovës ka filluar në mars 2010, pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 03/L-136 mbi Dhënien e Lejes së Punës dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës. Deri më tani janë lëshuar 3,290 leje të tilla.

Tabela 52. Numri i lejeve të punës të lëshuara për shtetasit e huaj në territorin e Kosovës gjatë viteve 2010-2011

Kohëzgjatja	2007	2008	2009	2010	2011	Total
Numri i lejeve të punës	0	0	0	1,339	1,951	3,290

Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- A ekzistojnë dispozita për të parandaluar diskriminimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë në bazë të shtetësisë së shtetasve të BE-së që punojnë në Kosovë për sa i përket kushteve të punës, shpërblimit apo shkarkimit nga puna?

Në Kosovë, aplikohet ligji me nr. 03/L-136 për dhënien e lejes së punës dhe punësimin të shtetasve të huaj. Qytetarët e BE-së posedojnë të drejtat e barabartë me të punësuarit vendore sa i përket punësimin, kushtet e punës, pagesat dhe të drejtat tjera të punësimin. Në Kosovë zbatohet ligji kundër diskriminimit (nr. 2004/3) që aplikohet për të gjithë punonjësit.

Qëllimi i ligjit nr. 2004/3 kundër diskriminimit është të parandaloj dhe luftoj diskriminimin, promovimin e barazisë efektive dhe realizimin e parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve. Çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin janë të rregulluara në bazë të parimeve:

- a. Parimi për trajtim të barabartë do të thotë se nuk do të ketë diskriminim direkt apo indirekt, kundër një personi në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, paaftësisë fizike apo

mendore, orientimit seksual, kombësisë, mendimit politik ose besimit, fesë, grupit etnik ose prejardhjes shoqërore, pasurisë, lindjes ose statuseve tjera;

- b. Parimi për përfaqësim të drejtë për të gjithë personat dhe të gjithë anëtarët e komuniteteve, në punësim brenda institucioneve publike në të gjitha nivelet.
- c. Gjithashtu Ligji i Punës nr. 03/L-212 Neni 5 ndalon të gjitha format e diskriminimit;
- d. Gjithashtu, ligji nr. 2004/3 kundër diskriminimit, paraqet dispozitat do të aplikohen ku bëhet fjalë për punësimin lidhur me punonjësit dhe punëdhënësit.

Gjithashtu, ligji nr. 03/L-136 për lëshimin e lejeve të punës për shtetasit e huaj rregullon kushtet dhe procedurat për dhënien e lejes të punës për shtetasit e huaj në Kosovë, sipas kushteve të përcaktuara me ligj, Konventat ndërkombëtare të punës dhe Marrëveshjet Bilaterale

3.4.2. Lëvizja e Shërbimeve

-Si kanë përparuar negociatat dhe konkluzionet e autoriteteve të Kosovës me vendet e rajonit në marrëveshjet dypalëshe për koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore?

Në bazë të konventave ndërkombëtare për sigurimet shoqërore, Republika e Kosovës ka trashëguar marrëveshje dypalëshe të nënshkruara nga ish RSFJ-së me Shtetet Anëtare të BE's dhe shtetet tjera evropiane (Gjermania, Austria, Zvicra, Franca, Italia, Belgjika, Holanda, Norvegjia, Danimarka, Polonia, Sllovakia, Republika Çeke, Bullgaria, Britania e Madhe, Rumania, Hungaria dhe Luksemburgu). Këto marrëveshje janë duke u implementuar në disa fusha (dalja në pension, pensionet e familjes dhe pjesërisht pensionet për persona me aftësi të kufizuara). Republika e Kosovës synon të negociojë me shumicën e këtyre vendeve, veçanërisht Zvicren, Austrinë dhe Gjermaninë, për ripërtëritjen e këtyre marrëveshjeve të sigurimeve shoqërore, si dhe për nënshkrimin e marrëveshjeve të reja me shtetet që kanë dalë nga ish RSFJ-së.

Më 1 Prill 2010, Këshilli Federal Zviceranë ka vendosur në mënyrë të njëanshme të përfundoj marrëveshjen me ish RSFJ-së. Marrëveshja për sigurimet shoqërore me Austrinë është duke u zbatuar pjesërisht. Më 23 - 26 Maj 2011, bisedimet midis zyrtarëve të Republikës së Austrisë dhe Republikës së Kosovës në fushën e sigurimeve shoqërore janë mbajtur në Vjenë, të cilat vazhduan edhe me 27 Shkurt - 2 Mars 2012, kjo rezultoi në një marrëveshje dypalëshe sa i përket fushës së sigurimeve shoqërore (me finalizimin e projekt-marrëveshjes), e cila fokusohet në fushën e daljes në pension dhe personave me aftësi të kufizuara. Marrëveshja për sigurimet shoqërore me Gjermaninë është duke u zbatuar siç duhet në disa fusha (dalja në pension, pensionet për familje dhe kujdesi ndaj personave me aftësi të kufizuara). Më 17 Tetor 2011, është nënshkruar Protokollin për Bashkëpunim midis Kosovës dhe Gjermanisë në fushën e sigurimit shoqëror sa i përket daljes në pension dhe personave me aftësi të kufizuara. Për më tepër, u zhvilluan disa takime ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Sigurimeve Shoqërore të Maqedonisë. Në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2011, palët shkëmbyen informacione në lidhje me rregullimin e sistemit pensional dhe invalidor, gjithashtu u diskutua edhe për çështjet dhe problemet që mund të lindin në realizimin e të drejtës së sigurimit pensional dhe invalidor për qytetarët e të dy vendeve të cilat plotësojnë kriteret për sigurim pensional në shtetet përkatëse.

-A do të funksionalizohet plotësisht Organi Koordinues për harmonizimin e legjislacionit?

Trupi koordinues për harmonizimin legjislacionit në fushën e shërbimeve është krijuar në shtator të vitit 2010. Ky trup koordinues deri më tani është takuar dy herë, dhe si rezultat i kësaj, në qershor të vitit 2011 ka hyrë në funksion një bazë e të dhënave. Kjo bazë e të dhënave do shqyrtojë dhe shikojë të gjitha ndryshimet legale që bëhen në fushën e shërbimeve.

- A janë zhvilluar marrëveshjet e njohjes reciproke (MNR) në harmonizim me standardet e BE-së?

Republika e Kosovës ende nuk ka arritur ndonjë marrëveshje reciproke të njohjes formale me vendet e tjera në lidhje me kualifikimet e arsimit. E vetmja marrëveshje në këtë fushë e arritur deri më tani ishte ajo me Serbinë në kuadër të dialogut teknik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Zbatimi i kësaj marrëveshje ka filluar në shkurt të vitit 2012. Sipas kësaj marrëveshjeje Shoqata Evropiane e Universiteteve (SHEU) është organi i vetëm i cili do të vërtetojë diplomat universitare nga të dyja palët, në mënyrë që procesi të kryhet në përputhje me procesin e integritimit evropian, e në veçanti në përputhje me Sistemin e Bolonjës dhe Njohjes së Konventës të Lisbonës. SHEU do të kryejë këtë proces në bashkëpunim me SPARK, një Organizatë Holandeze, e cila është aktive në Kosovë që nga viti 2000. Të paktën dy herë në vit SHEU do të mbledhet në një komitet për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë.

Megjithatë, në vend ekzistojnë Udhëzime Administrative (UA) me nr. 8/2012 mbi "*Parimet dhe procedurat për njohjen e diplomave të shkollave të larta profesionale dhe diplomave universitare të fituara jashtë vendit*", i cili rregullon parimet dhe përgjegjësitë që do të aplikohen në procedurën për njohjen dhe vlerësimin e diplomave të shkollave të larta profesionale dhe diplomave universitare të fituara në institucionet e akredituara të arsimit të lartë në vendet e tjera. Përveç kësaj, shkollat e larta profesionale dhe ato që nuk i përkasin nivelit universitar (nën nivelin Bachelor), do të shqyrtohen në bazë të këtij UA, duke iu referuar Standardeve Ndërkombëtare për Klasifikimin e Arsimit (SNKA) dhe EQF. Neni 3 i këtij UA përcakton parimet kryesore për vlerësimin dhe njohjen e këtyre kualifikimeve. Me përjashtim të Serbisë, bashkëpunimi si në lidhje me njohjen reciproke të kualifikimeve të arsimit me BE-në dhe vendet e tjera është shumë i mirë, edhe pse nuk eksiton ndonjë marrëveshje formale e nënshkruar.

Sipas Udhëzimit Administrativ, Ministria e Arsimit Shkencor dhe Teknologjisë ka krijuar Këshillin Kombëtar për Njohje e cila vendos mbi kërkesat për njohje në bazë të mendimit të Komisionit të Ekspertëve, përkatësisht Qendrës Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik Nacional (QKNIA), e cila vepron në përputhje me praktikat evropiane për njohjen e diplomave e bazuar në Konventën e Lisbonës për Njohjen e Arsimit të Lartë në Zonat Evropiane.

- A i nënshtrohet ushtrimi ose qasja në një veprimtari shërbimesh ndonjë licencimi ose autorizimi?

Ushtrimi i aktivitetit në shërbime (bankat, letrat me vlerë, fondet e investimeve, sigurimet, pensionet, shërbimet financiare me pakicë për konsumatorë individualë dhe shërbimet e pagesave) është i kushtëzuar vetëm me posedimin e licencës. Për aktivitetet bankare dhe disa nga aktivitetet të cilat mund të kryhen nga Institucionet Mikrofinanciare (IMF) dhe Institucionet Financiare Jo-Banka (IFJB) kërkohet Licenca për Banka apo regjistrimi për IMF/IFJB, të cilat lëshohen nga Banka Qendrore e Kosovës në bazë të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Jo-bankare, për aktivitetet e përshkruara në Nenet 44, 93 dhe 94 të këtij Ligji. Më tej, aktivitetet e fondeve pensionale dhe sigurimeve rregullohen me ligjet përkatëse (Ligjin nr. 04/L-101 mbi Fondin Pensional të Kosovës, Ligjin nr. 04/L-018 mbi për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit, e cila është në proces të zëvendësimit me një ligjin për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimit (i cili është në hartim e sipër). Të gjitha aktivitetet e lartpërmendura aktualisht rregullohen dhe mbikëqyren nga departamentet përkatëse të mbikëqyrjes financiare, si funksion i Bankës Qendrore të Kosovës. Sa u përket letrave me vlerë, në Kosovë aktualisht ka vetëm letra me vlerë afatshkurta (bono të thesarit), të cilat lëshohen nga Qeveria dhe rregullohen me rregulloret përkatëse për tregjet primare dhe sekondare dhe me Ligjin për Borxhet Publike.

- A ekziston ndonjë normë referente për kredi me normë interesi afatgjatë?

Normat referente për kredi nuk aplikohen në Kosovë. Një nga objektivat e BQK është përmirësimi i transparencës dhe inkurajimi i rritjes të aktiviteteve ndër-bankare. BQK'ja nuk mundë të prezantoj një normë referente sepse ende nuk e ka të pavarur politiken monetare, nga e cila kalkullohet norma referente.

- A ka filluar Kosova në nëntor 2011 lëshimin e letrave me vlerë për zhvillimin e tregjeve financiare?

Emetimi i Letrave me Vlerë të Qeverisë ka filluar, sipas planit të paraparë nga Qeveria e Kosovës, në janar 2012. Ankandi i parë i Letrave me Vlerë është mbajtur më 17 janar 2012.

- A është miratuar dhe zbatuar Ligji mbi Fondet Pensionale?

Po, Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës ka hyrë në fuqi më 31 mars 2012, dhe zbatohet në vazhdimësi.

- A është vënë në funksion Platforma Elektronike Tregtare për Funksionimin e Tregut të Hapur?

Platforma Elektronike Tregtare për Funksionimin e Tregut të Letrave me Vlerë është vënë në funksion prej janarit 2012.

- Cilat janë rregullat sa i përket sistemit të pagesave?

Rregullat në të cilat bazohet sistemi i pagesave në Kosovë janë:

- a. Rregulla dhe Procedura Operuese të Sistemit të Kliringut Ndër-bankar (2001);
- b. Rregullorja e UNMIK-ut për Transaksione të Pagesave (2001/26);
- c. Rregulla XIX e BQK-së për Sistemin Standard të Llogarive Bankare në Kosovë (iban);
- d. Rregulla XVIII e BQK-së për Kliring dhe Llogari të Shlyerjeve;
- e. Rregulla XVII e BQK-së, e përshtatur (mars 2012) në Rregullore mbi Minimumin e Rezervës së Detyruar;
- f. Rregulla XXXI e BQK-së për Skemën e Debitimit Direkt;
- g. Rregullorja për Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare; dhe
- h. Procedura dhe udhëzime të brendshme dhe të jashtme për operime të sistemit të kliringut dhe shlyerjeve dhe për mbikëqyrje të sistemit ndër-bankar.

Në kuadër të ngritjes dhe avancimeve të bazës ligjore për sistem të pagesave, të paraparë edhe me strategji të sistemit kombëtar të pagesave (*Shtylla 1. Baza Ligjore*), është finalizuar projektligji mbi sistemin e pagesave. Më tej, në proces të ndryshimeve dhe përshtatjeve janë një sërë rregulloresh dhe udhëzimesh për sistem të pagesave, si:

- a. Rregullorja dhe udhëzimi për pagesa ndërkombëtare;
- b. Rregullorja e minimumit të rezervës së detyrueshme për bankat ;
- c. Rregullorja e instrumenteve elektronike të pagesave;
- d. Rregullorja e mbikëqyrjes së sistemit të pagesave, debitimit direkt, kos giro-s;

Rregullorja e operimit të sistemit elektronik të kliringut ndër-bankar, etj.

- Ju lutemi paraqisni të dhënat kyçe mbi sektorin e shërbimeve financiare në Kosovë (p.sh. numri i të punësuarve, kontributi në PBB, numri i bankave, kompanitë e sigurimit, ndërmjetësuesit financiarë, qarkullimi [‘present’], hisja në treg [‘market share’], likuiditeti...)

Vlera e gjithëmbarshme e sektorit financiar në Kosovë në fund të vitit 2011 ka arritur në €3.5 miliardë euro (74.5% të PBB-së), gjë që paraqet një rritje vjetore prej 9.3%. Struktura e aseteve të sektorit financiar të Kosovës dominohet nga asetet e sistemit bankar (76.3%), pasuar nga asetet e sistemit pensional (17%), asetet e institucioneve mikrofinanciare (3.7%), asetet e kompanive të sigurimit (3%) dhe ato të ndihmësve financiarë (0.02%). Numri i të punësuarve në sistemin bankar në vitin 2011 ka qenë 3,728 punëtorë. Aktualisht në Kosovë operojnë 8 banka komerciale, 13

kompani të sigurimit dhe 57 ndërmjetësues financiarë (15 institucione mikrofinanciare, 5 institucione financiare jo-bankare (që merren me aktivitete të kredidhënies, 4 si zyra për transferim të parave, 30 zyra të këmbimit dhe 3 ndërmjetësues të sigurimeve).

- A ka pasur progres në implementimin e rregullave të kujdesshme për menaxhimin e rrezikut dhe të kapitalit në kuadër të 'Bazel II'?

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikro-financiare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare, janë hartuar rregulloret sekondare për menaxhimin e rrezikut të kapitalit dhe likuiditetit, të cilat përbëjnë komponentë të 'Bazel II' dhe 'Bazel III', të cilat pritet të finalizohen së shpejti.

- Ju lutem jepni informacione për sigurimin shoqëror dhe sistemin shëndetësor të Kosovës. A ekziston një sistemi i vetëm për sigurimin e bazuar në punës apo në vendbanime për sigurim social të cilat mbulojnë sigurimin e personave ndaj rreziqeve siç janë invaliditetet apo aksidentet në punë, dhe pensionet e të moshuarve?

Duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35, Rregulloren 2005/20 dhe Ligjin me nr. 2001/1 të Republikës së Kosovës, Pensioni Bazë (mosha e vjetër) është i paguar, për të gjithë personat që banojnë në Kosovë dhe kanë arritur moshën e pensionit, mosha 65 vjeçare. Ky pension ka karakter universal, dhe ka një normë të ulët të vlerës.

Duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK 2001/35, Rregulloren 2005/20 dhe Ligjin 03/L-084 të gjithë personat ekonomikisht aktive (punëtorë dhe të vetëpunësuar) janë të obliguar të marrin pjesë në Skema Individuale të Kursimeve Pensionale, e cila është një skemë kontribuuese në bashkëpunim me punëdhënësit dhe të punësuarit (ata që banojnë dhe punojnë në Kosovë) ku secili duhet të kontribuojë një minimum prej 5%(për qind) të pagave në një llogari individuale. Kjo shtyllë e pensioneve kohëve të fundit është rregulluar me Ligjin mbi fondin pensional në Kosovë i cili është miratuar nga Kuvendi në prill të vitit 2012.

Në bazë të Ligjit (Nr. 2003/23, për Fondin Pensional për persona me aftësi të kufizuara), e cila ju ofron përfitime njerëzve të cilët janë plotësisht dhe përherë me aftësi të kufizuara. Kjo skemë mbulon personat nga mosha 18 deri 65 vjeç.

- Ngjashëm, a ekziston ndonjë sistem publik i sigurimit shëndetësor, i cili mbulon punëtorët dhe/ose banorët për kujdes shëndetësor?

Republika e Kosovës ende nuk ka ndonjë sistem publik për sigurim shëndetësor. Shërbimet për shëndetësi janë të mbuluara nga buxheti ekzistues për të gjithë banorët. Ministria e Shëndetësisë ka hartuar Projektligjin për sigurim shëndetësor të harmonizuar me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar, i cili do të hyjë në fuqi pas zbatimit të suksesshëm të fazës së parë të reformës sistematike me zbatimin e Ligjit për Shëndetësi.

- A ka nënshkruar Kosova ndonjë marrëveshje bilaterale mbi sigurimin shoqëror me palët e treta?

Kosova ka trashëguar marrëveshjen bilaterale, e cila ishte e nënshkruar nga ish-RSFJ-së me vende të ndryshme Evropiane, si Gjermania, Austria, Zvicra, Franca, Italia, Belgjika, Holanda, Norvegjia, Danimarka, Polonia, Sllovakia, Republika Çeke, Bullgaria, Britania e Madhe, të Rumania, Luksemburgu, Hungaria.

Këto marrëveshje zbatohen në disa fusha (pensionet, pensionet familjare dhe pensionet e pjesshme për persona me aftësi të kufizuara), me përjashtim të marrëveshjes me shtetin e Zvicrës i cili është duke u zbatuar.

Kosova është duke negociuar me shtetin e Zvicrës, Austrisë dhe Gjermanisë, si dhe Maqedonisë për rinovimin e këtyre marrëveshjeve për sigurimet shoqërore, gjithashtu është duke bërë përpjekje për të nënshkruar marrëveshje të reja me Shtetet e rajonit dhe vendeve të BE-së

3.4.2.1. Kontrolli Financiar

- Sa auditorë të brendshëm janë në Kosovë?

Në bazë të Ligjit të Auditimit të Brendshëm me nr 03/L-128, Auditimi në Kosovë është i decentralizuar. Në sektorin publik, aktualisht janë 65 Njësi të Pavarura të Auditimit (NJPA) me nga 135 auditorë të brendshëm të cilët janë të trajnuar për të kryer auditime të brendshme.

- Si ka ecur/evoluar zbatimi në praktikë i kontrollit të brendshëm të financave publike?

Auditimi i Brendshëm në Kosovë ka filluar së funksionuari nga viti 2000 në kuadër të Autoritetit Qendror Fiskal (AQF), bazuar në Rregulloren nr. 1999/16 të datës 6 nëntor 1999. Me themelimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), sipas Rregullores nr. 2001/19, roli i auditorit të brendshëm është përfshirë në aneksin 11. Pastaj, çështja e auditimit të brendshëm është rregulluar me Nenin 8 të LMFP. Më 16 nëntor 2006 është miratuar Ligji nr. 02/L-74 për Auditim të Brendshëm (LAB). Më 26 shtator 2007 është miratuar Strategjia për Funkcionin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Republikën e Kosovës 2008 - 2012 (e hartuar në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë). Si kërkesë e kësaj strategjie dhe rekomandimeve të KE-së është edhe rishikimi i LAB-it. Ligji i nr. 03/L-128, i miratuar më 17 shtator 2009, kishte dy kërkesa kryesore:

- a. Krijimin e Njësisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), e cila është krijuar më 1 prill 2008 si strukturë e veçantë në kuadër të MF-së. Kjo njësi përgatit raport vjetor për funksionimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, i cili i dërgohet Ministrisë të Financave, e pastaj në Qeveri dhe Kuvend. Në vitin 2012 është dërguar dhe diskutuar raporti i katërt vjetor; dhe
- b. Decentralizimin e auditimit të brendshëm. Aktualisht funksionojnë 65 Njësi të pavarura të Auditimit të Brendshëm, me 135 auditorë të brendshëm.

Përveç LAB, MF ka nxjerrë edhe këto udhëzime administrative:

- a. UA nr. 22/2009 për Përcaktimin e Kritereve dhe Procedurën e Pajisjes me Licencë të Përkohshme të Auditorëve të Brendshëm të Sektorit Publik (dhjetor 2009);
- b. UA nr. 23/2009 për Themelimin dhe Funksionimin e Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik (dhjetor 2009); dhe
- c. UA nr. 11/2010 për Themelimin dhe Funksionimin e Komiteteve të Auditimit në Subjektet e Sektorit Publik (gusht 2010).

Gjatë periudhës 2010 - 2011 është zhvilluar Programi për Trajnim dhe Certifikim Ndërkombëtar (TIAPS), i financuar nga BE-ja, ku janë përfshirë 54 auditorë të brendshëm, dhe me sukses janë certifikuar 32 të tillë. Me qëllim të vazhdimin të programit për certifikim, gjatë viti 2011 janë trajnuar dhe certifikuar 12 trajnerë vendorë. Më 2004 është nxjerrë Doracak i parë për Auditim të Brendshëm, i cili është rishikuar më 2008 dhe së fundi më 2011.

Kontrolli i brendshëm i financave publike në Kosovë bazohet në dispozitat primare dhe sekondare ligjore. Menaxhimi i Kontrollit të Brendshëm fillimisht është i rregulluar me Udhëzimin Administrativ 1/1999, i cili ka përcaktuar kontrollin ex-ante të shpenzimeve. Ky udhëzim administrativ ka qenë nën autoritetin e AQF-së. Ndërsa LMFP ka filluar të zbatohet nga Institucionet e Përkohshme (IPVQ), të nënshkruar më 12 maj 2003 nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Ky ligj është miratuar në përputhje me Rregulloren e UNMIK nr. 2003/17. Ndërsa, në qershor të vitit 2008 ajo u amendamentua dhe u plotësua në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-221.

Për herë të parë në janar të vitit 2005, Qeveria e Kosovës miratoi Politikën mbi Auditimin e Brendshëm të Financave Publike (Vendimi 4/130). Ky dokument e krijoi bazën për themelimin e dy njësive, Njësia Qendrore e Harmonizimit / Njësia Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin e Financave dhe Kontrollin (NJQH/MFK, nën autoritetin e Thesarit), dhe Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NJQH/AB, nën autoritetin e Ministrisë të Financave). Me mbështetje teknike nga KE është përgatitur dhe miratuar, në korrik 2010, Rregulla Financiare 01 (për Menaxhim Financiar dhe Kontroll), e cila përbën bazën për përgatitjen e procedurave për menaxhim financiar dhe kontroll.

Në prill të vitit 2011, Dokumenti i Politikave për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike u rishikua dhe u miratuar nga Qeveria e Kosovës. Përveç këtij dokumenti, Manuali i Procedurave për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollim janë përgatitur dhe promovuar nga Ministria e Financave.

Në vitin 2012, NJQH / NJQHMFK kanë përgatitur për herë të parë një Raport vjetor për menaxhimin dhe kontrollin financiar, i cili është shqyrtuar nga Qeveria. Raporti është i bazuar në tabelën përmbledhëse për vetë-vlerësimin që është e plotësuar nga organizatat buxhetore.

Struktura menaxhuese e reformave të KBFP-së: Kosova ka zgjedhur që të ketë dy Njësi Qendrore e Harmonizimit (NJQH) të KBFP: e para për Menaxhimin Financiar dhe Sistemet e Kontrollit (MFK) dhe e dyta për Auditimin e Brendshëm (ABNJQH-ja për Auditim të Brendshëm i raporton drejtpërdrejt Ministrisë të Financave dhe i cili udhëhiqet nga një drejtor. Kjo i jep NJQH-së për AB autoritet të mjaftueshëm politikë dhe besueshmëri në punën e tij. Megjithatë, NJQH për MFK aktualisht gjendet nën një nga katër departamente brenda Thesarit dhe raporton tek Zëvendës Drejtori. Gjatë misionit buxhetor të DGJ-së në Kosovë në vitin 2011, DGJ-ja e Buxhetit sugjeroi se gjendja e tanishme e organizative si NJQH-ja për MFK-në nuk është optimale.

Përveç kësaj, DGJ-ja i buxhetit avokon për një strukturë më të përshtatshme sa i përket koordinimit dhe strukturave të ndryshme të menaxhimit, në nivel të lartë, për të mbuluar të gjitha reformat e menaxhimit financiar. Me një qasje të tillë, NJQH-ja mund të përfitojë vizibilitet më të lartë politik dhe legjitimitet e cilat do të jet më se e nevojshme për procesin e reformës. Mbi reflektimin e këtyre pikave Kosovës i është kërkuar një update. E njëjta vlen edhe për struktura organizative si NJQH / MFK.

Menaxhimi i reformave të KBFP: Në këtë rast NJQH-ja është menduar të udhëheq për reformën e KBFP-së. Gjatë misionit të DGJ-ve buxhetore për vitin 2011, DGJ -ja e Buxhet sugjeroi që NJQH për MFK duhet të luajë një rol më të fuqishëm dhe më aktiv sa i përket menaxhimit të reformave të KBFP dhe trajnimit e organizatave buxhetore. Ndërsa Kosovës i është kërkuar të komentoj mbi aspektet e mëposhtme të NJQH për performancën e MFK.

-A është NJQH për MFK përgjegjëse për mbarëvajtjen e progresit të e MFK sa i përket programit të implementimit? A ekziston ndonjë objektivë strategjike në këtë drejtim nga NJQH për MFK, si dhe ndonjë strategji dhe plan operues për ta zbatuar atë? Cilat janë elementet kyçe të metodës së menaxhimit të KBFP? Cila është natyra e këshillave dhe trajnimeve që NJQH për MFK ka ofruar dhe synon të ofroj gjatë 12 muajve të ardhshëm? Cila është sfida kryesore e NJQH për MFK për zbatimin e MFK në të gjithë sektorin publik?

NJQH / MFK është përgjegjës për ecurinë e implementimit të KMF. Në mënyrë që të arrihet kjo, duhet të aplikohen objektivat strategjike dhe operative. Pra, në planet strategjike, ne kemi:

- a. Identifikimi dhe shqyrtimi i nismave legislative (të tilla si ligjet dhe rregulloret për planifikim strategjik, buxhetim shumë vjetore, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe prokurimin publik,

- b. Koordinimi i projekteve me donatorë të ndryshëm,
- c. Monitorimi dhe raportimi mbi aktivitetet e zbatimit të KBFP
- d. Krijimi i grupeve punuese për krijimin e projektligjeve për procedurat e kontrollit të brendshëm të bazuara në njësitë pilote dhe gjithashtu trajnimet të mbështetur nga KE.
- e. Planet operative
- f. Koordinim sistematik i shkëmbimit të informacionit ndërmjet organizatave buxhetore në lidhje me angazhimin e tyre për zbatimin e MFK
- g. Formalizimi i të dhënave nga lista e modifikuara për vetë-vlerësim dhe caktimi i afateve në mënyrë që të përgatitet raporti vjetor i implementimit të QMF në Organizatat Buxhetore (OB),
- h. Krijimi i një rrjeti të zyrtarëve kryesorë financiarë për të identifikuar problemet e zbatimit të MFK-së dhe shkëmbimit të eksperiencave me organizatat tjera buxhetore.

Trajnimet: Deri më tani simpoziumet janë mbështetur nga një projekt i financuar nga BE-ja për Ministrat, Kryetarët dhe Sekretarët e Përgjithshëm. Këto simpoziume u mbajtën gjatë vitit 2011. Gjatë këtij viti dy pilot njësi ishin organizuar: Komuna e Fushë Kosovës dhe Departamentit i Thesarit. Në periudhën që vjen ne do të organizojmë një takim me Zyrtarë Kryesor Financiar të OB-të.

NjQH / MFK do të bëjë shpërndarjen e modifikuar për listat e vetë-vlerësimit për KMF, dhe do të organizoj takime me zyrtarët kryesorë financiarë mbi mënyrën e plotësimit të tyre, mënyrën e raportimit dhe fazat e paraqitjes.

Trajnimet për Zyrtarët Financiar dhe mirëmbajtësit e buxhetit nga secila organizatë buxhetore janë paraparë të mbështeten nga BE-ja. Numri i pjesëmarrësve dhe koha e trajnimeve do të varet prej projektit të mbështetur nga BE-ja.

- a. Ne kemi bërë rishpërndarjen e Dokumentit të Politikave KBFP.
- b. Organizimi i takimeve në qershor të vitit 2012 për zyrtarët kryesorë financiarë dhe për organizatat buxhetore;
- c. Promovimi i objektivave dhe roli i NjQH / MFK;
- d. Roli dhe përgjegjësia e zyrtarëve kryesorë financiarë për zbatimin e MFK;
- e. Mungesa e trajnimit për rrezikun e menaxhimit dhe modulet tjera të MFK

-Mbështetja vetëm në rregullat dhe rregulloret do të kufizojë miratimin e sistemit të Kontrollit Financiar të Menaxhmentit, të cilat në mënyrë që të korrë sukses varet vetëm nga menaxhimi i fuqizimit dhe llogaridhënies, në vend se të varet nga sistemi ligjor. Cilat janë përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar klimën për njohjen dhe pranimin e përgjegjësisë më të madhe menaxheriale brenda sektorit publik?

Në këtë rast ka aktivitete të ndërmarra për ngritjen e dijes në zbatimin e procedurave të delegimit dhe e përgjegjësisë dhe pranimin e përgjegjësive nga përformanca.

Kështu, NjQH / MFK i kanë bërë vizitë organizatës buxhetore (OB), komunave të rajonit të Prishtinës, në mënyrë që të jepen këshilla mbi rëndësinë e përfundimit të listës për vetë-vlerësim për MFK. Gjatë vitit 2012 të gjitha OB do të vizitohen për tu dhuruar ndihmë në implementimin e PIFC, që ka të bëjë me MFK. Gjatë vitit 2013 është paraparë që të ketë trajnime për CFO dhe bartësit buxhetore për procedurat e zbatimit të MFK.

- Çfarë përpjekjesh janë duke u zhvilluar për të bërë një ndarje në mes të vendimmarrjes administrative dhe kornizat e delegacionit?

Përshkrim më adekuat për vendet e punës dhe njoftimin e personelit për përgjegjësitë e tyre.

- Çfarë reforma të tjera të ngjashme janë duke vazhduar; p.sh. për përmirësimin e kapaciteteve për planifikimin e politikave, përmirësim i proceseve buxhetore dhe kontabilitetit?

Reformat në vazhdim e sipër janë:

- a. Reforma e administratës publike;
- b. Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- c. Rregullat për përcaktimin e notave dhe përshkrimet e pozicionit të punës
- d. Reforma e procesi të buxhetit;
- e. Buxheti i bazuar në performancën dhe hartimin shumë vjeçar të buxhetit dhe monitorimi i tyre gjatë implementimit.

Rishikimi i politikave të kontabilitetit:

Menaxhimi i pronës dhe zhvillimi i sistemeve të integruara të kontabilitetit:

Sfidat e identifikuar janë:

- a. Trajnimi i stafit;
- b. Mungesa e fondeve buxhetore;
- c. Ndryshimet e stafit të trajnuar.

Zbatimi i PIFC nga Përdoruesit e Buxhetit: Të gjithë përdoruesit e buxhetit janë të detyruar të zbatojnë legjislacionin e PIFC. Kosovës i është kërkuar të komentojë mbi aspektet e mëposhtme të zbatimit të PIFC-së në organizatat buxhetore.

- A kanë përdoruesit e buxhetit të PIFC-së plane të implementimit? Çfarë përmbajnë këto plane? A është NJQH e përfshirë në trajnimin e zhvillimit të këtyre planeve? A kanë përdoruesit e buxhetit të PIFC-së plane të implementimit? Çfarë përmbajnë këto plane? A është NJQH e përfshirë në trajnimin e zhvillimit të këtyre planeve?

Të gjitha CAO dhe CFO i kanë në dispozicion manualet dhe Dokumentet e Politikave të PIFC-së dhe MFK, ku në bazë të këtyre dokumenteve ata duhet të përgatisin planet e zhvillimit të PIFC-së. NJQH / MFK nuk është e përfshirë në zhvillimin e këtyre planeve. Plani i saj është ti bëjë ato nëpërmjet trajnimeve që do të mbahen në sesione trajnuese të ardhshme të mbështetura nga KE. Planet e zbatimit përbëhen nga:

- a. Shpenzimet e Kornizave Afatmesme;
- b. Planifikimi i buxhetit;
- c. Orari i angazhimeve dhe rrjedhja e parasë;
- d. Plani vjetor i punës;
- e. Plani për projektet kapitale;

Raporte financiare periodike dhe ato vjetore.

-Cilat janë elementët e tjerë kyç të këtyre planeve (me referencë të veçantë për rolin e Njësive Financiare)?

- a. Koordinimi i objektivave dhe aktiviteteve me njësit tjera të menaxhimit të organizatave buxhetore;
- b. Bashkëpunimi me mbajtësit e buxhetit për përgatitjen e Buxhetit tre-vjeçar duke përcaktuar prioritetet në përputhje me objektivat e vendosur nga ana e organizatës buxhetore;
- c. Shkëmbimi i informacionit mbi performancën e arritur për objektivat dhe prioritetet e përcaktuara gjatë procesit buxhetor;
- d. Harmonizimi i vendimmarrjes në përputhje me buxhetin e miratuar;

- Si është duke u monitoruar progresi i implementimit (duke përfshirë efikasitetin praktik të masave të ndërmarra)? A është NJQH duke përgatitur raportin vjetor mbi progresin e Qeverisë sa i përket zbatimit të MFK? Cili ka qenë reagimi i Qeverisë?

Raporti Vjetor për MFK është përgatitur në bazë të modifikimit të listave të vetë-vlerësimit të marra nga organizatat buxhetore. Raporti u shqyrtua nga qeveria dhe pritet të shqyrtohet edhe në Kuvend.

-Auditimi i Brendshëm Kosova ka një numër të konsiderueshëm të personave prej 1-2 Njësive të Auditimit të brendshëm. Njësi të tilla të vogla nuk janë konsideruar ti përkasin praktikave të mira. Çfarë rëndësie i ka dhënë Kosova krijimit të një modeli gjysmë të decentralizuar të Auditimit të Brendshëm, ku këto organizata të vogla buxhetore janë shërbyer nga një grup i pavarur i auditorëve të brendshëm?

Në mënyrë që të krijojë një sistem efektiv të auditimit të brendshëm kemi lëshuar udhëzimin administrativ, ku kriteret për krijimin e njësive të auditimit të brendshëm janë përcaktuar. Për çdo vit numri i auditorëve është duke u rritur në njësitë e auditimit të brendshëm dhe në këtë mënyrë kriteret e udhëzimit administrativ janë duke u plotësuar. Por, për shkak të kufizimeve buxhetore në numrin e punëtorëve, ky proces është duke shkuar më ngadalë krahas nevojave të organizatave buxhetore për auditor.

Për zbatimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm të organizatave buxhetore të vogla në nivelin qendror, për shkak të kosto / përfitim, është diskutuar edhe me Kuvendin e Kosovës për të rritur numrin e auditorëve të brendshëm në njësinë e auditimit të brendshëm në Kuvend, ku kjo njësi për auditimin është edhe të organizatat të vogla buxhetore të cilat raportojnë drejtpërdrejt në Kuvend.

Për shkak të specifikave në nivelin lokal në disa komuna ne jemi duke shqyrtuar mundësinë se si të krijohet një njësi e përbashkët e kontrollit të brendshëm i cila do ti mbulojë këto organizatat buxhetore me auditim.

Projektet e mëparshme për asistencë teknike kanë ndihmuar me trajnimin dhe certifikimin e auditorëve të brendshëm. A ka Kosova ndonjë plan për zhvillimin e një programi trajnues të qëndrueshëm për trajnerët e ardhëm të Auditimit dhe trajnim të vazhdueshëm profesional për auditorët e certifikuar?

Ne kemi një plan për të vazhduar programin për certifikimin dhe edukimin e vazhdueshëm profesional. Në gjysmën e dytë të këtij viti, ne planifikojmë të fillojmë me trajnimin e grupit të dytë të auditorëve të brendshëm në Programin e Trajnimit dhe Certifikimit. Trajnimi do të mbahet nga trajnerët lokal dhe do të mbështetet nga një projekti i financuar prej KE.

Sa i përket zhvillimit të dijes për zbatimin e procedurës për delegimin e përgjegjësive dhe pranimin e përgjegjësisë nga performanca janë marrë disa hapa në këtë drejtim. NJQH-IA ka qenë i angazhuar edhe në krijimin e sistemit për edukim të vazhdueshëm profesional. Aktualisht është duke e finalizuar Udhëzimin Administrativ për licencimin e profesionistëve të auditimit të brendshëm ku është i përfshirë edukimi i vazhdueshëm profesional. Në këtë udhëzim janë përcaktuar oraret dhe zonat adekuate për edukimin e vazhdueshëm profesional. Udhëzim pritet të miratohet nga Ministri i Financave.

Komitetet e Auditimit të Brendshëm

Një karakteristikë e veçantë në Kosovë është obligimi i të gjitha organizatave buxhetore të mëdha për të formuar komitetet e auditimit.

Kosova është pyetur për të komentuar mbi efektivitetin e këtyre komisioneve, duke përfshirë, vështirësitë e hasura për të rekrutuar anëtarë të kualifikuar, frekuenca e takimeve, pavarësia e anëtarëve dhe rezistenca e mundshme e këtyre komisioneve nga menaxhimi.

Në shumicën e organizatave buxhetore, nëse njësitë e auditimit të brendshëm janë krijuar atëherë komitetet e auditimit gjithashtu janë krijuar. Anëtarët e komisionit të auditimit janë zgjedhur nga ana e menaxhimit, për këto kualifikime adekuate duhet të takohet çdo tre muaj zakonisht. Për anëtarët e komiteteve të auditimit gjatë vitit 2011 kemi organizuar trajnime me temën, roli dhe përgjegjësia e auditimit. Trajnimi i anëtarëve të komisionit të auditimit është planifikuar të mbahet gjatë këtij viti.

Gjatë takimeve me komitetet e auditimit, raportet e auditorit të brendshëm dhe të jashtëm janë diskutuar. Pas konkluzioneve, diskutimet janë tërhequr, dhe nëpërmjet rekomandimeve të menaxhmentit është këshilluar për hapat që duhen ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve. Një vështirësi që komitetet e auditimit do të përballen gjatë funksionimit është kërkesa e anëtarëve për pagesë shtesë. Për shkak të mungesës së fondeve buxhetore dhe dispozitat e aplikueshme anëtarët e komisionit nuk mund të paguhet për takime të tilla. Kjo nuk ndikon në organizimin buxhetore që të themelojë komisionin e auditimit.

Auditimi i jashtëm:

- Kosova është pyetur për të komentuar mbi efektivitetin e bashkëpunimit në mes të OAG dhe Parlamentit, në veçanti, në lidhje me shqyrtimin e raporteve të auditimit të OAG-së nga Parlamenti.

Homologu kryesor i OAG-së në Kuvend është Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP). Ky komitet u krijua disa vjet më parë. Përgjegjësi e komisioneve është të mbikëqyrë ekzekutimin buxhetit qeveritarë. Një nga mënyrat për të bërë këtë është të analizohet zbatimi i buxhetit në bazë të raporteve të auditimit nga Auditorët e Përgjithshëm dhe të caktohet personi përgjegjës për mbikëqyrjen e buxhetit. Dëgjimet publike është një nga format për këtë.

Të përfshira në këtë është edhe caktimi i Auditorit Përgjithshëm për mbikëqyrjen e buxhetit. Baza për këtë është Raporti Vjetor i Performancës së AG-së.

Pavarësisht seancës së shkurtër në 2011 (për shkak të problemeve me zgjedhjet) Komiteti i ri pothuajse trajtoi 26 raporte individuale të auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet janë diskutuar në seancat ku përfaqësuesit e organeve të auditimit ishin të ftuar. Gjatë vitit 2011 KMFP gjithashtu ka shqyrtuar Raportin Vjetor të Performancës dhe Raportin Vjetor të Auditimit (dy raportet u miratuan në seancë plenare). Në një dëgjim publik rekomandimet e dhëna në Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2010 u diskutuan me përfaqësues nga OAG, MF, KRPP, Media, OJQ-ët dhe shoqëritë civile. Regjistrimi i aseteve, prokurimet publike dhe kontrollimet e brendshëm ishin zonat më të rëndësishme për tu përmirësuar të cilat edhe janë trajtuar me një interes të veçantë.

Komiteti mbajti tridhjetë e tre (33) mbledhje të rregullta dhe një dëgjim publik. Përfaqësuesit e OAG-it ishin të pranishëm në takimet ku kontribuuan me këshilla profesionale.

Ky është një progres i mirë. Mirëpo, në të njëjtën kohë duhet të zhvillohet kuptimi i rolit të formave të Komitetit dhe punës: prapë disa sfida mbeten:

- a. Vendet për përmirësim ekzistojnë ende, kur është fjala për të qenë jo-partiake;
- b. Perceptimi mbi rolin e Auditorit të Përgjithshëm të pavarur ndryshon. Në disa raste, në ende duhet trajtuar pikëpamje mbi auditimin si inspektime financiare apo kontrole dhe të kuptohet roli i auditimit të performancës i cili ndryshon thelbësisht;
- c. Kuptimi i thelbit dhe përmbajtja e konceptit modern publik ndryshon;
- d. Nevoja për "checks and balances" dhe qeverisjen e mirë në organizimin e përgjithshëm të sektorit publik lënë hapësirë për përmirësim;

- e. Të kuptuarit e rolit të Kuvendit dhe mbikëqyrjes nga Kuvendi në lidhje me Qeverinë në një shoqëri demokratike duhet të zhvillohet;
- f. Mekanizmi i shkarkimit ende mungon dhe rekomandimet e dhëna nga Komisioni në Kuvend janë shpesh të paqarta;
- g. Ndarja e përgjegjësive në mes të Komisioneve të Kuvendit të ndryshme në procesin e buxhetit është jo e qartë dhe jo efektive; dhe
- h. Format e bashkëpunimit mes KMFP dhe komisioneve faktike në raportet e auditimit të duhet të zhvillohet.

Në përgjithësi planifikimi i punës gjithashtu lë hapësirë për përmirësim. Disa mangësi në kryerjen e përgjegjësive janë të lidhura drejtpërdrejt me këtë. Të gjitha këto sfida kanë një ndikim të përbashkët në mes të KMFP-së dhe OAG-së. Por, edhe sfidat e OAG-së mund të kontribuojnë në këtë. Për shembull mënyra se si janë të shkruara dhe të paraqitura raportet që ende duhet të forcohet.

- Gjithashtu, Kosova është pyetur për të komentuar mbi progresin e saj në lidhje me zbatimin e standardeve të auditimit financiar dhe ati të performancës. Gjithashtu, Kosova është pyetur për të komentuar mbi progresin e saj në lidhje me zbatimin e standardeve të auditimit financiar dhe ati të performancës.

Në lidhje me auditimin e rregullsisë një manual i ri i auditimit u hartua në vitin 2009 si bazë për auditimin tonë. Në të gjitha pjesët materiale ky doracak është në përputhje me ISSAI-në e mëhershëm. Pas rishikimit të fundit nga ISSAI po bëhet ndryshimi i manualit tonë dhe skemën e certifikimit, të cilën ne jemi duke e përdorur si standard më moderne të auditimit të sektorit publik.

Ne jemi një nga institucionet e auditimit të pakta që kemi një skemë formale të certifikimit të siguruar nga një burim i jashtëm në pajtim me mbikëqyrje nga IFAC. Kur do të jetë përmirësuar kjo skemë, nëse nuk do të jemi të parët, ne do të jemi në mesin e të parëve që do të ketë bërë këtë në të gjithë botën. Thujse të gjithë auditorët tanë janë të përfshirë në këtë skemë certifikimi. Në disa raste ne kemi gjetur zgjidhje të tjera në lidhje me çështjet e komuniteteve. Përveç kontrollit të cilësisë "në përputhje profesionale" ne kemi një sistem për monitorimin e cilësisë. Sigurisht që ekzistojnë sfidat nëse shikohen standardet në mënyrë absolute, por në përgjithësi puna është avancuar mjaft. Numri i këtyre auditimeve është rritur nga 25 në sezonin e auditimit 2008/09 të 91 në sezonin aktual.

Në lidhje me auditimin e performancës, ka një udhëzues që nga viti 2009 dhe është ndërtuar mbi ISSAIs. Prezantimi i auditimit të performancës të duhur në ambientin e Kosovës është një vështirësi që mund të merr disa vite. Qasja analitike nuk është vendosur tërësisht në mendim dhe ky është një profesion i ndarë nga qasjet e tjera të auditimit. Për shkak të kësaj ne kemi shkuar në një bashkëpunim afatgjatë dypalësh me NAO suedeze duke adresuar këtë zonë në një mënyrë të përbashkët. Katër prej tyre janë në tubacion këtë sezon, në krahasim me tre në sezonin e kaluar (vetëm një e raportuar).

Duke na bërë të aftë për të prodhuar rezultate që nuk janë të lidhura vetëm me qasjen e auditimit të rregullsisë: cilësia e informacionit dhe rregullsinë në buxhet, ne kemi zhvilluar diçka që ne e quajmë auditimin e menaxhimit. Kjo është një formë e lehtë e auditimit të performancës e fokusuar në cilësinë e menaxhimit të një mandati apo detyrë. Dhjetë prej këtyre auditimeve janë në tubacion tani, ndërsa katër janë raportuar sezonin e kaluar dhe dy në sezonin para asaj. Në përgjithësi 105 raportet të auditimit janë në tubacion. Ata do të jenë në kohë relevante dhe do të sjellin një cilësi më të mirë se në tre vitet më parë.

Standardet e auditimit nuk janë vetëm në lidhje me cilësinë në detyrat individuale të auditimit të kryera. ISSAIs janë gjithashtu të lidhura edhe me menaxhimin e korporatave në përmbushjen e mandatit të Institucionit Suprem të Auditimit modern. Kjo natyrisht përfshin aspekte për marrjen e

rezultateve në formë të ndryshimeve aktuale në administratë, duke shtuar vlerën në ndërtimin e mirë të qeverisjes, etj. Duke vlerësuar qasjen tonë dhe rezultatet në këtë partneritet ndërkombëtar, janë vlerësuar lartë të arriturat deri më tani. Kjo nuk është e njohur plotësisht nga disa partnerë lokalë. Sfida jonë më e madhe është sigurimi i qëndrueshmërisë, duke nxitur organizimin tonë dhe ngritjen e vetëdijes në mesin e akterëve tanë.

3.4.3. Ligji i Kompanive

- A ka përmirësime lidhur me stafin dhe objektin, me funksionalizimin e Agjencisë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve?

Numri i punonjësve që punojnë në ARBK-ë është 14. Me strukturën e re organizative të aprovuar, numri i të punësuarve do të rritet me 5 të zyrarë të ri. Buxheti i ARBK-së për vitin 2012 është 101,440.071 euro.

Reformat në këtë fushë janë intensifikuar gjatë dy viteve të fundit, dhe kanë qene kryesisht të fokusuara në përshejtimin dhe rritjen e efikasitetit të implementimit. Deri më tani është bërë integrimi i sistemit të regjistrimit të bizneseve, gjë që ka bërë të mundur që të gjitha procedurat të kryhen në një vend të vetëm (dhënia e certifikatës së biznesit, certifikatës së TVSH-së, certifikatës së import-eksportit dhe numrit fiskal) në një procedurë dhe një vend të vetëm, dhe Qendra për Shërbime të Bizneseve gjithashtu ofron shërbime të tjera, si pajisja me marka tregtare, si dhe licenca të derivateve të naftës, turizmit dhe duhanit. Aktualisht janë duke u zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e një banke për ofrimin e shërbimeve të pagesave për klientë. Qendra në fjalë është rinovuar dhe është inauguruar së voni, me përkrahjen e Bankës Botërore. Më tej, është rritur numri i stafit që merren me pranimin e aplikacioneve (nga një në tre zyrarë) dhe janë duke u organizuar trajnime për përdorimin e sistemit për zyrtarët e rinj dhe këto trajnime do të mbahen së shpejti.

- A është i hapur regjistrimi Online për të gjitha Komunitet të përfshira në fazën e dytë të projektit të QRBK-së?

Regjistri i ARBK-se është modern dhe kompatibil me standardet e BE-së. Të gjitha Komunitet janë të kyçura në sistemin qendror të bazës së të dhënave, kanë mundësi të pajisen me certifikata në një vend (*One Stop Shop*), ndërsa aplikimi online ende nuk është funksional.

- Deri ku janë zbatuar në praktikë dy ligjet për Kontabilitet dhe Auditim? Ndonjë vështirësi e veçanta në zbatimin e tij që duhet të raportohet?

Në gusht 2011 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (LKRFA), i cili është në harmoni me Direktivën 4 të Këshillit Evropian 78/660/EEC për Llogaritë Vjetore të disa llojeve të Kompanive, Direktivën 7 të Këshillit Evropian 83/349/EEC për Llogaritë e Konsoliduara dhe Direktivën 8 të Këshillit Evropian 84/253/EEC për Miratimin e Personave Përgjegjës për të Kryer Auditimin Statusor.

Konform ligjit, është themeluar dhe janë emëruar shtatë anëtarë të rinj të Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) dhe në bazë të nenit 15, paragrafi 2 të tij janë themeluar komisionet e parapara: Komisioni i Standardeve të Kontabilitetit dhe Auditimit, Komisioni për Standarde Profesionale dhe Sigurimin e Cilësisë, Komisioni për Licencim dhe Komisioni për Hetim dhe Disiplinë.

Më tej, për zbatimin e ligjit janë nxjerrë dhe harmonizuar me ligjin e ri një numër udhëzimesh administrative. Këtu hyn UA 2012/4 për Zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe kërkesave të tjera për përgatitjen dhe auditimin e pasqyrave financiare, konform kërkesave dhe obligimeve që dalin nga ligji i ri dhe në harmoni me Direktivën 8 të Këshillit Evropian si dhe Standardin 8 Ndërkombëtar të Edukimit "Kërkesat për Kompetencë për Profesionistët e Auditimit",

të publikuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Edukimit për Kontabilitet (BSNK/IAESB). Ky UA është miratuar nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar. Gjithashtu ka hyrë në fuqi UA 2012/1 për Njohjen e Auditorëve të Jashtëm dhe Firmave të Jashtme të Auditimit (i cili ka zëvendësuar UA 2008/2), UA 2012/2 për Licencimin e Auditorëve Ligjorë Vendorë (i cili ka zëvendësuar UA 2008/3 dhe UA 2012/3 mbi Kriteret për Miratim të Firmave Kosovare të Auditimit (i cili ka zëvendësuar UA 2008/4).

Neni 11 i Ligjit kërkon që nga 30 prill, pasqyrat financiare të këtij viti duhet të plotësohet dhe dorëzohet në QKRF. Nuk ka vështirësi të veçanta për zbatimin e Ligjit që nga hyrja e tij në fuqi në shtator të vitit 2011.

3.4.4. Tregtia e Shërbimeve

- Cila është gjendja aktuale në lidhje me statistikat mbi shërbimet?

Llogaria e tregtisë së shërbimeve në vitin 2011 karakterizohet me një bilanc pozitiv, që shënoi një vlerë prej €634 milionë (krahasuar me €530 milionë gjatë vitit 2010. Më konkretisht, bilanci pozitiv në tregtinë e shërbimeve gjatë periudhës 2009 - 2011 reflekton të ashtuquajturat 'eksportet virtuale', përkatësisht shitjet e brendshme të emigrantëve. Përveç kësaj, bilanci pozitiv karakterizohet me rritje të të ardhurave nga shërbimet e komunikimit dhe shërbimeve të tjera të biznesit, më së shumti ato të ndërtimit. Gjatë vitit 2010, llogaria e shërbimeve realizoi të hyra në vlerë prej €515.0 milionë, një rritje vjetore prej 20.1%. Në të njëjtën kohë, pagesat për shërbimet e blera nga jashtë arritën vlerën prej gjithsej €477.9 milionë (rritje vjetore prej 55.2%).

Rritja e pagesave për shërbimet e ndërtimit, më konkretisht shërbimeve për ndërtimin e segmentit të parë të autostradës Morinë - Merdarë, ishin shkak kryesor për zvogëlimin e bilancit të shërbimeve gjatë kësaj periudhe. Të hyrat nga shërbimet e ndërtimit arritën vlerën prej €52.0 milionë gjatë vitin 2010 (€15.7 milionë gjatë vitit 2009), përderisa pagesat për 8 shërbimet e ndërtimit arritën vlerën €100.3 milionë (€5.0 milionë në vitin 2009). Deri në dhjetor 2010, të hyrat nga shërbimet e udhëtimit shënuan rritje vjetore prej 18.2%, duke përfaqësuar gjithsej rreth 43.2% të të hyrave nga shërbimet. Sidoqoftë, rritja e pagesave për shërbimet e udhëtimit (kryesisht udhëtime për pushime verore) për 28.1% ndikoi që bilanci i përgjithshëm i shërbimeve të udhëtimit të rritej për rreth 10.4%. Përveç shërbimeve të udhëtimit, komunikimit dhe shërbimeve qeveritare (shërbimet e ofruara për ambasada dhe praninë ushtarake të NATO-s), të gjitha shërbimet e tjera shënuan bilanc negativ në vitin 2010.

Tabela 53. Shërbimet tregtare (në milion EURO)

Periudha kohore	2009	2010	2011
Transporti	-39.1	44.1	-53.4
Udhëtimi	157.6	179.2	251.2
Shërbimet e komunikimit	58.3	49.0	77.0
Shërbimet e ndërtimit	10.7	20.2	-5.3
Shërbimet e sigurimit	-9.6	12.8	-17.1
Shërbimet Financiare	3.5	3.2	-0.8
Shërbimet informative kompjuterike	-1.5	3.7	-0.3
Taksat, lejet dhe tarifatat	-3.0	2.1	-0.4
Shërbimet e bizneseve tjera	-62.9	-	-22.0

		60.6	
Shërbimet, personale, kulturore dhe rekreative	0.7	- 0.2	0.7
Shërbimet qeveritare	79.7	56.4	51.6

Burimi: Banka qendrore e Kosovës

3.4.4.1. Shërbimet postare

- Sa është numri i stafit që punojnë në mbikëqyrjen e shërbimeve postare dhe çfarë trajnimesh u ofrohen atyre?

MZHE-ja dhe ART-ja janë përgjegjës për sektorin postar. MZHE-ja është përgjegjës për hartimin e legjislacionit dhe politikave, ndërsa ART-është përgjegjës për rregullimin e sektorit të shërbimeve postare. Ka 2 punonjës në MZHE dhe ART përkatësisht, dhe të cilët janë përgjegjës për shërbimet postare. Deri më sot, stafi MZHE-së dhe ART-së iu nënshtruan trajnimeve të përgjithshëm dhe kanë nevojë për më shumë trajnime të specializuara në lidhje me sektorin postar.

Janë të angazhuar 132 punonjës në procesin e mbikëqyrjes në postat e Kosovës; 48 në cilësinë e inspektimit të përgjithshëm; 21 në cilësinë e inspektimit të zyrave postare; 10 në cilësinë e inspektorëve operativ në terren, dhe 53 në cilësinë e zyrtarëve kyç të postave komunale. Stafi i Postës së Kosovës ka përfunduar trajnimin në qendër për trajnim dhe zhvillim në kuadër të PTK-së, duke përfshirë kodin e mirësjelljes ndaj konsumatorëve, si dhe zbatimin e udhëzimeve për shërbimet e ofruara nëpër degë.

3.5. Konkurrenca

- Si janë zhvilluar subvencionet dhe garancitë gjatë pesë viteve të fundit? Në bazë të cilave kriterëve ekonomike jepen ndihmat shtetërore? Ju lutem ofroni të dhëna në subvencione drejtpërdrejta për 5 vitet e fundit. Ju lutemi ofroni raportet vjetore për ndihmës shtetërore.

Në të kaluarën, nuk ka pasur legjislacion specifik që ka rregulluar kriteret për dhënie e ndihmës shtetërore. Subvencionet për ndërmarrjet publike janë dhënë në pajtim me ligjet për buxhetin vjetor, të cilat ofrojnë një rregullim të tillë për qëllime të interesit publik. Në janar të vitit 2012, ka hyrë në fuqi Ligji për Ndihmës Shtetërore Nr. 04/L-024 . Ky ligj ka rregulluar detajet, kriteret dhe procedurat e sigurimit të ndihmës shtetërore. Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji pritet të përfundojnë deri në fund të qershorit të vitit 2012, ndërsa një Komision Ndërmarrës për Ndihmën Shtetërore do të themelohet deri në këtë kohë.

Tabela më poshtë jep të dhëna të hollësishme mbi shumën e subvencioneve shtetërore të dhëna për ndërmarrjet publike gjatë pesë viteve të fundit (2007-2011).

Tabela 54. Subvencionet për ndërmarrjet me pronësi publike

Përshkrimi	Shpenzimet 2011	Shpenzimet 2010	Shpenzimet 2009	Shpenzimet 2008	Shpenzimet 2007
Energjia – KEK-u	27,350,000	29,035,995	64,221,073	23,000,000	11,451,000
Importi i Energjisë-rastet sociale	4,483,494	4,499,979	4,499,764	-	4,500,000
Hekurudhat e Kosovës	500,000	500,000	500,000	-	45,581
Nxehja Qendrore	1,947,996	1,403,289	1,933,000	999,962	2,486,904
Ujë dhe mbeturina	1,266,111	587,896	780,892	651,335	1,862,057
Miniera e Trepçës	1,911,380	3,082,870	4,739,431	984,058	3,089,431
Total	37,458,981	39,110,029	76,674,161	25,635,355	23,434,973

Burimi: Ministria e Financave

- Cila është korniza ligjore për dhënien e ndihmës shtetërore? Cilat janë tiparet kryesore të kësaj kornize? Si janë zhvilluar subvencionet dhe garancitë publike përgjatë pesë viteve të kaluara? Në bazë të cilave kritere ekonomike jepet ndihma shtetërore? Ju lutemi jepni të dhëna mbi subvencionet e drejtpërdrejta të dhëna gjatë 5 viteve të fundit. Ju lutemi siguroni/dërgoni raportet vjetore mbi ndihmën shtetërore.

Deri në fillim të vitit 2012, zona e ndihmës shtetërore nuk është rregulluar me ligj të veçantë. Në janar të vitit 2012, Ligji nr. 04/L-024 për Ndihmën Shtetërore ka hyrë në fuqi. Ky ligj përcakton në detaje kriteret dhe procedurat për sigurimin e ndihmës shtetërore. Legjislacioni shtesë për zbatimin e këtij ligji dhe Komisioni Ministror për Ndihmën Shtetërore pritet të përfundojë, përkatësisht të vendosur, deri në fund të qershorit 2012.

3.6. Pronësia intelektuale, industriale dhe komerciale

- Sa raste të shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale janë regjistruar?

Tabela 55. Statistikat e shkeljeve të së të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI) gjatë Janar- Dhjetor 2010

Llojet e shkeljeve	Rastet nën Hetim	Rastet dërguar në prokurori me autorë të njohur	Rastet e dërguara në prokurori pa Autor të njohur	Rastet e dërguara me raport në prokurori	Numri i personave të Arrestuar	Numri i kallëzimeve penale
Ceni i të drejtave të patentës						
Përdorimi i paautorizuar i firmës, markës apo modelit të huaj	4	3				3
Mashtrimet e konsumatorëve	2	4		1	2	8
Prodhimi dhe përdorimi i shenjave të etiketave, masat dhe peshat e rreme		1				1
Total	6	8	0	1	2	12

Burimi: Policia e Kosovës

Tabela 56. Statistikat e shkeljeve të së të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI) gjatë Janar- Dhjetor 2011

Llojet e shkeljeve	Rastet nën Hetim	Rastet dërguar në prokurori me autorë të njohur	Rastet e dërguara në prokurori pa Autor të njohur	Rastet e dërguara me raport në prokurori	Numri i personave të Arrestuar	Numri i kallëzimeve penale
--------------------	------------------	---	---	--	--------------------------------	----------------------------

Ceni i të drejtave të patentës						
Përdorimi i paautorizuar i firmës, markës apo modelit të huaj	1	4		1	4	5
Mashtrimet e konsumatorëve	5	4			1	1
Prodhimi dhe përdorimi i shenjave të etiketave, masat dhe peshat e rreme						
Total	6	8	0	1	5	6

Burimi: Policia e Kosovës

Tabela 57. Statistikat e shkeljeve të së të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI) gjatë vitit 2012

Llojet e shkeljeve	Rastet nën Hetim	Rastet dërguar në prokurori me autorë të njohur	Rastet e dërguara në prokurori pa Autor të njohur	Rastet e dërguara me raport në prokurori	Numri i personave të Arrestuar	Numri i kallëzimeve penale
Ceni i të drejtave të patentës						
Përdorimi i paautorizuar i firmës, markës apo modelit të huaj		1				2
Mashtrimet e konsumatorëve	1	1				1
Prodhimi dhe përdorimi i shenjave të etiketave, masat dhe peshat e rreme						
Total	1	2	0	0	0	3

Burimi: Policia e Kosovës

Tabela 58. Statistikat e shkeljeve të së të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI) gjatë vitit - Mars 2012

Periudha	2008	2009	2010	2011	2012	Total
----------	------	------	------	------	------	-------

kohore						
Numri i rasteve	2	4	1	8	2	17

Burimi: Gjykata Ekonomike e Prishtinës

Të gjitha rastet e paraqitura në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë janë të zgjidhur, përveç një rasti, i cili është paraqitur në Gjykatë më 3 maj 2012 (i cili është në procedurë). Prandaj mund të përfundohet se ato raste të shkeljeve së të drejtave pronësore intelektuale për të cilat është kompetente gjykata ekonomike zgjidhen shpejt dhe me efektivitet.

- A janë plotësuar boshllëqet në kornizën legjislative? A paguajnë gjoba kriminelët/shkelësit? Çfarë ndodh nëse nuk paguajnë?

Sa i përket kornizës ligjore në fushën e së drejtës së autorit, më 21 tetor 2011 është miratuar Ligji i ri nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (i cili zëvendëson ligji paraprak nr. 2004/45). Ligji i ri rregullon aspektet pasurore dhe etike të së drejtës së autorit, duke u fokusuar në pjesën e realizimit dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit. Administrimi i të drejtave është i garantuar dhe i shprehur qartë dhe saktë dhe në harmoni me praktikat evropiane. Ai parasheh dy forma të administrimit të të drejtave: kolektiv dhe individual. Pas hyrjes në fuqi të ligjit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka hartuar Rregulloren për Dhënien Përkatësisht Marrjen e Lejes Shoqatave për Administrim Kolektiv të të Drejtave. Përveç këtij ligji, të drejtat pronësore intelektuale dhe industriale mbrohen edhe me tri ligje të tjera: Ligjin nr. L-029 për Patenta, Ligjin nr. L-026 për Marka Tregtare dhe Ligji nr. L-028 për Dizajnin Industrial (të tre të miratuar më 29 korrik 2011 dhe dekretuar më 9 gusht 2011). Më tej, janë bërë përgatitjet përfundimtare për fillimin e hartimit të një ligji mbi treguesit gjeografikë (drafti fillestar i këtij projektligji do të hartohet në gusht 2012 dhe të dërgohet për miratim në Kuvend në nëntor 2012).

Sa i përket legjislacionit sekondar, në fuqi janë shtatë udhëzime administrative:

- UA për aplikimet e patentave, markave tregtare, dizajnëve industriale, patentave të lëshuara, markave tregtare dhe dizajnëve industriale të njohura para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ (miratuar në shtator 2007);
- UA mbi ekzaminimin e parakohshëm të Markave Tregtare (miratuar në janar 2012);
- UA mbi Përfaqësimin e të Drejtave të Pronësisë Industriale (miratuar në shtator 2008);
- UA nr. 2007/10 mbi Procedurat e Regjistrimit të Patentave (miratuar në shtator 2007);
- UA nr. 2007/12 mbi Procedurat e Regjistrimit të Dizajnit Industrial (miratuar në shtator 2007);
- UA nr. 2007/13 mbi Procedurat e Regjistrimit të Markave Tregtare (miratuar në shtator 2007);
- UA nr. 2009/19 mbi Taksat Administrative për Objektet e Pronës Industriale (miratuar në shtator 2009)

Më tej, pesë UA të tjerë janë në hartim e sipër (pritet të hyjnë në fuqi në shtator 2012):

- UA mbi Tarifat Administrative të Regjistrimit të Objekteve të Pronësisë Industriale;
- UA për Procedurat e Regjistrimit të Patentave;
- UA për Procedurat e Regjistrimit të Markave Tregtare;
- UA për Procedurat e Regjistrimit të Dizajnit; dhe
- UA për Komisionin e Ankesave në Zyrën për Pronësi Industriale

Infrastruktura ligjore parasheh dispozitat ndëshkuese me të cilat parashihet dënimi i kryesve të këtyre veprave në rastin e cenimit të drejtave pronësore intelektuale. *Ligji për Patenta* përcakton se varësisht prej shkelësit (person fizik apo juridik) dënimi me gjobë mund të jetë nga €200 deri në

€5,000. *Ligji për Markat Tregtare* përcakton dënime nga €500 deri në €15,000. *Ligji mbi Dizajnin Industrial* parasheh dënimin me gjobë nga €2,000 deri në €8,000 për shkelësit e kësaj të drejte. Së fundi, të drejtat pronësore intelektuale dhe industriale gjithashtu mbrohen me dispozita të legjislacionit penal. Projekt-Kodi e ri Penal të Kosovës (i cili pritet të hyjë në fuqi së shpejti) i përfshin shkeljet e këtyre të drejtave si vepra penale. Ky projekt-kod përmban të hollësishme për dënimin e llojeve të ndryshme të shkeljes së DPI-së (si gjoba deri në €50,000, ashtu edhe dënime me burgim prej 3 muaj deri në 8 vjet), siç është falsifikimi, pirateria dhe forma të tjera të cenimit të së drejtës së autorit. Ky kod gjithashtu do të plotësojë boshllëqet ekzistuese sa u përket markave tregtare.

Pra mund të përfundohet se nuk ka boshllëqe juridike në legjislacionin në fuqi. Sa u përket procedurave, aktgjykimet duhet detyrimisht të ekzekutohen brenda 15 ditësh pas marrjes së tyre, përfshirë pagesën për kompensim. Në rastet kur nuk kryhet pagesa, gjykata ka autoritetin dhe fuqinë juridike që të kërkoj nga Banka të bëjë bllokimin e xhirollogarisë së personit fizik apo juridik të dënuar në mënyrë që të sigurohet kompensimi i dëmit. Rasti më ekstrem mund të jetë kur i dënuari nuk mund ta mbulojë kompensimin e dëmit, për shkak të mungesës së mjeteve mjete të mjaftueshme në xhirollogari. Në raste të tilla gjykata urdhëron marrjen e pronës së pronarit, shitjen e saj në ankand, dhe më pas siguron që kompensimi i dëmit është bërë në pronësi. Të gjitha këto janë të rregulluara me Ligjin për Procedurën Kontestimore (miratuar më 30 qershor 2008 dhe dekretuar më 29 korrik 2008) dhe Ligjin për Procedurën Përmbarmore (miratuar më 2 qershor 2008 dhe dekretuar më 24 qershor 2008).

Sa i përket legjislacionit doganor mbi DPI-në, Ligji nr. 03/L-170 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (LMDMPI) nuk parasheh aplikimin e gjobave administrative për shkelësit, por parasheh dy procedura:

- a. *Procedurën e thjeshtëzuar*, që nënkupton marrëveshjen me shkrim për shkatërrimin e mallit ndërmjet bartësit të së drejtës dhe deklaruesit të mallit, e cila procedurë (LMDMPI parasheh konfiskimin dhe shkatërrimin e mallit dhe
- b. *Procedurën e rregullt*, që nënkupton zgjidhjen e kontestit përmes gjykatës kompetente.

Sa u përket boshllëqeve në legjislacionin për DPI, dy janë kryesoret: heqja e takës (prej €100) të paraparë për regjistrimin e një kërkesë për veprim, dhe vendosja e gjobave administrative për kriminelët/shkelësit e pronësisë intelektuale.

- Në çfarë mënyre përpiqet që të tërheq profesionistë e rinj Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (ZDADP)?

Që nga themelimi i saj, ZDA është forcuar dhe zhvilluar në aspektin profesional dhe ka rekrutuar profesionistë të rinj. Deri më tani kjo zyrë ka punësuar dhe zgjedhur Drejtorin e saj dhe një zyrtar për certifikim, të dy me kualifikime dhe përvojë profesionale adekuate (ky i fundit përfitues i programit të bursave Skema e Profesionistëve të Rinj, të financuar nga KE). Kjo Zyrë gjithashtu ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me profesionistë dhe ekspertë të së drejtës së autorit, me të cilët mban takime të ndryshme dhe diskuton zhvillimet, të arriturat, sfidat dhe problemet në këtë fushë. Në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës është në procesin e përzgjedhjes së dy praktikantëve të rinj.

3.6.1. Të drejtat e pronësisë industriale

A është vlerësuar përputhshmëria e Ligjeve mbi Markat Tregtare, Dizajni Industrial dhe Patentat, me Standardet e BE-së?

Meqenëse të gjitha ligjet që rregullojnë të drejtat pronësore industriale janë të rinj, gjatë përpilimit të tyre janë konsultuar të gjitha Rregulloret dhe Direktivat e nxjerra nga Institucionet e Bashkimit Evropian si dhe Konventat e ndryshme Ndërkombëtare.

Më poshtë është lista e Marrëveshjeve dhe Konventave Ndërkombëtare të cilat kanë qenë bazë juridike me të cilat ZPI është konsultuar gjatë përgatitjes së legjislacionit.

Ligji nr. L-029 për Patenta është në harmoni të plotë me:

- a. Direktivën 98/44/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi mbrojtjen ligjore të zbulimeve bio-teknologjike;
- b. Direktivën 2004/48/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi zbatimin e të drejtave pronësore intelektuale;
- c. Rregulloren 816/2006/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi licencat obligative të patentave në lidhje me prodhimin e produkteve farmaceutike për eksport në vendet me problemet e shëndetit publik;
- d. Rregulloren 469/2009/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi certifikimin e mbrojtjes shtesë të produkteve mjekësore; dhe
- e. Rregulloren 1610/96/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi krijimin e certifikimit mbrojtës për mbrojtjen e produkteve bimore.

Ligji nr. L-026 për Markat Tregtare është në harmoni të plotë me:

- a. Direktivën 2008/95/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me markat tregtare;
- b. Direktivën 2004/48/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- c. Rregulloren 207/2009/EC të Këshillit për markat tregtare komunitare;
- d. Marrëveshjen e TRIPS;
- e. Traktati i Ligjit të Markave Tregtare të Singaporit ;
- f. Marrëveshja e Madridit për regjistrimin ndërkombëtarë të markave dhe protokollin lidhur me marrëveshjen e Madridit për regjistrimin ndërkombëtarë të markave.

Ligji për Dizajnin Industrial - nr. L - 028 është në harmoni të plotë me këto:

- a. Direktiva 98/71/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 13 tetor 1998 mbi mbrojtjen ligjore të dizajneve;
- b. Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 29 prill 2004 për Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale;
- c. Rregulloren e Këshillit 6/2002/EC për dizajnet e komunitetit (e plotësuar dhe ndryshuar)
- d. Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (të rishikuar);
- e. Marrëveshjen TRIPS-it; dhe
- f. Marrëveshjen e Hagës për Regjistrimin Ndërkombëtarë të Dizajneve Industriale.

Legjislacioni i mbrojtjes së pronës intelektuale është gjithashtu në linjë me rregulloren nr.. 2003/1383 të Këshillit Evropian dhe marrëveshjeve TRIPS.

- A ka vendosur Kosova bashkëpunim formal me institucionet lokale, komunitetin e biznesit dhe administratat doganore ndërkombëtare/të vendeve të tjera?

Në fushën e së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta ka vendosur raporte dhe bashkëpunim formal me një numër institucionesh dhe partnerësh. Në kuadër të partnerëve vendorë, ajo ka vendosur raporte bashkëpunimi me institucionet kulturore me qëllim të sensibilizimit të opinionit kulturor dhe artistik për ekzistimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, si dhe ka pranuar nga to inputet dhe vërejtjet për zbatueshmërinë e legjislacionit në këtë fushë. Më tej, është vendosur bashkëpunim formal me palë të tjera të interesuara në zbatueshmërinë e ligjit mbi të drejtën e autorit, përfshirë Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Doganën e Kosovës, pastaj Odën Ekonomike të

Kosovës dhe komunitetin e biznesit (producentë të muzikës, fotografë, shtëpi botuese, video-prodhues dhe kompani që ofrojnë shërbime kabllore në treg), si dhe grupe përfaqësuese të interesit (respektivisht me Unionin e Artistëve të Filmit dhe Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës), e fokusuar kjo në njoftimin e tyre për të drejtat dhe përgjegjësitë që dalin nga ligji, përfshirë në kuadër të përgatitjes së Strategjisë kundër Piraterisë dhe Falsifikimit, mandatin dhe detyrat e ZDA-së dhe obligimet e këtyre akterëve në fushën e DPI-së.

Zyra për Pronësi Industriale ka komunikim dhe bashkëpunim të ngushtë me Njësitin për Krime Ekonomike të Policisë së Kosovës, Gjykatën Ekonomike, Inspektoratin e Tregut dhe institucione të tjera relevante për zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale. ZPI gjithashtu ka vendosur marrëdhënie të ngushta me komunitetin e biznesit (Odën Ekonomike të Kosovës dhe Aleancën Kosovare të Bizneseve), me fokus në shpërndarjen e informacioneve të biznesit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në lidhje me pronësinë industriale. Më tej, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ndërinstytucional, në shtator 2011 është themeluar Këshilli Kombëtar për Pronësinë Intelektuale në Kosovë. Këshilli kryesohet nga Drejtori i ZPI-së dhe anëtarë të tija janë përfaqësues nga Gjykata Ekonomike, Dogana e Kosovës, Inspektorati i Tregut, Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, Njësia e PK-së për Krime Ekonomike, Agjencia e Produkteve Medicinale, Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit, si dhe në përfaqësues të komunitetit të biznesit.

Së fundi, në kuadër të bashkëpunimit me institucione partnere të vendeve të rajonit ZPI ka nënshkruar Memorandume Bashkëpunimi me: Zrën për Pronësi Intelektuale të Republikës së Kroacisë (prill 2010), Zyrën për Pronësi Industriale të Republikës së Maqedonisë (gusht 2010) dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave të Republikës së Shqipërisë (nëntor 2011).

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet brenda vendit, Dogana e Kosovës si objektiv kryesor në përmbushjen e planit të saj të veprimit, ka paraparë ngritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, me komunitetin e biznesit dhe administratat Doganore ndërkombëtare. Me funksionalizimin e tij, Sektori i DPI-së në DK ka vendosur dhe po punon në vendosjen e bashkëpunimit me: ZPI (MTI, në korrik 2011), ZDA (MKRS, në proces të përcaktimit të arritjes). Më tej, në kuadër të pjesëmarrjes së vazhdueshme në 'Iniciativën e Venedikut', është krijuar bashkëpunim i mirëfilltë në mes të DK-së me doganat e rajonit, si dhe me ato të Turqisë dhe Italisë. Gjithashtu vlen të theksohet se është krijuar bazë e përbashkët të dhënash ku shkëmbehen informata të nevojshme ndërmjet doganave që janë pjesë e kësaj iniciative.

- A parasheh legjislacioni i Kosovës marrjen e vendimeve gjyqësore kundër ndërmjetësuesve, shërbimet e të cilëve përdoren nga një palë e tretë për të shkelur të drejtat pronësore intelektuale (ZPI), siç janë ato të drejta që rregullohen nga Direktiva 2001/29/EC?

Legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës, përkatësisht Ligji mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, nuk parasheh nxjerrjen e vendimeve gjyqësore kundër ndërmjetësuesve (ofruesve të shërbimeve digjitale-internetit) shërbimet e të cilëve shfrytëzohen nga personat e tretë dhe rezultojnë me shkelje të të drejtave pronësore intelektuale, të drejta këto të cilat rregullohen nga Direktiva e BE-së 2001/29, të cilat të drejta mbrohen edhe me legjislacionin në fuqi në Kosovë. Megjithatë, ky ligj është kryesisht i harmonizuar me Direktivën 2001/29. Janë të rregulluara në veçanti të drejtat ekskluzive të autorit si e drejta e riprodhimit, e drejta e komunikimit publik të veprave dhe vënia në dispozicion të publikut, dhe e drejta e shpërndarjes. Sipas ligjit, autori vendos për të drejtën e interpretimit publik, të drejtën e shfrytëzimit nga shërbyesit medial audiovizual, të drejtën e komunikimit publik me anë të fonogrameve dhe video programeve, të drejtën e shfaqjes publike, të drejtën e vënies së veprës në dispozicion të publikut. Ligji përcakton edhe masat kundër çdo veprimi për t'i shmangur masat teknologjike efektive dhe masat për mbrojtje të informacionit që siguron autorësinë. Shkelja e së drejtës së autorit nga organizata transmetuese apo ritransmetuese sanksionohet nga Komisioni i Pavarur për Media, ndërsa shkeljet tjera që konstatohen nga Gjykata,

gjithsesi me vendime gjyqësore. Ky ligj gjithashtu rregullon mënyrën dhe formën e paraqitjes së kërkesë-padive në kuadër të mbrojtjes gjyqësore të DPI-së.

- Pasi që niveli i bashkëpunimit me Organizatën Botërore për të Drejtat Pronësore Intelektuale (WIPO/OBDPI) është rritur, kur do të jetë në gjendje Kosova që të nënshkruajë traktatet kryesore për DPI? A është arritur ndonjë përparim në këtë drejtim?

Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, pasi që është përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për fushën e të drejtës së autorit, me punën e saj në teren, si stimulimin dhe krijimin e rrethanave dhe kushteve për themelimin e shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave, është duke krijuar mundësi dhe rrethana afirmative për anëtarësimin në WIPO dhe mekanizma të tjerë rajonalë e ndërkombëtarë që merren me të drejtat e autorit, si dhe nënshkrimin e traktateve dhe konventave si ato për WIPO-së, Konventën e Bernës etj. Bazuar në kapacitetet dhe trendin pozitiv të punës së ZDA-së dhe mekanizmave të tjerë qeveritarë dhe joqeveritarë, dhe sipas vlerësimeve të ZDA-së, Kosova do të mund të fillojë nënshkrimin dhe aderimin në konventat dhe traktet ndërkombëtare në fushën e të drejtës së autorit gjatë vitit 2014.

Niveli i bashkëpunimit me WIPO është i kënaqshëm. Që nga themelimi i ZPI-së jemi në kontakt me këtë organizatë dhe kemi përfituar nga ky bashkëpunim. Për momentin mund të themi se ky bashkëpunim është më tepër teknik, nga i cili kemi ZPI ka përfituar në instalimin e Sistemit Automatik të Pronësisë Industriale (*Industrial Property Automation System - IPAS*). ZPI është e angazhuar vazhdimisht në vendosjen e kontakteve dhe bashkëpunimit me zyrat e tjera ndërkombëtare dhe rajonale që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore intelektuale.

3.7. Prokurimi Publik

-A është duke përgatitur Kosova rregulla të veçanta për prokurim në sektorin e ndërmarrjeve publike dhe shërbimeve?

Një kapitull i veçantë i Ligjit për Prokurim Publik nr. 04/L-042, i cili ka hy në fuqi më 5 tetor 2011, i kushtohet aktiviteteve të prokurimit të operatorëve të shërbimeve publike. Ky kapitull përbëhet prej 4 neneve dhe është i bazuar në Direktivën e Prokurimit KE-së nr. 17/2004. Implementimi i aktiviteteve të prokurimit për operatorët e shërbimeve publike në mënyrë të hollësishme janë të parapara në Rregulloren e Prokurimit Publik, e cila ka hy në fuqi më 1 shkurt 2012.

- Sa zyrtarë të prokurimit punojnë aktualisht në Kosovë?

Aktualisht në të gjitha autoritetet kontraktuese në Kosovë punojnë rreth 530 zyrtarë të prokurimit publik. (KRPP)

-Ju lutem shpjegoni çfarë trajnime ka pasur zyrtarët e prokurimit publik? A janë testua zyrtarët e prokurimit? Ju lutemi shpjegoni çfarë trajnimesh u ofrohen zyrtarëve të prokurimit? A u nënshtrohen zyrtarët e prokurimit testeve?

Në nenin 25 të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042 është i përfshirë Trajnimi i zyrtarëve të prokurimit. IKAP, në bashkëpunim me KRPP është përgjegjës për zhvillimin e moduleve të trajnimit dhe kurrikulës për kualifikimet në prokurim. Trajnimet klasifikohen në dy nivele: themelore dhe të avancuara. Të gjithë zyrtarët e prokurimit janë të obliguar t'i nënshtrohen testeve për certifikim. Deri më tani trajnimet i kanë ndjekur 579 zyrtarë të prokurimit, prej tyre 542 janë të certifikuar.

Trajnimet e nivelit të avancuar për prokurimit publik, sipas kërkesave të këtij ligji, kanë filluar të mbahen gjatë dhjetorit 2011. Të drejtën për vazhdimin e këtyre trajnimeve e kanë pasur të gjithë zyrtarët e prokurimit të cilët paraprakisht e kanë përfunduar trajnimin në nivelin themelor. Trajnimet në këtë nivel i kanë vazhduar 457 zyrtarë të prokurimit (në fund të vitit 2011 janë përfunduar dy modulet e para, ndërsa gjatë këtij viti është planifikuar të vazhdohet me modulet e tjera). Në vitin 2012 është mbajtur trajnimi i nivelit themelor për prokurim publik i cili tani ka

përfunduar: nga 58 zyrtarë të prokurimit të cilët e kanë ndjekur këtë trajnim, 53 prej tyre kanë kaluar testin me sukses dhe janë certifikuar (ky numër është i përfshirë në numrin e përgjithshëm prej 542 zyrtarëve të certifikuar.

- Sa autoritete kontraktuese operojnë aktualisht në Kosovë?

Më 31 dhjetor 2011, në Kosovë kanë qenë të regjistruara 161 autoritete kontraktuese, të cilat përfshijnë autoritetet qendrore, lokale, kompanitë publike dhe të tjera.

- Cili është niveli i pagesave të ngarkuara nga KRPP-ja?

Në bazë të nenit 57, paragrafi 3, i LPP-së, Autoritetet Kontraktuese mund të kërkojnë sigurinë e tenderit 3% - 5% të vlerës së parashikuar të kontratës, por jo më pak se €1,000.00. Në bazë të nenit 63, paragrafi 2, të LPP-së, Autoritetet Kontraktuese mund të kërkojnë sigurinë e ekzekutimit të kontratës se paku 10% të vlerës së parashikuar. Në bazë të nenit 118, paragrafi 1, të LPP-së, të gjithë ankuesit duhet t'i paguajnë OSHP-së një tarifë të ankesave në vlerë prej €500, së bashku me dorëzimin e ankesës. Neni 118, paragrafi 4, parashihet se nëse paneli shqyrtues konstaton se cilado nga pretendimet e bëra në ankesë janë të rrejshme, OSHP mund të kërkojë nga parashtruesi i ankesës që të paguajë një gjobë shtesë deri në €5,000].

- Sa është numri i ankesave të zgjidhura?

Nga gjithsej 419 ankesa të pranuar, 386 ankesa janë parashtruar nga operatorët ekonomikë kundër vendimeve të Autoriteteve Kontraktuese për dhënien e kontratës, 30 ankesa janë të Autoriteteve Kontraktuese për shqyrtimin e vendimeve të APP-së, kurse 3 ankesa të Autoriteteve Kontraktuese kundër interpretimeve të KRPP-së.

Nga Organi Shqyrtues i Prokurimit:

- a. 8 ankesa nuk janë shqyrtuar në mungesë të dokumentacionit të kompletuar;
- b. 11 ankesa janë tërhequr nga ana e operatorëve ekonomikë;
- c. 3,167 ankesa të parashtruar nga operatorët ekonomikë, të cilat i kanë plotësuar kushtet ligjore për shqyrtim, në pajtim me nenet 105,106,113 dhe 114 të LPP-së, janë shqyrtuar dhe nga Paneli Shqyrtues janë marrë këto vendime:
 - I. Në 106 raste është kërkuar që vendimi i Autoritetit Kontraktues të anulohet dhe bëhet ri-vlerësim i ofertave;
 - II. Në 71 raste vendimi i Autoriteteve Kontraktuese është anuluar dhe është kërkuar që të ri-tenderohen aktivitetet e prokurimit;

Në 190 raste janë aprovuar Vendimet e Autoriteteve Kontraktuese.

- A planifikon Kosova që të rrisë normat minimale të gjobave (nga €5,000)?

Kosova nuk planifikon shtimin e normës së gjobave, pasi që minimumi është €5,000, ndërsa maksimumi nuk është i kufizuar. Kështu që vlerësojmë se është një gjobë e mjaftueshme ndaj Autoriteteve Kontraktuese.

3.8. Drejtësia dhe çështjet e brendshme

3.8.1. Fuqizimi i institucioneve dhe sundimi i Ligjit

- Ju lutem, ofroni një pasqyrë se si është organizuar Policia e Kosovës; organogram, burimet njerëzore dhe financiare.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli XI neni 128, i përcakton se Policia e Kosovës është përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.


Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Policinë Nr. 04/L-76, Policia është entitet Ligjor, policia e Kosovës operon në një zinxhir komandues të unifikuar nëpër tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe udhëhiqet nga Drejtori Gjeneral i Policisë.

Policia e Kosovës është e organizuar në dy nivele: qendror dhe lokal. Sipas strukturës së fundit organizative të policisë, e miratuar me 17, maj 2012, niveli qendror është i përbërë nga Drejtori gjeneral, 2 zëvendës drejtorë të përgjithshëm, njëri përgjegjës i operacioneve dhe tjetri i burimeve, 5 departamente, 9 divizione, dhe 36 drejtori. Departamentet që punojnë me PK-në janë: Operativa, hetuesia, policia kufitare, burimet njerëzore dhe shërbimet administrative/mbështetëse.

Struktura e divizioneve të Policisë së Kosovës është si në vijim: Siguria publike, Njësitë speciale, trafiku, kontrolli kufitare, Menaxhimi i integruar i kufijve, hetuesia, kundër krimit të organizuar, administrata dhe trajnimet.

Sa i përket strukturës së nivelit lokal të organizimit, lidhur me rendin publik dhe sigurinë ekzistojnë 6 Drejtori Regjionale (Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Prizreni, Peja dhe Mitrovica) të udhëhequra nga Drejtorët Regjional. Brenda drejtorive regjionale janë stacionet e policisë dhe nën stacionet si dhe njësitë operative.

Tabela 2. Struktura organizative e Policisë së Kosovës



Policia e Kosovës	Nr. Total i Policëve	Zyrtarët Civil	Stafi Total
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë	78	28	106
Zëvendës drejtori për Operativë	9	1	10
Departamenti i Operativës	4		4
Vizioni i trafikut	25	3	28
Divizioni i njësisë speciale	664	23	687
Divizioni i sigurisë publike	12	2	14
Drejtoria Regjionale e Policisë - Prishtinë	1171	152	1323
Drejtoria Regjionale e Policisë - Mitrovicë	846	135	981
Drejtoria Regjionale e Policisë - Pejë	761	104	865
Drejtoria Regjionale e Policisë - Prizren	693	114	807
Drejtoria Regjionale e Policisë - Gjilan	593	89	682
Drejtoria Regjionale e Policisë - Ferizaj	417	84	501
Departamenti i Policisë Kufitare	3	6	9
Divizioni i kontrollit kufitar	1212	40	1252
Divizioni i menaxhimit të integruar të kufijve	41	1	42
Departamenti i Hetimit	43	3	46
Divizioni i hetuesisë kundër krimit	217	11	228
Divizioni krimit të organizuar	235	5	240
Zëvendës drejtori për menaxhimin e burimeve	15	2	17
Departamenti i Burimeve Njerzore	3		3
Divizioni i personelit dhe administrimit	12	39	51
Divizioni i trajnimit	198	8	206
Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse	6	244	250
Divizioni ICT	11	31	42
Agjensioni laboratorik	25	17	42
Totali i përgjithshëm	7294	1142	8436

Policia e Kosovës ka një staf total prej 8436 persona prej të cilëve 1142 janë zyrtar civil. Ju lutem referohuni tek tabela 59. Statistikat e Policisë së Kosovës” më poshtë për më tepër detaje lidhur me kategorizimin e tyre në drejtori dhe departamente të ndryshme të Policisë së Kosovës:

Përbërja etnike e Policisë së Kosovës reflekton diversitetin etnik të popullatës së Republikës së Kosovës dhe siguron barazinë gjinore. Ju lutem shihet tabelën në vijim, për statistikat e përbërjes etnike dhe gjinore të PK-së.

Tabela 60. Statistika e përbërjes etnike dhe gjinore të PK-së

Etnia	Polic dhe staf	Përfaqësimi
--------------	-----------------------	--------------------

Gjinia Etniciteti	Polic			Staf civil			civil		gjinor	
	Meshkuj	Femra	Total	Meshkuj	Femra	Total	Total	Total %	Meshku j	85.6 0%
	Shqiptarë	5565	735	6300	724	294	1018	7318	86.75%	Femra
Serb	586	77	663	39	56	95	758	8.99%	Përfaqësimi komunitetit	
Turq	63	8	71	2	2	4	75	0.89%	Shqiptarë	86 .7 5 %
Boshnjak	149	27	176	11	5	16	192	2.28%	Të tjerë	13 .2 5 %
Romë	8	2	10	0	1	1	11	0.13%		
Ashkali	20	1	21	1	0	1	22	0.26%		
Çerkez	2	0	2	0	0	0	2	0.02%		
Egjiptian	10	0	10	0	0	0	10	0.12%		
Goran	34	0	34	3	1	4	38	0.45%		
Malazez	0	3	3	1	0	1	4	0.05%		
Kroat	3	0	3	0	1	1	4	0.05%		
Maqedon	0	1	1	0	0	0	1	0.01%		
Siloven	0	0	0	0	1	1	1	0.01%		
Total	6440	854	7294	781	361	1142	8436	100.00 %		

Sa i përket burimeve financiare të PK-së, buxheti i përgjithshëm për vitin 2012 është €78,712,708, në të cila përfshin shpenzimet të tilla si; pagat dhe mëditjet, mallra dhe shërbime, shërbimet komunale, subvencionet dhe transferet dhe shpenzimet kapitale. Për më tepër detaje ju lutem referojuni tabelë në vijim.

Tabela 61. shpenzimet, pagat dhe mëditjet, mallra dhe shërbime, shërbimet komunale, subvencionet dhe transferet dhe shpenzimet kapitale

Nr.	Departamentet	Pagat dhe mëditjet	Mallra dhe shërbime	Shërbimet komunale	Subven cionet dhe transfer et	Shpenzimet kapitale	Total 2012
914	Menaxhmenti		221,072 €				221,072 €
300	Personeli	50,097,26 4 €	176,264 €		470,000 €		50,743,528 €
301	Operativa/ren di publik		264,249 €				264,249 €
302	Operacionet speciale		186,893 €			5,260,000 €	5,446,893 €
303	hetimet		169,841 €			2,715,000 €	2,884,841 €

304	Shërbimet mbështetëse		8,827,185 €	1,567,000 €		6,654,000 €	17,048,185 €
305	Departamenti i trajnimeve		339,494 €			150,000 €	489,494 €
306	Policia kufitare		248,446 €			1,126,000 €	1,374,446 €
307	Drejtoria për mbrojtjen e dëshmitarëve		240,000 €				240,000 €
Buxheti total për PK-në in 2012		50,097,264 €	10,673,444 €	1,567,000 €	470,000 €	15,905,000 €	78,712,708 €

- Ju lutemi jepni informacione mbi atë se si është forma e bashkëpunimit të zbatimit të ligjit, në mes të drejtorive të ndryshme të PK-së, por edhe në mes të të PK-së dhe institucioneve të tjera (përfshirë ndër-kufitare), duke përfshirë doganat dhe policia kufitar / kufirit administrativ.

Sipas Kodit penal të Kosovës, Kodit të Procedurave penale dhe në veçanti të Ligjit për Policinë Nr. 04/L-76, Neni 6, Policia e Kosovës duhet të aplikoj urdhrat dhe instruksionet në pajtim me ligjin, të lëshuar nga Prokurori publik apo gjykatësi kompetent.

Bashkëpunimi mes drejtorive brenda Policisë së Kosovës është kryesisht i rregulluar dhe harmonizuar nëpërmjet Udhëzimeve administrative, doracakëve me parimet e punës dhe Procedurat Standarde të Operimit, dmth Sh-SOP- 1.12 Përpunimit dhe çështjeve të juridiksionit.

Sa i përket bashkëpunimit të Policisë së Kosovës dhe institucioneve tjera të zbatimit të ligjit, Policia e Kosovës ka nënshkruar një numër të Memorandumeve të Mirëkuptimit me agjensione të ndryshme, të tilla si Agjensioni Kundër Korrupsionit (MM e nënshkruar me 27.05.2010); Bankën Qendrore të Kosovës (MM e nënshkruar me 15.07.2009); Doganat e Kosovës (MM e nënshkruar me 22.10.2009); Agjensioni Kosovar i Pronës (MM e nënshkruar me 9.10.2009); Këshilli Gjyqësor i Kosovës-Prokuroria e Shtetit (MM e nënshkruar me 27.01.2010); Agjensioni Kosovar i Privatizimit (MM e nënshkruar me 22.12.2008) dhe Shërbimin korrektues të Kosovës (MM e nënshkruar në Maj 2012). Për më tepër, PSO-të në vijim janë hartuar dhe vendosur në vend në mënyrë që të fuqizoj bashkëpunimin me Doganat e Kosovës:

- PSO për Qendrën e përbashkët kombëtare për kontroll kufitar;
- PSO për përdorimin e pajisjeve të përbashkëta;
- PSO aktivitetet e përbashkëta.

Në praktikë, Policia e Kosovës bashkëpunon në baza ditore me gjykatësit dhe prokurorët për çështjet lidhura me lëndët. Për më tepër, zyrtarët e lartë policor mbajnë takime të rregullta mujore me gjyqtarët dhe prokurorët.

Ku bëhet fjalë për bashkëpunim në fushën e kontrollit dhe menaxhimit kufitar Policia kufitare e Kosovës bashkëpunon ngushtë me të gjitha agjensionet e përfshira si dhe me të gjitha departamentet që operojnë nën Policinë e Kosovës. Ky bashkëpunim ka mundësuar një punë më efikase dhe ka rezultuar me 192 raste të dorëzuara tek Doganat e Kosovës, 172 raste tek Agjensioni Kosovar i ushqimit dhe veterinarisë, 355 raste tek Divizioni i Rendit Publik dhe Sigurisë i Departamentit të Operativës dhe 186 raste tek Departamenti i Hetuesisë në vitin 2011.

3.8.2. Azili, migracioni, kontrollimi i kufijve/kufijve administrativ dhe çështja e vizave

-Përveç një azhurnimit të inputeve të marra për takimet sektoriale të DPSA-së në DLS-në e 7-9 shkurtit 2012 (i cili përfshin, migrimi, regjistri civil, siguria e dokumenteve, menaxhimi i kufijve,

si dhe ri-pranimin dhe ri-integrimin), përfshijnë përgjigjet në pyetje në vijim: Ju lutem ofroni informacione për legjislacionin apo dokumentet e tjera lidhur me politikat e vizave.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kapitulli II, neni 35 për Lirinë e Lëvizjes, e drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe qëndrimin në vend duhet të definohet me ligj. Si i tillë, ligji i ri për të huajt Nr. 04/L-069, lejon hyrjen në territorin e Kosovës, largim si dhe qëndrimi i të huajve në Republikën e Kosovës. Kapitulli III i këtij ligji ka të bëjë me politikën e vizave dhe parashikon masat për çështjet e mëposhtme: Lëshimin e vizave, vlefshmëria e vizave, llojet e vizave, procedura për lëshimin e vizave, shtyrja e vizës, jo-lëshimi i vizës, kompetencat e organit për kontrollin shtetëror kufitar dhe përgjegjësitë e bartësit.

Më tej, procedurat e lëshimit të vizave qeverisen nga dy Udhëzime Administrative, domethënë Udhëzimit Administrativ nr. 21/2010 mbi procedurën e lëshimit të vizave në pikat e kalimit kufitar dhe Udhëzim Administrativ nr. 04/2010 mbi procedurën e lëshimit të vizave nga zyrat konsullore të Republikës së Kosovës.

Më 16 maj 2012 Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë një vendimin nr 02/74, në lidhje me regjimin e vizave, që afektojnë 86 vende. Zbatimi i këtij vendimi do të pasojë më 1 janar 2013. Vendet, subjekt i këtij regjimi janë të shënuara në dy anekset. Aneksi I përmban një listë të 73 vendeve, qytetarët e të cilave, e para se hyjnë në Republikën e Kosovës, do të u jepet një vizë nga Republika e Kosovës zyrat konsullore, kur të aplikohet nga misioni diplomatik ose siç parashihet me procedurat e tjera të lëshimit të vizave. Aneksi II përfshin 14 vende të tjera, të cilave shtetasit duhet t'u jepet një vizë në pikat kufitare të Republikës së Kosovës. Regjimi e vizave nuk do të aplikohet për qytetarët e vendeve jo të listuara nën këto dy anekse, si dhe për mbajtësit e Dokumenteve të Udhëtimit të Kombeve të Bashkuara.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka caktuar Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme me detyrën e miratimit brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e vendimit, e nevojshme sipas akteve ligjore për zbatimin e tij.

Deri në hyrjen në fuqi të Vendimit Nr. 02/74, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), aplikon një procedurë hyrje / leje sipas të cilit të huajt, me anë të garancive të tyre, do të prezantojë një numër të dokumenteve para se të hyjnë në Kosovë. Miratimi për hyrje do të lëshohet nga Divizioni për të Huajt, viza dhe leja e qëndrimit në DSHAM (Departamenti për Nënshitetësi, Azil dhe Migracion) të MPB-së. Kjo procedurë zbatohet për qytetarët e atyre vendeve që BE-ja aplikon regjimin e vizave, me përjashtim të vendeve që Republika e Kosovës ka arritur marrëveshje dypalëshe për lëvizjen e lirë.

- Në lidhje me azilin, ju lutem ofroni një pasqyrë të situatës, për sa i përket rolit të institucioneve / autoritetet, si dhe përshkruani legjislacionin, politikat dhe situatën aktuale.

Në pajtim me kapitullin 2, neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut është një nga instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejt e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe në rast konflikti, ka përparësi mbi dispozitat e ligjeve dhe të tjera akte të institucioneve publike. Kjo nënkupton se neni 14 i kësaj deklarate, duke përcaktuar të drejtën për të kërkuar azil nga ndjekjet, është parashikuar që të jetë e zbatueshme drejtpërdrejt nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Më tej, në dhjetor 2011, Republika e Kosovës ka miratuar Ligjin e ri mbi azilin nr 04/L-073. Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë dhënien e azilit dhe njohjen e statusit të refugjatit, dhënien e statusit të mbrojtjes shtesë ose të përkohshme për personat që kanë nevojë, si dhe kthimi i tyre në vendin e origjinës, të prejardhjes ose në një vend të tretë. Një numër i akteve nënligjore është hartuar dhe miratuar duke shtrirë në detaje procedurat e azilit, të tilla si: Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2010,

për procedurat dhe standardet për Pranim dhe trajtim fillestar të azil kërkuesve në Kosovë; Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2010 - MPB për të drejtat dhe obligimet e azil kërkuesve; Procedurat standarde të punës (PSP) dhe Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për azil kërkuesit në Drejtorinë e Migracion dhe të Huajt të PK-së.

Është themeluar grupi i punës për harmonizimin e akteve nënligjore të sipër përmendura me Ligjin e ri për Azil Nr. 04/L-073 . Ky grup punues do të vazhdojë të hartojë legjislacionin e mbetur varësisht nga nevoja për zbatimin e këtij ligji.

Sipas nenit 9 të Ligjit për Azil Nr. 04/L-073, Departamenti për Nënshitetesi, Azil dhe Migracion është organi kompetent për të vendosur për dhënien ose refuzimin e azilit, si dhe për largimin e azilkërkuesit nga Kosova. Ky departament përbëhet nga Divizioni i Azilit dhe Qendrës për azilkërkuesit. Ndërkohë, Drejtorisë për të Huajt dhe Migrim të Policisë së Kosovës i është besuar disa detyrat specifike siç do të elaborohen më poshtë:

- a. Divizioni i azilit është përgjegjës për kryerjen e procedurës së azilit si trajtimi i kërkesave për azil, kryerjen e intervistave dhe vendimeve në shkallë të parë. Për më tepër, Qeveria e Kosovës me Vendimin nr 04/70 ka themeluar Komisionin Kombëtar për Refugjatët (KKR) si një trup që trajton kërkesën në shkallën e dytë. Së fundi, shqyrtimi gjyqësor mund të kërkohet nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, lidhur me ligjshmërinë e vendimeve të marra nga KKR-ja;
- b. Qendra për azilkërkuesit është vendi ku azilkërkuesit janë të pranuar dhe akomoduar;
- c. Drejtoria për Migrim dhe të Huajt në kuadër të Policisë së Kosovës, zhvillon procedurën paraprake, duke përfshirë: aplikimin intervistë paraprake, marrjen e shenjave të gishtërinjve dhe fotove. Palët e tjera të përfshira në çështjet e azilit janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe UNHCR-ja.

Baza e të dhënave e integruar për azil kërkuesit do të jetë funksionale në korrik të vitit 2012 dhe do të përmbajë të dhëna të integruara nga të gjitha institucioneve të përfshira në fushën e azilit.

- Ju lutemi ofroni një pasqyrë të migracionit të ligjshëm dhe të parregullt, në aspektin e roleve institucionale, legjislacionin, politikat dhe situatën aktuale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh që instrumentet ndërkombëtare të tilla si: Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollat e saj, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe të Drejtat Politike dhe Protokollat e saj, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e Këshillit të Evropës, janë të gjitha drejtpërdrejt të zbatueshme dhe në rast konflikti kanë përparësi mbi dispozitat e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Për këtë arsye është hartuar legjislacioni në fushën e migracionit në përputhje të plotë me instrumentet e lartpërmendura ndërkombëtare.

Marrëveshjet më të hollësishme në lidhje me rregullat dhe procedurat për të Huajt janë të vendosura nëpërmjet këtyre akteve nënligjore: Udhëzimi Administrativ Nr 02/2010 - MPB për përmbajtjen, formën, dhënien dhe procedurën e anulimit të lejes së qëndrimit; Udhëzimi Administrativ Nr 03/2010-MIA për ndalimin e hyrjes në Republikën e Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr 19/2010-MIA mbi procedurën për lajmërim të vendbanimit dhe qëndrimit; Udhëzimi Administrativ 20/2010 - MPB për formën e dhe përbërjen e regjistrit ABCD për regjistrin e shënimeve dhe regjistrin e mysafirëve.; Udhëzimi Administrativ Nr 22/2010 - MPB për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit për të huajt; Udhëzimi Administrativ 23/2010 - MPB për ruajtjen dhe menaxhimin e shënimeve për të huajt; Udhëzimi Administrativ 31/2010 - MPB për kartat e identitetit për të huajt; Udhëzimi

Administrativ Nr 01/2010 - MPB për themelimin e komisionit të shqyrtimit dhe të komisionit të apelit; Udhëzimi Administrativ 21/2010 - MPB për lëshimin e vizave në pikat e kalimit kufitar.

Pasi që ky ligj ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2012, Qeveria e Kosovës ka ngritur grupin e punës për harmonizimin e aktet nënligjore të vjetra me Ligjin e ri për të Huajt Nr 04 L-069 dhe ka hartuar nën legjislacioni e mbetur që është i nevojshëm për zbatimin e të këtij Ligji.

Ligji për Ri-pranim Nr 03 / L 208 përcakton rregullat dhe procedurat për ri-pranimin e një personi i cili është ose një shtetas i Republikës së Kosovës apo i huaji, i cili nuk i plotëson ose i cili nuk plotëson më tej kushtet për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkues. Për zbatimin e këtij ligji ekziston Udhëzim Administrativ në vijim: Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2011 për zbatimin e Ligjit për ri-pranimin.

Republika e Kosovës ka lidhur në total 16 Marrëveshje të Ri-pranimit me vendet e mëposhtme: Republikën e Shqipërisë, Republikën e Francës, Këshilli Federal Zvicëran, Republikën Federale të Gjermanisë, Mbretërinë e Danimarkës, Republikën e Austrisë, Republikën e Norvegjisë, Republikën e Sllovenisë, vendet e Beneluksit , Republikën Çeke, Republikën e Malit të Zi, Mbretërinë e Suedisë, Republikën e Finlandës dhe Republikën e Hungarisë. Marrëveshjet me Republikën e Kroacisë, Republikën e Bullgarisë dhe Republikën e Maltës, janë finalizuar dhe nënshkrimi i tyre pritet të ndodhë së shpejti, ndërkohë që negociatat janë duke u zhvilluar me Republikën e Estonisë, Republikën e Italisë dhe Republikën e Letonisë. Lidhja e marrëveshjeve të tilla është propozuar me Republikën e Turqisë dhe Republikën e Maqedonisë, për më shumë detaje shih Shtojcën 4.

Ligji për Nënshtetësi Nr. 03/L-034 ndjekur nga Ligji Nr 04/L-05 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03-L-034 për Nënshtetësinë e Kosovës, përcakton rregullat dhe procedurat për blerjen dhe humbjen e Nënshtetësisë së Republikës së Kosovës dhe rregullon çështje të tjera që lidhen me shtetësinë e Republikës së Kosovës. Ekziston një numër i akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji, megjithatë një grup pune është ngritur për të harmonizuar aktet nënligjore të mëparshme dhe ka hartuar pjesën e mbetur të legjislacioni vartës të nevojshëm , siç kërkohet nga Ligji Nr. 04/L-05 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03-L-034 për Nënshtetësinë e Kosovës.

Sa për dokumentet e politikave në lidhje me migracionin, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë e saj Kombëtare për Migracionin 2009-2012 dhe Planin e Veprimit. Kjo strategji synon parandalimin e migracionit të paligjshëm dhe nxitjen e migracionit të ligjshëm. Aktualisht kjo strategji dhe AP-ja janë duke u rishikuar.

Qeveria ka miratuar në maj të vitit 2010 Strategjinë e Rishikuar për ri-integrimin e personave të riatdhesuar që synon ri-integrimin e plotë të kësaj kategorie të qytetarëve, me fokus të veçantë në nevojat e tyre sociale dhe arsimore. Për këtë qëllim, Qeveria ka alokuar 3.170.000,00 euro dhe ka themeluar Bordin ekzekutiv për menaxhimin e këtij fondi dhe koordinimet e tjera dhe strukturat zbatuese.

Departamenti për Nënshtetësi, Azil dhe Migracion (DNAM) është organi kompetent për bërjen e politikave për të monitoruar migracionin legal dhe ilegal. Brenda kërrij departamenti, divizioni për të huajt, vizat dhe lejet e qëndrimit merret me regjistrimin dhe menaxhimin e rasteve lidhur me të huajt. Brenda MPB-së, dy komisione janë themeluar për të trajtuar kërkesat për lejet e qëndrimit në Republikën e Kosovës. Komisioni i shkallës së parë, përkatësisht Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të huajve për qëndrim të përkohshëm dhe të përhershëm, dhe për pezullimin, refuzimin dhe revokimin e lejeve të qëndrimit, është i përbërë nga një zyrtar nga DNAM, një nga Departamenti Ligjor i MPB-së dhe një zyrtar nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj

të Policisë së Kosovës. Kërkesat fillimisht trajtohen nga komisioni i shkallës së parë, ndërkohë që komisioni i shkallës së dytë, përkatësisht Komisionit për të shqyrtuar ankesat e të huajve, merret me ankesat kundër vendimeve të komisionit të shkallës së parë. Ky komision, gjithashtu është i përbërë nga një përfaqësues nga DNAM, një nga MPB-Departamenti Ligjor dhe një përfaqësues nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (Megjithatë jo të njëjtët persona si në komisionin e shkallës së parë). Drejtoria për Migrim dhe të Huaj siguron largimin e të huajit nga Kosova, në bazë të vendimit të gjykatës

Brenda DNAM-së, Divizioni për të kthyerit dhe Ri-pranimi ka të bëjë me kërkesat e ri-pranimit të marra nga shtetet që Republika e Kosovës ka lidhur marrëveshje ri-pranimi dhe në pajtim me Ligjin për Ri-pranimin. Ky divizion ndërmerr masat e duhura procedurale në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj (PK) për kthim (në parim të vendit të tij / saj të origjinës) të emigranti kur i u mohua statusi i azilit.

Në drejtim të parandalimit të emigracionit ilegal Kosova ka zhvilluar një fushatë për ngritjen e vetëdijes së gjerë. Si e tillë, ka pasur tre seri të reklamave të transmetuar që nga nëntori i vitit 2011, për të edukuar njerëzit në këtë temë dhe pasojat e migrimit të paligjshëm. Fletushka dhe broshura, në 5 gjuhë të ndryshme, kanë qenë të shpërndarë nëpër të gjithë Kosovën, përfshirë institucionet publike dhe private dhe zyra komunale për ri-integrim. Përveç kësaj, këto materiale mund të gjenden edhe në zyrat konsullore të së Republikës së Kosovës si në Bruksel, Berlin, Frankfurt, Shtutgart, Bern, Cyrih, Gjenevë, Paris, Vjenë, Stokholm, Londër, Romë, New York. Më tej, fletushka informative janë vendosur në seksionin e Vizave të Ambasadës Zvicerane e cila përfaqëson Austrinë dhe Francën në lëshimin e vizave për kosovarët..

Këtë vit do të ketë pamflete në të gjitha komunat e Kosovës si pjesë e fushatës sensibilizuese për migracionin e paligjshëm. Tre video spote në gjuhët e pakicave që trajtojnë parandalimin e migracionit të paligjshëm janë finalizuar dhe do të transmetohen në mediet publike. Ambasada e Belgjikës është duke konsideruar financimin e transmetimin të spoteve në mediet private.

Në lidhje me luftimin e grupeve kriminale të përfshira në kontrabandimin e emigrantëve, PK-ja, gjatë vitit 2011 ka trajtuar 14 raste të kontrabandimit të emigrantëve, ku 19 persona janë arrestuar dhe janë identifikuar 42 viktima : 7 Kosovarë, 10 Afganë, 14 Turq dhe 11 Palestinezë.

3.8.3. Luftimi i shpëlarjes së parave

- Cilat janë rezultatet e hetimit të krimit për vitit 2011?

Gjatë vitit 2011, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (dhe Task Forca Anti-Korrupsion ka proceduar në total 17 raste të pastrimit të parave duke rezultuar në 6 akuza penale të ngritura kundër të dyshuarve.

Tabela 62. Statistikat e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit 2011

	DHKEK	TFAK
Rastet totale	14	3
Rastet e mbetura nën vëzhgim	4	3
Rastet e dërguara në prokurori me kryesit e ditur	3	0
Rastet e dërguara me raport në prokurori	7	0
Numri i të arrestuarve	1	0
Të dyshuarit kundër të cilëve janë ngritur kallëzime penale	6	0
Konfiskim i pasurisë	€164.000.00	0

Doganat e Kosovës punojnë për parandalimin e pastrimit të parave, duke siguruar se të hollat janë deklaruar në sektorin e hyrjes dhe largimit nga Aeroporti, si dhe në pikat rrugore kufitare të Kosovës. Si të tilla, gjatë vitit 2011 ata kanë zbuluar 30 raste të jo deklarimit të të hollave në pikat kufitare (22 raste në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, 4 raste në vendkalimin kufitar në Merdare, 2 raste në vendkalimin kufitar në Han të Elezit, 1 rasti në vendkalimin kufitar në Kullë dhe 1 rast në pikën kufitare në Vërmicë). Shuma e përgjithshme e parave jo të deklaruar ishte € 782, 794,00. Këto raste janë dorëzuar Policisë së Kosovës për hetime të mëtejshme.

Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF), e themeluar me Ligjin mbi Shpëlarjen të Parave dhe Financimit të Terrorizmit Nr 03 / L -196, vepron në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF) si një institucion qendror i pavarur kombëtar përgjegjës për kërkimin, mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente, shpalosjen e informacionit që ka të bëjë me pastrimin e mundshëm të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjatë vitit 2011, NJIF ka dorëzuar 114 raste apo kërkesa për agjencitë kompetente të zbatimit të ligjit, të tilla si: Policia e Kosovës, Agjencia Kosovare e Inteligjencës, prokurori kompetent, Doganat e Kosovës, Administrata Tatimore Departamenti i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe KFOR-i.

- A është tani Agjencia për menaxhimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara me personel të plotë dhe të trajnuar?

Agjencia për Menaxhimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara (AMPKS) është themeluar me Ligjin mbi Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara Nr 03/L-141. Agjencia është operative, me personel dhe përbëhet nga 17 zyrtar. Sa për trajnime, gjatë vitit 2011 dhe 2012 ka pasur 22 trajnime që stafi i Agjencisë së ka marrë pjesë. Për më shumë detaje mbi temat e trajnimeve ju lutem referojuni listës së mëposhtme. Për më tepër, AMPKS-ja do të përfitojnë nga projekti IPA-së e vitit 2012 i cili synon mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve të kësaj agjencie, si dhe sigurimin e më shumë trajnimeve për stafin e saj.

- a. Konfiskimi i pasurisë", organizuar nga ILECU në Prishtinë;
- b. Konfiskimi i pasurisë ", organizuar nga EULEX-i, Prishtinë;
- c. Teknikat e avancuara të hetimit financiar," organizuar nga Departamenti Amerikan i Thesarit (SHBA.) në Prishtinë;
- d. Përafrimi i Legjislacionit kombëtarë me EU-në, Organizuar nga Projekti i twiningut në Prishtinë;
- e. Ligji i BE-së, zbatimi dhe interpretimi i tij;
- f. Ndihma Ligjore Ndërkombëtare - çështjet penale;
- g. Konfiskimi i pasurisë – standardet e BE-së;
- h. Zyrat e BE-së për kthimin e pasurisë, Organizuar nga TAIEK – Komisioni Evropian në Prishtinë;
- i. Sistemi për menaxhimin e pagave, organizuar nga KIPA Prishtinë;
- j. Karakteristikat kyçe të Ligjit për shërbime civile Nr. 03/L-149 në Republikën e Kosovës;
- k. Komunikimi dhe hartimi i dokumenteve në administratën publike;
- l. Asistenca dhe instrumentet Financiare të BE-së;
- m. Vlerësimi dhe performanca e menaxhimit në institucionet e Shërbimeve Civile;
- n. Rregulloret e Shërbimeve Civile, të dala nga Ligji për Shërbime civile të Republikës së Kosovës;
- o. Planifikimi strategjik dhe menaxhimit;
- p. Moduli i blerjeve, organizuar nga Ministria e Financave, Prishtinë;
- q. Vlerësimi i ndikimit të Rregullatorit;
- r. Certifikim në menaxhimin Publik Financiar;
- s. Moduli i miratimeve – zotimet;
- t. Moduli i të hyrave;
- u. Vlerësimi doganor i mallrave; dhe

v. Moduli i shpenzimeve - certifikimi/miratimi.

- A është planifikuar një ligj që kërkon nga organizatat të raportojnë transaksionet e bazuara në para të gatshme për më shumë se 10,000 Euro?

Çështja e raportimit të transaksioneve me para nga Organizatat e Biznesit është e rregulluar me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit Nr 03 / L -196, Neni 16, i cili përcakton se çdo person ose mallra tregtare të entiteteve ligjore, gjatë marrjes së pagesës me para në dorë në vlerë prej € 10,000 ose më shumë duhet të raportojë atë në NJIF.

Përveç kësaj, Ligji mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr 03/L-222 thekson se çdo Organizatë e Biznesit duhet të raportojë një herë në vit të gjitha blerjet e saj që tejkalojnë prej € 500 në Administratën Tatimore të Kosovës. Ky ligj kërkon që çdo transaksion mbi 500 € është bërë nëpërmjet llogarisë bankare (neni 13).

- Si ka planifikuar Kosova luftën kundër transaksioneve financiare në llogaritë private lidhur me biznesit dhe numrin e madh të entiteteve që bëjnë biznes pa qenë të regjistruar?

Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës është plotësisht operacional dhe monitoron të gjitha transaksionet në para me fokus të veçantë në transaksionet me para të dyshimta. Për më tepër, në prill të vitit të vitit 2012 Administrata Tatimore e Kosovës ka themeluar Njësinë e Hetimeve Tatimore të saj, në mënyrë që të përmirësojë luftën kundër evazionit fiskal. Në mars të vitit të vitit 2012 ATK-ja ka themeluar Njësinë e saj financiar dhe është duke punuar në ngritjen e kapaciteteve të saj. Këto njësi bashkëpunojnë ngushtë me NJIF-in, Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në kuadër të Policisë së Kosovës, Zyrën e Prokurorit dhe Doganat e Kosovës.

- OJQ-të a i përmbushin në mënyrë sistematike detyrimet e tyre të raportimit financiar në ndaj zyrës së regjistrimit të OJQ-ve në Ministrinë e Administratës Publike?

Në mbështetje të nenit 18, të Ligjit për Lirinë e Shoqatave dhe Organizatave Joqeveritare Nr. 04/L-57 çdo OJQ-je që i është dhënë statusi i përfituesit publik duhet të dorëzojë çdo vit një raport vjetor tek organi kompetent në lidhje me operacionet dhe aktivitetet e saj brenda Kosovës. Në total ka 243 OJQ që veprojnë nën status të përfituesit publik në Kosovë dhe 190 prej tyre kanë përmbushur detyrimet financiare të raportimit të tyre për vitin 2011. Kështu ne arrijmë në përfundimin se shumica e OJQ-ve të përmbushin detyrimin e tyre ndaj zyrës së regjistrimit të Ministrisë së Administratës Publike.

- Si ka planifikuar Kosova të rrisë kapacitetin e saj për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet ekonomike?

Një nga trupat kryesore që punojnë në fushën e luftimit të krimeve ekonomike është Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit i cili është i ndarë në këto seksione dhe punëson 113 policë dhe 7 civilë:

- a. Sektori për hetimin e krimeve ekonomike;
- b. Sektori i hetimeve financiare;
- c. Sektori për hetimin e korrupsionit;
- d. Sektori i njësisë regjionale;
- e. Zyra për statistika dhe analizim;

Ekzistojnë trajnimet të vazhdueshme që zhvillohen në mënyrë që të rrisin më tej kapacitetet e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit. Sipas planit të trajnimit për të vitit 2012, 68 policë të Kosovës që punojnë në fushën e krimit ekonomik do të përfitojnë nga 8 trajnime për krime ekonomike.

Në lidhje me rritjen e kapaciteteve të rasteve të ndjekjes penale të krimeve ekonomike, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bashkëpunim me palët e interesuara relevantë është duke planifikuar trajnime të specializuara për prokurorët që kanë të bëjnë me rastet e krimeve ekonomike.

- Si do të forcojë dhe adresoj Kosova në një fazë të hershme të hetimit konfiskimin e pasurisë në rastet e pastrimit të parave dhe krimit ekonomik?

Kodi Penal i Kosovës, Kapitulli VII, dispozitat e konfiskimit të përfitimeve materiale të fituara nga kryerja e veprave penale. Megjithatë, mbulimin që Kodi Penal ka ofruar për konfiskimin e aseteve është konsiderua si i pamjaftueshëm. Si rezultat i kësaj Kosova është në fazën përfundimtare të hartimit të Ligjit për konfiskimin e aseteve të blera përmes një veprave penale. Ky ligj pritet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës në shtator të vitit 2012. Nga ana tjetër, Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Nr. 03 / L -196), neni 22 i përshkruan qëllimet e ngrirjes së aseteve të mundshme që në thelb është një ndalim i transferimit, konvertimit, dispozicionin ose lëvizjen e fondeve ose pronave të tjera në bazë të, dhe për kohëzgjatjen e vlefshmërisë së, një vendim të një autoriteti gjyqësor apo tjetër kompetent. Sipas këtij ligji, fondet e ngrira ose prona tjetër mbetet pronë e personave ose subjekteve që mbajnë një interes në fondet e caktuara apo pronës tjetër në kohën e ngrirjes, dhe mund të vazhdojnë të administrohen nga institucioni financiar.

- A ka lidhje identifikimi i veprimtarisë së paligjshme me importin dhe eksportin e sasive të madhe parash në aeroportin e Kosovës që janë inkorporuar në punën rutinë të doganave?

Obligimi për të deklaruar shumën monetare prej € 10 000 ose më shumë, kur hyjnë apo lënë Kosova është vendosur në nenin 29 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit Nr 03/L-196. Sipas këtij ligji, është përgjegjësi e zyrtarëve të Doganës të Kosovës për të marrë të gjitha masat e duhura për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit dhe të raportojnë çdo transaksion të dyshimtë ose financimet e dyshimta terroriste për Njësinë e Inteligjencës Financiare. Në rrjedhën e detyrave të tyre zyrtarët doganore do të ndërlidhet me NJJF, prokurorët, policinë, Administrata Tatimore dhe organet e tjera relevante.

Kur një person dështon të deklarojë shumën monetare prej € 10.000 apo më shumë, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit Nr 03/L-196, ai / ajo do t'i nënshtrohet një gjobë prej 25 për qind të shumës totale në posedim të tij/saj.

Gjatë vitit 2011, Dogana e Kosovës kanë zbuluar 22 raste të jo deklarimit, sasia totale e parave të padeklaruar ka qenë 125.801.23€ nga Largimi, dhe 212.719.05€ arritjet e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.

Për më tepër, ka pasur disa teste për vlerësimin e rrezikut për çështjen e mos-deklarimit. Kontrollat janë kryer nga zyrtarët e Doganës së Kosovës (DK) në Aeroportin së bashku me Drejtorinë për zbatimin e ligjit të DK-ve, komponent e Doganave e EULEX-it, Policia e Kosovës dhe K9 i Policisë së Kosovës dhe EULEX-it.

Në lidhje me pastrimin e parave, gjatë vitit 2011 personeli i doganave të Kosovës ka marrë pjesë në një trajnim të specializuar i cili ka hulumtuar format e mundshme të pastrimit të parave. pjesëmarrës në këtë trajnim ishin zyrtarët doganorë që punojnë në shtyllën doganore "aeroport" . që nga janari të vitit 2012, dk-ja ka krijuar strukturat e saj hetimore që do të hetojë aktivitetet ilegale të lidhura me importin dhe eksportin e shumës së tepruar të parave.

- Si do të e shëroj Kosova mungesën e përvojës dhe specializimit të prokurorëve dhe gjykatësve në pastrimit të parave?

Në mbështetje të nenit 3 të Ligjit mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës është organi kompetent për të trajtuar raste të pastrimit të parave.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës do të emërojë prokurorë të veçantë në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Këshilli Prokurorial i Kosovës ka planifikuar trajnime të mëtejshme për këtë çështje, që do të organizohet në bashkëpunim të ngushtë me NJIF, ATK-ja, Anti-Korrupsionit, ekspertët e financave, dhe oficerë të policisë pjesë e Task-Forcës Anti Korrupsion e Prokurorisë Speciale. Këto trajnime janë zbatuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me partnerët tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Që nga 2006 ka pasur 19 trajnime të zbatuara nga IGJK-ja me module të caktuara në luftën kundër pastrimit të parave. Për më tepër, IGJK do të vazhdojë të bashkëpunojnë jo vetëm me KPK-në dhe KGJK-në, por edhe vendet e rajonit në mënyrë që të hartojnë dhe zbatojnë programe më të avancuar në pastrimin e parave.

3.8.4. Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe aktivitetet tjera kriminale, duke përfshirë terrorizmin

- Ju lutem jepni një përmbledhje të strategjive , politikat, legjislacionin, si dhe autoritetet dhe institucionet relevante të përfshira (burimet, fushëveprimi, detyrat, bashkëpunimi dhe koordinimi).

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar kuadrin e nevojshëm ligjor dhe strategjik në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar duke përfshirë terrorizmin. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli I, neni 7 thekson se një nga parimet kryesore të rendit kushtetues në vend, është parimi i sundimit të ligjit. Janë, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe ligjet e tjera që i referohen krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera kriminale në më shumë hollësi. Neni 274 i Kodit Penal përcakton format kryesore dhe ndëshkimet për pjesëmarrje në një grup të organizuar kriminal, si dhe kryerjen e një krimi të rëndë si pjesë e grupit të organizuar kriminal, ndërsa nenet 109-113 të këtij Kodi siguron përkufizimin e terrorizmit , format dhe mjetet të saj si dhe dënimet për aktivitet të tillë kriminale.

Neni 213 i Kodit të Procedurës Penale parashikon ndalimin e arrestit të përkohshëm dhe paraburgimit kur një person është i dyshuar për terrorizëm ose krim të organizuar, ndërsa neni 257 i këtij Kodi përcakton procedurën për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit në mbështetje të terrorizmit ose i krimit të organizuar. Kosova ka miratuar Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në shtator të vitit 2010. Ky Ligj përcakton masat, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për më shumë informacion mbi kornizën ligjor të Republikës së Kosovës për luftimin e krimit të organizuar dhe aktivitete të tjera kriminale, duke përfshirë terrorizmin ju lutem referojuni listës poshtë.

Korniza ligjore kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera kriminale, duke përfshirë terrorizmin:

- a. Kushtetuta e republikës së Kosovës;
- b. Kodi Penal i Kosovës;
- c. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës;
- d. Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit Nr. 03/L- 196;
- e. Ligji për mbrojtjen e Dëshmitarëve Nr. 04/L-015;
- f. Ligji për Zyrën e Prokurorisë Speciale Nr. 03/L-052;
- g. Ligji për parandalimit dhe luftimin e krimeve kibernetike Nr. 03/L -16;
- h. Ligji për Deklarimi, Origjinën dhe Kontrollin e Pasurisë Nr. 03/L-15;

- i. Ligji për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale Nr. 04/L-03;
- j. Ligji për mbrojtjen e informatorit Nr. 04/L-04;
- k. Ligji për Kontrollimin dhe mbikëqyrjen e kufijve shtetërore Nr. 04/L-072;
- l. Ligji për Policinë Nr. 04/L-076;
- m. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale Nr. 03/L -19;
- n. Ligji për agjencinë e Kosovës për Inteligjencë Nr. 03/L-063;
- o. Ligji kundër korrupsionit Nr. 2004/34;
- p. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit Nr. 04/L-051;
- q. Ligji për prokurorinë e shtetit Nr. 03/L-22;
- r. Ligji për Gjykatat Nr. 03/L-19;
- s. Ligji penal për të mitur i Kosovës;
- t. Ligji për Doganat dhe kodin e akcizës së Kosovës Nr. 03/L-109;
- u. Ligji për narkotik, substanca psikoterapie dhe prekursorë Nr. 02/L-12;
- v. Ligji për Menaxhimin dhe Konfiskimin e Pasurisë nr. 03/L-141;
- w. Ligji për klasifikimin e informacionit dhe siguri Nr. 03/L -17;
- x. Ligji për mbrojtjen e të dhënave Personale nr. 03/L - 172;
- y. Draft ligji për përgjim ligjor;

Sa për strategjitë dhe politikat relevante, Kosova ka miratuar dokumentet e nevojshme strategjike për luftimin e krimit të organizuar dhe terrorizmit. Ju lutem referojuni listës së mëposhtme për dokumentet strategjike dhe të politikave në fushën e luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar.

- a. Strategjia e Sigurisë kombëtare (2011);
- b. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës kundër Krimit të Organizuar 2009-2012;
- c. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës dhe Plani i Veprimit kundër Terrorizmit 2009-2012;
- d. Strategjia Kombëtare Anti Drogë dhe Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës 2009-2012;
- e. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit 2009-2012;
- f. Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufijve dhe plani i veprimit;
- g. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Migracionin dhe plani i veprimit 2009-2012;
- h. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore 2011-2014;
- i. Policia e udhëhequr nga inteligjenca;
- j. Sistemi i integruar i menaxhimit të emergjencave;
- k. Plani Kombëtar i reagimit;
- l. Programi kombëtar i aviacionit civil i Republikës së Kosovës.

Çdo Strategji e miratuar e ka koordinatoren e vet Kombëtar mandati i të cilit është që të koordinojë, monitorojë dhe raportojë zbatimin e politikave, aktivitetet dhe veprimet e parapara me strategjinë përkatëse. Kështu, Qeveria e Kosovës ka emëruar institucionet e mëposhtme:

- a. Koordinatori Kombëtar kundër krimit të organizuar;
- b. Koordinatori Kombëtar kundër Terrorizmit;
- c. Koordinatori Kombëtar kundër trafikimit me qeniet njerëzore;
- d. Koordinatori Kombëtar anti drogë;
- e. Koordinatori Kombëtar Menaxhimin e integruar të kufijve;
- f. Koordinatori Kombëtar për migracion;
- g. Koordinatori Kombëtar i planit kombëtar për reagim në raste emergjente;
- h. Agjencioni Kosovar i Inteligjencës (AKI);
- i. Policia e Kosovës;

- j. Qendra e Inteligjencës Financiare;
- k. Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK);
- l. Doganat e Kosovës;
- m. Zyrat e Prokurorisë Speciale dhe Gjykatat.

Përveç kësaj, secili nga këto organe dhe institucione luan një rol të veçantë në luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar:

- a. Sekretaritetë e Koordinatorëve të strategjive kombëtare - janë organe roli i të cilëve është që të mbledhë të gjitha informacionet dhe të dhënat nga institucionet e tjera në mënyrë që të analizojë dhe vlerësojë informacione të tilla dhe përgatitjen e raporteve analitike për koordinatorët Kombëtare;
- b. Ministria e Punëve të Brendshme - harton politika për parandalimin, mbrojtjen, gjurmimin dhe reagimin ndaj aktivitetëve të krimit të organizuar duke përfshirë terrorizmin;
- c. Këshilli i Sigurisë së Kosovës - është organi që analizon, vlerëson dhe rekomandon politika për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar duke përfshirë terrorizmin, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d. Agjensionit Kosovar për Inteligjencë - është organ që mbledh dhe përcjell informacion në lidhje me kërcënimet e aktivitetëve terroriste kundër sigurisë së Kosovës
- e. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës - mekanizëm i saj organizativ ndihmon në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar duke përfshirë edhe terrorizmin;
- f. Ministria e Ekonomisë dhe Financave - nëpërmjet, të Doganave Njesisë së Inteligjencës Financiare dhe Administratës Tatimore ndihmon për të parandaluar lëvizjen ndërkuftare të mallrave dhe materialeve që kanë për qëllim aktivite terroriste dhe ndihmon në identifikimin, raportimin dhe bllokimin e aktivitetëve kriminale financiare si dhe aktivite terroriste;
- g. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - përmes mekanizmit të pushtetit vendor ndihmon në identifikimin e elementeve që mund të çojnë në aktivite kriminale dhe terroriste dhe për të marrë pjesë aktive në parandalimin dhe përgatitjen ose reagimin ndaj aktivitetëve terroriste;
- h. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - luan një rol të rëndësishëm në parandalimin e krimit dhe terrorizmit nëpërmjet edukimit, kurrikulave të bazuara në shkollë, qasje ndër- programore dhe aktivitetëve të ndryshme jashtë programit;
- i. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - përmes programeve për parandalimin e terrorizmit ofron trajnime dhe aktivite ndërgjegjësuese për OJQ dhe grupe joformale;
- j. Qendra e Situatave - shërben si qendër operative për mbledhjen e informacionit, analizave bazë dhe mbështetje për menaxhimin e krizës;
- k. Prokuroritë dhe Gjykatat, janë institucionet përgjegjëse për ndjekjen penale të terroristëve dhe kryesve të krimit të organizuar, të ndëshkimit të tyre adekuat, konfiskimin e pronës dhe pasurive të fituara nëpërmjet veprimtarive kriminale dhe terroriste;

- Ju lutemi ofroni një pasqyrë të situatës lidhur me trafikimin e drogës dhe trafikimin e qenieve njerëzore, sidomos në lidhje me burimet, bashkëpunimin dhe koordinimin, duke përfshi vendkalimet kufitare. Përqendrohuni tek parandalimi, prokuroria dhe, në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore, mbrojtjen e viktimave.

Në vitin 2009, Kosova ka miratuar Strategjinë e saj Kombëtare kundër Drogës 2009-2012. Qëllimet kryesore të kësaj strategjie janë reduktimi i kërkesës dhe minimizimi i dëmit të konsumimit të drogës, reduktimi i ofertës së drogës dhe furnizimit dhe rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet agjencive që punojnë në luftën kundër drogës. Kjo strategji përfshin shumë palë të tillë si: Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës, Doganat e Kosovës, prokurorët, gjykatat, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë,

Ministrinë e Integrimit Evropian, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve , OJQ të ndryshme dhe palët e tjera.

Gjatë vitit 2011, Dogana e Kosovës ka bashkëpunuar ngushtë me Policinë e Kosovës / Drejtorinë për Hetimin e Trafikimit të drogës. Sektorin e Inteligjencës dhe sektorin Anti-kontrabandë të Doganës së Kosovës (50 Zyrtar doganor) janë të pajisur me pajisje të posaçme për kontrollin e automjeteve, duke përfshirë Fibro SCOPES, busters dhe skaner me rreze X.

Gjatë vitit 2011, DK-ja dhe PK-ja kanë organizuar 25 operacione të përbashkëta kundër trafikimit të drogës ndërkohë DK-ja u ka ofruar ndihmë për Policinë e Kosovës në 20 raste, 3 prej të cilëve kishte rezultuar në 14.86 kg drogë të konfiskuar. Për më tepër, DK-ja ka zbuluar 7 raste të trafikimit të drogës dhe konfiskoi 58.74 kg drogë (marihuanë, heroin dhe kokainë).

Nga janari deri në maj 2012, 20 operacione të përbashkëta kundër trafikimit të drogës kanë ndodhur. Këto operacione kanë rezultuar në 4 raste të trafikimit të drogës dhe 21.048 kg drogë të konfiskuar. Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të drogës (PK) përbëhet nga 85 zyrtarë, duke punuar në ekupe të ndryshme duke përfshirë parandalimin dhe Njësinë për Hetime. Kjo Drejtori është mbështetur nga departamentet tjera brenda PK si dhe nga agjenci të tjera (dogana, Agjensioni Kosovar për Inteligjencë, Inspektorët shëndetësor, Agjensioni i Kosovës për Produkte Medicinale etj). Është përgjegjësia e kësaj drejtorie për të kryer hetime lidhur me drogën.

Për të dhënat statistikore të vitit 2012 në lidhje me rastet e trafikimit të drogës dhe të dyshuarit ju lutem referohuni tabelës së më poshtme.

Tabela 63. Rastet e trafikimit të drogës dhe të dyshuarve për vitin 2012

2012	Raste	Të dyshuarit	Arrestuar	Paraburgosur	Shqip	Serb	Të tjerë	M	Femra	Operacione	Trafikim	Posedim	Vepra të tjera
Janar	37	76	55	41	71	0	5	73	3	14	15	30	0
Shkurt.	36	55	45	29	51	2	1	55	0	12	14	27	0
Mars	63	110	92	61	94	1	15	106	4	28	20	55	2
Prill	39	60	47	26	53	5	2	60	0	6	7	22	0
Total	175	301	239	156	269	8	23	284	7	60	56	139	2

Tabela 64. Llojet e drogave të konfiskuara gjatë vitit 2012

2012	Heroin	Marihuanë	Kokainë	Fara të Kanabisit	Bimë të Kanabisit	Ekstazë	Tjera	Armë	Para	Makina
Janar	23221.28	10287.74	0.4	1128		20	109	5	19,405 €	3
Shkurt	7111.4	27815.6	3013	228	6	60		1	75 €	3
Mars	687.1	82956	73	4607	32	1	131 bimë PS	4	2,450 €	
Prill	18363	20554	0	311	0	0	0	11	27,505 €	4
Total	49kg & 383g	141kg 613g	3kg 86.4g	6274	38	81		21	49,435 €	10

Sa i përket bashkëpunimit ndërkufitar, ka pasur një bashkëpunim të frytshëm me Republikën e Shqipërisë dhe Maqedonisë në raste të gjetjes të trafikimit të drogës. Shkëmbimi i informacionit me Republikën e Shqipërisë ka rezultuar me konfiskimin e tipit drogës heroinë 18.363 kg dhe arrestimin e 3 të dyshuarve në shkurt të vitit 2012